







Universiteti  
European i  
Tiranës

DSSH/ASD  
**DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE III / 2016**

albanian studies days / journées d'études albanais

EDICIONI III

UET / 29-30 Prill 2016

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference

**"ALBANIA AS A CASE STUDY: ECONOMY, POLITICS, SOCIAL  
DEVELOPMENT, AND FUTURE PERSPECTIVE"**

PROCEEDINGS



UET - PROGRAMI I MADH KËRKIMOR / SHQIPËRIA INOVATIVE 2015-2020

PK / **LIGJI MIDIS EFICENSËS DHE DREJTËSISË**

Universiteti European i Tiranës

Tiranë, dhjetor 2016



Titulli i librit: **Albania as a case study: Economy, politics, social development, and future perspective/**

**Projekti Kërkimor: Ligji midis eficensës dhe drejtësisë. Proceedings.**

**International Scientific Conference. Ditët e Studimeve Shqiptare III/ 2016. Albanian studies days /  
Journées d'études albanais.**

Autori: Universiteti Europian i Tiranës

Art grafik: Besnik **FRASHNI**

Libri është pjesë e kolanës "ACTA SCIENTIARUM".

---

© 2016 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar

"Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

[uetpress@uet.edu.al](mailto:uetpress@uet.edu.al)

[www.uet.edu.al/uetpress](http://www.uet.edu.al/uetpress)

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-190-97-0

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare

"UET Press" është pjesë e

Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, dhjetor 2016

DSSH/ASD  
**DITËT E STUDIMEVE SHQIPTARE III / 2016**  
albanian studies days / journées d'études albanais

EDICIONI III

UET / 29-30 Prill 2016

Konferencë ndërkombëtare shkencore / International scientific conference

**"ALBANIA AS A CASE STUDY: ECONOMY, POLITICS, SOCIAL  
DEVELOPMENT, AND FUTURE PERSPECTIVE"**

PROCEEDINGS



UET - PROGRAMI I MADH KËRKIMOR / SHQIPËRIA INOVATIVE 2015-2020

PK / **LIGJI MIDIS EFICENSËS DHE DREJTËSISË**

Universiteti European i Tiranës



## DSSH / ASD

### Fillimi i një tradite për shkencat humane në Shqipëri



**Prof. Dr. Adrian Civici**  
Presidenti i UET

**D**itët e studimeve shqiptare është një logo e re që UET krijon për të ndërtuar një ansambël të madh aktivitetesh me karakter shkencor, debatesh dhe idesh në lidhje me prurjet më të mira të studimeve shqiptare në vit.

Tani që po i afrohemi dekadës së parë të jetës së tij UET ka grumbulluar një përvojë të çmuar në kërkimin shkencor, në hapjen dhe mbajtjen gjallë të debatit në Shqipëri në lidhje me ato tema, subjekte e realitete që kanë nevojë të shqyrtohen dhe studiohen shkencërisht në interes të shoqërisë dhe të publikut. Pikërisht kjo është arsyeja përse ne e kemi quajtur pikërisht kështu, Ditët e Studimeve Shqiptare, tërësinë e aktiviteteve, konferencave, debateve, tryezave, ekspozitave, promovimit të librave, kolokiumeve, nën një logo të përbashkët.


Ditët e Studimeve Shqiptare do të jetë një aktivitet i përvitshëm që do të zhvillohet çdo fillim maji, gjë që përkon në Shqipëri me fillimin e pranverës dhe me një atmosferë të hareshme në një vend mesdhetar si Shqipëria.

Ditët e Studimeve Shqiptare do të jetë një festival idesh, një panair i paraqitjeve shkencore, një panair i debatit, një vend kontakti i të gjithë studiuesve shqiptarë dhe të huaj, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër kanë subjekt të temave të doktoraturave, të diplomave apo të artikujve shkencorë pikërisht Shqipërinë.

Ky aktivitet i destinohet të gjithë atyre shkencëtarëve, kërkuesve, doktorantëve, studentëve, pedagogëve që kanë nevojë të komunikojnë aktivitetin e tyre shkencor, të ndajnë me të tjerët pikëpamjet dhe idetë e tyre, të promovojnë apo të plotësojnë kërkesat e tyre për kualifikimin shkencor.

Ky aktivitet është gjithashtu një zë i fuqishëm në shoqërinë shqiptare për të drejtuar sytë nga universiteti, nga korporata e profesionistëve dhe të shkencës dhe të kërkimit, të cilët mund të ishin të dobishëm për vendimarrësit, për biznesin, për aktorët shoqërorë, për partnerët ndërkombëtare në lidhje me atë se çfarë realitetesh, perspektivash, prognozash, ka për shoqërinë shqiptare, cila është origjina e fenomeneve e atyre që sot ngjasin dhe si mundet që shkenca të bëhet e dobishme për shoqërinë.

Për të gjitha këto arsye ne kemi konceptuar dhe për herë të parë do të venë në jetë Ditët e Studimeve Shqiptare këtë vit, duke shpresuar që idesë sonë do t'i bashkëngjiten më shumë aktorë, partnerë, individë në këtë festival të shkencëtarëve shqiptarë të cilët në një farë mënyre merren me apo kanë në fokusin e studimeve të tyre, studimet shqiptare.



# DSSH / ASD

## Udhërrëfyes i shkurtër i Ditëve të Studimeve Shqiptare

**PSE DSSH:** Ditët e studimeve shqiptare është një tërësi konferencash shkencore ndërkombëtare të ndërtuara me sistemin e “peer review” për të debatuar sipas fushave të ndryshme në lidhje me problematikën e shoqërisë shqiptare, të ekonomisë, të institucioneve juridike, debateve historike, mediave, institucioneve politike, politikave publike apo të zhvillimit të edukimit dhe arsimit, impakteve në zhvillimin shqiptar dhe politikave publike.

### PJESËMARRËSIT:

- Studiuesve të huaj të cilët kanë objekt dhe fokus të studimeve të tyre ose punimeve të tyre doktorale Shqipërinë.
- Pedagogëve shqiptarë të cilët punojnë në universitetet perëndimore prej vitesh pas viteve '90 ose më parë, dhe që kanë e vazhdojnë të kenë Shqipërinë si objekt të tyre të studimeve.
- Doktorantëve të huaj që kanë një temë të tyre për Shqipërinë
- Doktorantëve shqiptarë të cilët ndodhen në universitetet perëndimore, që kanë për temë studimi një temë që lidhet me Shqipërinë apo me rajonin.
- Doktorantëve të UET të cilët kanë nevojë të takojnë komunitetin shkencor përkatës.
- DSSH është veprimtaria kryesore shkencore e tetë departamenteve të UET, e trupës së saj akademike dhe studentëve më të shkëlqyer të nivelit master shkencor.

**KOHA:** Aktiviteti do të organizohet çdo fillim muaji maj dhe do të jetë i ndarë në 10 konferenca sipas problematikës dhe departamenteve të cilat i kanë miratuar komunitetet shkencore të konferencës. *(shih programin bashkëngjitur)*

**KALENDARI I AKTIVITETEVE:** Aktiviteti do të përmbajë gjithashtu një numër aktiviteteve të tjera (shih programin jashtë konferencës), pikërisht me elementë që përbëjnë jetën shkencore dhe produktin shkencor siç janë: promovimi i librave dhe debati për to, dokumentarë, ekspozita fotografish apo dokumentarë të cilët ilustrojnë problematikën e studimeve shqiptare.

Mirë se vini në Ditët e Studimeve Shqiptare!





# PËRMBAJTJA

---

**Ndërmjetësimi në Shqipëri si një mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, 1**  
*Evelina Çela*

**Grupimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjet e përbashkëta tregtare: një mundësi më shumë në fuqizimin e tyre ekonomik, 5**  
*Edi Spaho*

**Zhvillimi i të drejtës së sigurimeve në Dhqipëri, 11**  
*Heralda Jahollari*

**Regjimi pasuror martesor me kontratë. Kontrata paramartesorë, 16**  
*Eugena Bisha*

**Instituti i përfaqësimit në fushën e së drejtës civile, 21**  
*Sevdai Morina & Burim Kryeziu*

**Kontrata e Agjencisë në Kodin Civil Shqiptar, 28**  
*Endira Bushati*

**Liria kontraktore: Si duhet të orientohet legjislacioni shqiptar?, 33**  
*Brikena Mile*

**Praktika gjyqësore mbi mosmarrëveshjet e punës me karakter ndërkombëtar, 39**  
*Blerta Aliu*

**Regjimi i ri i pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare pas ndryshimeve të fundit ligjore të ligjit nr. 9901. Aplikimi i kësaj dispozite në procedimet gjyqësore dhe risia në fushën e të drejtës private, 43**  
*Marsidi Gupi*

**Praktika gjyqësore shqiptare dhe problematikat e mosmarrëveshjeve në fitimin e pronësisë me kontratë, 48**  
*Ardvin Kraja*

**E drejta e pronës në fokusin e procesit të legalizimeve, si një mënyrë e fitimit të pronësisë mbi sendet e paluajtshme, 54**  
*Orgent Nazaj*

**Non-pecuniary damages; compensation and value of the beneficiary subjects. A comparison with the decisions of the Italian Supreme Court of Cassation, 62**  
*Hemion Braho*

**Barazia gjinore në punë në Shqipëri. Diskriminimi gjinor, 68**  
*Alma Hoti*

**Raporti i juridiksionit midis gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare, 76**  
*Arta Mehmeti*

**E drejta për një proces të rregullt ligjor, 80**  
*Erjona Ramaj*

**Shqipëria, Stalini, Hrushovi, thyerja e marrëdhënieve dhe ritakimi diplomatik në vitin 1990, 87**  
*Juljana Krisafi*

**Raporti i juridiksionit midis gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare, 91**  
*Arta Mehmeti*



# NDËRMJETËSIMI NË SHQIPËRI SI NJË MËNYRË ALTERNATIVE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

---

**PHD EVELINA ÇELA**

UET, Fakulteti Juridik, E drejtë private

evelina.cela@uet.edu.al

---

## ABSTRAKT

Shtetet e zhvilluara në botë sot, kanë arritur evolucion për sa i përket mënyrave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (alternative dispute resolution, ADR), pra mënyrave jo gjyqësore me qëllim uljen e ngarkesës së gjykatave të zakonshme të tilla si nogociatat, ndërmjetësimi, arbitrazhi, pajtimi. Përpullariteti i rritjes së efektivitetit të mënyrave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në veçanti ndërmjetësimi, lidhet me disa faktorë të tillë si: ngarkesa shumë e madhe e gjykatave tradicionale, kostot relativisht të ulta në krahasim me procedurën gjyqësore, natyra konfidenciale e procedurave si dhe dëshira e palëve në konfliktit të kenë kontroll në zgjedhjen e personave që do të ndihmojnë për zgjidhjen e konfliktit. Kështu edhe në vëndin tonë gjithnjë e më tepër shihet rritja e kërkesave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyra të tjera krahas procedurave gjyqësore.

**Fjalë kyç:** *ndërmjetësim, mënyrë alternative, negociata, pajtim*

---

## Hyrje

Interesi në rritje për ndërmjetësim në nivel ndërkombëtar është pasqyruar në organizata të shumta ndërkombëtare dhe regionale, në legjislacione e protokolle.

Mund të përmendim Dhomenë Ndërkombëtare të Tregtisë “ICC” e cila ofron rregulla dhe procedura për zgjidhjen e konflikteve private tregtare me ndërmjetësim. Sistemi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i Organizatës Botërore të Tregtisë ofron ndërmjetësimin si një metodë të zgjidhjes së konflikteve tregtare midis anëtarëve<sup>1</sup>.

Një shembull kryesor të legjislacionit mund të përmendim Ligjin Model për Pajtimin Ndërkombëtar Tregtar që është krijuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të drejtën ndërkombëtare tregtare “UNCITRAL”.<sup>2</sup> Ligji Model, i cili është rekomanduar nga Kombet e Bashkuara për miratim nga shtetet anëtare në vitin 2002, sygjeron një konsensus ndërkombëtar mbi vlerën e ndërmjetësimit si metodë kryesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Sot, ngarkesa shumë e madhe e gjykatave, shpenzimet relativisht të ulta në krahasim me procedurën gjyqësore<sup>3</sup>, natyra konfidenciale e vetë procedurave dhe dëshira e palëve në konflikt të kenë kontroll mbi procesin, solli pikërisht kërkesat gjithnjë e në rritje të përdorimit të kësaj procedure.

Sipas autores Jacqueline Nolan, studiuesit dhe praktikuesit e njohin potencialin e madh të kësaj procedure si procedure konfidenciale duke kursyer koston dhe kohën, një proces marrëdhëniesh që u jep palëve kontroll mbi çështjen dhe shpesh rezultatet janë më të kënaqshme se sa ato të një procesi gjyqësor.<sup>4</sup>

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka për qëllim analizimin e karakteristikave të procedurës së ndërmjetësimit si një prej mënyrave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Nëpërmjet nxjerrjes në pah të këtyre karakteristikave na çon në objektivën e studimit e cila është: analiza e risive që ka sjell legjislacioni aktual mbi ndërmjetësimin.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Një nga *pyetjet kryesore* të kërkimit është identifikimi i karakteristikave të procedurës së ndërmjetësimit dhe si reflektojnë ato në efektivitetin e kësaj procedure. Pyetja pasuese është se sa efektiv është ky proces në zgjidhjen e konflikteve mes palëve në krahasim me procedurën gjyqësore.

*Hipoteza e punimit* – Domosdoshmëria e përdorimit të procedurës së ndërmjetësimit në ditët e sotme lidhet me një numër faktorësh, ndër to ngarkesa shumë e madhe e gjykatave tradicionale, koston relativisht të ulta në krahasim me procedurën gjyqësore...etj., për këtë, punimi synon të vërtetoj këtë domosdoshmëri gjithnjë e në rritje si një mënyrë efikase për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me rezultate të kënaqshme për palët në konflikt.

*Metodologjia* e ndjekur në këtë punim shkencor është identifikuese-analizuese-krahasuese.

## Analizë, interpretim të dhënash

Domosdoshmëria kryesore për krijimin e ligjit për ndërmjetësimin erdhi menjëherë pas miratimit të Direktivës 2008/52/EC, 21 Maj e vitit 2011 së Këshillit dhe Parlamentit Europian “Për aspekte të caktuara të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare”, qëllimi i së cilës ishte lehtësimi dhe promovimi i qasjes në zgjidhjen miqësore/alternative të mosmarrëveshjeve duke inkurajuar përdorimin e ndërmjetësimit si dhe duke siguruar një marrëdhënie të ekuilibruar ndërmjet ndërmjetësimit dhe procesit gjyqësor.

Sot, ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve i cili plotësoi ligjin e mëparshëm (të vitit 2003 nr. 9090) ushtrohet në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, si dhe ligjin nr. 81/2013 Për disa shtesa në ligjin nr. 10385, dt. 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Neni 1 i ligjit nr. 10385 ndërmjetësimin e përcakton si është një veprimtari jashtëgjyqësore me anë të së cilës palët kërkojnë të zgjidhin konfliktin e tyre me anë të një personi të tretë të pavarur (ndërmjetësi) për arritjen e një zgjidhje që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

<sup>1</sup> Shiko, World Trade Organization Understanding on Rules and Procedures Governing the Settlement of Disputes (DSU), Art. 5.1. [http://www.wto.org/english/tratop\\_e/dispu\\_e/dsu\\_e.htm](http://www.wto.org/english/tratop_e/dispu_e/dsu_e.htm)

<sup>2</sup> [http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral\\_texts/arbitration/2002Model\\_conciliation.html](http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/2002Model_conciliation.html)

<sup>3</sup> Boulle Laurence, Mediation: Principles, Processes, Practice, Australia. Butterworths 2005, P. 134.

<sup>4</sup> Nolan-Haley Jacqueline, Teaching comparative perspectives in mediation: Some preliminary reflections // St. John’s Law Review. Winter 2007, Vol. 81 Issue 1.

Pra, ndërmjetësimi është një proces vullnetar ku një person apo një grup personash mbështetin palët në përpjekjen e tyre për arritjen e një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes së palëve. Sipas nenit 6 të Ligjit Nr. 10385, ndërmjetësimi është një proces edukimi, i dyanshëm i cili ka si qëllim të parandalojë zgjidhjet gjyqësorë të mosmarrëveshjeve dhe të zbusë pasojat sociale të tyre, të harmonizojë interesat e palëve, duke krijuar mirëkuptim ndërmjet tyre.

Rëndësia e ndërmjetësimit, parë në këndvështrimin e karakteristikave të procedurës, buron në faktin se bazohet në parimin e barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, respektimin e fleksibilitetit të transparencës së procedurave, neutralitetit, vullnetit të palëve në proces dhe së fundmi, vendimi përfundimtar ka natyrë këshillimore se sa detyruese për palët<sup>5</sup>. Kjo tregon jo vetëm një angazhim për përdorimin e ndërmjetësimit, por edhe në të praktikuarit të kësaj procedure me standarde të larta të integritetit profesional.

Nga ana tjetër edhe pse procedura e ndërmjetësimit është më pak formale se për shembull procedura e arbitrazhit, gjithsesi marrëveshja e pajtimit është e detyrueshme për palët. Legjislati tonë këtë moment e rregullon në këtë mënyrë: “Kur palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me ndërmjetësit, nënshkruajnë marrëveshjen<sup>6</sup> përkatëse, në kuptim dhe në zbatim të kushteve, rasteve dhe të procedurave të parashikuara në këtë ligj. Kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit” (neni 22, pika 1, ligji nr. 10385).

*Qëllimi i procedurës së ndërmjetësimit* është që të sjell palët që janë në konflikt në një marrëveshje. Pra, ideja kryesore është zgjidhja jo gjyqësore e mosmarrëveshjeve. Prej shumë vitesh mbarë bota, me evolucionin dhe perfeksionimin e sistemit gjyqësor, drejtohet gjithmonë e më shumë drejt gjykatave për të zgjidhur çështjet dhe duke krijuar kështu mënyrat “alternative” të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Kështu, përgjithësisht, shtetet perëndimore të Bashkimit Europian kanë zhvilluar politika me synim uljen e ngarkesës së gjykatave dhe përmirësimin të tërthortë dhe si rrjedhojë e kësaj të cilësisë së dhënies së drejtësisë, nëpërmjet ndërmjetësimit apo procedurave të tjera.

*Roli i procedurës së ndërmjetësimit* është që të çojë një ose disa palë në konflikt drejt një zgjidhjeje të mosmarrëveshjes që kanë. Pra ndërmjetësi është detyrimisht një person i tretë në konflikt. Ai duhet të përdor të gjithë mjetet që ka përfituar nga formimi i tij për t’i afruar palët drejt njëra tjetrës me qëllim gjetjen e një kompromisi, tu japë këshilla, sygjerime, të përcjell kërkesat dhe përgjigjet nga njëra palë tek tjetra si dhe ndërhyt që ti pajtoj qëndrimet e kundërta.<sup>7</sup>

Në krahasim me ligjin e vitit 2003, Nr.9090, ligji Nr. 10385 zgjeron llojet e mosmarrëveshjeve që lejohen të zgjidhen me ndërmjetësim ku përveç mosmarrëveshjeve civile, tregtare, familjare dhe në disa raste penale<sup>8</sup>, përfshihen edhe mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës të cilat janë të parashikuara në Kodin e Punës, por specifikohe gjithashtu edhe si çështje që përfshihen brenda fushës së zbatimit të ligjit për ndërmjetësimin<sup>9</sup>. Një risi tjetër e ligjit, parashikohet të zgjidhen me procedurë ndërmjetësimi *për aq sa është e mundur*<sup>10</sup> edhe mosmarrëveshjet në rastet kur vetëm njëra nga palët në konflikt ka vendbanim në Republikën e Shqipërisë.

Përveç kësaj, ligji i jep Ministrisë së Drejtësisë një rol më të gjerë në procesin e ndërmjetësimit, ndër to: kompetenca në lidhje me procesin e liçencimit të ndërmjetësve, në lidhje me caktimin e formës dhe përmbajtjes së Rregjistrimit të ndërmjetësve në bazë të një urdhërese.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” ka dy raste kur iniciohet procedura e ndërmjetësimit: *rasti i parë* është kur personat në konflikt e kërkojnë vet hapjen e procedurës së ndërmjetësimit.

(Për shembull në rastet kur palët në konflikt nuk dëshirojnë ta zgjidhnin çështjen e tyre në një gjykatë të zakonshme, për arsye të shpenzimeve apo kohëzgjatjes së procedurës si dhe në rastet kur tashmë çështja është depozituar në gjykatë. *Rasti tjetër* është kur gjykata është vet iniciatore e dërgimit të çështjes në një procedurë ndërmjetësimi dhe konkretisht në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare, të punës.

Rasti tjetër është kur vet gjykata e kërkon ndërhyrjen e ndërmjetësit. Këtë, gjykata duhet ta bëjë detyrimisht në rastet: “Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkretisht në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës, familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve; në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes; me karakter pasuror me objekt padie deri në 500 mijë lekë, si dhe për paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cënimit të posedimit.

Për sa i përket fuqisë ligjore të ndërmjetësimit, vlen të theksohet se nëse një marrëveshje arrihet, ajo është detyrimisht e zbatueshme. Siç parashikon ligji: “Marrëveshja është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit” si dhe “nëse aktmarrëveshja respekton kushtet e përcaktuara përmben titull ekzekutiv dhe, në këtë rast, ngarkohet shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e tij”. Palët janë të detyruara ta zbatojnë ato menjëherë dhe vullnetarisht, përndryshe për këtë marrëveshje kërkohet lëshimi i urdhrat të ekzekutimit.

<sup>5</sup> Malcolm N. Shaw. International Law. 7th Edition. Cambridge. 2014, F. 738.

<sup>6</sup> Me ligjin e ri marrëveshja e ndërmjetësimit përbën në vetvete një titull ekzekutiv që në momentin e nënshkrimit të saj.

<sup>7</sup> Gruda Zejnullah, E drejta ndërkombëtare publike. Prishtinë 2013, F. 483-485.

<sup>8</sup> Ndërmjetësimi në fushën penale sipas legjislati tonë, zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë.

<sup>9</sup> Mëneri Suela, E drejta e Arbitrazhit dhe e Ndërmjetësimit Ndërkombëtar tregtar. Tiranë 2012, f. 111.

<sup>10</sup> Pika 8, neni 2, Ligji 10385 dt.24.02.2011 Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

## Konkluzione dhe Rekomandime

- Ndërmjetësimi si profesion në Shqipëri është ende në zhvillim; është institucionalizuar së fundmi në kulturat ligjore dhe është relativisht risi në jurisprudencën tonë.
- Pavarësisht këtij fakti, në praktikën gjyqësore shqiptare është vërtetuar se një shumicë e konsideruar e çështjeve civile, si për shembull në fushën familjare, në raste të caktuara të fushës penale është zgjidhur me pajtim.
- Traditat ligjore kombëtare i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme zbatimit të ndërmjetësimit. Kështu, për shembull avokatët duhet të ketë një kuptim të dallimeve dhe nuancave në të drejtën e ndërmjetësimit si dhe praktikë në traditat e shumta ligjore duke qënë se ata janë aktorë të zgjidhjes së konflikteve si në arenën kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare.
- Duhet të kuptojmë gjithashtu se si ligjet dhe institucionet ligjore punojnë me praktikën e ndërmjetësimit në vende të tjera, kjo për arsye se qasjet rregulluese ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin në varësi të sistemeve të common law apo civil law.

## Bibliografia

1. Boule Laurence, *Mediation: Principles, Processes, Practice*, Australia. Butterworths 2005.
2. Dixon Martin, *E drejta ndërkombëtare*. AIIS. Tiranë 2009, F. 365.
3. Gruda Zejnullah, *E drejta ndërkombëtare publike*. Prishtinë 2013. F. 483-485.
4. Mëneri Suela, *E drejta e Arbitrazhit dhe e Ndërmjetësimit Ndërkombëtar tregtar*. Tiranë 2012.
5. Puto Arben, *E drejta ndërkombëtare publike*. Guttenberg, Tiranë, 2010. F. 427.
6. Shaw Malcolm N. *International Law*. 6th Edition. Cambridge. 2008.
7. Shaw Malcolm N. *International Law*. 7th Edition. Cambridge. 2014. F. 738.
8. Steven Friel, Christian Toms, Brown Rudnick LLP, *The European Mediation Directive, Legal and Political Support for Alternative Dispute Resolution in Europe* // *Bloomberg Law Rep*, 2011.
9. Nolan-Haley Jacqueline, *Teaching comparative perspectives in mediation: Some preliminary reflections* // *St. John's Law Review*. Winter 2007, Vol. 81 Issue 1.

### Burime nga Interneti

1. <http://www.ligjet.org/>
2. [http://www.wto.org/english/tratop\\_e/dispu\\_e/dsu\\_e.htm](http://www.wto.org/english/tratop_e/dispu_e/dsu_e.htm)
3. [http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral\\_texts/arbitration/2002Model\\_conciliation.html](http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/2002Model_conciliation.html)

# GRUPIMI I SHOQËRIVE TREGTARE DHE SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA TREGTARE: NJË MUNDËSI MË SHUMË NË FUQIZIMIN E TYRE EKONOMIK

---

**PROF.ASOC.DR. EDI SPAHO**

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik, Departamenti i së Drejtës Private

Email: edispaho@yahoo

---

## ABSTRAKT

Shoqëritë tregtare ushtrojnë veprimtarinë tregtare në funksion të aktivitetit të tyre, me qëllim të rritjes së aktiveve dhe kapitaleve të tyre, duke shtuar kështu mundësinë e ndarjeve të fitimeve më të mëdha për ortakët dhe aksionerët. Në shumë raste, për të realizuar këtë qëllim, shoqëritë tregtare ndërveprojnë me njera tjetrën, nëpërmjet formave të ndryshme kontraktuale, ku ndër më kryesoret janë grupimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjet e ndryshme të përbashkëta tregtare. Këto bëjnë dallim nga bashkimet dhe ndarjet e shoqërive tregtare, ku ndërveprimi i shoqërive tregtare sjell automatikisht prishjen e disa shoqërive dhe vazhdimin e aktivitetit tregtar të disa të tjerave, por gjithashtu ky ndërveprim është i kufizuar vetëm për shoqëritë e kapitalit, dmth, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare. Tek grupimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjet e përbashkëta tregtare, ndërveprimi i tyre nuk sjell prishjen e asnjë prej shoqërive ndërvepruese, por në këtë rast kemi vetëm ndryshim të kontrollit të shoqërive tregtare nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të përqindjes së administratorëve, të anëtarëve të këshillit të administrimit, apo të ndryshimit të kontrollit të përqindjes së votave në asamblenë e përgjithshme. Gjithashtu, duhet theksuar se ky ndërveprim midis shoqërive nuk është kufizuar vetëm për shoqëritë e kapitalit, sic ndodh tek bashkimet dhe ndarjet e shoqërive, por është i lejueshëm për të gjitha llojet e shoqërive tregtare. Gjatë këtij punimi do të trajtohet ndërveprimi midis dy shoqërive tregtare, në marrëdhëniet e krijuara si shoqëri kontrolluese dhe e kontrolluar, ose mëmë dhe bijë, por edhe marrëdhëniet midis shumë shoqërive tregtare midis tyre, ku njëra do të jetë kontrolluese dhe të tjerat do të jenë të kontrolluara, duke krijuar atë që në literaturë do të quhen grupimi holding. Gjithashtu, do të trajtohen dhe sipërmarrjet e ndryshme të përbashkëta tregtare ndërmjet shoqërive tregtare, bazuar në marrëdhënie të ndryshme kontraktuale, si joint venture, konsorciumet dhe shoqëritë e përbashkëta.

**Fjalë kyç:** Shoqëri tregtare, grupimi i shoqërive tregtare, joint venture, konsorcium, shoqëritë e përbashkëta

---

## Hyrje

Shoqëritë tregtare mund të kenë një gamë të gjerë bashkëpunimi. Ky bashkëpunim mund të jetë kontraktual, nëpërmjet ndarjes së pronësisë, ose nëpërmjet ndërveprimit në drejtimin e shoqërive tregtare.<sup>1</sup>Një grup korporatash përbëhet nga një korporatë mëmë si dhe disa filiale që janë tërësisht apo në shumicën e tyre nën pronësinë e korporatës mëmë. Pjesa më e madhe e juridiksioneve e përkufizojnë grupin korporatë në të njëjtën mënyrë, por rezultati funksional i grupimit të kompanive të inkuorporuara, dallon në varësi të ligjit të legjislacionit të vendit përkatës. Korporatat kanë tendencë të krijojnë filiale për krijimin e një linje demarkacioni ndërmjet operimeve të një korporate në marrëdhënie me një tjetër. Korporata mëmë ende ka në pronësi filialin, por për shkak se filiali është i inkuorporuar veç, ka më shumë pavarësi se sa një degë e kompanisë mëmë, i cili ka menaxhimin, operimet si dhe sistemet financiare të veta. Në vendet ku e drejta e korporatave për qëllime detyrimesh, i njeh subjektet e inkuorporuara si individë të ndarë, korporata mëmë dhe filiali janë krejtësisht të mbrojtura ndaj detyrimeve ligjore të tjetrës.

Një grupim korporatash mëmë dhe filiale ka një marrëdhënie të natyrshme mes njera tjetrës pasi korporata mëmë zotëron filiale. Trajtimi i grupit si një subjekt i vetëm autorizohet nga një pjesë e ligjit në vendin ku janë të vendosura operacionet. Ky trajtim mund të autorizohet sipas ligjit për raportimin financiar, taksat, apo për qëllime detyrimesh ligjore. Është e rëndësishme të theksohet se duke i konsideruar subjektet e inkuorporuara veç si një subjekt të vetëm, para së gjithash vë në rrezik arsyet e inkuorporimit të filialeve, kështu që duhet treguar kujdes për të kuptuar implikimet financiare të konsolidimit të korporatave në juridiksione të ndryshme. Në SHBA, Kodi Federal i Taksave u mundëson kompanive që kanë të bëjnë me njëra tjetër në një grup korporatash të paraqesin një taksë të konsoliduar. Konsolidimi e bën korporatën mëmë përgjegjëse për përfshirjen e raporteve financiare të filialeve në një prezantim të përgjithshëm, i cili përfaqëson mënyrën se si transaksionet e ndërlihdura ndikojnë në gjendjen financiare të të gjithë grupit. Për qëllime taksimi dhe raportimi financiar, grupi trajtohet si një subjekt i vetëm, por secila kompani mban statusin e vet ligjor si një subjekt i veçantë në çdo mënyrë tjetër. Ligji shqiptar për shoqëritë tregtare vlerëson se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues.<sup>2</sup>

Gjermania dhe disa vende të tjera në Europë e trajtojnë grupin e korporatave si një subjekt të vetëm si për çështjet ligjore ashtu edhe ato ekonomike. Ndryshe nga SHBA-të, ligji i korporatave nuk u mundëson anëtarëve të një grupi të kenë detyrime të veçuara ligjore në rastet kur financat e tyre mbahen në mënyrë kolektive.

## Filiali

Ndërveprimi i parë dhe më i thjeshti midis dy shoqërive tregtare është marrëdhënia e krijuar ndërmjet shoqërisë kontrolluese dhe e kontrolluar, ose mëmë dhe bijë. Një korporatë apo kompani filial është ajo ku një korporatë tjetër, zakonisht më e madhe, e cila njihet si korporata mëmë, zotëron të gjitha apo një pjesë të aksioneve. Si zotëruesja apo pronarja e filialit, korporata mëmë mund të kontrollojë veprimtaritë e filialit. Kjo marrëveshje ndryshon nga një shkrirje, ku një korporatë blen një kompani tjetër dhe shkrin apo shpërbën strukturën organizative dhe identitetin e kompanisë së blerë. Ligji shqiptar për shoqëritë tregtare parashikon se kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar, dhe ky kontroll quhet grup influencues.<sup>3</sup>

Filialet mund të formohen në mënyra dhe për arsye të ndryshme. Një korporatë mund të krijojë një filial ose duke blerë një interes kontrollues në një kompani ekzistuese ose duke e krijuar vetë kompaninë. Kur një korporatë blen një kompani ekzistuese, formimi i një filiali mund të pëlqehet më shumë se një shkrirje pasi korporata mëmë mund të blejë një interes kontrollues me një investim më të vogël sesa mund të duheshin për një shkrirje. Përveç kësaj, nuk kërkohet as miratimi i aksionerëve të firmës së blerë si në rastin e një shkrirjeje. Kur blihet një kompani, korporata mëmë përcakton nëse njohja e emrit të kompanisë së blerë në treg meriton për ta bërë atë filial apo ta shkrijë me kompaninë mëmë. Një filial përsëri mund të prodhojë mallra ose shërbime që mund të jenë krejt të ndryshme nga ato të prodhuara nga korporata mëmë. Në këtë rast, shkrirja e korporatave nuk do të kishte kuptim. Korporatat që kanë fushëveprim në më shumë se një vend, shpesh e shohin krijimin e filialeve si të dobishëm dhe të nevojshëm. Për shembull, një korporatë multinacionale ose shumëkombëshe mund të krijojë një filial në një vend për të përfituar trajtim preferencial taksash dhe tatimesh, ose një vend mund t'u kërkojë korporatave multinacionale të themelojnë filiale vendase që ato biznese të operojnë aty.<sup>4</sup>

Korporatat po ashtu krijojnë filiale për qëllime të veçanta të kufizimit të përgjegjshmërisë së tyre në marrëdhënie me një biznes të ri me risk. Korporata mëmë dhe filiali mbeten subjekte ligjore të ndara, ndërsa detyrimet e njërës janë të ndara

<sup>1</sup> Janet Dine, *The Governance of Corporate Groups*, Cambridge University Press, 2006, f.39.

<sup>2</sup> Neni 207, pika 1, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

<sup>3</sup> Neni 207, pika 2, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

<sup>4</sup> Janet Dine, *The Governance of Corporate Groups*, Cambridge University Press, 2006, f.41.



nga detyrimet e tjetrës. Megjithatë, nëse një filial bëhet i pasigurtë nga ana financiare, korporata mëmë shpesh paditet nga kreditorët. Në disa shkallë, gjykatat mbajnë përgjegjës korporatën mëmë, megjithëse në përgjithsi ndarja e identiteteve të korporatës i jep korporatës mëmë imunitet për sa i përket përgjegjësisë fiskale për detyrimet e filialit. Kjo është konsoliduar edhe nga çështja *Adams vs. Cape Industries Plc*.<sup>5</sup>

Një prej disavantazheve të marrëdhënies korporatë mëmë-filial është përgjegjësia e tatimit të shumëfishtë. Është krejt tjetër gjë detyra e korporatës mëmë në promovimin e interesit të filialit të korporatës, të veprojë në interes të saj, si dhe të arrijë të mbajë një identitet të ndarë nga korporata. Nëse korporata mëmë nuk arrin t'i përmbushë këto detyrime apo kërkesa, gjykatat e përcaktojnë filialin si thjesht degë biznesi të korporatës mëmë, dhe për qëllime përgjegjshmërie, të dy korporatat do të shihen si një e pandarë. Tatimi i dyfishtë është shmangur në Bashkimin Europian nëpërmjet krijimit të atyre që quhen shoqëritë europiane, të cilat krijohen nëpërmjet rregullores për krijimin e tyre.<sup>6</sup>

## Llogaritë e konsoliduara

Llogaritë e konsoliduara parashikohen nga direktiva e shtatë e Këshillit<sup>7</sup>. Një kompani mëmë dhe të gjitha filialet e saj janë kompani për t'u konsoliduar atëherë kur si kompania mëmë ashtu edhe një apo më shumë filiale janë themeluar si kompani me përgjegjësi të kufizuar në rastet kur kompania mëmë ushtron një ndikim dominues mbi filialin. Kjo direktivë përkufizon rrethanat në të cilat llogaritë e konsoliduara duhet të përgatiten. Çdo kompani mëmë që në mënyrë të ligjshme kontrollon një kompani tjetër, filialin, ka për detyrë të hartojë llogaritë e konsoliduara. Në shumicën e rasteve, kontrolli ligjor merr formën e mbajtjes së shumicës të së drejtave për të votuar. Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian, po ashtu, mund të kërkojnë llogari të konsoliduara për të qenë të përgatitur në raste të tjera kur një kompani mëmë ka në zotërim vetëm një pakicë aksionesh, por ushtron kontroll de facto. Ata mund të parashikojnë edhe përjashtimin nga ky detyrim. Direktiva përcakton metodat e hartimit të llogarive të konsoliduara:

- Llogaritë e konsoliduara përbëjnë llogarinë e balancuar të bilancit, llogarinë e konsoliduar të fitimeve dhe humbjeve si dhe shënimet për këto llogari. Llogaritë e konsoliduara duhet të japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të pasurive, detyrimeve, gjendjes financiare dhe fitimeve dhe humbjeve të kompanive të përfshira, të marra në një e tërë.
- Llogaritë e vlerave të aksioneve. Vlerat e aksioneve në kapitalin e kompanive të përfshira në një konsolidim duhet të jetë si për shoqërinë mëmë, ashtu dhe për shoqëritë bija.
- Llogaritë e konsoliduara duhet të hartohen në të njëjtën datë dhe me të njëjtat metoda si të llogarive vjetore të kompanisë mëmë.

Gjithashtu theksohet se mbi çështje të tilla si metodat e vlerësimit, emrat dhe zyrat e regjistruara të sipërmarrjeve të përfshira në konsolidim, shuma e përgjithshme e disa llojeve të caktuara borxhesh, etj., duhet të jepen informacione të caktuara tek pjesa e shënime. Direktiva po ashtu rregullon përmbajtjen e raportit vjetor të konsoliduar. Kjo po ashtu duhet të përfshijë të paktën një shqyrtim të drejtë të ecurisë së zhvillimit të biznesit si dhe gjendjen e sipërmarrjeve të përfshira në konsolidim e marrë si një e tërë, si dhe tregues të caktuar për secilën prej atyre sipërmarrjeve si, numrin dhe vlerën nominale të aksioneve, etj. Direktiva vendos një sistem auditimi sipas të cilit një kompani që përgatit llogari të konsoliduara, duhet të mundësojë që ato të auditohen nga një apo më shumë persona të autorizuar për auditimin e llogarive sipas ligjit të shtetit anëtar ku bazohet ajo kompani. Personi apo personat përgjegjës për auditimin e llogarive të konsoliduara duhet gjithashtu të verifikojnë që raporti vjetor i konsoliduar përputhet me llogaritë e konsoliduara në të njëjtin vit financiar.

## Shembull grupimi të shoqërive tregtare, grupimi holding

Grupimi holding do të quhet ai grupim i korporatave ku njëra prej tyre është kompania mëmë, ndërsa kompanitë e tjera janë bijat, ose filialet e saj. Si rregull, kompania mëmë jep orientimet tregtare, strategjike dhe operacionale, ndërsa kompanitë bija zhvillojnë në terren veprimtaritë e ndryshme tregtare. Në Shqipëri nuk janë shumë të përhapura rastet e grupimit holding të shoqërive tregtare. Një rast i vetëm që mund të përmendim është ekzistenca për një periudhë kohe të grupimit Vefa Holding, ndërsa në botë ka shembuj pa fund të funksionimit të tyre. Në këtë punim do të trajtojmë më me gjerësi grupimin holding të grupit Safran. Ky është një grup lider ndërkombëtar në teknologjinë e lartë apo high-tech, me tre aktivitete tregtare bazë: hapësirën ajrore, mbrojtjen dhe sigurinë. Duke ushtruar veprimtarinë në të gjithë botën, ky grup ka 62,500 punonjës dhe vetëm në vitin 2012 ka patur shitje në shifrat 13.6 miliardë euro. Përmes kësaj pranije globale ndërton marrëdhënie komerciale dhe industriale me kontraktuesit dhe operatorët lider kryesorë në botë, duke ofruar shërbime lokale të shpejta tek klientët nëpër botë. E përbërë nga disa kompani, Safran zotëron, vetëm ose në partneritet, pozicione lideri europiane apo botërore në tregjet kryesore të saj<sup>8</sup>. Veprimtaritë kryesore që zhvillon grupi Safran janë:

<sup>5</sup> Rene Thomas Wieser, *Liability within Corporate Groups*, Societas, 2013, f.16.

<sup>6</sup> Council Regulation (EC) No 2157/2001 of 8 October 2001 on the Statute for a European company (SE).

<sup>7</sup> Seventh Council Directive 83/349/EEC of 13 June 1983, "On consolidated accounts".

<sup>8</sup> <http://www.safran-group.com/group-0#1>

- a) Motorrët dhe pajisjet ajrore dhe hapësinore. Safran zhvillon, prodhon dhe tregton motorrë, sisteme lëshimi për aereoplanë dhe helikopterë civilë dhe ushtarakë, predha hedhëse, automjete lëshimi dhe satelitë. Ofron gjithashtu një gamë të gjerë sistemesh dhe pajisjesh për aereoplanë dhe helikopterë civilë dhe ushtarakë.
- b) Pajisjet elektronike në fushën e mbrojtjes. Duke operuar në tregjet optronike, elektronike dhe pajisjeve të sigurisë në fushën e mbrojtjes, Safran u ofron forcave të armatosura të sotme një gamë të plotë sistemesh dhe pajisjesh optronike, lundrimi dhe optike për përdorim në ajër, tokë dhe det.
- c) Rol global në zgjidhjet e sigurisë. Safran ofron zgjidhje të përkryera në plotësimin e kërkesave në rritje e sipër mbi sigurinë e individëve të ndryshëm, bizneseve dhe qeverive, bazuar në teknologjitë multibiometrike, kartave smart dhe sigurimin e dokumenteve të identifikimit dhe udhëtimit. Qeverisja e korporatës së grupit Safran drejtohet nga Safran SA, një kompani e regjistruar në Francë me një bord drejtorësh, dhe seli në Paris. Safran është e renditur në NYSE Euronext Paris, dhe aksionet e saj janë pjesë e CAC 40. Bordi i drejtorëve të kompanisë përbëhet nga 15 anëtarë, duke përfshirë katër përfaqësues qeverie dhe dy përfaqësues aksionerë punonjës. Bashkë me ndryshimin e drejtimit të korporatës më 21 prill 2011, Safran ka modifikuar apo ndryshuar po ashtu strukturën e vet të menaxhimit të korporatës. Bordi i drejtorëve Safran ka formuar tre komitete: Komitetin e Rreziqeve dhe Auditit, Komitetin e Shpërblimeve dhe Emërimeve, si dhe Komitetin e Projekteve dhe Strategjive. Disa kompani drejtuese të grupit janë:
- Snecma. Një prej liderëve botërorë të prodhimit të motorrëve, të raketave dhe aereoplanëve, Snecma harton, zhvillon, prodhon dhe tregton, vetëm apo në partneritet, motorrë për aereoplanë civilë dhe ushtarakë, satelitë dhe mjete lëshimi. Po ashtu u ofron linjave ajrore, forcave të armatosura dhe operatorëve të tjerë një gamë të gjerë shërbimesh mirëmbajtjeje, riparimi dhe remonti.<sup>9</sup>
  - Turbomeca. Turbomeca është prodhuesi lider botëror i turbinave të gazit për helikopterë, duke ofruar gamën më domethënëse të motorrëve turbinë. Motorrët turboshaft të Turbomeca fuqizojnë helikopterët civil dhe ushtarakë të bëra nga prodhuesit lider botërorë. Përveç, Turbomeca bën motorrë xhet për aereoplanë dhe raketë.<sup>10</sup>
  - Techspace Aero. Techspace Aero harton apo dizajnon, zhvillon dhe prodhon module dhe pajisje për motorrë aereoplanësh komercialë dhe ushtarakë, si edhe motorrë raketash. Përveç kësaj, kompania dizajnon, stilon, instalon dhe modernizon standat e testimit të motorrëve.<sup>11</sup>
  - Messier-Bugatti-Dowty. Messier-Bugatti-Dowty është lideri botëror në sistemet e uljes dhe të frenimit të aereoplanëve. Aftësitë e kompanisë përfshijnë ciklin e plotë jetësor të produkteve të ndryshme, duke nisur nga stilimi dhe prodhimi deri në mbështetjen në riparim dhe remont. Messier-Bugatti-Dowty është partner në 33 leading commercial, military, business and regional airframers, dhe mbështet më shumë se 22,000 aereoplanë.<sup>12</sup>
  - Sagem. Duke operuar si në tregun civil ashtu edhe atë ushtarak, Sagem ofron teknologji të përkryera si dhe shërbime në pajisjet optronike, si lider botëror në kontrollin e fluturimit të helikopterëve, pajisje elektronike dhe software sigurie. Sagem po ashtu stilon dhe prodhon sisteme dronësh taktike. Ai është lideri botëror në biometrikë mbi bazën e shenjave të gishtave, dhe specialist lider në teknologjitë multibiometrike, kartat smart, sigurimin e transaksioneve si dhe zgjidhje për menaxhimin e identitetit, Sagem plotëson nevojat në zhvillim e sipër të individëve, kompanive dhe qeverive për sigurinë. Sagem është prezent edhe në Shqipëri nëpërmjet filialit të vet Aleat, duke fituar të drejtën e koncesionit të përgatitjes së kartave të identitetit dhe pashaportat biometrike për shtetasit shqiptar.<sup>13</sup>

## Joint Ventures – Shoqëritë e përbashkëta

Joint venture, ose shoqëritë e përbashkëta, janë sipërmarrje tregtare të dy apo më shumë personave apo organizatave për të ndarë shpenzimet dhe fitimet e një projekti të caktuar tregtar. Shoqëria joint venture nuk është një organizatë tregtare në kuptimin e një pronësie ortakërie, apo shoqërie tregtare. Ajo është një marrëveshje mes palësh për një qëllim të caktuar dhe zakonisht për një afat kohor të caktuar. Joint venture mund të jenë jozyrtare apo informale, si psh, një shtrëngim dore dhe një marrëveshje ndërmjet dy firmave për të ndarë hapësirën në një panair tregtar. Marrëveshje të tjera mund të jenë tejet të ndërlikuara, të tilla si një konsortium firmash të mëdha elektronike që bashkohen për të zhvilluar microchips të reja. Popullariteti i joint ventures është rritur gjatë viteve të fundit, megjithë përqindjen relativisht të lartë të mungesës së suksesit në përpjekje të tilla, për një arsye apo një tjetër. Pronarët e bizneseve të vogla kreative në vite kanë qenë në gjendje ta përdorin këtë strategji biznesi në të mirë të tyre, edhe pse kjo praktikë mbetet e lidhur kryesisht me korporatat e mëdha.

Shumë prej shoqërive joint ventures janë formuar me pikësynimin parësor për të kursyer para. Kjo është po aq e vërtetë si për dyqanet e vogla nëpër lagje që pajtohen për të reklamuar bashkarisht në gazetën javore, ashtu edhe për kompanitë ndërkombëtare të karburantit që pajtohen të punojnë bashkë me synim nxjerrjen dhe shfrytëzimin e naftës dhe gazit. Joint venture janë tërheqëse sepse u mundësojnë kompanive të ndajnë si rreziqet ashtu edhe kostot. Në mes të mirave më domethënëse që vijnë nga shoqëritë joint ventures është fakti që palët në këtë shoqëri kursejnë para dhe ulin rrezikun përmes ndarjes së kapitalit dhe burimeve. Shoqëritë joint venture, po ashtu u japin mundësinë kompanive më të vogla të punojnë me

<sup>9</sup> <http://www.snecma.com/snecmas-pivotal-role-development-commercial-aviation>

<sup>10</sup> <http://www.turbomeca.com/helicopter-engines>

<sup>11</sup> <http://www.techspace-aero.be/safran-center-excellence-low-pressure-compressors-turbofan-engines>

<sup>12</sup> <http://www.safranmbd.com/landing-gears>

<sup>13</sup> [www.sagem-ds.com](http://www.sagem-ds.com)

ato më të mëdha për të zhvilluar, prodhuar dhe nxjerrë në treg produktet e reja të tyre. Gjithashtu, ato u japin kompanive të të gjitha përmasave mundësinë e rritjes së shitjeve, të kenë qasje në tregje më të zgjeruara si dhe të rrisin mundësitë teknologjike nëpërmjet kërkimeve dhe zhvillimeve të hartuara nga më shumë se një palë. Deri së fundmi, kompanitë amerikane shpesh ngurronin të përfshiheshin në partneritete kërkimore dhe zhvillimi, ndërsa agjencitë qeveritare përpiqeshin që të mos përfshiheshin në zhvillimin e biznesit. Megjithatë, me ngritjen e vendeve që kanë industri me teknologji të avancuar, të tilla si mikroçipe kompjuterike apo elektronike, të ndihmuara shumë nga financimet qeveritare, kompanitë amerikane tregohen më të gatshme për të marrë pjesë në shoqëri joint venture në këto fusha, që ndryshe quhen konsociume.

Në legjislacionin europian, shprehja joint-venture është një koncept i vështirë ligjor, i përkufizuar më mirë tek rregullat e ligjeve nacionale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Në Francë, shprehja joint venture sipas rastit përkthehet si association d'entreprises, entreprise conjointe, coentreprise ose entreprise commune, që do të thotë një sipërmarrje e përbashkët. Në Gjermani, shoqëria joint venture përfaqësohet më mirë si kombinim kompanish ose combination of companies (Konzern). Në Shqipëri, shoqëritë joint venture përdoren kryesisht për të kryer punë publike, në ato që quhen pjesëmarrje të bizneseve private në prokurime publike.

Një shoqëri joint venture mund të formohet në mënyrat e mëposhtme:<sup>14</sup>

- Kur një investues i huaj blen një interes në një kompani vendase;
- Kur një firmë vendase blen një interes në një firmë të huaj ekzistuese;
- Kur si sipërmarrësi vendas ashtu edhe i huaj formojnë së bashku një ndërmarrje të re;
- Së bashku me kapitalin publik dhe/ose hua bankare;
- Ndjekja e synimeve.

## Shembuj Joint Venture

**Sony Mobile Communications** (ish Sony Ericsson Mobile Communications AB) është një kompani multinacionale për prodhimin e telefonëve celularë me seli në Tokyo, Japan, dhe një filial tërësisht nën pronësinë e Sony Corporation. U themelua në 1 tetor 1987 si një shoqëri e thjeshtë ndërmjet Sony dhe kompanisë suedeze të pajisjeve të telekomunikacionit (Swedish Ericsson), nën emrin Sony Ericsson. Sony bleu aksionet e Ericsson në këtë shoqëri në 16 shkurt 2012. Sony Mobile Communications ka mjedise për hulumtime dhe për zhvillime në Tokyo, Japan; Chennai, India; Lund, Sueden; Beijing, China dhe Silicon Valley, United States. Sony Mobile është prodhuesi i katërt më i madh i smartphone sipas aksioneve të treg në tremujorin e katërt të vitit 2012. Pajisja më e shitur deri tani e Sony është Sony Xperia Z, smartphone i parë high-end waterproof. Në Shtetet e Bashkuara, Ericsson hyri në ortakëri me General Electric në fillim të viteve nëntëdhjetë, kryesisht për të patur praninë e SHBA-ve si dhe për njohjen e markës. Ericsson kishte vendosur të merrte pajisje për telefonët e vet nga një burim i vetëm, një punishte e Philips në New Mexico. Në mars të vitit 1986, një zjarr që ra në fabrikën e Philips shkaktoi ndotje në punishten dhe Philips e siguroi Ericsson dhe Nokia se prodhimi nuk do të vonohej më shumë se një javë. Kur u bë e qartë se prodhimi do të kompromentohej për disa muaj, Ericsson duhej të përballej me një çështje serioze. Nokia tashmë kishte nisur të merrte pajisje nga burime alternative, por pozicioni i Ericsson ishte shumë më keq pasi prodhimi i modeleve ekzistuese dhe dalja e modeleve të reja ishte penguar.<sup>15</sup>

Ericsson, që kishte qenë në tregun e telefonisë celulare për dekada dhe ishte prodhuesi i tretë më i madh në botë për prodhimin e telefonëve celularë, po përballej me humbje të mëdha. Kjo erdhi kryesisht për shkak të zjarrit dhe pamundësisë për të prodhuar telefonë më të lirë si Nokia. Për reduktimin e humbjeve, mendoi dhe kalimin e linjës së prodhimit tek kompanitë aziatike, të cila mund t'i prodhonin këta telefonë me kosto më të ulët. Me 2 janar 1999, Sony Ericsson shpalli në Stockholm se disa prej telefonëve të tij do bëheshin në Indi dhe se dy prej ortakëve të tij, Flextronics dhe Foxconn do të prodhonin dhjetë milion telefonë celularë në vit deri në 2009. Pas nxjerrjes së Apple iPhone në tremujorin e tretë të vitit 2007, Sony Ericsson kaloi një periudhë të vështirë. Ngarkesat me telefonë celularë ranë nga 30.8 milionë në tremujorin e katërt të vitit 1999 në vetëm 8.1 milionë në tremujorin e parë të vitit 2003. Kompania kishte humbje neto në gjashtë nga 15 tremujorët, ndërsa rezervat në para të thata kishin rënë nga €2.2mld në €599mln, pasi kishte marrë një ndihmë prej €375mln në para të thata nga pronarët e përbashkët.

Sony Ericsson ishte kaluar nga rivali i tij në Korenë Jugore LG Electronics në tremujorin e parë të vitit, Q1 - 2008. Fitimet e kompanisë Sony Ericsson ranë nga 43% në €133 milion (rreth US\$180 milion), shitjet ranë nga 8% ndërsa aksionet në treg ranë nga 9.4% në 7.9%, megjithë kushtet favorizuese se tregu i telefonëve celularë të dorës pritej në rritej me 10% në 2008. Sony Ericsson shpalli një paralajmërim tjetër fitimesh në qershor 2008, ndërsa fitimet neto ranë në me 97% në tremujorin e dytë të vitit 2008, duke njoftuar shkurtrimin e 2.000 vendesh pune, duke sjellë një frikë të madhe se Sony Ericsson është në prag rënieje bashkë me rivalin Motorola, që po ashtu po kalonte periudhë të vështirë. Në tremujorin e tretë, fitimet ishin pak a shumë në të njëjtin nivel, megjithëse muajt nëntor dhe dhjetor shënuan rritje të fitimeve së bashku me nxjerrjen e modeleve të reja si C905 i cili ishte një prej modeleve më të shitura në Mbretërinë e Bashkuar.

Në 27 tetor 2011, Sony shpalli blerjen e pjesës së Ericsson në Sony Ericsson për €1.05 miliardë (\$1.47 miliardë), duke e bërë biznesin e telefonisë celulare një filial krejtësisht në pronësi të Sony. Kryerja e transaksionit pritej të ndodhte në janar

<sup>14</sup> <http://www.investopedia.com/terms/j/jointventure.asp>

<sup>15</sup> <http://www.sonymobile.com/gb/products/phones/>

2012. Në 2012 Consumer Electronics Show, Kaz Hirai i Sony njoftoi se Sony Ericsson do të njihej thjesht si Sony Mobile Communications në pritje të kryerjes së transaksionit. Me 26 janar 2012, Bashkimi Europian e miratoi blerjen. Në 16 shkurt 2012, Sony njoftoi se kishte përfunduar blerjen e plotë të Sony Ericsson. Me 7 janar 2013, Sony Mobile përfundoi lëvizjen e selisë kryesore të saj nga Lund, Suedi në Tokio, Japoni në mënyrë që të integrohej plotësisht me kompaninë mëmë.

**Formimi i Industrisë Airbus.** Airbus A300, i pari aereoplan i nxjerrë nga Airbus. Airbus Industrie u themelua zyrtarisht si Groupement d'Interet Économique (Economic Interest Group or GIE) me 18 dhjetor 1970. U formua nga një nismë qeveritare ndërmjet Francës, Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar që e ka origjinën në 1967. Aksionerët fillestarë të saj ishin kompania franceze Aérospatiale dhe kompania gjermane Deutsche Airbus, secila me 50% të aksioneve.<sup>16</sup> Emri "Airbus" u morr nga një term që nuk ishte në pronësi, i përdorur nga industria e linjave ajrore në vitet 1960 kur bëhej fjalë për një aereoplan tregtar të përmasave apo gamë të caktuar, pasi ky term ishte i pranueshëm për francezët nga ana gjuhësore. Aérospatiale dhe Deutsche Airbus secila kishin 36.5% aksione të punës prodhuese, Hawker Siddeley 20% dhe kompania hollandeze Fokker-VFW 7%. Secila kompani do t'i dorëzonte sektorët e vet të pajisur plotësisht, si pjesë gati për fluturim. Në tetor 1971, kompania spanjolle CASA bleu 4.2% aksione të Airbus Industrie, ku Aérospatiale dhe Deutsche Airbus reduktuan aksionet e tyre në 47.9%. Në janar 1979, British Aerospace, që kishte marrë Hawker Siddeley në vitin 1977, bleu 20% aksione të Airbus Industrie. Shumica e aksionerëve i reduktuan aksionet e tyre në 37.9%, ndërsa CASA e mbajti pjesën e vet prej 4.2%.

## Konkluzione

Shoqëritë tregtare ushtrojnë veprimtarinë tregtare në funksion të aktivitetit të tyre, me qëllim të rritjes së aktiveve dhe kapitaleve të tyre, duke shtuar kështu mundësinë e ndarjeve të fitimeve më të mëdha për ortakët dhe aksionerët. Në shumë raste, për të realizuar këtë qëllim, shoqëritë tregtare ndërveprojnë me njera-tjetrën, nëpërmjet formave të ndryshme kontraktuale, ku ndër më kryesoret janë grupimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjet e ndryshme të përbashkëta tregtare. Korporatat kanë tendencë të krijojnë filiale për krijimin e një linje demarkacioni ndërmjet operimeve të një korporate në marrëdhënie me një tjetër. Korporata mëmë ende ka në pronësi filialin, por për shkak se filiali është i inkuorporuar veç, ka më shumë pavarësi se sa një degë e kompanisë mëmë, i cili ka menaxhimin, operimet si dhe sistemet financiare të veta. Në vendet ku e drejta e korporatave për qëllime detyrimesh, i njeh subjektet e inkuorporuara si individë të ndarë, korporata mëmë dhe filiali janë krejtësisht të mbrojtura ndaj detyrimeve ligjore të tjetrës.

Filialet mund të formohen në mënyra dhe për arsye të ndryshme. Një korporatë mund të krijojë një filial ose duke blerë një interes kontrollues në një kompani ekzistuese ose duke krijuar vetë kompaninë. Kur një korporatë blen një kompani ekzistuese, formimi i një filiali mund të pëlqehet më shumë se një shkrimje pasi korporata mëmë mund të blejë një interes kontrollues me një investim më të vogël sesa mund të duheshin për një shkrimje. Përveç kësaj, nuk kërkohet as miratimi i aksionerëve të firmës së blerë si në rastin e një shkrimjeje. Çdo kompani mëmë që në mënyrë të ligjshme kontrollon një kompani tjetër, filialin, ka për detyrë të hartojë llogaritë e konsoliduara. Në shumicën e rasteve, kontrolli ligjor merr formën e mbajtjes së shumicës të së drejtave për të votuar. Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian, po ashtu, mund të kërkojnë llogari të konsoliduara për të qenë të përgatitur në raste të tjera kur një kompani mëmë ka në zotërim vetëm një pakicë aksionesh, por ushtron kontroll de facto.

## Bibliografia

- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".  
 Council Regulation (EC) No 2157/2001 of 8 October 2001 on the Statute for a European company (SE).  
 Seventh Council Directive 83/349/EEC of 13 June 1983, "On consolidated accounts".  
 Janet Dine, Cambridge University Press, (2006), The Governance of Corporate Groups.  
 Rene Thomas Wieser, Societas, (2013), Liability within Corporate Groups,.  
<http://www.safran-group.com/group-0#1>  
<http://www.snecma.com/snecmas-pivotal-role-development-commercial-aviation>  
<http://www.turbomeca.com/helicopter-engines>  
<http://www.techspace-aero.be/safran-center-excellence-low-pressure-compressors-turbofan-engines>  
<http://www.safranmbd.com/landing-gears>  
[www.sagem-ds.com](http://www.sagem-ds.com)  
<http://www.investopedia.com/terms/j/jointventure.asp>  
<http://www.sonymobile.com/gb/products/phones/>  
<http://www.airbus.com/aircraftfamilies/>

<sup>16</sup> <http://www.airbus.com/aircraftfamilies/>

# ZHVILLIMI I TË DREJTËS SË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI

---

**HERALDA JAHOLLARI**

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik  
jahollariheralda@yahoo.com

---

## ABSTRAKT

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, përveç avantazheve, që sjell për shtetin shqiptar, në rrugën e tij drejt integritimit evropian, bën të rëndojnë mbi ekzekutivin dhe ligjvënësin një detyrim shumë të madh për sa i takon përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire* dhe direktivat e Bashkimit Evropian. Kështu, për të bërë të mundur përfrimin e legjislacionit vendas me atë evropian, Shqipëria ka miratuar një sërë ligjesh ndër të cilat mund të përmendim ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, me anë të të cilit është krijuar sistemi i Gjykatave administrative në Shqipëri, ose ligjin 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon aktivitetin e kompanive të sigurimit dhe risigurimit, të cilat veprojnë në territorin shqiptar. Ligji “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, është përpiluar në bashkëpunim me Bankën Botërore. Për hartimin e tij, janë marrë për shembull modelet e vendeve fqinje dhe rregullat e vendosura në nivel evropian, nëpërmjet 12 direktivave, që rregullojnë këtë fushë. Tre elementë pikasin në këtë ligj të ri, që e bëjnë të jetë një ligj me i plotë dhe më cilësor, krahasuar me atë që u shfuqizua, dhe që tregojnë se ligjvënësi shqiptar ia ka arritur qëllimit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*: Ligji zgjeron kompetencat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, organ që kontrollon dhe sanksionon sjelljen e kompanivë të sigurimit dhe risigurimit në Shqipëri; Ligji detajon dhe shton, të drejtat e konsumatorit dhe detyrimet e operatorit, në marrëdhënien kontraktuale që lidhet midis tyre; Ligji parashikon një sërë dispozitash, që lejojnë shndërrimin e degës së shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar, në momentin kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian.

**Fjalë kyç:** *sigurim, ligj, risi, mbikëqyrje, konsumator*

---

## Hyrje

Aktiviteti i sigurimit ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm vitet e fundit në Shqipëri. Ky zhvillim është rezultat i disa faktorëve:

1. Së pari, ligjvënësi, në disa raste, ka parashikuar detyrimin për subjektet, që të lidhin një kontratë sigurimi. Përmendim, këtu, sektorin e transportit, i cili i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr. 10 076, dt. 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 455, dt. 21.07.2011. Detyrimi për t’u siguruar, në zbatim të ligjit nr. 10 076, i ndryshuar, prek pronarin e çdo mjeti transporti përpara përdorimit të mjetit. Kjo kategori përfshin pronarët e automobilëve private, mjetet e transportit publik, të cilët bëjnë transport pasagjerësh, pronarët dhe përdoruesit e avionëve si dhe pronarët dhe përdoruesit e mjeteve lundruese. Përfshirja e të gjitha kategorive të transportit (përfshirë bën transporti hekurudhor, për të cilin është duke u përgatitur një ligj i ri), ndikon ndjeshëm në zhvillimin e aktivitetit të sigurimit në tregun shqiptar.
2. Së dyti, subjektet, si personat fizikë ashtu edhe personat juridikë, janë ndërgjegjësuar, tashmë, për efektet pozitive të ekzistencës së një kontrate sigurimi, falë së cilës ata mund të përballojnë shpenzime të rëndësishme, të shkaktuara nga realizimi i një rreziku të caktuar. Nganjëherë, lidhja e një kontrate sigurimi, është një domosdoshmëri për marrjen e një kredie, e cila lejon zhvillimin e një biznesi ose rritjen e mirëqënies së një familjeje, që vendos të financojë një projekt të sajën.
3. Së treti, sjellja e kompanive të sigurimit në treg, ndikon në zhvillimin e aktivitetit të sigurimit. Ky faktor është, njëherazi, shkak edhe pasojë e zhvillimit të tregut të sigurimit. Kompanitë e sigurimit rrisin dhe pasurojnë ofertat e tyre për sigurime, në sektorë të ndryshëm, nisur nga kërkesat e konsumatorëve për t’u siguruar kundër një rreziku apo një tjetri, për të siguruar një element të pasurisë së tyre apo një tjetër. Anasjelltas, edhe konsumatorët do të shtyhen të lidhin më shumë kontrata sigurimi, nëse ofertat në treg janë të ndryshme, qoftë kjo për sa u takon llojeve të sigurimit, që ofrohen, apo primeve, që praktikohen nga kompanitë e sigurimit. Përveç kësaj, në qoftë se shoqëritë e sigurimit janë korrekte, në respektimin e detyrimeve të tyre kontratore, atëherë, konsumatorët do të shtyhen edhe më tepër të lidhin kontrata sigurimi.

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Zhvillimi i aktivitetit të sigurimit dhe risigurimit në Shqipëri duket qartë në analizën e tregut dhe rritjen e numrit të kompanive, që vepron në të.

Kompania e parë e sigurimeve në Shqipëri është kompania INSIG sh.a., e cila është krijuar në vitin 1991. Ajo ushtron aktivitetin e saj prej 15 vitesh dhe zotërohet, aktualisht, në masën 100% nga Ministri i Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, i cili është aksioneri i vetëm. Ministri i Ekonomisë ka filluar procedurat e privatizimit të kësaj shoqërie.

Sot, në Shqipëri, vepron 11 kompani sigurimi.

- 3 kompani janë të licensuara për të vepruar në fushën e sigurimeve të jetës dhe 9 janë të licensuara për të vepruar në fushën e sigurimeve të jojetës.
- Një prej kompanive ka dy licenca. Ajo vepron njëherazi edhe në fushën e sigurimeve jetë edhe në atë të sigurimeve jojetë. Bëhet fjalë për kompaninë INSIG sh.a.
- Ekziston edhe një kompani, e cila zotëron një licencë për aktivitetin e sigurimit dhe një tjetër par aktivitetin e risigurimit. Bëhet fjalë për shoqërinë SIGAL UNIQA Group Austria sh.a.

Për të organizuar, në mënyrën më të mirë të mundshme, funksionimin dhe kontrollin e aktivitetit të tregut të sigurimeve, por edhe për t’iu përshtatur detyrimeve, që rrjedhin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabizilim Asocimit, në vitin 2007, ligjvënësi shqiptar ka vendosur të miratojë një ligj të ri, në vitin 2014, konkretisht ligjin nr. 52, dt. 22.05.2014.

Miratimi i ligjit nr. 52/2014 është rezultat i bashkëpunimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës Botërore. Hartimi i tij është bërë duke marrë parasysh rregullat e vendosura në nivel të Bashkimit Evropian, nëpërmjet 12 Direktivave, që ekzistojnë, si dhe aktet ligjore, në fushën e sigurimeve, në disa vende të rajonit dhe anëtare të Bashkimit Evropian. Në hartimin e projektligjit janë marrë parasysh edhe parimet më të fundit të Shoqatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Sigurimeve, si dhe është synuar përputhshmëria e rregullimeve të bëra me këto parime. Ligji ka pasur si qëllim, që rregullat e caktuara, t’i standartizojë me legjislacionin e vendeve fqinje, të cilat kanë problematika të ngjashme të tregjeve financiare.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Analizimi i kuadrit ligjor të adoptuar së fundmi në fushën e sigurimit dhe risigurimit, bën të lindë pyetja se cilat janë risitë, që ka sjellë ligji nr. 52/2014, në këtë fushë dhe në tregun vendas të sigurimit dhe risigurimit. Ligji nr. 52/2014 ka sjellë disa elementë pozitivë dhe të rinj, të cilët nuk ekzistonin në ligjin e mëparshëm, të cilët na bëjnë të mendojmë, që ky ligj garanton

një mbrojtje më efektive të klientit në marrëdhëniet me kompanitë e sigurimit. Jo vetëm kaq, por nga përmbajtja e ligjit nr. 52/2014, duket që ligjvënisi ka ndërhyrë për të garantuar që aktiviteti i sigurimit dhe risigurimit nuk do të bëhet pre e veprimeve të paligjshme, siç janë pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, nëpërmjet miratimit të disa rregullave të reja.

Me qëllim përgatitjen e këtij artikulli është bërë një analizë cilësore e ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, e cila ka lejuar studimin e risive të sjella prej tij. Në analizë nuk ka munguar edhe aspekti krahasimor me ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i cili ka qënë në fuqi për një periudhë prej dhjetë vjetësh.

## Analizë, interpretim të dhënash

Standartizimi i legjislationit, përveç përmbushjes së detyrimeve, që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Associmit, lehtëson zbatimin e tij si dhe favorizon zhvillimin e aktivitetit, pasi shoqëritë do t'i nënshtrohen zbatimit të të njëjtave rregulla, pavarësisht vendit në të cilin ato vendosin të ushtrojnë aktivitetin. Në këtë mënyrë, shoqëritë e vendosura në Shqipëri do të kenë më pak pengesa në zgjerimin e tyre jashtë vendit dhe shoqëritë e huaja do të piren të investojnë në Shqipëri, pasi legjislationi vendas nuk do të krijojë pengesa të tjera.

Për kontrollin e ushtrimit të aktivitetit, nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, ligjvënisi ka krijuar një strukturë të posaçme, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është krijuar që në vitin 2006, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9572, dt. 03.07.2006. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 52/2014, kompetencat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare janë përforcuar dhe shtrihen tashmë, jo vetëm në pjesën e dhënies dhe heqjes së licencave për ushtrimin e aktivitetit, por mbulojnë edhe mjaft aspekte të menaxhimit të kompanive të sigurimit. Në ndryshim nga parashikimet e ligjit nr. 9267, dt. 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i shfuqizuar tashmë, ligji 52/2014, i jep mundësinë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të ndërhyjë në aktivitetin e një shoqërie, në rastet kur ajo fillon të hasë vështirësi, por para se situata të bëhet kritike. Ligji nr. 9267 parashikonte rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në një fazë më të vonë, pra, kur shoqëria kishte ndërmarrë hapat e para për prishjen dhe likuidimin e saj, si pasojë e pamundësisë për të vazhduar aktivitetin. Aktualisht, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund t'i kërkojë një kompanie sigurimi ose risigurimi të marrë disa masa paraprake, në rastet kur ajo konstaton, që problemet me të cilat përballlet shoqëria, përveç vështirësive të krijuara deri në atë moment, mund të kenë si pasojë falimentimin e shoqërisë.

Ndërhyrja e Autoritetit bëhet nëpërmjet identifikimit të zonave më me rrezik në aktivitetin e shoqërisë dhe përcaktimit të shkallës së ndërhyrjes, për të sjellë riskun në nivele të pranueshme. Mbikëqyrja nënkupton kryerjen e një analize financiare dhe inspektimeve në vend dhe jo caktimin e rregullave teorike. Ligji parashikon dispozita të reja për kryerjen e inspektimit.

Ligji nr. 52/2014 sjell edhe risi të tjera për sa i përket për shembull, klasifikimit të rreziqeve të mëdha dhe riformulimit të klasave të jetës, në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian.

Procedura e licensimit të shoqërive, të cilat ushtrojnë aktivitet në fushën e sigurimit, është e njëjtë me atë të parashikuar në ligjin nr. 9267/2004, të shfuqizuar tashmë. Kjo procedurë përbëhet nga dy faza:

- Faza e parë është ajo e miratimit paraprak;
- Faza e dytë është ajo e dhënies së licencës.

Por, ligji i miratuar rishtazi ka përforcuar kushtet, që shoqëria duhet të përmbushë, për të marrë licencën për ushtrimin e aktivitetit. Ndër kushtet e reja, që duhet të përmbushen për marrjen e licencës përmendim:

- Paraqitjen e një dokumenti, që përmbledh politikat dhe procedurat e brendshme të shoqërisë, për mënyrën e trajtimit të drejtë të konsumatorit.
- Përgatitjen e një programi për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Mbrojtja e konsumatorit është një element, të cilit ligji nr. 52/2014 i kushton rëndësi të veçantë, rëndësi që vërehet edhe në faktin që, në ligj është krijuar një kapitull specifik, për këtë qëllim. Synimi i ligjvënësit ka qënë të organizojë një mbrojtje sa më efektive të konsumatorit dhe të krijojë rregulla të kuptueshme dhe të zbatueshme me lehtësi nga konsumatorët, të cilët mund të jenë njohës të fushës (kur bëhet fjalë për persona juridikë, të cilët ushtrojnë një aktivitet biznesi), ose edhe qytetarë të thjeshtë, që nuk i njohin rregullat e funksionimit të aktivitetit të sigurimit.

Kështu, ligji nr. 52/2014, përmban disa parashikime, në lidhje me detyrimin e siguruesit për dhënien e informacionit të plotë dhe të qartë, të siguruarit, para nënshkrimit të kontratës, si edhe gjatë afatit të vlefshmërisë së saj. Ky informacion lidhet jo vetëm me kushtet e zbatimit të kontratës, por edhe me ndryshimet në legjislationin e fushës, të cilat mund të kenë për pasojë ndryshimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në kontratë. Tjetër risi e ligjit nr. 52/2014 është ajo e vendosjes së një sërë kushtesh, të cilat kanë për qëllim shmangien e pastrimit të parave, nëpërmjet aktivitetit të sigurimit, dhe evitimin e përdorimit të fondeve të dhëna apo të marra, në marrëdhëniet e sigurimit, për financimin e terrorizmit.

Kujdesi për të shmangur pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, nëpërmjet aktivitetit të sigurimit, prek disa aspekte të aktivitetit. Kështu, shoqëria duhet të paraqesë, bashkë me kërkesën për marrjen e miratimit paraprak dhe licencës

për ushtrimin e aktivitetit, një program për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Por, shoqëria duhet të verifikojë edhe origjinën e fondeve të përdorura nga aksionerët për krijimin e shoqërisë për t'u siguruar, që ato nuk janë frut i një aktiviteti të paligjshëm ose nuk lidhen me aktivitete terroriste. Në këtë drejtim, shoqëria duhet të verifikojë edhe situatën e aksionerëve ose të personave, që propozohen për të ushtruar funksione drejtuese dhe vendimmarrëse në shoqëri (Administrator, Anëtar bordi ose Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës), për të marrë konfirmimin, që, ndaj tyre, nuk është dhënë më parë një dënim, për shkak të ushtrimit të aktiviteteve, që lidhen me financimin e terrorizmit ose që kanë për qëllim pastrimin e parave.

Së fundi, lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është një element, për të cilin shoqëria duhet të tregojë një kujdes të vazhdueshëm, pasi gjatë gjithë kohës së ushtrimit të aktivitetit, ajo ka detyrimin të raportojë pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, nëse konstaton parregullsi në këtë drejtim. Shoqëritë e sigurimit janë, gjithashtu, subjekt i zbatimit të ligjit nr. 9917, dt. 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Ky ligj ka mundësuar krijimin e një strukture të posaçme, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, në varësi të Ministrit të Financave, i cili kontrollon aktivitetin e një sërë profesioneve dhe fushash biznesi (noterë, struktura bankare, struktura sigurimi, agjensi të këmbimit të valutave etj.), për t'u siguruar, që veprimet e kryera nga këto struktura janë në përputhje me rregullat e vendosura nga ligji nr. 9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 52/2014, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka mundësi të kontrollojë aktivitetin e një shoqërie sigurimi dhe të grupit, në të cilin bën pjesë kjo shoqëri. Kjo gjë është bërë e mundur nëpërmjet përfshirjes në ligj, të koncepteve të reja, që lidhen me grupin, duke zgjeruar në këtë mënyrë, rrethin e shoqërive, të cilat mund të mbikëqyren, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, nga Autoriteti. Edhe përkufizimi i grupit, që ligji ka dhënë për të përcaktuar rrethin e personave, që mund të mbikëqyren nga Autoriteti, është shumë i gjerë. Në nenin 141 të ligjit, grupi përkufizohet si një njësi e përbërë nga dy ose më shumë persona juridikë, prej të cilëve, të paktën njëri, është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi përcaktohet duke u bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontratore, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqëndrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksioneve brenda grupit.

Ligji përmban një kapitull të veçantë për ndërmjetësit në sigurime (brokerat dhe agentët), të cilët u nënshtrohen një sërë rregullash për liçensim, që udhëhiqen nga të njëjtat parime, të profesionalizmit dhe mungesës së dënimeve për veprime të parregullta të kryera më përpara, si dhe personat, të cilët duan të ushtrojnë aktivitetin e sigurimit. Mbi brokerin dhe ndërmjetësin në sigurime rëndon, gjithashtu, detyrimi për informim e konsumatorit, para nënshkrimit të kontratës dhe pas nënshkrimit të saj.

Për ushtrimin e aktivitetit, brokeri dhe agjenti marrin vetëm miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, procedurë kjo e cila lehtëson ndjeshëm formalitetet dhe shkurton kohën për përfundimin e procedurave. Rregullat për liçensimin e brokerave dhe agjentëve në sigurime janë hartuar duke marrë parasysh rregullimet e vendosura nga Direktivat e Bashkimit Evropian.

Vlerësuesi i dëmeve duhet t'i drejtohet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për të kërkuar liçencë për ushtrimin e aktivitetit. Gjatë punës së tij, vlerësuesi duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur. Ai duhet të veprojë në përputhje me standardet dhe etikën profesionale.

Ligji i ka lënë tagër Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që, nëpërmjet rregulloreve, të cilat miratohen nga Bordi i tij, të parashikojë në detaje procedurat, që duhet të ndjekin brokerat, ndërmjetësit dhe vlerësuesit për të marrë liçencën e ushtrimit të aktivitetit. Autoriteti përcakton, gjithashtu, edhe kriteret teknike, që duhet të përmbushë secili prej tyre, në mënyrë që të aplikojë për marrjen e liçencës.

Për të rregulluar përshtatjen e shoqërive, që ishin të pranishme në treg në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit, ligjvënësi ka përcaktuar disa dispozita kalimtare. Shoqëritë, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, kishin liçencë për të ushtruar një veprimtari sigurimi dhe ishin të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin e sigurimit, sipas dispozitave të ligjit nr. 52/2014, në klasat e sigurimit të përcaktuara në liçencën ekzistuese. Ndërkohë, shoqërive u lihet një afat prej 2 vjetësh, për t'u përshtatur me rregullat e reja, të cilat kanë ndryshuar ose janë shtuar, në raport me ligjin nr. 9267/2004. Afatet e përshtatjes për brokerat, agjentët në sigurime dhe vlerësuesit, janë më të shkurtra, vetëm 6 muaj.

## Konkluzione/ Rekomandime

Ligji nr. 52/2014, përshkruhet në tërësinë e tij, nga qëllimi i ligjvënësit për të përafuar rregullat e parashikuara nga ky ligj, me rregullimet, që gjejnë zbatim në nivelin e Bashkimit Evropian.

Ligjvënësi është përpjekur që, nëpërmjet këtij ligji, të lehtësojë procedurat për ushtrimin e aktiviteteve, që lidhen me fushën e sigurimit, qoftë për siguruesit, për brokerat, vlerësuesit apo agjentët në sigurime. Megjithatë, ai i ka lënë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare kompetenca të plota për të kontrolluar aktivitetin e aktorëve, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurime. Jo vetëm kaq, por, në disa raste, kompetencat e Autoritetit janë zgjeruar, duke i dhënë atij mundësi të përfshihet edhe në aspekte të ushtrimit të aktivitetit, të cilat shoqëritë, në zbatim të ligjit nr. 9267/2004 i menaxhonin plotësisht në mënyrë të pavarur.



Qëllimi i ligjvënësit ka qënë dukshëm mbrojtja e konsumatorit dhe krijimi i garancive reale, që ky i fundit të përfitojë nga të drejtat, që i njihen nga ligji. Në mënyrë të vazhdueshme, ligjvënësi ka vënë theksin në përforcimin e masave për të luftuar pastrimin e parave në dhe nëpërmjet aktivitetit të sigurimit, si dhe për të shmangur lidhjet e tij të mundshme me financimin e terrorizmit.

Ligji nr. 52/2014, i miratuar më 22.05.2014, është dekretuar nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 8597, dt. 17.06.2014 dhe ka hyrë në fuqi më 4 korrik 2104, pra 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare nr. 93, dt. 19 qershor 2014. Afati i përshtatjes së shoqërive të sigurimit, me rregullat e reja të përcaktuara nga ky ligj, nuk ka përfunduar ende. Për këtë arsye, është akoma shpejt për t'u shprehur mbi efektet, që ka pasur ligji nr. 52/2014 në këtë drejtim.

## Bibliografia

- Ligji nr. 52, dt. 03.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 93.  
 Ligji nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172.  
 Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 60.  
 Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78.  
 Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, i ndryshuar.  
 Raporti vjetor për aktivitetin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2014, prezantuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

# REGJIMI PASUROR MARTESOR ME KONTRATË. KONTRATA PARAMARTESORE

---

## EUGENA BISHA

Universiteti Europian i Tiranës, PhD candidate, Fakulteti Juridik, E drejte civile

E-mail: eugenabisha@yahoo.com

---

## ABSTRAKT

Nënshkrimi i kontratës paramartesore është një aspekt shumë i rëndësishëm për fillimin dhe vazhdimin e lidhjes martesore ndërmjet çiftit. Pavarësisht se rregullimi i regjimit pasuror martesor me kontratë njihet si një koncept relativisht modern, kontrata të ngjashme kanë ekzistuar që në Egjiptin e lashtë. Kontratat bëheshin atëherë për të mbrojtur gruan, që në rast divorci apo vdekje të bashkëshortit, të mos mbetet e pastrehë. Edhe pse martesa është një marrëdhënie e krijuar mbi bazën e ndjenjave të bashkëshortëve, nuk duhet harruar se ajo përbën edhe një marrëdhënie me karakter pasuror. Ekzistenca e një kontrate të tillë shpesh herë konceptohet si një element lëkundës i marrëdhënies personale martesore, kjo si pasojë e një kulture të varfër në njohjen juridike të saj. E definuar here si marrëveshje apo si kontratë, ajo është përqafuar pothuajse nga të gjitha legjislacionet e vendeve të ndryshme, por e pa rregulluar me ligj nga vendet e së drejtës islamike. Kjo kontratë është konsideruar shpesh si “arma” e bashkëshortëve për të ruajtur interesin e tyre sidomos në lidhje me çështjet pasurore..

**Fjalë kyç:** *kontrata paramartesore, regjim pasuror martesor, martesa, shkurorezimi, bashkëshortët*

---

## Hyrje

Ekzistenca e kontratave martesore evidentohet mijëra vite më parë. Historia sjell në vëmendje kontratën martesore të hebrenjve që quhej “Ketuba” e cila daton para 2 mijë vitesh si një nga dokumentat e parë ligjorë që u jepnin të drejta finansiare dhe ligjore grave.

Objekt i të drejtës martesore janë marrëdhëniet e natyrës personale dhe pasurore. Rregullimi me ligj i marrëdhënieve pasurore martesore ndihmon në mirëfunktionimin e marrëdhënieve personale. Përcaktimi i regjimit pasuror martesor me ligj apo me kontratë është me rëndësi që të bëhet para lidhjes së martesës edhe pse në Shqipëri ky koncept njihet shumë pak nga bashkëshortët e ardhshëm. Në vendin tonë kjo kontratë ka filluar relativisht vonë të njihet dhe të praktikohet. Në ndryshim nga sot, ku përmbajtjen e kësaj kontrate e përcakton vetë çifti i ardhshëm bashkëshortor, në kohët e mëparshme ishin prindërit e dhëndrit dhe nuses ato që vendosnin në emer të tyre<sup>1</sup>. Megjithatë duhet pranuar se akoma sot prindërit luajnë një rol të madh influencues në përmbajtjen e kontratës.

Marrëdhëniet martesore sjellin pasoja të rëndësishme edhe në fushën e pasurisë së përbashkët të dy bashkëshortëve<sup>2</sup>. Kontrata paramartesore përcakton të drejtat pasurore të secilit bashkëshort gjatë martesës dhe në rast shkurorëzimi. Ndërsa askush nuk mendon për divorc gjatë momentit të lidhjes së martesës, në praktikë vëmë re se gjithmonë e më shumë çiftet u drejtohen gjykatave për të prishur martesën. Në kushte të tilla, ekzistenca e një kontrate paramartesore do ndihmonte që ndarja e pasurisë midis ish-bashkëshortëve të jetë e pranueshme nga të dy palët, duke qënë se kanë qënë ato vetë që e kanë vendosur një ndarje të tillë. Kjo kontratë shpesh përdoret për të mbrojtur bizneset familjare dhe pasurinë e njërit bashkëshort, e cila mund të ketë diferenca të mëdha nga ajo e bashkëshortit tjetër. Sipas Mimoza Sadushaj, presidente e Dhomës Kombëtare të Noterisë, *... janë ende shumë të rralla rastet kur shqiptarët drejtohen tek noteri për të bërë një kontratë. Janë të huajt që martohen në vendin tonë ata që e ndjekin këtë praktikë. Gjithsesi, sipas saj, rastet po vijnë në rritje.*<sup>3</sup>

## Qellimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka për qëllim studimin dhe hulumtimin e kontratës paramartesore si një ndër aspektet më të rëndësishme në lidhjen e martesës dhe për vazhdimësinë e saj. Studimi i kuadrit ligjor dhe teorik të kontratës paramartesore paraqet një rëndësi të madhe në kushtet e një mungese të thelluar të doktrinës shqiptare në lidhje me institutin e martesës dhe çështjet e lidhura me të. Me anë të këtij punimi synoj të vë në pah mangësitë dhe problematikat që shfaq zbatim i kontratës paramartesore në praktikë.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

### *Pyetja Kërkimore:*

Kontrata paramartesore a i mbron interesat mbi të cilat lidhet martesa dhe a cënon dispozitat urdhëruese të kodit të familjes që imponojnë të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve?

### *Hipoteza:*

Një kontratë e bërë në interes të dy palëve dhe në ndersmeri të plotë kundrejt njëri tjetrit padyshim nuk mund të lëkundë marrëdhënien bashkëshortore, por përkundrazi i jep asaj sigurinë e nevojshme.

### *Metodologjia e punimit:*

Për hartimin e këtij punimi kam marrë parasysh disa metoda kërkimore shkencore të larmishme si metoda analitike, historike, shpjeguese, krahasuese dhe përshkruese. Këto metoda gjenden në të gjithë punimin si të përziera.

## Analizë, interpretim të dhënash

Kur njërëzit i drejtohen altarit për të kurorëzuar martesën mendojnë se ajo do zgjasë gjithë jetën. Realiteti i ftohtë tregon se një përqindje e madhe e tyre përfundojnë në divorc.

Martesa, si një institut që karakterizohet nga karakteri personal, vë në plan të dytë kontekstin pasuror të saj. Në situata të caktuara krizash bashkëshortore, bashkëshortët mund të ndihen të pasigurtë rreth pasurisë së vënë para dhe pas martese në rast të një divorci të mundshëm. Tërësia e rregullave juridike që rregullojnë të drejtat pasurore të çiftit bashkëshortor në Kodin e Familjes të RSH-së emertohen “regjimet juridike martesore”. Kontrata paramartesore është një marrëveshje e bërë ndërmjet dy bashkëshortëve të ardhshëm të cilët zgjedhin si regjim pasuror martesor atë me kontratë. Marrëveshja e tillë, kalon në filtrin e respektimit të rregullave të përcaktuara sipas Kodit të Familjes dhe që duhet të respektohen nga noteri

<sup>1</sup> A.katherine E.Stoner &SH.Irving, J.D, “Prenuptial Agreements, How to write a fair &lasting contract”, botim i 4-t, 2012, fq 9

<sup>2</sup> A.Kalia, “E drejta Ndërkombëtare Private”, Sejko, Tiranë, 2010, fq.202

<sup>3</sup> Kontratat paramartesore, interviste me Mimoza Sadushajn, 10.04.2013, Top Channel

dhe bashkëshortët e ardhshëm në çdo negociatë lidhur me regjimin pasuror<sup>4</sup>. Ajo është një përpjekje nga bashkëshortët për të përcaktuar të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga lidhja e martesës gjatë dhe pas përfundimit të saj. Pavarësisht frikës se një kontratë e tillë e lidhur para martesës, inkurajon divorcin, në fakt ajo është një mjet shumë efektiv për të siguruar dhe promovuar martesën. Kjo kontratë është e vlefshme dhe nëse bëhet me anë të përfaqësuesve të bashkëshortëve të ardhshëm

Kontrata martesore mund të bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre<sup>5</sup>.

Rregullimi i marrëdhënieve pasurore bashkëshortore me kontratë, u jep një lloj autonomie bashkëshortëve në përcaktimin e rregullave për administrimin ose ndarjen e pasurisë në rast divorci dhe u përshtatet nevojave dhe interesave të çiftit. Zgjedhja e regjimit pasuror martesor është në vullnetin e palëve dhe se karakteri detyruar për të pasur regjimin pasuror martesor me ligj është në rastet e martesave të të miturve<sup>6</sup>. Pikërisht për të reflektuar mbi rëndësinë e parimit të autonomisë në përcaktimin e regjimit, në nenin 315 të Kodit të Familjes, mund të ndryshojë me marrëveshje të bashkëshortëve, sipas dispozitave të këtij Kodi<sup>7</sup>. Në kontratë mund të vendoset për pasuritë e përbashkëta ndërmjet bashkëshortëve apo pasuritë e ndara që në fillim. Përmbajtja e kontratës mund të ndryshojë me vullnetin e palëve jo më shpesh se një herë në dy vjet. Nëse bashkëshortët e ardhshëm dëshirojnë të kenë një regjim me kontratë, për përpilimin e kontratës dhe shprehjen e vullnetit duhet të paraqiten tek një zyrë noterie me qëllim që noteri të redaktojë një akt noterial lidhur me regjimin me kontratë. Sipas nenit 49 të Kodit të Familjes "...Noteri ka detyrimin të depozitohet kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës...". Zgjedhja e regjimit pasuror martesor me kontratë duhet të cilësohet në aktin e martesës të përgatitur nga nënpunësi i gjendjes civile. Regjimi pasuror martesor, si me ligj ashtu dhe me kontratë, merr efekt pas solemnizimit të martesës. Bashkëshortët me anë të një marrëveshje të përbashkët mund të ndryshojnë ose modifikojnë regjimin pasuror martesor<sup>8</sup>. Ndryshimet, në këtë rast, duhet të bëhen në të njëjtën formë që kërkohet për kontratën fillestare të martesës<sup>9</sup>. Ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka efekt kundrejt të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës. Në mungesë të këtij shënimi, ndryshimi nuk kundërshtohet nga të tretët, në qoftë se në aktet e bëra midis tyre, bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimin pasuror martesor<sup>10</sup>. Ndryshimet në kontratën e martesës duhet të depozitohen dhe në regjistrin tregtar nëse njëri nga bashkëshortët ushtron veprimtari tregtare.

Dimë se moshë e lejuar për të lidhur martesë është ajo 18 vjeçare moshë që përkon dhe me fitimin e zotësisë juridike për të vepruar. Çfarë ndodh nëse gjykata është shprehur pro, që një i/e mitur të emancipohet në një lidhje martesore?

Kur gjykata e vendit ku lidhet martesë, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara moshës 18 vjeçare, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore derisa të mbushë moshën 18 vjeç, çast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë. Dispozitat urdhëruese të Kodit të Familjes në lidhje me të drejtat dhe detyrimet midis bashkëshortëve që rrjedhin nga martesë, zbatohen pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve. Në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesë nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre.<sup>11</sup>

## Pse përdoret një kontratë paramartesore?

Ka disa arsye pse palët (njëri prej bashkëshortëve të ardhshëm ose të dy) të kërkojnë rregullimin e regjimit pasuror martesor me anë të një kontrate. Ndër arsyet kryesore mund të përmendim:

- thjeshtimi i ndarjes së pasurisë në rast divorci
- kushtëzimi i veprimeve të njeri-tjetrit nëpërmjet penalteteve financiare (psh. tradhëtia e njërit bashkëshort e penalizon atë me shuma financiare)
- mbrojtja e bizneseve familjare
- diferenca e thellë e gjendjes ekonomike të bashkëshortëve të ardhshëm dhe synimi për t'u siguruar që kjo martesë është frut i dashurisë së çiftit dhe nuk ka qëllim për perfitime financiare
- shmangien e përgjegjësisë së një debie nga njëri bashkëshort

Të gjitha këto arsye janë të ligjshme dhe mund të vendosen në objektin e kontratës duke i formuluar dhe në formë kushti ndërmjet palëve. Kontratat paramartesore janë gjithashtu të rëndësishme në këndvështrimin e palëve të treta pasi ato rregullojnë përgjegjësinë e bashkëshortit respektiv për borxhet e tjetrit<sup>12</sup>.

<sup>4</sup> A.Mandro-Balili, "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare martesore", botim i Shkollës së Magjistraturës dhe UNDP, Tiranë, 2014, 91

<sup>5</sup> Neni 69 paragr. 1, Kodi i familjes në Republikën e Shqipërisë

<sup>6</sup> Martesa e të miturve 16-18 vjeç bëhet vetem me lejin e gjykatës

<sup>7</sup> A.Mandro, "E drejta familjare", Emal, Tiranë, 2010, fq.217

<sup>8</sup> <http://www.coupleseurope.eu/en/belgium/topics/3-hoë-can-the-spouses-arrange-their-property-regime/> parë me dt.05.03.2016

<sup>9</sup> Neni 72 paragr.2, Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë

<sup>10</sup> Neni 72, Ligji nr.9062, dt. 08.05.2003 "Kodi i Familjes"

<sup>11</sup> Neni 54, Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë

<sup>12</sup> C.Wood, "The technical problems, and possible solutions, in drafting international marriage contracts and pre-nuptial agreements", Londër, 2012, fq. 3

Në vendet e zhvilluara qëllimi i lidhjes së një kontrate të tillë ka filluar të dalë jashtë kornizave tradicionale të lartpërmendura duke rënditur ndër qëllimet kryesore për nënshkrimin e një kontrate paramartesore edhe besimin fetar apo mbiemrin që do marrin fëmijët, administrimin e të ardhurave, etj. Nuk mund të pretendohet që nëpërmjet kësaj kontrate të premtohet dashuria e përjetshme apo mos ndryshimi i karakterit të personit. Me lidhjen e kontratës paramartesore ata (bashkëshortët) mund ta anashkalojnë në tërësi regjimin pasuror të pronësisë së përbashkët, mund ta zgjerojnë atë në tërë pasurinë e tyre aktuale apo edhe në atë të ardhshme<sup>13</sup>. Disa legjislacione si ai francez e konsiderojnë këtë kontratë të jetë në kundërshtim me politikat publike nëse i referohet mospërbushjes së detyrimit për ushqim<sup>14</sup>. Ndërsa kontrata paramartesore lejohet, palët nuk kanë liri të palimituar në lidhje me kontratën. Sipas Kodit Civil francez, bashkëshortët e ardhshëm duhet të paraqiten tek një noter para martesës për të zgjedhur një ndër regjimet pasurore martesore. Në regjimin pasuror martesor të zgjedhur palët mund të bëjnë modifikime në varësi të interesave të tyre të përbashkëta, por gjithmonë duke iu përmbajtur kufizimeve që jep e drejta franceze në lidhje me dispozitat e detyrueshme të Kodit të Civil. Gjermania gjithashtu i njeht kontratat paramartesore me kufizime dhe se kontrata ashtu si në shumicën e legjislacioneve të tjera duhet të bëhet në një zyrë noteriale. Austria i lejon në përgjithësi kontratat paramartesore, por me kufizime specifike. Sipas ligjit Austriak mbi të drejtën ndërkombëtare private kushtet formale për kontratën paramartesore rregullohen nga ligji i vendit ku është bërë kontrata.<sup>15</sup>

Në shumicën e shteteve<sup>16</sup>, deri në vitet 1980, kontratat paramartesore u konsideruan se binin ndesh me politikat publike.. sepse inkurajonin divorcin dhe lejonin bashkëshortin që të shmangte detyrimin e tij ligjor për t'i dhënë gruas pensionin ushqimor pas zgjidhjes së martesës.<sup>17</sup> Sipas Kodit Civil Belg "Bashkëshortët i rregullojnë marrëveshjet e tyre martesore siç ata e gjykojnë në arsyeshme, me kusht që ato të mos përmbajnë asnjë dispozitë në kundërshtim me rendin publik dhe normat morale"<sup>18</sup>.

### Disavantazhet e përpilimit të një kontrate paramartesore

- në kohën kur ajo përpilohet dhe nënshkruhet, njëri prej bashkëshortëve të ardhshëm në shenjë të "dashurisë së madhe", mund të dakortësojë kushte të cilat, nuk janë në favor të tij apo saj.
- mungesa e informacionit për të kuptuar rëndësinë juridike të kontratës
- njëri nga bashkëshortët mund të mos dëshirojë ta ndryshojë përmbajtjen e kontratës pas disa viteve martesë për t'iu përshtatur realitetit dhe kushteve të reja ekonomike familjare
- ekzistenca e një kontrate të tillë mund të krijojë "presionin" mendor tek çifti se martesë nuk është e përjetshme dhe se ajo mund të përfundojë nga çasti në çast.

### Roli i gjykatës në vlerësimin e kontrates

Edhe pse objekti i kontratës paramartesore përcaktohet nga vetë çifti, në raste mosmarrëveshje është gjykata ajo që vendos sesa vlerë ka kjo kontratë. Tradicionalisht, gjykatat e shohin këtë kontratë me një sy dyshues, sepse pothuajse gjithmonë ajo (kontrata), përfshin heqjen dorë nga bashkëshorti më pak i pasur nga të drejtat ligjore dhe financiare<sup>19</sup>. Në gjykimin e vlerës së saj, gjykata merr në konsideratë një sërë elementesh që mund të influencojnë në vendimin e saj. Është me rëndësi në vlerësimin e kontratës të dihet momenti i nënshkrimit të saj, nëse ka qënë me vullnet të lirë apo i vesuar. Element tjetër i rëndësishëm është dhe mosha e njërit ose të dy partnerëve në kohën e arritjes së marrëveshjes. Në praktikë ndodh shpesh që mosha e partneres (bashkëshortes së ardhshme) të jetë shumë e re (shpesh sapo ka mbushur 18 vjeç) dhe që ajo të mos kuptojë realisht në vetvete as kuptimin e martesës dhe aq më pak një kontratë martesore dhe të drejtat e detyrimit që ajo sjell. Duke 'përfituar' nga kjo situatë, bashkëshorti i ardhshëm ose bashkëshorti<sup>20</sup> mund të vendosë të drejta dhe detyrime në kontratë në favor të tij. Praktika tregon se elementët negativ që mund të ndikojnë në zhvlerësimin e kontratës janë të shumtë dhe që ndryshojnë me kalimin e viteve. Në një kontratë martesore duhet të ketë drejtësi, reciprocitet dhe mundësi të barabarta për të dy bashkëshortët<sup>21</sup>.

### Konkluzione/ Rekomandime

Është me rëndësi që bashkëshortët e ardhshëm të marrin konsulencën e duhur juridike në lidhje me procedurat dhe të drejtat e detyrimit që u lindin nga kontrata paramartesore. Noteret para se të përpilojnë kontratën duhet t'i informojnë palët në detaj rreth rëndësisë së kontratës.

<sup>13</sup> V.Totaj, "Kontrata (para)martesore", Revista shkencore "Justicia", Instituti gjyqësor i Kosoves, Nr.1/2009, fq.113

<sup>14</sup> *Shih*: C.Wood, "The technical problems, and possible solutions, in drafting international marriage contracts and pre-nuptial agreements", Londër, 2012, fq.2

<sup>15</sup> <http://www.international-divorce.com/prenuptial-agreements.htm> parë me dt.10.03.2016

<sup>16</sup> Termi i referohet SHBA-së

<sup>17</sup> *Shih*: <https://www.institutedfa.com/prenuptial-agreements-marriage-contracts-1/> parë me dt. 01.03.2016

<sup>18</sup> Neni 1387, Kodi Civil Belg

<sup>19</sup> A.katherine E.Stoner &SH.Irving, J.D, "Prenuptial Agreements, Hoë to ërite a fair &lasting contract", botim i 4-t, 2012, fq.12

<sup>20</sup> Në varësi të kontratës paramartesore apo martesore

<sup>21</sup> A.Mandro-Balili, "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare martesore", botim i Shkollës së Magjistraturës dhe UNDP, Tiranë, 2014, 95

Rrethanat e ardhshme financiare janë të vështira për t'u parashikuar dhe palët duhet të jenë të vetëdijshëm se me nënshkrimin e kontratës ato duhet t'i përmbahen kushteve të saj, derisa të vendosin ose për ndryshimin e kushteve të kontratës duke iu përgjigjur realitetit financiar të familjes.

Duke qënë se Kodi i Familjes nuk jep një afat kohor midis momentit të nënshkrimin e kontratës me datën e lidhjes së martesës, ndodh në praktikë që kontrata të lidhet brenda të njejtës ditë me celebrimin, shpesh herë dhe në kushtet e presioneve të jashtme për të dakordësuar disa kushte që martesë të bëhet. Hasja e problematikave të tilla në praktikë nxjerr në pah nevojën për të vendosur një afat minimum 10 ditë ndërmjet lidhjes së kontratës paramartesore me celebrimin e lidhjes së martesës, afat ky që përkon dhe me shpalljen e martesës sipas nenit 15 të Kodit të Familjes.

## Bibliografia

Ligji nr.9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes” në RSH

Mandro-Balili,A.(Tiranë,2014) “Diskriminimi gjinor në çështjet familjare martesore”, botim i Shkollës së Magjistraturës dhe UNDP

Kalia,A. (Tiranë,2010) “E drejta Ndërkombëtare Private”, Sejko

Mandro,A. (Tiranë,2010)“E drejta familjare”, Emal

Totaj,A “Kontrata (para)martesore”, Revista shkencore “Justicia”, Instituti gjyqësor i Kosoves, Nr.1/2009

Ëood,C (Londër,2012) “The technical problems, and possible solutions, in drafting international marriage contracts and pre-nuptial agreements”

Kodi Civil Belg

Katherine,A. Stoner,E. &Irving,Sh. J.D,(2012) “Prenuptial Agreements, Hoë to ërite a fair &lasting contract”, botim i 4

### **Burime nga interneti:**

<http://www.coupleseurope.eu/en/belgium/topics/3-hoë-can-the-spouses-arrange-their-property-regime/>

<https://www.institutedfa.com/prenuptial-agreements-marriage-contracts-1/>

<http://www.international-divorce.com/prenuptial-agreements.htm>

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=254979>

# INSTITUTI I PËRFAQËSIMIT NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE

---

## **SEVDAL MORINA**

PhD kandidat në Universitetin European të Tiranës, Drejtimi Civil, Ligjërues në Kolegjin GJILANI në Gjilan/Republika e Kosovës dhe aktualisht punon si zyrtar ligjor në Komunën e Kamenicës/Republika e Kosovës.  
Email add (sevdai\_morina@hotmail.com).

## **BURIM KRYEZIU**

Ka përfunduar studimet master në drejtimin civil në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe aktualisht punon si bashkëpunëtorë profesional në Kuvendin Komunal të Komunës së Kamenicës/Republika e Kosovës.  
Email add buli\_20k@hotmail.com.

---

## **ABSTRAKT**

Veprimet juridiko-civile mund të krijohen edhe përmes institutit të përfaqësimit. Përfaqësimi si institut juridik nënkupton kryerjen e veprimeve juridike në emër të tjetërkujt dhe për llogari të tjetërkujt, zakonisht me kompensim. Te ky institut subjektet njihen si përfaqësues dhe përfaqësuar. Personi i cili kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të tjetërkujt quhet përfaqësues, ndërsa personi në emër të të cilit ndërmerren veprime juridike quhet i përfaqësuar. Përfaqësim në procesin gjyqësor kemi atëherë kur një person që nuk është palë në gjykim kryen veprime procedurale në emër të saj, me efekt të drejtpërdrejtë për të. Veprimet e përfaqësuesve shkojnë në dobi dhe në dëm të palëve të përfaqësuar, vetëm me kusht nëse janë legjitimuar si përfaqësues dhe me kusht që të veprojnë brenda suazave të autorizimeve të caktuara me ligj apo me prokurë. Kur përfaqësuesi kryen veprime procedurale në emër e për llogari të njëjës palë, do të thotë se kur ai vepron brenda autorizimeve që i janë dhënë, veprimet e tij shkojnë në dobi ose në dëm të palës së përfaqësuar prej tij. Kur përfaqësuesi kryen veprime procedurale jashtë kufijve të autorizimeve që i janë dhënë nga i përfaqësuar, nuk sjellin asnjë pasojë ndaj këtij. Pala në procesin gjyqësor mund t'i kryejë vetë veprimet procedurale ose me anë të përfaqësuesit. E drejta e subjektit palë ndërgjyqëse për t'u përfaqësuar në procesin gjyqësor nuk është e kufizuar me asnjë kusht. Përkundrazi, siç do të shihet me vonë, me dispozitat ligjore në fuqi janë vënë disa kufizime të diskutueshme për personin, për ta ndjekur vetë pa përfaqësues çështjen në gjyq.

**Fjalë kyç:** *përfaqësim, përfaqësues, i përfaqësuar, prokurë, efekt*

---

## Hyrje

Veprimet juridiko civile mund të krijohen edhe përmes institutit të përfaqësimit. Përfaqësimi si institut juridik, nënkupton kryerjen e veprimeve juridike në emër të tjetërkujt dhe për llogari të tjetërkujt, zakonisht me kompensim. Te ky institut subjektet njihen si përfaqësues dhe i përfaqësuar. Personi i cili kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të tjetërkujt quhet përfaqësues, ndërsa personi në emër të të cilit ndërmerren veprime juridike, quhet i përfaqësuar. Përfaqësim në procesin gjyqësor kemi, atëherë kur një person që nuk është palë në gjykim kryen veprime procedurale në emër të saj, me efekt të drejtpërdrejtë për të. Veprimet e përfaqësuesve shkojnë në dobi dhe në dëm të palëve të përfaqësuara, vetëm me kusht nëse janë legjitimuar si përfaqësues, si dhe me kusht që të veprojnë brenda suazave të autorizimeve të caktuara me ligj apo me prokurë. Kur përfaqësuesi kryen veprime procedurale në emër e për llogari të njëres palë, do të thotë se kur ai vepron brenda autorizimeve që i janë dhënë, veprimet e tij shkojnë në dobi ose në dëm të palës së përfaqësuar prej tij. Kur përfaqësuesi kryen veprime procedurale jashtë kufijve të autorizimeve që i janë dhënë nga i përfaqësuari, nuk sjellin asnjë pasojë ndaj këtij. Pala në procesin gjyqësor mund t'i kryejë vetë veprimet procedurale ose me anë të përfaqësuesit. E drejta e subjektit palë ndërgjyqësore për t'u përfaqësuar në procesin gjyqësor nuk është e kufizuar me asnjë kusht. Përkundrazi, siç do të shihet me vonë me dispozitat ligjore në fuqi, janë vënë disa kufizime të diskutueshme për personin për ta ndjekur vetë pa përfaqësues çështjen në gjyq. Natyrisht, që këtu është fjala për personat me zotësi të plotë për të vepruar, sepse për ata që nuk e kanë këtë zotësi, ose janë të penguar nga ndonjë shkak tjetër për të vepruar vetë si palë në proces, përfaqësimi gjyqësor është i detyrueshëm. E drejta për të kryer veprime procedurale dhe veprime të tjera të ligjshme në procesin gjyqësor në emrin e një tjetri që është palë në proces, mbështetet në fakte të ndryshme juridike, me të cilat ligji lidhë lindjen e tagrave të përfaqësuesit. Këto fakte përbejnë shkaqet e lindjes së të drejtave të përfaqësuesit. E drejta procedurale, sikurse edhe ajo materiale, i njeh tre lloj përfaqësuesish: përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin e personit juridik dhe përfaqësuesin me prokurë (vullnetar).

## Kuptimi i institutit të përfaqësimit

Fjala përfaqësim vjen nga anglishtja, *advocacy* që do të thotë edhe thirrje, ndërmjetësim, kërkim. Përndryshe fjala *advocacy* rrjedh nga rrënja angleze (*ad*–kah, në drejtim, deri; *voca*–zë, fjalë, thërret, flet). Në këtë kontekst, përfaqësimi paraqet dhënien e zërit, grupeve, që tradicionalisht nuk kanë qenë të konsultuara (kanë qenë të pazëshme) në procesin e sjelljes së vendimeve (Spasenoski, Bulldioski, Bilarska-Mirçeski, Aleksov, 2010:7). Përfaqësimi nënkupton ndërmarrjen e punëve juridike në emër dhe në llogari të huaj. Personi i cili ndërmer punët juridike në emër dhe në llogari të tjetrit quhet përfaqësues, ndërsa personi në emër të të cilit ndërmerren ato punë juridike quhet i përfaqësuar. Varësisht nga personi i cili duhet përfaqësuar, kemi përfaqësimin e personave fizik dhe përfaqësimin e personave juridik Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, e parashih institutin juridik të përfaqësimit nga neni 72 deri në nenin 84. Neni 72 e parashih mundësinë që përfaqësuesi të lidhë kontratë në emër të përfaqësuesit në bazë të autorizimit. Paragrafi 1 i po të njëjtit nen parashih “Lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhet edhe me përfaqësues. Po ashtu, paragrafi 2 i këtij neni parashih “Autorizimi për përfaqësim bazohet në ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në deklarinimin e vullnetit të përfaqësuarit (prokura)”.

Kryerja e punëve juridike me anë të institutit të përfaqësimit në disa raste nuk lejohet. Ligji për Familjen në Kosovë, nuk lejon lidhjen e martesës përmes përfaqësuesit. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në nenin 64 paragrafi 2 përcakton “Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit të kryhet nga vetë personi”. Kjo do të thotë se në raste të caktuara disa punë juridike duhet të lidhen nga vet personi i cili kryen punë juridike p.sh. testamenti (Aliu, 2013:340).

Ekziston dallimi i konceptuar lidhur me institutin e përfaqësimit në të drejtën Anglosaksone (Common Law) dhe asaj në kontinentin Evropian (Civil Law). Në Common Law është e mundur që një person të autorizojë një tjetër për të kontraktuar për të. Por marrëveshja duhet detyrimisht të ketë formën e kontratës dhe pëlqimi i dyanshëm është esencial për vlefshmërinë e marrëveshjes. Kurse në kontinentin Evropian (vendet e Civil Law) situata është e ndryshme.

Fillimisht, rregullimi ligjor i përfaqësimit u zhvillua nën influencën (ndikimin) e konceptit romak të mandatit (*mandatum*), koncept ky i përdorur në të drejtën romake për të treguar një urdhër ose një komandë (Nuni, 2012:245).

Instituti i përfaqësimit krijon tre momente apo raporte të ndryshme:

1. Fuqinë juridike të përfaqësuarit që të mbartë/kalojë mbi përfaqësuesin mundësinë që në emër dhe për llogari të tij (të përfaqësuarit) të realizojë veprime juridike.
2. Rrethin e veprimeve që përfaqësuesi mund të kryejë, në emër dhe për llogari të përfaqësuarit.
3. Deklaratën e njëanshme-fuqinë juridike të përfaqësuarit, me të cilin përfaqësuesi u drejtohet personave të tretë dhe informon për rrethin e punëve/veprimeve që ai mund të kryejë për të.

Dy raportet e para përbejnë të ashtuquajturin raport të brendshëm midis të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit, dhe i treti është raport i jashtëm midis të përfaqësuarit dhe personave të tretë. Në çoftë se këto tri raporte i quajmë autorizim, në kuptimin e gjerë të fjalës, raporti i brendshëm mund të quhet autorizim, ku i përfaqësuari autorizon përfaqësuesin, duke e ngarkuar-duke u dhënë pushtet (Latifi, 2009:128).



## Natyrë juridike e përfaqësimit

Përfaqësimi është veprimi juridik, ku i përfaqësuarit shfaqet si shprehës i dëshirës së tij me ndërmjetësinë e përfaqësuesit. Duke iu referuar kësaj ideje mund të themi:

1. Është përfaqësuesi, i cili kryen aktin e përfaqësimit me dëshirën e tij. Në këtë drejtim, ka rëndësi që ai të jetë i aftë (zotësi juridike për të vepruar) për të kryer veprimin e përfaqësimit dhe që veprimi i tij nuk duhet të jetë i vesuar.
2. Një përfaqësim i mirë ka vlerë, pasi është vetë ligji që pranon vlerën e administrimit ose të rregullimit të çështjes nga përfaqësuesi, në favor të përfaqësuarit.
3. Ligji pranon përfaqësimin e të paafetëve (fëmijëve, të mitur dhe personave madhorë), nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor (Latifi, 2009:129).

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në nenin 66 paragrafi 1 parasheh mundësinë që veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi brenda tagrave që i janë dhënë krijojnë pasojë drejtpërdrejtë për të përfaqësuarin. Edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, në nenin 73 paragrafi 1 thekson se “kontrata të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar dhe në kuadrin e autorizimeve të veta, e obligon drejtpërdrejtë të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktues”.

Përfaqësimi, jo vetëm që nënkupton lidhjen e punës juridike në emër të tjetërkujt por nënkupton edhe për llogari të tjetër kujt, që do të thotë se të drejtat dhe detyrimet si dhe efekti i arritur pasuror me anë të punës juridike të ndërmarrë nga përfaqësuesi, krijojnë përfitime ose pasojë ndaj masës pasurore të përfaqësuarit (Aliu, 2013:341). Lidhja e punës juridike nga përfaqësuesi prodhon efekte juridike për të përfaqësuarin, respektivisht përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të përfaqësuarit.

## Llojet e përfaqësimit

Duke marrë parasysh se përfaqësimi mund të krijohet me ligj apo me kontratë, në këtë punim për objekt trajtimi kemi përfaqësimin ligjor, kontraktues, përfaqësuesin e personit juridik dhe përfaqësimin me prokurë.

### Përfaqësimi ligjor

Përfaqësues të këtyllë janë prindërit dhe kujdestari. Ata nuk i emëron vetë pala. Autorizimet e përfaqësuesit ligjor dalin drejtpërdrejt nga ligji apo nga akti i organit të kujdestarisë. Të miturin, i cili nuk është nën kujdestari, e përfaqësojnë, sipas ligjit, prindërit e tij bashkërisht. Kjo që u tha vlen edhe për ata të moshës madhore, të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore. Përfaqësimi ligjor ekziston, atëherë kur përfaqësuesi dhe kufijtë e autorizimeve të tij burojnë drejtpërsëdrejti nga dispozitat ligjore. Përfaqësuesi ligjor është personi fizik i cili në bazë të ligjit është i autorizuar që të ndërmarrë veprime juridike, respektivisht punë juridike në emër dhe për llogari të përfaqësuarit që mund të jenë persona fizik (Morina & Nikci 2012:179) ose juridik (Aliu, 2013:342). Në përfaqësimin ligjor, ose siç quhet ndryshe i detyrueshëm, është ligji ai që përcakton lindjen e përfaqësimit, caktimin e përfaqësuesit, si dhe kufijtë e të drejtave të tij, tagrat e përfaqësimit. Ai vendos detyrimisht, si për të përfaqësuarin dhe për përfaqësuesin, me vërtetimin e atij fakti juridik me të cilin ligji lidh lindjen, ndryshimin apo shuarjen e marrëdhënies juridike të përfaqësimit. Shembull: lindja e fëmijës, është një ngjarje, e cila sjellë si pasojë lindjen e marrëdhënies së përfaqësimit të fëmijës nga prindërit e tij. Përfaqësimi ligjor mund të krijohet edhe si rezultat i një vendimi gjyqësor, në rastet kur: caktimi i kujdestarisë për të miturin. Sipas nenit 263 të Kodit të Familjes në Shqipëri, janë të miturit që vendosen nën kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti (Latifi, 2009:135). Përfaqësimi, përveç që bëhet me normë ligjore, ai mund të bëhet edhe në bazë të aktit të përgjithshëm të personit juridik, në bazë të aktit të organit kompetent, dhe në të gjitha këto raste përfaqësimi quhet përfaqësim ligjor.

Në bazë të aktit të përgjithshëm të personit juridik (statutit) mund të përfaqësohen vetëm personat juridik me të cilin akt caktohet personi (individit) i cili është i autorizuar nga statuti si përfaqësues i personit juridik. Përfaqësimi me aktin e organit kompetent ekziston në rastet kur organi shtetërorë p.sh. gjykata me vendim të veçantë e cakton përfaqësuesin për mbrojtjen e interesave të personit, i cili nuk ka përfaqësues ligjor e është e nevojshme përfaqësimi i tij. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, në nenin 72 paragrafi 2 e parasheh si bazë në të cilin mund të bazohet autorizimi për përfaqësuesin edhe aktin e organit kompetent. Shembull: mund të përmendet rasti kur gjykata me vendim të saj e cakton përfaqësuesin (Aliu, 2013:343).

Neni 100 i Ligjit për procedurën jokontestimore në Kosovë, thotë se personi ndaj të cilit vazhdohet e drejta prindërore e përfaqëson kujdestari i posaçëm të cilin e cakton organi i kujdestarisë ose përfaqësuesi i përkohshëm, të cilin e cakton gjykata e cila e zhvillon procedurën për vazhdimin e të drejtës prindërore. Kur përfaqësuesi emërohet me vendim të gjykatës, konsiderohet përfaqësues i aktit të organit kompetent. Mundësinë për ta caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, palës së paditur me vendim të veçantë nga gjykata e parasheh neni 79 i Ligjit për Procedurën Kontestimore në Kosovë. Kështu, si raste kur gjykata me vendim e cakton përfaqësuesin e përkohshëm palës së paditur, bazuar në nenin 79 paragrafi 2 i Procedurës

Kontestimore në Kosovë janë: a) nëse i padituri nuk e ka zotësinë procedurale, ndërsa nuk e ka përfaqësuesin ligjor; b) nëse ekzistojnë interesat e kundërta të paditurit dhe përfaqësuesit ligjor të tij; c) nëse të dy palët ndërgjyqësore kanë përfaqësimin e njëjtë ligjor. Po ashtu, neni 79 paragrafi 3 i Ligjit për Procedurën kontestimore në Kosovë parasheh këto raste kur gjykata mund t'i caktojë palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm: a) nëse vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë; b) nëse i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij, nuk kanë përfaqësues me prokurë, ndodhen jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur të bëhet.

Në pajtim e dispozitat e nenit 79 të Procedurës Kontestimore në Kosovë, gjykata ia cakton e përfaqësuesin e përkohshëm dhe personit juridik. Kjo mundësi parashihet në nenin 80 të Ligjit për procedurën kontestimore në Kosovë. Gjithashtu, neni 82 paragrafi 1 i këtij ligji ka paraparë që përfaqësuesi i përkohshëm për të cilën është caktuar, i ka në procedurë të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor.

## Përfaqësimi kontraktues

Përfaqësimi krijohet me punë juridike (kontratë), e cila lidhet në mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Kontrata përmban prokurën nga e cila rrjedhë autorizimi për përfaqësim. Neni 77 paragrafi 2 i Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë thekson se, ekzistimi dhe vëllimi i prokurës janë të pavarur nga raporti juridik për bazën e së cilës është dhënë prokura. Po ashtu, paragrafi 3 i të njëjtit nen parasheh që i autorizuar mund të jetë edhe personi juridik. Kjo ndodhë kur si i autorizuar nga personi fizik, për përfaqësim është p. sh. një zyre ligjore apo grup ekspertësh të cilët e kanë statutin e personit juridik. Neni 70 i Kodit Civil të Shqipërisë parasheh se, prokura është dokument në të cilin i përfaqësuarit, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagrave që i ka dhënë përfaqësuesit.

Prokura shihet në dy kuptime: kuptimi i parë i termit prokurë, i referohet asaj si shkresë-si dokument, në të cilin fiksohet, materializohet shfaqja e vullnetit të përfaqësuarit, si dhe kufijtë e të drejtave të përfaqësuesit, si dhe tagrat e përfaqësimit. Kuptimi i dytë i termit prokurë, i referohet veprimit juridik të përfaqësimit, mbi bazën e të cilit lind marrëdhënia juridike e përfaqësimit, midis të përfaqësuarit, i cili shfaqë vullnetin e tij për caktimin e personit-përfaqësuesit, i cili do të veprojë në emër dhe për llogari të tij (Latifi, 2009:137).

## Përfaqësimi me prokurë

Prokura është autorizim me shkrim, të cilin mund ta japë personi fizik apo juridik. Përfaqësim me prokurë, apo përfaqësim vullnetarë kemi në të gjitha ato raste kur përfaqësimi lindë në bazë të deklarimit të vullnetit të të përfaqësuarit. Përfaqësuesi me prokurë quhet personi i cili përfaqëson në bazë të prokurës. Termi "prokurë" ka disa kuptime; **së pari** prokura është veprim juridik i njëanshëm me anë të të cilit subjekti si palë ndërgjyqëse shfaq vullnetin e vet që një person tjetër i caktuar prej tij që quhet përfaqësues të kryejë në emër e për llogari të të përfaqësuarit veprime procedurale, të cilat krijojnë të drejta e detyrime drejtpërdrejt për të përfaqësuarin. **Së dyti**, me prokurë kuptohen tagrat që i janë dhënë përfaqësuesit nga i përfaqësuarit dhe **së treti** me prokurë kuptohet edhe forma shkresore e kërkuar nga ligji, me anë të së cilës shprehet vullneti i të përfaqësuarit. Personi i cili kryen punë juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Përveç personit fizik, përfaqësuesi me prokurë mund të jetë edhe personi juridik.

Neni 77 paragrafi 3 i Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, shprehimisht parasheh se i autorizuar mund të jetë edhe personi juridik. Personi juridik, mund të jetë prokurë-marrës vetëm në kufijtë e zotësisë së tij juridike në pajtim me veprimtarinë që ushtron p. sh., nëse personi juridik është i autorizuar për lidhje të kontratave, atëherë detyrë e tij do të ishte lidhja e kontratës në emër dhe për llogari të prokurë-dhënësit. Personi juridik, mund të jetë edhe prokurë-dhënës, të cilën prokurë për personin juridik zakonisht e jep organi individual i tij ose kryetari i organit kolegjial të tij (kryetari i bordit) ose punëtori me autorizim të veçantë (Aliu, 2013:347).

## Forma e prokurës

Kur ligji e përcakton formën e prokurës, atëherë prokura duhet të lëshohet sipas formës së përcaktuar me ligj, në të kundërtën ajo është e pavlefshme. Neni 72 paragrafi 2 i Kodit Civil të Shqipërisë, thekson se prokura për të lidhur kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme. Kurse, neni 78 i Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë parasheh se forma e parashikuar me ligj për ndonjë kontratë ose për ndonjë punë tjetër juridike vlen edhe për prokurën që jepet për lidhjen e kësaj kontrate, përkatësisht për ndërmarrjen e kësaj pune juridike. Prokurë-marrësi kryen punë juridike në emër dhe për llogari të prokurë-dhënësit. Në këto raste, prokurë-dhënësi duhet të jap prokurën (autorizimin) me shkrim, ashtu siç kërkohet me ligj forma për lidhjen e kontratës (p.sh., kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë duhet të bëhet me shkrim dhe të vërtetohet te noteri (Aliu, 2013:347/348).

## Vëllimi i prokurës

Varësisht nga vëllimi i autorizimit që i jep i përfaqësuarit përfaqësuesit të tij, dallojmë prokurën e përgjithshme dhe prokurën e veçantë. Kur i përfaqësuarit i jep autorizime përfaqësuesit të tij për të kryer veprime juridike të rregullta të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përjashtimisht, atyre të drejtave të përjashtuara shprehimisht nga vetë i përfaqësuarit, konsiderohet prokurë e përgjithshme. Në këtë kuptim Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, në nenin 79 paragrafi 2 thekson se përfaqësuesi, të cilit i është dhënë prokura e përgjithshme

mund të ndërmerret vetëm punë juridike që i takojnë ushtrimit të veprimtarisë së rregullt. Kurse, ndërmarrja e veprimeve juridike nga përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, të cilat nuk bëjnë pjesë në punë të rregullta konsiderohet autorizim i veçantë.

Prokurën e veçantë e parashih Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë në nenin 79 paragrafi 3 puna që nuk hyn në veprimtari të rregullt mund të ndërmerret nga përfaqësuesi, vetëm në qoftë se është i autorizuar, veçanërisht për ndërmarrjen e kësaj pune ose të llojeve të punëve ku bën pjesë e njëjta. Kështu në nenin 79 paragrafi 4 thuhet se përfaqësuesi nuk mundet, pa autorizim të veçantë për secilin rast të veçantë, të ndërmarrë detyrimin kambialor, të lidhë kontratë për dorëzanimë, për pajtimin, për gjykatën e zgjedhur ose arbitrazhin, për tjetërsimin apo ngarkimin e paluajtshmërive, që të përfshihen në një kontest e as të heqë dorë nga ndonjë e drejtë pa shpërblim.

Si prokura e përgjithshme edhe ajo e posaçme, mund të përmbajnë kufizime për veprimtarinë e përfaqësuesit. P.sh., ato mund të kenë të bëjnë me administrimin e pasurisë së të përfaqësuarit, por jo me tjetërsimin e të mirave të të përfaqësuarit (Nuni, 2012:258/259).

### **Shuarja e prokurës**

Shuarja e prokurës së dhënë nga përfaqësuesi, mund të shuhet në rastet e parashikuara me ligj. Prokura mund të shuhet kur prokurë-dhënësi e revokon prokurën e dhënë; kur prokurë-dhënësi heq dorë nga e drejta e dhënë me prokurë; me vdekjen e prokurë-dhënësit apo të prokurë-marrësit; në rast të shuarjes së personit juridik si prokurë-dhënësi apo si prokurë-marrës; në rast se prokurë-dhënësi i hiqet zotësia për të vepruar.

Revokimi si formë e shuarjes së prokurës mund të bëhet me anë të deklaratës në çdo kohë dhe pa ndonjë formë të posaçme. Prokurë-dhënësi mund ta revokojë prokurën e dhënë, edhe në qoftë se me kontratë ka hequr dorë nga e drejta e revokimit, sepse sipas ligjit heqja dorë nuk prodhon efekt juridik. Përveç revokimit të prokurës, prokurë-dhënësi ka të drejtë edhe në kufizimin e prokurës. Në këtë rast prokura nuk shuhet, por kufizohet autorizimi i dhënë nga prokurë-dhënësi. Revokimi si formë e njëanshme e deklaratimit të vullnetit të prokurë-dhënësit me të cilën bëhet tërheqja e prokurë së dhënë, shkakton shuarjen e tërësishme të prokurës, kurse kufizimi i prokurës shkakton shuarjen e prokurës vetëm në pjesët e kufizuara d.m.th., këtu kemi shuarje të pjesërishtme të prokurës. Në qoftë se me revokimin ose me kufizimin e prokurës është cenuar kontrata për dekretin ose kontrata për veprën, apo ndonjë kontratë tjetër, i autorizuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar me këtë. Në rastet kur prokurë-dhënësi e revokon apo e kufizon prokurën e dhënë, kjo nuk do të ketë efekt ndaj personit të tretë i cili ka lidhur kontratë, apo ndonjë punë tjetër juridike me të autorizuarin dhe nuk e dinte, e as që ishte i obliguar ta dinte faktin se prokura është kufizuar apo revokuar. Në këtë rast, personi i tretë i cili ka lidhur kontratë me përfaqësuesin, të cilit i është hequr apo kufizuar prokura, për të cilën ai nuk kishte dijeni, ka të drejtë të kërkojë nga i autorizuari shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga puna juridike. Prokurë-dhënësi, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga lidhja e punës juridike të kryer nga i autorizuari i cili nuk kishte autorizim, sepse autorizimi i ishte revokuar apo kufizuar, këtë të drejtë nuk mund ta realizojë në qoftë se i autorizuari nuk ishte në dijeni, e as që ishte i obliguar ta dinte se prokura është revokuar apo kufizuar. Po ashtu, prokura shuhet ashtu siç u përmend më lartë, kur shuhet personi juridik si i autorizuar, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndryshe, pastaj prokura shuhet me vdekjen e autorizuesit, ajo shuhet me shuarjen e personit juridik, përkatësisht me vdekjen e personit që e ka dhënë atë, përveç nëse puna e filluar nuk mund të ndërpritet pa u shkaktuar dëm trashëgimtarëve ligjorë, apo nëse prokura vlen edhe në rast të vdekjes së dhënësit të prokurës, si me vullnetin e tij, ashtu edhe duke marrë parasysh karakterin e punës.

### **Përfaqësimi i personit juridik në bazë të statutit**

Përfaqësimi i personit juridik buron nga statuti me të cilin është themeluar dhe regjistruar. Neni 31 i Kodit Civil të Shqipërisë, thekson se personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, me aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij. Personat juridikë marrin pjesë në qarkullimin juridik me anë të personave fizikë, të cilët kryejnë veprime relevante. Personat fizikë, që veprojnë në emër të personave juridikë, caktohen zakonisht me statutin e tyre. Në qoftë se në aktet e tilla nuk ka dispozita për përfaqësimin e personave juridikë, subsidiarisht zbatohen dispozitat adekuate ligjore. Personat e përmendur kanë autorizime që të emërojnë përfaqësues me prokurë, të cilët tagrat e tyre i mbështesin në vullnetin e organeve të personave juridikë. Personi juridik nuk ka zotësi veprimi, nga e cila arsye edhe punët juridike i ndërmerret nëpërmjet të përfaqësuesit. Përfaqësuesi i personit juridik është i caktuar me ligj ose me akte normative të personit juridik, ku është i caktuar edhe vëllimi i autorizimeve. Pra, personat juridik përfaqësohen në gjykatë nga organet e tyre të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut.

### **Përfaqësimi në bazë të aktit të organit shtetërorë (përfaqësimi gjyqësorë)**

Gjykata në disa raste mund të caktojë përfaqësues si për personin fizikë, po ashtu edhe për atë juridik. Neni 78 paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën kontestimore në Kosovë thekson kur gjykata konstaton se pala nuk ka përfaqësues ligjor, apo se përfaqësuesi ligjor nuk e ka autorizimin e veçantë, kur ky nevojitet, do të kërkojë që organi kompetent i kujdestarisë, t'ia caktojë kujdestarin personit me pazotësi procedural, respektivisht do të ftojë përfaqësuesin ligjor që të pajiset me autorizim të veçantë ose të ndërmarrë masa të tjera që nevojiten që pala me pazotësi procedurale të përfaqësohet në mënyrë të drejtë. Kurse në nenin 79 paragrafi 1 parashih rastet kur mund të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm ligjor: poqëse, gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë tregohet se procedura e zakonshme rreth përfaqësimit ligjor për të paditurin do të zgjaste shumë, kështu që për këtë arsye do të mund të lindnin pasoja të dëmshme për njërin apo të dy palët, gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm. Në nenin 79 paragrafi 2 i Ligjit për

Procedurën kontestimore në Kosovë, theksohet se nën kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm sidomos në këto raste: a) në qoftë se i padituri nuk e ka zotësinë procedurale, ndërsa nuk e ka përfaqësuesin ligjor; b) në qoftë se ekzistojnë interesat e kundërta të të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij; c) në qoftë se të dy palët ndërgjyqësore kanë të njëjtin përfaqësues ligjor. Kurse, po në nenin 79 paragrafi 3 i Ligjit për Procedurën kontestimore në Kosovë, parasheh se gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë; b) në qoftë se i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij, nuk kanë përfaqësues me prokurë, ndodhen jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur të bëhet. Pra, Përfaqësuesi gjyqësor caktohet me vendim të gjykatës gjatë zhvillimit të një procedure gjyqësore nën kushtet e parashikuara me ligj (neni 79 i LPK) dhe përfaqësuesi i caktuar nga ana e gjykatës i ka në procedurë të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor.

## Efektet e përfaqësimit

Nga përfaqësimi krijohen të drejta dhe obligimi për të përfaqësuarin, edhe pse veprimi juridik i kryer është ndërmarrë nga përfaqësuesi i tij. Në nenin 73 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, paragrafi 1 parashihet se “kontrata të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar dhe në kuadrin e autorizimeve të veta, e obligon drejtpërdrejtë të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese”. Kurse neni 66 i Kodit Civil të Shqipërisë, paragrafi 1 përcakton se veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi brenda tagrave që i janë dhënë, krijojnë pasoja drejtpërdrejtë për të përfaqësuarin. Kryerja e punës juridike nga përfaqësuesi, i cili shfaqë vullnetin e vet në kryerjen e kësaj pune, krijon të drejta dhe obligime për të përfaqësuarin në emër dhe për llogari të cilit lidhë punën juridike. Pra, masa pasurore e të përfaqësuarit me punët juridike të bëra nga përfaqësuesi mund të shtohet ose të zvogëlohet dhe efekti pasuror lind vetëm për të përfaqësuarin dhe nuk e prekë fare përfaqësuesin, të cilit në të shumtën e rasteve për punën e bërë i takon shpërblimi (Aliu, 2013:341).

## Tejkalimi i autorizimit për përfaqësim

Veprimet të cilat mund t'i ndërmarrë përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, duhet të jenë brenda autorizimit të dhënë. Tejkalimi i autorizimit nga përfaqësuesi nuk e obligon të përfaqësuarin, megjithëse i përfaqësuarit mund ta pranojë punën e kryer e cila nuk ishte brenda autorizimeve të dhëna.

Në nenin 75 paragrafi 1 parashihet se kur përfaqësuesi i tejkalon kufijtë e autorizimit, i përfaqësuarit është në obligim vetëm në qoftë se e miraton kapërcimin. Në qoftë se i përfaqësuarit nuk e aprovon kontratën brenda afatit që nevojitet, ku kontrata e llojit të tillë të shqyrtohet e të vlerësohet, do të konsiderohet se aprovimi nuk është dhënë fare (neni 75 paragrafi 2 i LMD-së së Kosovës). Kurse në paragrafin 4 të nenit të njëjtë, theksohet se në qoftë se, pa tjetër nuk ka ditur dhe as që është dashur ta dinte për kapërcimin e autorizimit, menjëherë posa të ketë mësuar për tejkalimin e bërë, mundet duke mos pritur që i përfaqësuarit të deklarohet rreth kontratës, ta deklarojë se nuk e quan veten të obliguar nga kontrata.

Palës së tretë me të cilin është lidhur puna juridike nga përfaqësuesi jashtë autorizimit të dhënë nga i përfaqësuarit i lejohet të heqë dorë nga puna juridike. Në qoftë se i përfaqësuarit e refuzon lejin, përfaqësuesi dhe i përfaqësuarit janë solidarisht përgjegjës për dëmin që e ka pësuar pala tjetër, po qe se kjo nuk ka ditur dhe as që është dashur të ishte në dijeni për tejkalimin e autorizimit (LMD i Kosovës neni 75 paragrafi 5). Shkaktimi i dëmit nga ana e përfaqësuesit, qoftë për shkak të tejkalimit të autorizimit ose veprimtarisë së rregullt të tij, mund të ndodhë vetëm te punët juridike ku kërkohet deklarimi i vullnetit të tij, p.sh., shkëputja e kontratës (Aliu, 2013:349).

## Përfundim

Nga trajtimi i kësaj teme shihet se përfaqësimi është një marrëdhënie juridike civile në të cilën një person fizik ose juridik, duke vepruar brenda kufijve të të drejtave që i janë dhënë nga ligji, prokura apo gjykata-tagrave të përfaqësimit kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të një personi fizik apo juridik tjetër, veprime nga të cilat vijnë pasoja juridike, drejtpërdrejtë për të përfaqësuarin. Po ashtu u pa se përfaqësuesi ka disa karakteristika të cilat janë: përfaqësuesi duhet të ketë zotësi juridike për të vepruar, duhet të veprojë vetë përveç rasteve kur është lejuar nga vetë i përfaqësuarit ta caktojë një zëvendës; përfaqësuesi kryen veprime në emër dhe për llogari të tij (përfaqësuarit); veprimet e kryera brenda kufijve të përfaqësimit janë të detyrueshme për të përfaqësuarin, përfaqësuesi.

Nga trajtimi i këtij punimi vërehet se efekti kryesor i përfaqësimit i realizuar në ndonjë veprim juridik është që të drejtat dhe detyrimet lindin, jo në emër dhe për llogari të përfaqësuesit, por në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, me emrin e të cilit është përfunduar veprimi juridik. Po ashtu u vërejt se veprimi juridik i përfaqësimit sjell këto pasoja juridike: përfaqësimi bën që të lindin detyrime në raportin përfaqësues i përfaqësuar; detyrimin e përfaqësuarit që të sillt në ushtrimin e funksionit të tij si një person që me maksimumin e mundësive të përmbushë funksionin dhe më pas të jap llogari për veprimet që ka kryer, me personat e tretë me të cilët ka kontaktuar përfaqësuesi; ai nuk është i lidhur me detyrimet e lindura nga veprimi juridik si për shembull kontrata.

## Bibliografia

- Aliu, Abdullah, (2013), E drejta civile, Prishtinë.
- Nuni, Ardian, (2012) E drejta civile, Tiranë.
- Latifi, Juliana, (2009) E drejta civile, Tiranë.
- Dimitar Spasenoski, Darko Bulldioski, Sllavica Bilarska- Mirçeski, Darko Aleksov, (2010), Doracak për përfaqësim, asociacioni për qytetar , Most, Shkup, Maqedoni.
- Morina, Iset & Nikci, Selim, (2012) Komentari i Ligjit për Procedurën Kontestimore, Botim i GiZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH & Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Prishtinë.
- Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin nr.8536, datë 18.10.1999 ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 dhe ligjin nr.17/2012.
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë, Nr. 04/ L-077, 10 maj 2012.
- Ligji për Procedurën kontestimore në Kosovë, Nr. 03/ L-006, 30 qershor 2008.
- Ligji për Procedurën jokontestimore në Kosovë Nr. 03/ L-007, 20 nëntor 2008.

# KONTRATA E AGJENCISË NË KODIN CIVIL SHQIPTAR

---

## ENDIRA BUSHATI

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik, Departamenti i të Drejtës Private

E-mail: endira.bushati@uet.edu.al

---

## ABSTRAKT

Kontrata e Agjencisë parashikohet në Kodin Civil Shqiptar në nenet 950-961. Ndryshimet në këtë kod në vitin 2012, sollën ndryshime thelbësore në përmbajtjen e kësaj kontrate, në krahasim me rregullimin e mëparshëm. Me zhvillimin ekonomik, agjencia po përhapet cdo ditë e më shumë, si kontratë që promovon biznesin në fushën e qarkullimit civil. Punimi analizon natyrën e kontratës së agjencisë, karakteristikat e kontratës, marrëdhëniet mes porositësit dhe agjentit. Gjithashtu, trajtimi teorik i përmbajtjes së kontratës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, çështjet e ekskluzivitetit, gjejnë trajtim në punim. Të gjitha këto aspekte ilustrohen edhe me raste praktike, duke evidentuar dhe vecoritë që hasen tek kjo kontratë në vendin tonë. Po kështu nxirren në pah dhe përmirësimet në rregullimin ligjor pas ndryshimeve në Kodin Civil në vitin 2012.

**Fjalë kyç:** *detyrim, agjenci, agjent, porositës, dëm*

---

## Hyrje

Me rritjen e zhvillimit ekonomik, rritjen e qarkullimit civil, agjencia po përhapet cdo ditë e më shumë si kontratë që promovon biznesin dhe i vjen në ndihmë konsumatorëve dhe klientëve në përgjithësi. Kontrata e agjencisë është një kontratë moderne që u përgjigjet kërkesave të biznesit në fushën e tregtisë, të cilët përmes rolit të agjentit arrijnë të realizojnë shpërndarjen e produkteve të tyre në qarkullimin civil.

Fillesat historike në Europë (Itali, Francë) kjo kontratë i pati rreth viteve 1800 në fushën tregtare, si nevojë e rritjes së shkëmbimeve tregtare ndërkombëtare. Rregullimi ligjor, konceptet dhe sistemimi i normave përkatëse në vendet e familjes Civil Laë erdhi shumë më vonë, p.sh. në legjislacionin italian u parashikua si kontratë më vete, vetëm në Kodin Civil të 1942.

Kontrata e Agjencisë në kodet civile ka qëndruar për shumë kohë e pandryshuar, derisa u bë objekt rregullimi me Direktivën 86/653 KEE datë 18.12.1986 “Mbi koordinimin e të drejtave të shteteve anëtare në lidhje me agjentët tregtarë të pavarur”.

Kontrata e Agjencisë parashikohet nga kreu XIII, në nenet 950-961 të Kodit tonë Civil. Ndryshimet që iu bënë Kodit Civil me Ligjin nr.17/2012 sollën ndryshime thelbësore në rregullimin ligjor të kësaj kontrate, në raport me rregullimin e mëparshëm.

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Sipas nenit 950 të Kodit Civil, “Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.” Punimi shkencor i cili do të trajtojë, lidhet me marrjen në vështrim analizues të çështjeve që lidhen me përmbajtjen e kontratës së agjencisë sipas Kodit Civil shqiptar. Do të shihen dhe analizohen në detaje të drejtat e porositësit dhe agjentit në këtë kontratë. Kontrata e agjencisë ka për objekt kryerjen e veprimeve, ka karakter periodik e të vazhdueshëm dhe është kontratë me shpërblim. Ndryshimet e vitit 2012 në KC sollën një rregullim të ri ligjor për kontratën e agjencisë. Nën prizmin e këtyre ndryshimeve do të trajtohet edhe punimi mbi këtë kontratë.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

*Hipoteza:* Kontrata e agjencisë ka për objekt kryerjen e veprimeve, lidhjen e kontratave në një zonë të caktuar nga njëra palë, në mënyrë të vazhdueshme dhe kundrejt shpërblimit, për llogari të palës tjetër. Megjithatë, mes porositësit dhe agjentit nuk ka lidhje varësie apo hierarkike, edhe pse agjenti është i detyruar të ndjekë udhëzimet e porositësit. Agjenti ka pavarësi ekonomike dhe funksionale në kryerjen e aktivitetit të vet.

*Metodologjia e punimit:* Metodologjia e përdorur në përgatitjen e këtij punimi është metoda e analizës së legjislacionit dhe vendimeve eventuale gjyqësore në praktikën shqiptare. Kjo metodë konsiston në formulimin e problemeve ligjore nepërmjet analizës së legjislacionit. Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nepërmjet interpretimit të këtyre normave.

*Pyetja kërkimore:* Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të porositësit dhe agjentit, si dhe raporti mes tyre?

## Kontrata e Agjencisë në Kodin Civil Shqiptar

### Karakteristikat e kontratës

Në nenin 950 të Kodit Civil jepet përkufizimi i kontratës së agjencisë. Kështu, “Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.” Në paragrafin e dytë të këtij neni parashikohet e drejta e secilës palë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj. Nga ky përkufizim, dalin elementët dhe karakteristikat e kontratës:

1. Kontrata e agjencisë bën pjesë në grupin e atyre kontratave që kanë për objekt kryerjen e veprimeve. Palët në këtë kontratë quhen agjenti dhe porositësi.
2. Kontrata e agjencisë ka karakter vazhdueshmë ose periodik, në kuptimin që agjenti ka një marrëdhënie të vazhdueshme me porositësin, për llogari të të cilit lidh kontrata në një zonë të caktuar.
3. Kontrata e agjencisë është kontratë me shpërblim.
4. Nga paragrafi i dytë i nenit, kontrata e agjencisë kategorizohet si kontratë formale, ku forma kërkohet për efekt provueshmërie.
5. Kontrata e agjencisë mes një agjenti dhe porositësi lidhet për kryerjen e veprimeve vetëm në një zonë të të caktuar.
6. Mes porositësit dhe agjentit nuk ka lidhje varësie apo hierarkike, edhe pse agjenti është i detyruar të ndjekë udhëzimet e porositësit. Agjenti ka pavarësi ekonomike dhe funksionale në kryerjen e aktivitetit të vet.

Në nenin 951 parashikohet ekskluziviteti, si një nga elementët më thelbësorë të kësaj kontrate. Kështu, porositësi nuk mund të pajtojë njëkohësisht më shumë se dy agentë në të njëjtën zonë dhe për të njëjtën fushë të veprimtarisë. Nga ana tjetër, agjenti nuk mund të marrë përsipër të trajtojë në të njëjtën zonë dhe për të njëjtën fushë, marrëveshjet e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre. Agjentit mund t'i drejtohen kundërshtimet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e kontratës të lidhur nëpërmjet tij dhe reklamimet lidhur me mospërbushjen e kësaj kontrate. Agjenti mund të kërkojë marrjen e masave mbrojtëse në interes të palës porositëse dhe të paraqesë reklamimet që janë të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave që i takojnë kësaj të fundit.<sup>1</sup> Gjithashtu, në nenin 952 parashikohet se, agjenti nuk ka të drejtë të vjelë kreditë e palës porositëse. Në qoftë se kjo e drejtë i është dhënë nga porositësi, ai nuk mund të bëjë zbritje ose të lejojë vonesa pa patur autorizim të posaçëm të porositësi për këto veprime.

## Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Sipas neneve 954 e në vijim të Kodit Civil, kontrata e agjencisë është kontratë e dyanshme. Kjo nënkupton që mes porositësit dhe agjentit lindin të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Këto të drejta dhe detyrime janë:

- a) Agjenti duhet të përmbushë detyrën e ngarkuar në përputhje me udhëzimet e marra nga porositësi;
- b) Agjenti duhet t'i japë palës porositëse informacionet që kanë të bëjnë me kushtet e tregut në zonën që është caktuar;
- c) Agjenti duhet ta informojë porositësin mbi gjendjen pasurore të klientëve të mundshëm dhe t'i japë atij çdo informacion tjetër të dobishëm për të vlerësuar leverdinë e marrëveshjeve të veçanta;
- d) Agjenti duhet të zbatojë detyrimet që i takojnë komisionerit deri sa ato nuk përjashtohen nga natyra e kontratës së agjencisë;
- e) Përveç marrëveshjes së kundërt, agjenti nuk mund të depozitojë ose të regjistrojë shenjat dalluese që identifikojnë veprimtarinë e palës porositëse;
- f) Agjenti kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e besuar duhet të njoftojë menjëherë palën porositëse, përndryshe detyrohet të shpërblejë dëmin;
- g) Agjenti ka të drejtë të shpërblehet për ndërmjetësim vetëm për marrëveshjet që janë zbatuar rregullisht. Në qoftë se marrëveshja është zbatuar në mënyrë të pjesshme, shpërblimi që i takon agjentit është në përpjesëtim me pjesën e kryer të saj. Dispozita ligjore parashikon se shpërblimi paguhet edhe për marrëveshjet e përfunduara drejtpërdrejt nga pala porositëse, të cilat duhet të ekzekutohen në zonën e rezervuar për agjentin, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe;
- h) Agjenti ka të drejtë për shpërblim mbi marrëveshjet e përfunduara edhe pas zgjidhjes së kontratës, po qe se përfundimi është sidomos rrjedhim i veprimtarisë së kryer prej tij. Në këtë rast, agjenti nuk ka të drejtë të ripaguhet për shpenzimet e agjencisë;
- i) Pala porositëse duhet të vërë në dispozicion të agjentit dokumentet e nevojshme për pasurinë ose shërbimet e trajtuara;
- j) Porositësi duhet t'i japë agjentit informacionet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sidomos ai duhet të njoftojë agjentin, brenda një afati të arsyeshëm, sapo të parashikojë se vëllimi i operacioneve tregtare do të jetë mjaft më i ulët nga vëllimi që agjenti do të priste normalisht.
- k) Pala porositëse duhet gjithashtu të informojë agjentët brenda një afati të arsyeshëm për pranimin ose refuzimin dhe moskryerjen e një marrëveshjeje që e ka siguruar agjenti. Pala porositëse i dorëzon agjentit një ekstrakt llogarie të shpërblimit që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit, gjatë të cilit ai është fituar. Ekstrakt llogaria duhet të tregojë elemente thelbësore në bazë të të cilave është kryer llogaria e shpërblimit. Brenda të njëjtit afati shpërblimet e likuiduara duhet t'i paguhet efektivisht agjentit;
- l) Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet, në veçanti një ekstrakt i librave të llogarive të nevojshme për verifikimin e madhësisë së shpërblimeve të likuiduara;
- m) Shpërblimi i takon agjentit edhe për marrëveshjet që nuk janë zbatuar për shkaqe që i përkasin palës porositëse. Në qoftë se pala porositëse dhe pala e tretë merren vesh për të mos zbatuar kontratën pjesërisht ose tërësisht, agjenti ka të drejtë që, për pjesën e pazbatuar, të përfitojë një shpërblim të zvogëluar në masën e caktuar me marrëveshje, sipas zakonit dhe në mungesë të tyre nga gjykata.

Kontrata e agjencisë sipas nenit 958 të Kodit Civil, është një kontratë me afat të caktuar. Por, kjo dispozitë ligjore parashikon se, kur kontrata vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të afatit, atëherë kontrata e agjencisë shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Nëse kontrata e agjencisë është me afat të pacaktuar, secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati.

Dispozita ligjore parashikon kohën më të shkurtër të këtij afati në raport me kohëzgjatjen e kontratës. Kështu, afati i njoftimit paraprak nuk mundet, sidoqoftë të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, katër muaj për vitin e katërt, pesë muaj për vitin e pestë dhe gjashtë muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjithë vitet në vazhdim. Palët mund të merren vesh për afatin e njoftimit paraprak të kohëzgjatjes më të madhe, por pala porositëse nuk mund të zbatojë një afat më të shkurtër se sa ai i caktuar për agjentin Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të njoftimit paraprak duhet të përkohet me ditën e fundit

<sup>1</sup> Neni 953 KC



të muajit kalendarik. Dispozita ligjore e nenit 959 parashikon se, në mbarim të marrëveshjes së agjencisë, pala porositëse detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim në masën dhe kur:

- agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm marrëveshjet me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga marrëveshjet me këta klientë;
- pagimi i këtij shpërblimi quhet i përshtatshëm, kur janë patur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht shpërblimi që agjenti humbet nga marrëveshjet me këta klientë.

Nuk paguhet shpërblim kur:

- pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak të një mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila për shkak të përmasave të saj, nuk lejon vazhdimin qoftë edhe të përkohshëm të marrëveshjes;
- agjenti tërhiqet nga kontrata përveç rastit kur tërheqja justifikohet nga rrethanat që mund t'i përkasin agjentit, siç janë moshja, paaftësia e përkohëshme ose sëmundjet, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;
- lidhur me një marrëveshje që ka me palën porositëse, agjenti i lëshon një pale të tretë të drejtat dhe detyrimet që ai ka nga kontrata e agjencisë.

Madhësia e shpërblimit nuk mund të tejkalojë një shifër të barabartë me shpërblimin vjetor të llogaritur mbi bazën e mesatares vjetore të shpërblimeve të përfituara nga agjenti në pesë vjetët e fundit dhe po qe se kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, mbi mesataren e periudhës në fjalë. Dhënia e shpërblimit nuk privon agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve. Agjenti e humb të drejtën e shpërblimit të parashikuar në këtë nen po qe se brenda një viti nga ndërprerja e marrëdhënies nuk i njofton palën porositëse kërkesat e tij. Marrëveshja që kufizon konkurrencën nga ana e agjentit pas zgjidhjes së kontratës duhet të bëhet me shkrim. Kjo duhet të trajtojë të njëjtën zonë klientele dhe sende, pasuri ose shërbime për të cilat ishte lidhur kontrata e agjencisë dhe kohëzgjatja e saj nuk mund të tejkalojnë dy vitet e mëpasme nga zgjidhja e kontratës.

Në nenin 961 të Kodit Civil parashikohet një dispozitë refereruese, duke përcaktuar se dispozitat për kontratën e agjencisë zbatohen edhe kur pala porositëse i jep agjentit të drejtën e përfaqësimit për lidhjen e kontratave.

- ii. Përfundimi i kontratës së agjencisë

Në mënyrë të përmbledhur rastet e përfundimit të kontratës së agjencisë janë:

1. kur kontrata ka qëllim realizimin e një objekti të caktuar dhe ky objekt realizohet;
2. kur kontrata është lidhur me afat të caktuar, përfundon me mbarimin e këtij afati;
3. vdekja e agjentit ose porositësit;
4. ekzistenca e papërgjegjshmërisë për shkak të sëmundjeve mendore të agjentit ose porositësit;
5. falimentimi i porositësit apo dhe i agjentit.

## Ngjashmëria me kontratat e tjera

Kontrata e agjencisë ka për objekt kryerjen e veprimeve apo shërbimeve nga njëra palë në favor të palës tjetër, dhe si e tillë kjo kontratë ka një ngjashmëri të madhe me kontratën e porosisë dhe me kontratën e ndërmjetësimit. Por, midis këtyre kontratave, përveç ngjashmërive, ekzistojnë dhe dallime. Në kontratën e porosisë, i porosituri kryen veprime në emër të vet dhe për llogari të porositësit. Tek kontrata e agjencisë, agjenti lidh kontrata në emër dhe për llogari të porositësit. Ndërkohë, kontrata e agjencisë dallon edhe nga kontrata e ndërmjetësimit, për shkak se ndërmjetësimi ka karakteristikë rastësinë dhe objektivitetin, ndërkohë që kontrata e agjencisë ka karakter vazhdues apo periodik, pra një marrëdhënie të qëndrueshme mes porositësit dhe agjentit.<sup>2</sup> Nuk ka praktikë gjyqësore për kontratën e agjencisë. Në Gjykatën e Tiranës gjatë periudhës 2013-2016, figuron në evidencat statistikore të kësaj gjykate vetëm një çështje dhe ajo e pushuar. Në këto kushte, është e vështirë të arrish në konkluzione të caktuara mbi vecoritë e kësaj kontrate në praktikat tregtare të vendit tonë.

## Vështrim krahasues

Kodi civil Italian e jep përkufizimin e kontratës së agjencisë në nenin 1742 të tij.<sup>3</sup> Shihet qartë që kodi ynë shqiptar ka ndjekur të njëjtin përkufizim. Në të drejtën italiane, pranohet se qëllimi i kontratës së agjencisë është promovimi i aktivitetit të porositësit, që aktiviteti i agjentit duhet të jetë i qëndrueshëm dhe jo rastësor, dhe që kontrata është formale për efekte

<sup>2</sup> Nuni A., Mustafaj I., Vokshi A., E drejta e detyrimeve II, Tiranë 2008, faqe 180

<sup>3</sup> “Col contratto di agenzia una parte (agente) assume stabilmente l’incarico di promuovere, per conto dell’altra (preponente), verso retribuzione, la conclusione di contratti in una zona determinata”

provueshmërie. Nëse agjenti lidh kontrata për llogari dhe në emër të porositësit, atëherë ai operon si përfaqësues tregtar. Agjenti duhet të veprojë me ndershmëri dhe mirëbesim<sup>4</sup> dhe duhet të jetë i regjistruar në një dhomë tregtie. Edhe në të drejtën franceze gjendet i njëjti përkufizim, me nënvizimin që mes agjentit, i cili mund të jetë person fizik ose juridik, dhe porositësit, nuk ka lidhje varësie apo hierarkike dhe agjenti e ushtron aktivitetin e tij në mënyrë të pavarur.

Një përjashtim është zhvilluar në fushën e *law of agency në familjen Common Law*. Pranohet që, nëse një *agent*, një person i caktuar për të kujdesur interesa të caktuara, një përfaqësues etj, gjendet në një situatë emergjence, ai mund të operojë në interes të *principal-it*, edhe pa marrë paraprakisht autorizimin (*agency of necessity*).<sup>5</sup> *Agency of necessity* përbën një institut, për shumë aspekte, paralel me institutin kontinental të gjerimit të punëve. Kërkohej në fakt që *agent* të ketë vepruar në një situatë emergjence, në interes të *principal* dhe në pamundësinë për t'u vënë direkt në kontakt për të marrë udhëzime. Nëse rezultojnë të integruara të gjitha këto kushte, *agent* mund të pretendojë, edhe gjyqësisht, për t'u rimbursuar nga *principal-i*. Pavarësisht këtyre shtrirjeve, *agency of necessity* vazhdon të përbëjë një institut me fushë zbatimi shumë të ngushtë. Kontrata e agjencisë shfaqet në disa forma, si psh. agjenci tregtare për shitjen ndërkombëtare të mallrave, të sigurimeve etj

## Konkluzione/ Rekomandime

Kontrata e agjencisë hyn në grupin e kontratave që ka për objekt kryerjen e veprimeve. Ajo ka si qëllim promovimin e biznesit apo aktivitetit të porositësit në qarkullimin civil. Pas ndryshimeve të fundit ligjore në 2012, kodi ynë civil ka një rregullim ligjor të përmirësuar në raport me rregullimin e mëparshëm. Kontrata e agjencisë është kontratë e dyanshme, me shpërblim, me afat, por mund të jetë dhe me afat të pacaktuar, kontratë formale, ku forma kërkohej për efekt provueshmërie. Në praktikën shqiptare ajo hasë më shpesh në fushën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme, në shitjen e mallrave, në fushën e sigurimeve etj. Në vitet e fundit, me rritjen e volumit të qarkullimit civil, edhe kjo kontratë haset më shpesh në praktikën e tregtisë. Sic edhe në vendet e tjera, përvec rregullimit ligjor nga kodi civil, kontrata e agjencisë gjen rregullim edhe në ligjet e tjera të vecanta, si ai tregtar, i konkurrencës, sigurimeve etj, me specifikat përkatëse për fushën.

Në nivel evropian, kontrata e agjencisë u bë objekt rregullimi me Direktivën 86/653 KEE datë 18.12.1986 “Mbi koordinimin e të drejtave të shteteve anëtare në lidhje me agjentët tregtarë të pavarur”.

## Bibliografia

1. Kodi Civil i RSH
2. Kodi Civil Italian
3. Direktiva 86/653 KEE datë 18.12.1986 “Mbi koordinimin e të drejtave të shteteve anëtare në lidhje me agjentët tregtarë të pavarur”.
4. Nuni A., Mustafaj I., Vokshi A., E drejta e detyrimeve II, Tiranë 2008
5. Galgano F., E drejta private, Luarasi 2008
6. Bushati E., Begatimi pa shkak, Dizertacion doktrature 2009

<sup>4</sup> Neni1746 I KCI

<sup>5</sup> Shih: Bushati E., Begatimi pa shkak, Dizertacion

# LIRIA KONTRAKTORE: SI DUHET TË ORIENTOHEM LEGJISLACIONIN SHQIPTAR?

---

**BRIKENA MILE, MSC**

Universiteti Europian i Tiranës, Juridik, E drejtë private  
brikena.mile@gmail.com

---

## ABSTRAKT

Në kodin tonë civil “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijëve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.” Për sistemin civil law vullneti i palëve formësohet në varësi të parashikimit që bën ligji për çdo marrëveshje specifike. Në sistemin common law (kryesisht ai britanik) i lejohet palëve të vendosin vetë përmbajtjen e kontratës. Doktrina e “laissez faire” ka pasur influencë të madhe në zhvillimin e të drejtës kontraktore, dhe sidomos në lirinë kontraktore. Në këtë sistem është vullneti i palëve ai që udhëheq gjithë marrëdhënien juridike. Është e rëndësishme që sistemi ekonomik i një vendi të korrespondojë me atë ligjor. Qëllimi i punimit synon reflektimin mbi çështjen dhe skicimi i një propozimi për të ndërhyrë në legjislacionin ekzistues dhe përmisimi i tij në linjë me sistemin ekonomik aktual. Punimi mbështetet tek analiza krahasuese e dy sistemeve, duke marrë në konsideratë specifikat e Shqipërisë. Duke bërë një interpretim logjik dhe historik të Kodit Civil, rezulton që iniciativa e lirë ekonomike dhe normat imperative funksionojnë në dëm të njëra-tjetres. Legjislacionet e common law e kanë zgjidhur prej kohësh këtë problem duke realizuar një harmonizim të plotë midis shoqërisë, ekonomisë dhe ligjit. Është e rëndësishme të kuptohet që individi është përgjegjës për veprimet që ndërmerr në raport me veten dhe të tjerët. Është e drejta e tij të hyjë në marrëdhënie kontraktore me cilindo dhe të negociojë për të gjitha elementet që ai beson se do përmbushin sa me mire qëllimin e lidhjes së kontratës. Të drejtën mund ta shfrytëzosh deri në atë pikë sa e drejta ngelet e ligjshme.

---

## Hyrje

“Kjo është një gjykatë ligji djalosh, jo një gjykatë drejtësie”.<sup>1</sup>

Si një vend me synime evropiane Shqipëria detyrohet të përafroj praktikat më të mira të vendeve me traditë të hershme juridike. Ndryshimet ekonomike duhet të korrespondojnë me kontesktin ligjor, ndërkaq lind nevoja për azhurnim dhe përshtatje të normave ekzistuese. Qarkullimi i lirë civil duhet të jetë në harmoni me frymën e ligjit civil ndaj dhe dua ta shtjelloj më tej idenë time për të nxjerr në pah ngurtësinë ligjore dhe përplasejn e saj me qëllimin fillestar. Dikur, duke qene nje shoqeri e izoluar shkuam drejt nje ekonomie te centralizuar e cila pasonte nje liri kontraktore thujtse te paqenë. Sot qe mbizotëron ekonomia e tregut jemi ende perballë një kuadri ligjor që nuk përmbush më së miri kërkesat e tij. Integrimi ne struktura europiane dhe ndërkombëtare do diktoj nevojën e riparjes së legjislacionit, sidomos atij civil-kontraktor. Azhurnimet e fundit të Kodit Civil nuk kanë mjaftuar për të shmangur një sërë ekuivokesh mes institueve të së drejtës civile. Zakonisht nocioni i iniciativës së lirë ekonomike nuk përputhet konceptualisht me autonominë kontraktore. Sidoqoftë autonoma kontraktore është instrument për të kuadruar lirinë ekonomike dhe për t'i vendosur asaj limite ligjore. Raporti mes tyre ngelet i kushtëzuar dhe në marrëdhënie simbiotike. Çdo kufizim i lirisë kontraktore ngelet legjitim nëse është në përputhje me parimet themelore kushtetuese. Në bazë të parimit sovran të vullnetit të palëve, interesat pasurore dhe jo vetëm rregullohen në mënyrë të vullnetshme dhe të padiskuteshme nga vetë ato, e gjyqtari mundet të ndërhyje vetëm në rast paqartësie. Liria kontraktore është pjesë e parimeve themelore kushtetuese dhe si e tillë konkuron me parimet e tjera, si solidariteti, siguria, rendi kushtetues etj. Punimi do të ndjekë këtë strukturë: Fillimisht do të shprehet qëllimi dhe objektivat e punimit, të cilat do të motivojnë hulumtimin dhe integrimin e një shumësie çështjesh. Pastaj do të vijohet me hipotezën, pyetjet kërkimore dhe metodologjinë e punimit. Punimi do të vazhdojë me analizën e të dhënave empirike si vendimet gjyqësore, legjislacioni civil law dhe common law dhe krahasimi mes tyre. Ne fund do të paraqesë konkluzionet dhe rekomandimet relevante për temën. Studimi mbështetet sidomos në doktrinën e huaj mbi sistemin civil law dhe common law, e cila mundëson një perspektivë të gjerë të pershkrimit dhe analizës së tyre. Përveç saj një rol i konsiderueshëm do t'i jepet praktikës gjyqësore në të dyja sistemet. Duke qenë se fokusi i studimit ngelet legjislacioni shqiptar mbi këtë fushë, do merret në analizë doktrina, ligjet dhe çdo praktikë e mundshme gjyqësore që referon drejt lirisë kontraktore dhe formave të shprehjes së saj.

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

**Qëllimi:** Ky studim ka për qëllim të evidentojë divergjencat mes sistemeve civil law dhe common law në fushën e përcaktimit të vullnetit kontraktor. Format e shprehjes së vullnetit në Kodin Civil shqiptar janë të pamjaftueshme për të ezauruar menyrat e shprehjes se vullnetit. Nëpërmjet këtij studimi synoj të përfshij forma të reja të shprehjes me qëllim adaptimin me ritmet socio-ekonomike qe po përjeton shoqëria jonë. Duke qenë një e drejtë e qarkullimit civil dhe element i drejtpërdrejtë i marrëdhënieve ekonomike te tregut, e drejta kontraktore kërkon një lloj autonomie që duhet të përcaktohet nga palët kontraktuese. Në një shoqëri të iniciativës së lirë si kjo e jona është mirë të tregohet kujdes me normat imperative. Një ekonomi tregu kërkon në mënyre logjike liri të madhe kontraktore. Dikur ishim një ekonomi e centralizuar dhe të pasurit nderhyrje në vullnetin e palëve ishte dicka që shkante paralelisht me gjithë sistemin ekonomik e shoqëror. Legjislacionet e common law e kanë zgjidhur prej kohësh këtë problem duke realizuar një harmonizim të plotë midis shoqërisë, ekonomisë dhe ligjit. Pra palët duhet të jenë në pozita të përafërta. Nëse vullnetet përputhen, roli i gjykatës është thjesht arbitrar mbi premtimet që palët i kanë bërë njëra tjetrës dhe jo zbulimi i “mirëbesimit” në kontratë. Hapësira e negociimit midis tyre është e madhe. Ligji anglez i përmbahet parimit se “njerëzit janë të detyruar nga kontrata që kanë lidhur, vetëm nëse vullneti i tyre ka qenë i vërtetë dhe i pavesuar”. Qëllimi i këtij projekti është transpozimi i legjislacionit civil në Shqipëri në përputhje me praktikat më të mira të sistemit Common Law.

**Objektivat** e projektit janë: 1. Studimi i detajuar i legjislacionit civil law për vullnetin kontraktor; 2. Studimi i detajuar i legjislacionit common law për vullnetin kontraktor; 3. Krahasimi i dy sistemeve të së drejtës.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

**Hipoteza:** Legjislacioni civil shqiptar nuk ofron një raport të mirë mes lirisë kontraktore dhe efikasitetit ekonomike. Kjo do të jetë edhe hipoteza e punimit tim. Duke analizuar legjislacionin nga njëra anë dhe tendencën për liri ekonomike nga ana tjetër pretendoj të arrijë në këtë përfundim.

**Pyetja kërkimore** që pason këtë hipotezë është: A ofron legjislacioni shqiptar mjaftueshëm mbrojtje juridike mbi lirinë kontraktore të palëve? Si nën-pyetje mbështetëse: 1. Cilat janë praktikat më të mira të sistemit Common Law në fushën e legjislacionit civil?; 2. A duhet të jenë lejuese apo imperative normat mbi formën e shprehjes së vullnetit kontraktor?

**Metodologjia:** Të dhënat që do të përdoren në këtë studim janë pjesë nga legjislacioni dhe praktika gjyqësore e vendeve

<sup>1</sup> Oliver Wendell Holmes as quoted by Walters Justice is God's idea: Man has corrupted and destroyed it! (2012) 24.

te sistemit civil law dhe common law. Këto të dhëna do të mblidhen nëpërmjet shqyrtimit të kujdesshëm të doktrinës dhe legjislacionit përkatës. Të dhënat do të analizohen duke përdorur metodën krahasuese. Të dhënat që do të përdoren do të jenë ato nga legjislacioni në fuqi pasi studimi synon të përfitojë nga praktikat ligjore më të përparuara.

Një tjetër metodë efektive për studimin do ishte analiza logjike pasi duke bërë një interpretim logjik dhe historik të Kodit Civil, rezultojnë që iniciativa e lirë ekonomike dhe normat imperative funksionojnë në dëm të njëra-tjetrës. Legjislacionet e common law e kanë zgjidhur prej kohësh këtë problem duke realizuar një harmonizim të plotë midis shoqërisë, ekonomisë dhe ligjit. Të dhënat që do përftoheshin dhe analizohen përmes metodave të lartpërmendura do t'i nënshtrohen interpretimit doktrinar. Në këtë pikë do të bëhet e vlefshme perspektiva teorike e zgjedhur.

## Analizë, interpretim të dhënash

Nga përvoja historike e drejta private është ndikuar nga eksperiencia franceze dhe në vecanti nga Kodi Civil i Napoleonit (1804), që ndër kodifikimet e para moderne rregulloi kontratën si kategori të përgjithshme, por la jashtë normimit vullnetin kontraktor. Liria kontraktore është një specifikim i vullnetit të lirë.<sup>2</sup> Ajo shfaqet në dy forma; negative dhe pozitive. Të shfaqurit pozitiv rezultojnë nga llojet e ndryshme të kontratave. Dhe rregullimet e ndryshme ligjore. Të shfaqurit negativ, në ato raste kur ligji vendos kufijtë mbi përmbajtjen e kontratës. Liria kontraktore përfshin edhe mundësinë për të përdorur kontrata atipike. Në këtë rast palët synojnë të arrijnë një fitim të caktuar ekonomik të njëhësuar. Legjislatori ju njeh në mënyrë të shprehur subjektëve civil mundësinë për të rënë dakord mbi formën që do të ketë kontrata finale. Dimensionin negativ manifestohet në lirinë e subjektit për mos pësuar interferencë të jashtme në sferën e tij juridiko-ekonomike. Një subjekt që nuk ka marrë pjesë në kontratë nuk mund të privohet nga pasuria e tij ose të detyrohet të kryej shërbime në dobi të tjerëve. Kontrata nuk është e detyrueshme, përveç atyre që kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë pëlqimin për krijimin, ndryshimin dhe përfundimin e një marrëdhënie juridiko-civile.

### Roli i vullnetit kontraktor:

Sipas nenit 659 të Kodit Civil “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”.<sup>3</sup> Norma evidenton dy momente thelbësore të kontratës; elementin subjektiv dhe atë objektiv. Në aspektin e parë kontrata paraqitet si akord brenda sferës juridike të palëve. Ana objektive mund të përkufizohet si vetërregullim i marrëdhënieve juridike-civile. Në dallim nga norma ligjore, që e ka burimin nga një autoritet sovran, publik, norma që mund të negociohet, e ka burimin e saj në një akt të autonomisë kontraktore. Ky koncept referohet edhe në nenin 690 ku shprehimisht thuhet: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”. Ka edhe një drejtim të tretë që quhet ‘teoria e deklarimit të vullnetit’, sipas të cilës thelbi i kontratës nuk është vullneti i brendshëm i propozuesit, por vullneti i prezumuar, për aq sa mund të perceptojë një person me inteligjencë mesatare. Në funksion të mbrojtjes legjitime, afirmohet parimi i përgjegjësisë vetjake, sipas të cilit lëshuesi i deklaratës duhet të parashikojë që marrësi ta ketë kuptuar në mënyrë të arsyeshme edhe pse kjo mund ta mbajë të lidhur pavarësisht vullnetit të tij të brendshëm.

Përkufizimi i kontratës: Së pari lexojmë që kontrata është akordi mes ‘një ose disa palëve’. Nga ky përkufizim del qartë pluraliteti i kontratës dhe përputhja e interesave të tyre divergjente për arsyë zakonisht ekonomike. Liria kontraktuale mund të kufizohet vetëm nga një dispozitë ligjore. Në këtë kuptim rezultojnë se nëse autonomia private ka natyrën jashtëgjyqësore, e paformalizuar akoma, liria e kontratës është konfirmuar në sistemin ligjor, duke krijuar kështu mjetin ligjor të quajtur kontratë.

### Analiza e sistemit civil law

A është efikas ky sistem ligjor? Kjo pyetje mund të duket e pazakontë për ata që nuk janë të njohur me hipotezën e efikasitetit të Common Law. Ligji dhe ekonomistët janë të vetëdijshëm mbi të gjitha llojet e ligjeve, por me fokus të vecantë në common law. Rjedhimisht duket e vështirë për t'u marrë parasysh koncepti efikasitet në të drejtën civile, pa iu referuar fillimisht common law. Pyetja do të ishte: mungesa e Kodit Civil do të mund të lehtësonte përzgjedhjen e rregullave më efikase? Argumenti i “zgjedhjes” të kthen në hipotezën se ligji jo efikas në kosto shumë të mëdha financiare. Hipoteza e Posnerit tregon se si në fushtat me kosto të ulët financiare “ligjet jo efikase do të jenë të pavlefshme nga vullnetet e shprehura të palëve”. Kjo do të thotë, se gjyqtarët që do priren ta zbatojnë ligjin në mënyrë efikase dhe nuk do ta kapërcejnë atë, do ta bëjnë eficient gjithë sistemin. Në vendet e së drejtës civile ligji është ndarë mes lex data (ligji që zbatohet nga gjyqtari) dhe lex feranda (ligji i krijuar nga ligjvënësi). Ky dallim në pozitën e “nënshtuar” të gjyqtarit dhe nënkupton se ligjvënësi është ai që prodhon ligje. Ndodh ndryshe në common law, ku gjyqtari është ai që krijon ligjin, duke ofruar zgjedhje në rastet për të cilat duhet marrë një vendim. Në Angli ose në Amerikë, jurisprudencë ka qenë prej kohësh burimi kryesor i ligjit. Këto rregulla jo të kodifikuara përbëjnë atë që quhet common law. Gjykatat megjithatë janë të detyruara të zbatojnë ligjet statutorë, por të para si ndihmëse të së drejtës komune. Në këtë kuptim, ligji ekziston i pavarur nga kodifikimi dhe supermacia e gjyqtarit për

<sup>2</sup> Santoro-F. Passarelli, *Dottrine generali del diritto civile*, Napoli, 1973, 125.

<sup>3</sup> Shih për më tepër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë; nenet 659-690

të bërë ligjin është evidente. Në sistemin civil gjyqtarët janë interpretues të ligjit, brenda hapësirës që ju ofron ligji. Parimi i gjyqtarit si interpretues i ligjit është thelbi i pozitivizmit ligjor, karakteristike për traditën romano-gjermanike. Parimi i gjyqtarit si “përkthyes i ligjit” është thelbi i pozitivizmit, karakteristike ligjore e traditës romano-gjermanike. Për këtë arsye, jurisprudenca nuk është një burim i ligjit. Ka një asimilim mes rregullave dhe ligjit. Për të justifikuar këtë pozicion, autorët pozitiviste i referohen Montesquieu, sipas të cilit gjyqtari nuk ka fuqi. Ai është i qartë në këtë pikë. Në *Spirit of the Laws*, ai shkruan: “gjyqtarët e kombit s’janë vec goja e perifrimit të ligjit, qeniet e pajetë të të cilët nuk mund ta ndryshojnë forcën e as vendosmërinë e tij”. Autori logjikisht konkludohet kështu: “fuqia e gjykimit nuk është një forcë aktive, as nuk do të jetë një forcë politike, siç janë pushtetet legjislativë dhe ekzekutive”. Analiza ekonomike e ligjit është një qasje efektive për të analizuar pothuajse çdo fushë të doktrinës juridike, si dhe natyrën dhe funksionin e të gjithë sistemit ligjor. E drejta civil laë mund të analizohet njësoj si e drejta common laë. Kodi Civil është një institucion dinamik i cili kërkon të zvogëlojë pasigurinë që mbizotëron në botën ekonomike. Shumica e debateve doktrinale në vendet e së drejtës civile nuk shpëtojnë nga logjika e ekonomisë.

## Common Law

E drejta e detyrimeve, një nga institucionet themelore të kapitalizmit, redukton kostot e transaksionit, duke negociuar dhe zbatuar shkëmbimin. Duke vepruar kështu, ligji kontaktor rrit efikasitetin ekonomik të pronës private, ekonomisë së tregut të lirë. Pse? Duke i mbajtur subjektet të lidhura me premtimet e tyre ligji i kontratës (1) inkurajon shkëmbimet, (2) redukton kostot e transaksionit të mallrave, (3) parandalon sjelljen oportuniste, dhe (4) lehtëson të papriturat e paparashikuara.

Parimet e lirisë dhe paprekshmerisë së kontratës janë të rrënjësura në filozofitë politike dhe ekonomike të *laissez-faire*. Ky model klasik i ligjit bazohet në supozimin se palët në përgjithësi kanë liri të vërtetë zgjedhjeje dhe se palët gëzojnë të njëjtin nivel të drejtash.<sup>4</sup> Ato kanë lirinë të pranojnë ose refuzojë kushtet e kontratës. Modeli klasik i ligjit mbështetet në supozimin se konkurrenca e tregut është në nivel ideal dhe se palët në fakt negociojnë kushtet e kontratës. Megjithatë merret si aksiome edhe fakti që këto supozime janë të pasakta, dhe se ligji kontraktor mbetet një sferë ku autonomia individuale gjen shfaqje të dukshme. Liria kontraktore dhe pëlqimi i palëve është faktori bazë legjitimues për forcën detyruese të kontratës. Balanca mes lirisë dhe paprekshmerisë së kontratës dhe drejtësisë si mirëbesim, mbetet një nga problemet me të cilat perballlet ligji i ri i kontratave. Jurisprudenca tregon se paprekshmeria e kontratës prevalon mbi drejtësinë.

### A i ka përfshirë e drejta kontraktore e Common Law, vlerat themelore kushtetuese?

Ligji që rregullon kontratat në thelb ka të bëjë me marrëdhëniet kontraktuale private që rregullon marrëdhëniet socio-ekonomike në këtë sferë. Ligji i kontratave në common laë i referohet ligjit të bërë nga gjykata në krahasim me interpretimin që bën gjyqtari në civil laë. Common law është një është sistem i pakodifikuar, që është zhvilluar nëpërmjet doktrinës së ‘stare decisis’. Nisur nga natyra e tij saj, ky system duhet të modifikohet, zgjerohet ose të plotësohet për të siguruar se është në koherencë me nevojat shoqërore dhe sociale. Kushtetuta është ngritur mbi vlerat e dinjitetit njerëzor, barazisë dhe lirisë. Pyetja që lind është: Sa i përveçson common law vlerat kushtetuese? Nevoja për siguri ‘versus’ nevojës për mirëbesim dhe paanësi.<sup>5</sup>

### Liria dhe shenjtëria e kontratës

Klauzolat e kufizimit kohor në kontratat e sigurimit dhe klauzola e përjashtimit në lidhje me kujdesin shëndetësor privat, ndonjëherë janë në kundërshtim jo vetëm me vlerën e barazisë, por edhe me vlerat e dinjitetit dhe lirisë. Kur një palë është në pozitë të dobët të bisedimeve paraprake, ajo ka pak mundësi për të negociuar kushtet disfavorizuese të kontratës, të tilla si klauzolat e kufizimit kohore, klasike për kontratat tip. Kontratat të tilla çenojnë vullnetin kontraktor të palëve duke eliminuar mundësinë për të negociuar kushtet e saj. Konsumatorët nuk kanë pushtet negocimi mbi kushtet e kontratës, duke u vendosur përballë zgjedhjes “take-it-or-leave-it”.<sup>6</sup>

### E drejta kontraktuale në common law dhe koncepti i “mirëbesimit”

Keqbesimi në të drejtën kontraktore trajtohet në disa mënyra, duke përfshirë mënyrën në të cilën është marrë konsensusi; pamundësia e përmbushjes së detyrimit, parimi i cili thotë se në qoftë se ka paqartësi, kontrata duhet të interpretohet kundër atij që e ka propozuar. Klauzolat e kontratës sjellin element mirëbesimi, duke siguruar që kushtet e caktuara të zbatohen për një pjesë të veçantë të kontratës sipas ligjit. Ajo është e bazuar në parimin se, ajo që është ekonomikisht e qëndrueshme, në përgjithësi është e drejtë dhe e arsyeshme. Duke ndjekur këtë logjikë, parimi i të mirës publike balancon pacenushërinë e kontratës dhe mirëbesimin e saj: për shembull, një përmbajtje tregtare e paarsyeshme, trajtohet si kundër politikës publike dhe nuk do të zbatohet nga gjykatat. Qasja ndaj mosmarrëveshjeve në lidhje me përmbajtjen e marrëdhënieve tregtare, kërkon

<sup>4</sup> Cserne *Freedom of Contract and Paternalism: Prospects and Limits of an Economic Approach* (2012) 81.

<sup>5</sup> Bhana & Pieterse ‘Towards a reconciliation of contract and constitutional values: Brisley and Afrox Revisited’ 2005 SALJ 865 887.

<sup>6</sup> The contract does not thus represent the agreement between the consumer and the supplier. See Naude 2009 SALJ 505 529; Mupangavanhu idem 1188.

që gjyqtarët të balancojnë lirinë e kontratës *versus* iniciativës së lirë, me qellim interesin e shoqërisë dhe produktivitetit të antarëve të saj. Barra e provës është e palës që pretendon se marrëveshja tregate bie në kundërshtim me interesin publik. Si liria, ashtu edhe pazgjidhshmëria e kontratës , konkurojnë të dyja, përveç kur marrëveshja është e paarsyeshme. Sistemi common law nuk i njeht marrëveshjet që janë në kundërshtim me rendin publik dhe ato do të shpallehin të pavlefshme nëse do të kishin përplasje me vlerat themelore kushtetuese.<sup>7</sup> Ajo promovon parimin e mirëbesimit, drejtësisë, paanshmërisë dhe arsyeshmërisë. Ndërkohë që politikat publike mbështesin lirinë dhe pacenueshmërinë e kontratës, që mund të pengojnë zbatimin e saj. Parimet e rendit publik nuk janë statike dhe mund të ndryshojnë në varësi të rrethanave ndryshuese.

## Situata ligjore në Shqipëri

Pluralizmi i pas 90ës pati rezonancë jo vetëm politike. Sfera që mori hov dhe u zhvillua sipas logjikës së tregut ishte ekonomia. Që të kishte rezultat financiar të dukshëm u desh miratimi fillimisht i një Kushtetute dhe më pas i ligjeve që do mundësonin marrëdhëniet civile.

Neni 11 i Kushtetutës parashikon : “1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. 2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. 3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike” Nga kjo dispozitë del edhe qellimi ligjor i rregullimit të veprimtarisë kontraktore. Nga njëra anë premtohet dorë e lirë për autonominë kontraktore ( *laissez faire*) dhe nga ana tjetër mbartet risku i kufizimit të tij, në ato raste që do të klasifikohen si *interes publik*. Gjatë këtyre viteve Gjykata e Lartë sidomos, është munduar të qartësojë pozicionin se çfarë realisht prevalon *de facto* në Shqipëri.

Në vendimin nr 923/2000, Gjykata e Lartë shprehet se : “...Një kontratë nuk mund të bëjë debitor apo kreditor pa pëlqimin e tij një person të tretë...Në cdo rast, në një kontratë huaje, huadhënasi nuk ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrën se si i administron apo i perdor huamarrësit paratë e marra hua. Në këtë kontratë huadhënasi ka të drejtë të kërkojë vetëm kthimin e shumës së dhenë hua, si dhe kamatat e stipuluara, në qoftë se huamarrësi e ka marrë persiper një detyrim të tillë. Reziqet eventuale, që rrjedhin nga administrimi i shumës së marrë hua, nga investimi i saj, apo nga kryerja prej huamarrësit me këtë shumë e veprimeve të tjera juridike me qellim rritjen e fitimeve, rëndojnë kurdoherë mbi huamarrësin”.<sup>8</sup> Nga ky rast rezultoi se Kodi Civil nuk ka pranuar parimin e lirisë së kontraktimit dhe të konkurrencës sipas rregullave të tregut. Ky është qëndrim i arsyeshmë për një treg të lirë të mallrave, parave dhe kapitaleve, ku respektohen “rregullat e lojës”, por në një treg të deformuar e të pushtuar nga nderhyrjet e faktorëve të kunderligjshëm deri edhe kriminale, sic ishin skemat mashtruese piramidale, nuk mund të bëhet fjale për liri të kontraktimit, por për të kundërtën e saj. Sipas nenit 422 të Kodit Civil, “*Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njeri tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes*”. Permbajtja e kësaj dispozite dhe atyre që përcaktojnë kushtet e përgjithshme të kontratave të con në përfundimin që edhe liria e kontraktimit nuk është absolute. Ajo gjithsesi mund “të kufizohet” nga disa faktorë ekonomike e moralë, sic janë edhe ato të përmendur në dispozitën e sipërcituar, e që duhet t’i ketë parasysh edhe gjykata në zgjidhjen e cdo çështjeje konkrete. Injorimi i faktoreve të mësipërm con në mungesë proporcionaliteti, apo, sic shprehet ligjvënësi, në dëmtim të shpërpjesëtar të interesave të palës kontraktuese, gjë që nënkupton që vullneti (pëlqimi) i kësaj pale nuk ka qenë krejt i lirë.

Në nenin 681 të K.Civil përcaktohet se : “*Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qellimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve...*”

Ky nen duket sikur i mëshon fort lirisë kontraktore dhe e con vëmendjen e gjyqtarit tek qëllimi i legjislatorit, pra tek parimi i mirëbesimit. Nga ana tjetër praktika gjyqësore ka zhvilluar teorinë se ligji është rregullues më i mirë i vullnetit të palëve , duke dhenë shpesh zgjidhje pragmatiste ose të vonuara lidhura me atë cka palët kanë kontraktuar.

## Konkluzione/ Rekomandime

Duke parë ligjin civil në kohë, duket qartë karakteri abstrakt i dispozitave të tij. Në Kodet Civile, madje edhe rregullat për lloje të veçanta të kontratës kanë tendencë të jenë të një natyre abstrakte, sepse ato zbatohen për pothuajse të gjitha kontratat e një lloji të caktuar, pavarësisht nga objekti të veçantë të transaksionit, dhe rrethanat që e rrethojnë e kontratën dhe palët kontraktuese. Krijimi i një “kornize ligjore” do i reduktonte marrëdhëniet kontraktore , duke rrezikuar të kishin karakter ezaurues, dhe në praktike do të përdorë vetëm kontratat e parashikuara , duke kufizuar autonominë e vullnetit për të lidhur kontrata të tjera që do impononin dinamikën e reja.

Vetë *natyra e kontratës* si një marrëveshje midis dy apo më shumë palëve është thelbi i autonomisë kontraktore. Parimi, në një marrëdhënie kontraktore është se kontrata përbën ligj për palët dhe se kuadri normativ që përdoret për rregullimin e kësaj marrëdhënieje është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm , në funksion të mbrojtjes së interesit publik duke balancuar interesat e paleve.<sup>9</sup>

<sup>7</sup> Sasfin (Pty) Ltd v Beukes supra n 32 at pars 8 and 9

<sup>8</sup> Shih për më tepër vendimin unifikues nr 923/2000 të Gjykatës së Lartë.

<sup>9</sup> Albert Choi and George Triantis, “Completing Contracts in the Shadow of Costly Verification”, Working Paper, University of Virginia School of Law (2007) (available at SSRN: <http://ssrn.com/abstract=958752>).

Nocioni “e drejtë private” mbeshitet në autonominë e vullnetit dhe një mbirregullim ligjor do krijonte kaos kuridik për marrëdhëniet mes privatëve.

*Si konkluzion*, duke parë dhe dallimet apo të përbashkëtat mes dy sistemeve rezulton që liria kontraktore në Shqipëri është e pozicionuar mes të sistemeve. Si pjesë e familjes kontinentale, kodifikimi është tipari kryesor edhe për sitemin tonë. Kodi Civil ka parashikuar kontratat klasike që mund të finalizohen nga palët, nisur nga nevojat e kushtëzuara nga dinamikat socio-ekonomike. Të gjendura përballë kornizës ligjore subjektet që do duan të shprehin vullnet duhet të respektojnë të gjitha kërkesat e ligjit përta i përket formës dhe formaliteteve të tjera. Ngjashmëria me sistemin common law vihet re tek parimi i mirëbesimit, të cilës ky sitem i mëshon më së shumti. Dispozita që shpreh këtë parim është neni 681 i Kodit Civil, ku duket se shkon drejt akordit fillestar të palëve sa herë që interpretohet një kontratë. E gjendur mes kodifikimit dhe parimit të mirëbesimit gjykata nuk ndjek një standard në dhënien e vendimeve. Ajo mjaftohet me formalizimin e kontratës sipas kërkesës ligjore dhe harron arsyen për të cilën palët kanë iniciuar një marrëdhëni civile. Një vendim edhe pse në përputhje me intepretim *mot a mot* të ligjit, nëse nuk është efcient për palët vazhdon të jetë jo i drejtë. Në common law mirëbesimi njehsohet me koston ekonomike, ndërsa në sistemin tonë ky parim merret i vecuar nga komponentët e tjerë. Pozita disfavorizuese e njëres palë nuk përben cënim të këtij parimi dhe gjykatësi priret ta jap vendimin vetëm nisur nga ana procedurile, pra respektimi i afateve, formës etj. Edhe palët kanë lirinë të negociojnë kushtet e kontratës, ata vazhdojnë të qëndrojnë të lidhur me obligimin për të qënë konorm ligjit. Subjekti privat ka vetëm lirinë e lidhjes së një kontrate, por jo lirinë e shprehjes së përmbajtjes së saj. Ligjvënësi e ka parashikuar këtë rregullim me qellim shmangien e abuzime nga palët dhe parandalimin e konfliktit. Kjo logjikë nuk premtan ta përmbush motivin për të cilin është hartuar, pasi praktika gjyqësore shqiptare është plot me raste ku palët simulojnë lidhje kontratash për qellime të tjera ekonomike, pra kuadri ligjor sidoqoftë nuk e shmang dot problemin, por vetëm kushtëzon interesat e tyre brenda një kohe të caktuar gjyqësore. Arsyeya pse palët duan një kontratë lidhet drejtpërdrejtë me interesin ekonomik e janë vetë ato që mund të parashikojnë të drejtat dhe detyrimet brenda saj. Ligjvënësi nga ana tjetër mund të argumentonte qe pikërisht ky parashikim ligjor e mbron palën nga keqbesimi. Duke u munduar të zgjidhet gjithcka nëpërmjet ligjit, rrezikohet të krijohet mbivendosi dhe përplajse e dyzuar interesash. Nëse intelekti i subjektit nuk arrin mesataren e kuptueshmërisë së ligjit, ky nuk duhet të jete problem që zgjidhet po nga ligji, por me këtë duhet të investohet sistemi arsimor etj. Ideja ime shkon drejt ndarjes se sistemeve nga njëri –tjetri dhe liria kontraktore edhe nëse përballat me abuzim apo mashtrim, është risk që e mban subjekti me vullnetin e tij të lirë.

## Rekomandime

Duke pasur një parashikim ligjor të detajuar marrëdhënia juridiko-civile rrezikon të zhvendosë vëmendjen e palëve nga çështjet ekonomike, tek ato ligjore. Nëse do të prevalonte vullneti kontraktor palët nuk do humbnin kohë, duke rënë pre e ngërceve juridik, por do shfrytëzonin aktivitetin e tyre ekonomik. Një ekonomi e de-rregulluar performon më mirë se një ekonomi e mbirregulluar. Rregullat e lojës ekonomike (elementët e kontratës) nuk duhen përcaktuar të gjithë nga një perspektivë jo ekonomike (në këtë rast nga perspektiva ligjore). Si përfundim rekomnadoj thjeshtëzim të rregullmit kontraktor dhe forcimin e parimit të mirëbesimit mes palëve. Kjo nuk do linte hapësirë për abuzime sepse parimi që *kontrata është ligj për palët* nuk cënohet në asnjë pjesë.

## Bibliografia

- Oliver Wendell Holmes as quoted by Walters Justice is God's idea: Man has corrupted and destroyed it! (2012) 24.  
 Santoro-F. Passarelli. (1973) *Dottrine generali del diritto civile*, Napoli, 125.  
 Cserne, Peter (2012) *Freedom of Contract and Paternalism: Prospects and Limits of an Economic Approach*, Palgrave Macmillan 81.  
 Bhana & Pieterse 'Towards a reconciliation of contract and constitutional values: Brisley and Afrox Revisited' 2005 SALJ 865 887.  
*The contract does not thus represent the agreement between the consumer and the supplier.* 2009 SALJ 505 529; Mupangavanhu idem 1188.  
 Sasfin (Pty) Ltd v Beukes supra n 32 at pars 8 and 9  
 Albert Choi and George Triantis (2007), "Completing Contracts in the Shadow of Costly Verification", Working Paper, University of Virginia School of Law (2007) (available at SSRN: <http://ssrn.com/abstract=958752>).  
 Vendimin unifikues nr. 923/2000 i Gjykatës së Lartë.



# PRAKTIKA GJYQËSORE MBI MOSMARRËVESHJET E PUNËS ME KARAKTER NDËRKOMBËTAR

---

**BLERTA ALIU**

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik, Profili – E Drejtë Biznesi

E-mail: baliu@uet.edu.al

---

## ABSTRAKT

Punimi trajton aspekte të zgjidhjes së konflikteve të ligjeve, gjë që kërkon të mobilizohen instrumentet e bashkërendimit të legjislativëve me synimin “të lehtësojnë disa nga pasojat e diversitetit të normave kombëtare, pa prekur përmbajtjen e tyre”. Kemi të bëjmë me dispozita të së drejtës procedurale, të cilat synojnë të zgjidhin konfliktet ligjore që lindin për shkak të dimensionit ndërkombëtar të situatës së punës. Vështirësitë janë të mëdha për shkak të shumëllojshmërisë së burimeve dhe fushës së zbatimit, si gjeografike ashtu edhe materiale. Instrumenti i parë ishte në fillim një konventë ndërkombëtare jospesifikë për kontratat e punës, Konventa e Romës 19 qershor 1980, në lidhje me ligjet që zbatohen për detyrimet kontraktuale. Norma e dytë është një direktivë europiane e vitit 1996, në sferën e së drejtës së posaçme komunitare, e cila prevalon, kur është e zbatueshme, ndaj dispozitave kryesore të burimit të parë. Ajo vepron vetëm në rastet kur një shoqëri dërgon punëmarrësit e saj për të realizuar një shërbim në një nga vendet e Bashkimit Europian. Legjislativi dhe praktika janë kërkojnë një vëmendje më të madhe për shkak të lëvizshmërisë së lartë dhe emigrimit të punonjësve shqiptarë apo edhe të huaj në Shqipëri.

**Fjalë kyç:** konflikte ndërkombëtare pune, Konventa e Romës, Direktiva për mobilitetin e punonjësve, praktikë gjyqësore.

---

## Hyrje

Rregullorja e Romës, ka hyrë në fuqi në 1 prill 1991, (Sylvie H. Muriel, Marion Del Sol 2013, fq.) Para saj, gjyqtarët kishin në dispozicion vetëm normat e së drejtës ndërkombëtare private të vendit të tyre për të zgjidhur konfliktet e ligjeve. Standartizimi i rregullave të përcaktimit të ligjit që zbatohet për një kontratë me përmasa ndërkombëtare në të gjitha shtetet anëtare. A ka një përkufizim të unifikuar për “kontratën e punës”? Neni 8 i kushtohet kontratës individuale të punës, ai nuk i specifikon elementët e cilësimit.

Cilësimi i kontratës së punës nuk është përcaktuar në mënyrë uniforme, por varet nga mënyrat kombëtare të konceptimit, të cilat janë pak a shumë “liberale”. Çfarë i jep karakter ndërkombëtar “kontratës së punës”. Neni 1 i Rregullores parashikon se zbatimi i saj, kërkon që të jemi në prani të “situatave [kontraktuale] që kanë konflikt ligjor”. Pra, duhet të ekzistojnë elementë të huaja që mund të kenë të bëjnë me ligjet e disa vendeve të ndryshme. Cilët janë këta elementë? Një ndër to është, mënyra e përcaktimit të vendodhjes. Pra, vendi i kryerjes së punës është tepër i rëndësishëm, psh vendosje e përkohshme në Itali e një punëmarrësi me kërkesën e punëdhënësit të tij me seli në Gjermani.

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i punimit është identifikimi i hapësirave ligjore në çështje të kontratave të punës me elementë të huaj, nëpërmjet identifikimit të mekanizmave ndërkombëtarë ligjorë dhe shqyrtimit të interpretimit të praktikës së GJED. Në këtë mënyrë, sikurse theksohet në titull, kërkimi bazohet në një analizim të dispozitave ligjore të Bashkimit Europian për statusin që gëzon punonjësi në tregun e brendshëm dhe lehtësitë që i akordohen atij duke gëzuar lirinë e qarkullimit. Për të përplotësuar këtë kornizë, vjen në ndihmë GJED, me interpretimet ndaj Direktivave apo Rregulloreve të caktuara të BE, si dhe ndaj legjislacioneve të ndryshme të shteteve anëtare që shkojnë ndesh me to.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Punimi realizohet nëpërmjet metodave cilësore. Analiza në shkencë juridike bazohet kryesisht në interpretim dhe trajtim të legjislacionit apo jurisprudencës, qoftë kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare. Më tej, ato kanë një ndërthurje, duke u mbështetur në metoda krahasimore të vendeve apo sistemeve të ndryshme juridike. Punimi do të jetë i ndarë në pjesë të veçanta, ku secila do trajtojë një problematikë të caktuar. Secila do të përmbajë elementë ligjorë të së drejtës së punës shqiptare që ndërthuren me atë europiane. Po ashtu, elementë jurisprudencialë të praktikës gjyqësore shqiptare si dhe të asaj të GJED.

## Analizë, interpretim të dhënash

“Kontrata bazohet në ligjin e zgjedhur nga palët” (neni 3,1) Zgjedhja e bërë nga palët është e detyrueshme për gjyqtarin. Kjo krijon teorikisht, mundësinë që shoqëritë e lidhura me kontrata pune ndërkombëtare të mund t’i shpëtojnë veprimit të një legjislacioni më të rreptë. Kur punëdhënësi është i vendosur në një vend ku legjislacioni social mbron punëmarrësit dhe kur ai zhvendoset drejt vendeve me legjislacione më pak të rrepta. (si vendet afrikane dhe aziatike) ose vende më liberale (ShBA dhe Anglia), ai mund t’i referohet nenit 8/1 në mënyrë që të shmangë veprimin e legjislacionit të punës që është në fuqi në vendin ku ka selinë e tij. *Është i mjaftueshëm vullneti i palëve për t’i dhënë kontratës së punës një dimension ndërkombëtar?*

Kur të gjitha elementët janë të vendosura në të njëjtin vend dhe kur kontrata është e lidhur në bazë të rendit juridik vetëm të këtij vendi, a është e mundur që në kontratë të parashikohet zbatimi i ligjit të një shteti tjetër? Në fakt, asnjë dispozitë e Konventës nuk e ndalon këtë. Ndërsa sa i përket mënyrave të zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm. Autonomia kontraktuale mund të shfaqet në dy mënyra; në raport me objektin për të cilin palët duhet të bëjnë zgjedhjen, në raport me momentin kur mund të bëhet zgjedhja. Në kapitullin për rregullat e përgjithshme, parashikohet se “palët mund të përcaktojnë ligjin që zbatohet për gjithë kontratën ose për një pjesë të kontratës së tyre.” (neni 3,1).

Mund të vendoset që vetëm një pjesë e marrëdhënies së punës të rregullohet nga ligji i zgjedhur (psh mënyra e përfundimit të saj, ose çdo gjë që ka të bëjë me kohën e punës), çka sjell një lloj copëzimi të kontratës dhe një zbatim të shpërndarë të ligjit të zgjedhur dhe të ligjit që zbatohet në rast se nuk është bërë një zgjedhje. Në rastet e mungesës së përcaktimeve, zgjedhja e ligjit do të bëhet për të gjitha aspektet e marrëdhënies së punës. Neni 3,1 parashikon se: “zgjedhja duhet të shprehet apo të tregohet me qartësi në nenet e kontratës ose në rrethanat e arsyes së lidhjes së kontratës”. Zgjedhja mund të bëhet në çdo moment (neni 3,2). Ligji nuk zgjidhet detyrimisht në momentin e lidhjes së kontratës; kur bëhet në fillim, kjo gjë mund të ndryshohet më vonë, me pëlqimin e palëve. Zgjedhja në formën e një klauzole të veçantë, të përfshirë në kontratë, që përcakton ligjin e zbatueshëm në rast mosmarrëveshjes.

Gjyqtari zbaton ligjin “objektiv” dhe jo ligjin e zgjedhur, vetëm lidhur me dispozitat absolute të rendit juridik (dispozita të pacënueshme) apo edhe sa herë që rregullat e ligjit objektiv janë më të favorshme për punëmarrësit. Neni 39 i Traktatit të Bashkimit Europian mbi lirinë e qarkullimit të lirë të punëmarrësve. Në parim, punëmarrësi varet nga legjislacioni i punës

së shtetit anëtar në të cilin ai punon. Po nëse punëdhënësi i vendosur në një shtet anëtar fiton një kontratë në një shtet tjetër anëtar dhe zhvendos aty, një numër të caktuar të të punësuarve të tij, për të realizuar këtë kontratë. Në këtë rast, mobiliteti i të punësuarve ka të bëjë me ushtrimin e lirë të një shërbimi, dmth, në kuadrin e lirisë ekonomike të shpallur në nenin 49 të Traktatit. Kjo nuk lidhet me zbatimin e parimit të qarkullimit të lirë të punëmarrësve. Direktiva 96/71e Bashkimit Europian vendos lirinë e qarkullimit të punonjësve karshi lirisë së ofrimit të shërbimeve.

Në vendimin Rush Portugesa, (1990) GJED dha përgjigje të qarta në emër të ofrimit të lirë të shërbimeve. Në këtë rast bëhej fjalë për një shoqëri portugeze ndërtimesh dhe punësh publike, e cila punonte në Francë në cilësinë e nënkontraktorit në ndërtimin e linjës hekurudhore TGV Atlantik. Për kryerjen e punimeve që ishin ngarkuar, ajo kishte sjellë në Francë, një numër të caktuar punëmarrësish.

Pas një kontrolli në vendin e punës, një inspektor i punës konstatoi se këta punëmarrës nuk kishin lejen e punës që u duhej për ushtrimin e një aktiviteti me pagesë nga një person i huaj. Pra, duhet të sqarohet çështja nëse kjo leje mund t'u kërkohej në këtë rast, duke ditur se kjo leje u kërkohej të huajve që kërkojnë punë në Francë. GJED dha përgjigje negative. Prania e këtyre të punësuarve portugezë në Francë lidhej me ofrimin e lirë të shërbimeve. Në një rast të tillë, autoritetet e shtetit anëtar ku duhet të kryhen punimet [në Francë] nuk mund t'i vendosin ofruesit të shërbimeve kushte në lidhje me punësimin e krahut të punës vendas ose me marrjen e një leje pune për personelin portugez."

Moslejimi i zhvendosjes së punëmarrësve të saj për ekzekutimin e një kontrate do të thoshte "të diskriminoje ofruesin e shërbimit në raport me konkurrentët e tij të vendosur në vendin pritës dhe që mund të angazhojnë pa pengesa personelin e tyre". Sidoqoftë, GJED nuk largon dimensionin social nga vëmendja dhe përpiqet të gjejë një kompromis midis tregut të lirë dhe mbrojtjes së të punësuarve.

Perimetri gjeografik dhe material: "shoqëritë e vendosura në një shtet anëtar dhe që, në kuadrin e një ofrimi transkombëtar shërbimesh, zhvendosin punëmarrës, ..në territorin e një shteti anëtar", (neni 1,1). Pra ajo merret me situatat e zhvendosjes ndërkombëtare.

2/Situatat e zhvendosjes për të cilat bëhet fjalë janë tri situata:

1. Zhvendosja në kuadrin e ofrimit të një shërbimi të kryer nga punëdhënësi në një shtet tjetër anëtar
2. Zhvendosja brenda të njëjtit grup shoqërisht
3. Vënia në dispozicion e punëmarrësve pranë një ndërmarrjeje që i përdor dhe që gjendet në një shtet tjetër anëtar

Në vendimin Laval (2007) (GJED, 18 dhjetor 2007, Laval un Partneri Ltd) bëhej fjalë për shumën e shpërblimit që u duhej dhënë disa punëmarrësve të zhvendosur nga një shtet anëtar (Letoni) në një shtet tjetër (Suedi) për kryerjen e një pune, pikërisht ndërtimin e një shkollë. Shoqëria Letone kishte refuzuar të nënshkruante konventën kolektive suedeze të ndërtimit (ndërkohë në Suedi, kjo ishte e detyrueshme). Ky nënshkrim do të sillte pagesën e një rroge minimale për orë pune, të cilën sipërmarrësi e refuzonte (pagë më e lartë se në Letoni).

Duke u mbështetur në Direktivën 96/71, GJED-ja, vlerësoi se paga minimale bën pjesë tek "grupi i garancive kryesore" që një shtet anëtar mund t'ua imponojë punëmarrësve të zhvendosur në territorin e tij. Duhet ditur se paga minimale në Suedi, nuk përcaktohet me ligj, por nga Konventa kolektive shoqërisht ose sektorësh, konventa që nuk janë të detyrueshme për të gjithë. Pra, nga kjo pagë minimale konvencionale nuk mund t'i kundërdrejtohej sipërmarrësit letonez.

Kodi i punës në nenin 3, përcakton se fusha e zbatimit në hapësirë të këtij kodi parashikon se, kontrata e punës rregullohet nga ligji i shtetit, ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e vet, edhe nëse ai dërgohet nga punëdhënësi të punojë përkohësisht në një shtet tjetër. Kur punëmarrësi nuk e kryen punën zakonisht në të njëjtin shtet, kontrata e punës rregullohet nga ligji i shtetit ku ndodhet qendra e tij/saj e punës. Kur qendra e punës nuk mund të përcaktohet, ajo rregullohet nga ligji i shtetit, ku ndodhet qendra e personit fizik ose juridik, që ka punësuar punëmarrësin.

Kur nga tërësia e rrethanave kontrata e punës ka lidhje më të ngushta me ligjin e një shteti tjetër, atëherë zbatohet ky ligj. Palët me marrëveshje mund të zgjedhin zbatimin e një ligji tjetër, ndryshe nga sa parashikohet në paragrafët e mësipërm. Kjo zgjedhje nuk mund ta privojë punëmarrësin nga mbrojtja që i sigurojnë atij dispozitat urdhëruese të ligjit që do të jetë i zbatueshëm në mungesë të zgjedhjes. Në kuptim të kësaj dispozite, quhen urdhëruese të gjitha dispozitat që, në bazë të ligjit, nuk duhet të cënohen me kontratë në dëm të punëmarrësit.

Nga ana tjetër, ligji nr.10 428, datë 2.6.2011 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private, në nenin 48 mbi kontratën e punës, kontrata individuale e punës rregullohet nga ligji i zgjedhur nga palët. Kur palët nuk kanë zgjedhur ligjin e zbatueshëm, ndiqen rregullat e parashikuara në nenin 3 të Kodit të Punës.

Në një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, paditësja Eriona Haxhijaj ka qënë në marrëdhënie pune pranë anës së paditur në pozicionin e Këshilltarit të Licensimit të Biznesit, me kontratë me afat të përcaktuar. Ana e paditur, Chemonics International INC është zyrë e përfaqësimit të Kompanisë Chemonics International INC, shoqëri e themeluar sipas Ligjit të Përgjithshëm të Shoqërive të shtetit Delaëare, me zyrë përfaqësimi në Shqipëri.

Ana e paditur ka njoftuar paditësen për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës dhe i ka kërkuar të paraqitet për bisedime rreth arsyeve të zgjidhjes së kësaj kontrate dhe paditëses i është njoftuar vendimi përfundimtar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Paditësja, Eriona Haxhijaj, me pretendimin se zgjidhja e kontratës së punës është me shkak abuziv, pa shkaqe të arsyeshme, ka kërkuar zgjidhjen e pasojave ekonomike të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rrefuzuar kërkesën e palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.

Me arsyetimin: "... përcaktimi paraprak i juridiksionit të një çështjeje që paraqitet për shqyrtim para gjykatave shqiptare ka gjetur rregullim të shprehur nëpërmjet një norme të ligjit të brendshëm (jus cogens). Përjashtimet nga rregullimi i mësipërm kërkojnë në

*natyrën apo lëndën e mosmarrëveshjes (administrative apo kushtetuese) dhe, kur ka një element të huaj, në rastin më të mirë në aktet ndërkombëtare të pranuar nga palët (konventë apo marrëveshje dy palëshe), apo kërkohet në parimet e së drejtës ndërkombëtare, siç janë reciprociteti, ose norma të kolizionit.*

Kundër vendimit ka ushtruar ankim të veçantë ana e paditur Chemonics International INC, me të cilin kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për efekt të njehsimit të praktikës gjyqësore, mban një qëndrim që buron dhe nga jurisprudenca e GJEDNJ, sipas së cilës “... disa kufizime mbi aksesin (në gjykatë) duhet të konsiderohen si të qënësishme, si për shembull ato kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror”.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se pavarësisht se Marrëveshja Ekonomike Dypalëshe midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk parashikon shprehimisht heqjen dorë nga imuniteti, ky “emision” nuk sjell mosnjohjen e këtij parimi dhe aq më pak mosaplikimin e tij. Në të kundërt, siç rezulton në rastin konkret, palët e kanë pranuar mundësinë e heqjes dorë nga imuniteti që buron nga Marrëveshja dhe e kanë aplikuar atë në lidhje me marrëdhëniet e punës, duke parashikuar shprehimisht në nenin XI kontratën e punës se: “Çdo mosmarrëveshje që lind nga ekzekutimi i kësaj kontrate që nuk do të zgjidhet në mënyrë miqësore do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë”.

Në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se në kushtet kur pala e paditur Chemonics International INC ka përpiluar dhe nënshkruar një kontratë pune, e cila në mënyrë të qartë ka pranuar juridiksionin e një gjykate shqiptare për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në kontratë, kjo përbën një shprehje të qartë të vullnetit të saj për heqjen dorë nga imuniteti që gëzon në bazë të Marrëveshjes Dypalëshe dhe nënshtrimin, vetëm për këtë lloj marrëdhënie juridiko civile, juridiksionit të gjykatave shqiptare.

Pavarësisht pretendimit se përcaktimi i juridiksionit në kontratën e punës është në kundërshtim me nenin 7/3 të Kodit të Punës, i cili parashikon se: “Marrëveshjet që lidhen me juridiksionin janë të vlefshme vetëm nëse përcaktohen pas lindjes së konfliktit”. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se në rastin konkret nuk gjen zbatim dispozita e mësipërme. Dispozita që parashikon juridiksionin e gjykatave shqiptare në rastin konkret është pasojë e heqjes dorë nga imuniteti, gjë që përbën specifikë të veçantë dhe e dallon atë nga një marrëveshje për ndryshim juridiksioni në kuptim të dispozitës së mësipërme. Për më tepër ky ndryshim, përveç se bëhet në favor të palës më vulnerabël në një kontratë punësimi, punëmarrësit, me qëllim rritjen e aksesit të tij në gjykatë duke rritur shkallën e garancive që ai gëzon në lidhje me zbatimin e kontratës, i shërben gjithashtu arritjes së një zgjidhjes sa më të shpejtë e më të drejtë lidhur me mosmarrëveshjen, duke qenë kështu larg të qenit “*alteration in pejus*”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njehsues se nëse në kontratat e punësimit të lidhura midis subjekteve të mësipërme me cilësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve shqiptarë është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të marrëdhënies së punës palët mund t’i drejtohen gjykatës shqiptare, një gjë e tillë do të konsiderohet si pranuar vullnetar i juridiksionit të gjykatave shqiptare.

## Konkluzione/ Rekomandime

Në kuadër të zhvillimeve aktuale mbi të drejtën e punës, nëpërmjet studimit të rregullimeve ligjore europiane, arrijmë në përfundimin se është e nevojshme të rritet mbrojtja e punonjësve shqiptarë me punëdhënës me shtetësi të huaj, që zgjedhin territorin dhe legjislacionin shqiptar, për shkak të standarteve të ulëta, psh pagës minimale, për t’u shpëtuar kostove ekonomike. Përpjekjet për të përmirësuar legjislacionin shihen në rritje të kodit të punës, edhe lidhur me kontratat e reja të punës. Aktualisht në ligjin Nr.10 428, Datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private” që parashikon nenin 48 për këto çështje, referohet më shumë nenin 3 të Kodit të Punës. Harmonizimi i normave ligjore me Direktivën 96/71, e cila parashikon disa garanci ligjore në kontrata ndërkombëtare të punës duhet të jetë një pikësynim i legjislatorit. Së fundi, në praktikën e gjykatës shqiptare ka ende shumë pak interpretime që lidhen me zbatimin e parimeve të parashikuara ndërkombëtarisht.

## Bibliografia

- Sylvie Hennion, Muriel Le Barbier-Le Bris, Marion Del Sol (2013) “E drejta sociale evropiane dhe ndërkombëtare” Papyrus, Tiranë.
- Traktati i Bashkimit European, (Lisbonës)
- Direktiva 96/71 “Për zhvendosjen e punonjësve”
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
- Ligi Nr.10 428, Datë 2.6.2011 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”
- Vendim GJED, 18 dhjetor 2007, Laval un Partneri Ltd
- Vendim GJED, (1990) Rush Portuguesa
- Vendim Nr.8, date 10.06.2011 i Gjykatës së Lartë.

# REGJIMI I RI I PAVLEFSHMËRISË SË THEMELIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE PAS NDRYSHIMEVE TË FUNDIT LIGJORE TË LIGJIT NR. 9901. APLIKIMI I KËSAJ DISPOZITE NË PROCEDIMET GJYQËSORE DHE RISIA NË FUSHEN E TË DREJTËS PRIVATE

---

DOKTORANT MARSIDI GUPI

---

## ABSTRAKT

Ndryshimet ligjore të rregjimit të pavlefshmërisë së themelimit, të prezantuara nga ndryshimet e ligjit 9901, jo vetëm risollën mundësinë e shpalljes së pavlefshmërisë së shoqërisë tregtare, por definuan më qartë dallimet midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative. Në pikturën e re të nenit 3/1, jo cdo detaj është i qartë; një pjesë e dispozitës flet drejtpërdrejtë dhe kuptueshëm, ndërsa aspekte të tjera mbetet të sqarohen nga jurisprudenca. Shkaqet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të themelimit të shoqërive tregtare janë të ndryshme nga ato të cilat shkaktojnë këto lloj pavlefshmëri sipas Kodit civil. Në dialektikën teorike duhet të thellohet studimi se deri në çfarë mase konceptet e të drejtës civile mbi pavlefshmëritë janë të zbatueshme në të drejtën e shoqërive tregtare. Është një tipar i zakonshëm i lex specialis të derivojë dhe po ashtu të devijojë nga parashikimet e lex generalis, të cilat zbatohen kur nuk kemi një rregullim specifik. Analizimi i vendimeve gjyqësore dhe praktika mund të çojë drejt një hipoteze se cilat shkaqe çojnë në pavlefshmëri absolute apo relative. Pavlefshmëria absolute konstatohet nga gjykata dhe sjell për pasojë prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Pavlefshmëria relative shpallet nga gjykata dhe nuk ka si pasojë prishjen e menjëhershme të shoqërisë. Shkaku i pavlefshmërisë mund të korrigjohet nga ortakët apo aksionarët deri para shpalljes së vendimit gjyqësor që konstaton pavlefshmërinë. Nëse shkaku është korrigjuar dhe publikuar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit sipas kërkesave të ligjit 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, të ndryshuar, gjykata mund të deklarojë pavlefshmërinë. Dispozita i mbron të tretët që kanë përfituar të drejta të caktuara para shpalljes së pavlefshmërisë: askush nuk mund të çenojë gëzimin e qetë të këtyre të drejtave mbi pretendimin se shoqëria është prishur për shkak pavlefshmërie. Pavlefshmëria gjithashtu, nuk cliron themeluesit e shoqërisë nga detyrimi për të paguar kontributet e nënshkruara prej tyre në aktin e themelimit të shoqërisë ose rritjes së mëpasshme të kapitalit. Ligji megjithatë lë një shteg për moszbatimin e kësaj kërkesë ndaj themeluesve, në rastin kur kreditorët e shoqërisë mund të shlyhen gjatë procesit të likuidimit me asetet e vetë shoqërisë.

**Fjalë kyç:** *pavlefshmëri e themelimit, pavlefshmëri absolute, pavlefshmëri relative, vendime gjyqësore, QKR.*

---

## Hyrje

Në ligjin e vjetër “Për Shoqëritë Tregtare”, nr.7638,i datës 19 nëntor të vitit1992, rregullonte në mënyrë të qartë rastet e pavlefshmërisë të akteve të shoqërive tregtare. Këtu përfshiheshin edhe rastet mbi pavlefshmërinë e themelimit të shoqërive tregtare. Analiza e praktikës të gjykatave tregon se marrëdhëniet në fushën e të drejtës tregtare kanë gjeneruar konflikte në institutin e pavlefshmërisë së akteve të themelimit të shoqërive.

Në ligjin e vjetër tashmë të shfuqizuar e parashikonte pavlefshmërinë e shoqërive tregtare në nenin 231 : “Pavlefshmëria e një shoqërie ose e një akti që ndryshon statutin , mund të rezultojë vetëm nga një dispozitë e vecantë e këtij ligji ose e atyre që rregullojnë ligjërisht pavlefshmërinë e kontratave. Përsa u perket shoqërive me pergjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare, pavlefshmëria e shoqërisë nuk mund të rezultojë nga një e metë e marrëveshjes ndërmjet ortakëve ose nga paaftësia të paktën deri në atë masë sa kjo paaftësi nuk ka prekur të gjithë ortakët themelues. Pavlefshmëria e akteve ose vendimeve të tjera nga ato të parashikuara nga paragrafi i mësipërm mund të rezultojë vetëm nga shkelja e një dispozite urdhëruese të këtij ligji ose e ligjshmërisë në fuqi për kontratat”.

Me tej, ligji rregullonte edhe aspekte më specifike të pavlefshmërive si psh. pavlefshmërinë që prek njërin nga ortakët, pavlefshmërinë e akteve të shoqërisë për shkak të mungesës së publikimit ose në përgjithësi pavlefshmërinë e akteve pas themelimit.

Mungesa e një seksioni të vecantë mbi pavlefshmërinë e shoqërive tregtare në ligjin e ri të shoqërive, të miratuar në vitin 2008, ndryshoi krejtësisht përfaqshjen e deriatëhershme mbi mundësinë e deklarimit të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare. Ligjvënësi zgjodhi ti japë përparësi mbrojtjes së të tretëve nga pasojat që mund ti shkaktojë pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë. Gjithashtu dhe të konsiderojë se , që prej momentit të regjistrimit ekzistenca e shoqërisë tregtare është fakt i kryer, më pas mund të diskutohet për pavlefshmërinë e akteve që shoqëria apo organet e vecanta të saj nxjerrin gjatë ushtrimit të funksioneve , e ndoshta dhe për përgjegjësinë e themeluesve për parregullsitë e themelimit “neni 10”, por jo për vlefshmërinë e themelimit.

Ligji në një sërë dispozitash ofron mundësinë ligjore për të kërkuar dhe deklaruar pavlefshmërinë e vendimeve të deklaruara të shoqërisë ose organeve të saj si psh. deklarimi i pavlefshmërisë së vendimit të emetimit të parregullt të aksioneve , të vendimeve të parregullta të administratorëve , të klauzolave të statutit që kufizojnë dispozitat taksative mbi të drejtat e aksionarëve e të tjera. Një pjesë e këtyre dispozitave mbrojnë në mënyrë të posacme të tretët duke evituar efektet e pavlefshmërisë së akteve mbi të tretët që janë me mirëbesim.

Disa prej akteve të shoqërive tregtare i nënshtrohen vetëm shkaqeve të pavlefshmërisë së parashikuar në ligjin 9901: psh. vendimi i asamblesë është i pavlefshëm nëse nuk është bërë njoftimi i mbledhjes për ortakët ose aksionarët sipas parashikimeve ligjore. Aktet e tjera u nënshtrohen shkaqeve të pavlefshmërisë së ligjit nr.9901 ose kodit civil.

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ndryshimet ligjore të regjimit të pavlefshmërisë së themelimit ,të prezantuara nga ndryshimet e ligjit 9901, jo vetëm risollën mundësinë e shpalljes së pavlefshmërisë së shoqërisë tregtare , por defnuan më qartë dallimet midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative.

Qëllimi qëndron tek risia që sjell ndryshimi ligjor në nenin 3/1 pasi jo cdo detaj është i qarte dhe një pjesë e dispozitës flet drejtpërdrejt dhe kuptueshëm , ndërsa aspekte të tjera mbetet ti sqarohen nga jurisprudenca<sup>1</sup>. Shkaqet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të themelimit të shoqërive tregtare janë të ndryshme nga ato të cilat shkaktajnë këto lloj pavlefshmërisë sipas kodit civil mbi pavlefshmërinë janë të zbatueshme në të drejtën e shoqërive tregtare. Këtu qëndrojnë dhe objektivat e studimit.

Është një tipar i zakonshëm i lex specialis të prevalojë dhe po ashtu të derivojë nga parashikimet e lex generalis të cilat zbatohen kur nuk kemi një rregullim specifik.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

Pyetja kërkimore qëndron a janë shkaqet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të themelimit të shoqërive tregtare janë të ndryshme nga ato të cilat shkaktajnë këto lloj pavlefshmërisë sipas kodit civil mbi pavlefshmërinë janë të zbatueshme në të drejtën e shoqërive tregtare?

Hipoteza qëndron se gjyqtari nuk mund të konstatojë apo shpallë pavlefshmerinë e themelimit mbështetur në shkaqe të tjera apo dispozita të tjera ligjore pasi këtë përcakton edhe neni 3/2.<sup>2</sup> Me anë të këtij regjimi, ligjvënësi ka pasur për qëllim të zvogëlojë numrin dhe llojin e shkaqeve që cojnë në pavlefshmërinë e themelimit të subjektit juridik , pas regjistrimit të tij në regjistrin tregtar. Për më tepër një interes themelor që mbrohet në këtë rast është interesi i palëve të treta në mirëbesim,

<sup>1</sup> Sipas A.Malltezi, J.Rustemaj, A.Kromeci, Gjykatat Shqiptare për shoqëritë tregtare, fq94-98.

<sup>2</sup> Sipas ligjit nr.9901 i vitit 2008 “Per tregtaret dhe shoqerit tregtare”

garantimi i sigurisë së transaksioneve tregtare, ulja e kostove të informacionit, inkurajimi i subjekteve të hyjnë në marrëdhënie tregtare.

Këto janë elementët që do merren në trajtim gjatë këtij punimi sipas një metode kumulative interpretuese ku burimi primar janë interpretimi i nenit të këtij ligji dhe doktrinës ekzistuese në fushën e të drejtës tregtare, dhe burimi sekondar është vendimi i Gjykatës së Lartë dhe rasteve të tjera të praktikës gjyqësore.

## Analizë, interpretim të dhënash

Në fushën e shoqërive tregtare pavlefshmëria e akteve dhe pavlefshmëria e themelimit perbejnë dy regjime të ndryshme. Përmendim psh. se kontratat e lidhura nga shoqëria tregtare do të nënshtrohen shkaqeve të pavlefshmërisë së kodit civil dhe afateve të parashkrimit, ndërsa shkaqet e pavlefshmërisë dhe afatet për vendimet e asamblesë parashikohen në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe zakonisht i nënshtrohen afatit të parashkrimit tre vjeçar. Ndërsa, regjimi i pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare, përcaktohet në mënyrë të vecantë nga neni 3/1 i ligjit 9901<sup>3</sup>.

Pra edhe kur ligji tregtar i referon shkaqet e pavlefshmërive në kodin civil, dispozitat e këtij të fundit duhet të kuptohen dhe interpretohen sëbashku me dispozitat e ligjit tregtar që kufizojnë efektet e pavlefshmërisë, duke u dhënë përparësi këtyre të fundit. Në mënyrë të përmbledhur, përsa i përket ligjit 9901 me ndryshimet e fundit duhet theksuar se: a) ligji 9901 ka një regjim të ndryshëm për pavlefshmërinë e themelimit dhe një tjetër për pavlefshmërinë e akteve, b) regjimi i pavlefshmërisë së themelimit neni 3/1 nuk përmban referenca tek kodi civil në lidhje me shkaqet që mund të cojnë në pavlefshmërinë e një shoqërie tregtare, përkundrazi i përcakton shkaqet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të themelimit në mënyrë shteruese, me karakteristikat specifike të fillimit të prodhimit të pasojave ex nunc, dhe afate të vecanta parashkrimi. Dhe c) regjimi i pavlefshmërisë së akteve të shoqërive tregtare mbështetet në dispozitat e ligjit 9901 dhe/ose kodit civil (një kontratë tregtare mund të deklarohet e pavlefshme sipas dispozitave të kodit civil dhe ose ato të ligjit 9901)<sup>4</sup>.

Ligji nuk i ka përcaktuar qartë rastet e mësipërme se cili prej tyre nuk do shkaktojë një lloj pavlefshmerie apo një tjetër, por theksonse të dy format e pavlefshmërisë mund të konstatohen vetëm nga gjykata, e cila realizon një proces gjyqësor për të vlerësuar nëse ekzistojnë ose jo shkaqet e pavlefshmërisë. Por meqë dispozita mbi pavlefshmeritë është e re dhe nuk ka filluar ende të leshojë gjurmeët e saj në praktikën gjyqësore mund të drejtohem i doktrinës për të qartësuar rastet që cojnë në pavlefshmëri absolute apo në pavlefshmëri relative.<sup>5</sup>

Vetëm gjykata do të japë përgjigje me zhvillimin e praktikës së saj, klasifikimit të shkaqeve që përmban kjo dispozitë, në shkaqe për pavlefshmëri absolute apo relative. Nëse i përmbahemi kriterit të interesit që mbron dispozita, mund të themi për ilustrim se rastet e përmendura në pikën një të cilat mbrojnë një interes më të ngushtë, cojnë në pavlefshmëri relative dhe mund të rregullohen para se gjykata të japë vendim. Përmendim këtu që autorët e cituar në këtë pjesë vënë në dukje faktin se interesi individual, nuk do të thotë domosdoshmërisht, interesi i një personi, një grup personash, një grup personash që kanë të njëjtin interes mund të klasifikohet si ineresi i ngushtë në një rrethanë të caktuar, ose si interesi i përgjithshëm në një rrethanë tjetër. Pra çështja kërkon analizim sipas kushteve konkrete të konfliktit gjyqësor përballë gjykatës.

Ndryshe nga sfera e të drejtës civile ku pavlefshmëritë i shtrijnë efektet tek të tretët në mirëbesim dhe madje ex tunc në të drejtën tregtare të tretët në mirëbesim janë të mbrojtur nga efektet e pavlefshmërisë, të cilat nisin të prodhohen duke filluar nga momenti i deklarimit të kësaj pavlefshmërie.

Në mënyrë të vecantë në lidhje me pavlefshmërinë e themelimit, dy kategoritë gjenerojnë pasoja të ndryshme:

1. Pavlefshemria absolute konstatohet nga gjykata dhe sjell për pasojë prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
2. Pavlefshmëria relative, shpallet nga gjykata dhe nuk ka si pasojë prishjen e menjëhershme të shoqërisë. Shkaku i pavlefshmërisë mund të korigjohet nga ortakët apo aksionarët deri para shpalljes së vendimit gjyqësor që konstaton pavlefshmërinë. Nëse shkaku është korigjuar dhe publikuar në QKR sipas kërkesave të ligjit 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, të ndryshuar, gjykata nuk mund të deklarojë pavlefshmërinë.

Dispozita i mbron të tretët që kanë përfutur të drejta të caktuara para shpalljes së pavlefshmërisë; askush nuk mund të çenonë gëzimin e qetë të këtyre të drejtave mbi pretendimin se shoqëria është prishur për shkak të pavlefshmërisë. Pavlefshmëria gjithashtu, nuk cliron themeluesit e shoqërisë nga detyrimi për të paguar kontributet e nënshkruara prej tyre në aktin e themelimit të rritjes së mëpasshmetë kapitalit. Ligji duhet thënë se lë një hapësirë për mos-zbatimin e kësaj kërkesë ndaj themeluesve, në rastin kur kreditorët e shoqërisë mund të shlyhen gjatë procesit të likuidimit me asetet e vetë shoqërisë.

Një rast praktik është edhe vendimi K.H ndaj F.I e shoqërisë “Trans Bistrica” SH.P.K. Në datën 20.05.2003 paditësi ka depozituar padinë objekt gjykimi, me të cilën kërkon deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të aktit të themelimit të datës 07.06.2000. për shoqërinë “Trans-Bistrica” shpk bazuar në nenin 121 e vijues dhe ligjit nr.7638, dhe ligjit nr.7667. Fillimisht paditësi përdin e ka ngritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr.2862, datë 12.05.2005 ka shpallur

<sup>3</sup> A.Malltezi, J.Rustemaj, A.Kromeci, Gjykatat Shqiptare pwr shoqwrw tregtare, fq 92-100.

<sup>4</sup> Sipas ligjit nr.9901 i vitit 2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

<sup>5</sup> Sipas A.Malltezi, J.Rustemaj, A.Kromeci, Gjykatat Shqiptare pwr shoqwrw tregtare, fq94-98.

moskompetencën duke i dërguar aktet Gjykatës së Rrethit gjyqësor Sarandë si gjykatë kompetente. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e rrethit gjyqësor Sarandë, paditësi K.H ka saktësuar objektin e padisë dhe shkaku ligjor të saj.

Ka rezultuar se me vendimin nr.24097, datë 04.06.2000 të Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, shoqëria “Trans Bistrica” sh.p.k është rregjistruar si person juridik me 11 ortakë, me administrator të paditurin F.I ku sipas aktit të themelimit dhe statutit të saj paditësi dhe i padituri do të dispononin nga 5 kuota secili, ndërsa 9 ortakët e tjerë nga 10 kuota.

Paditësi ka pretenduar se një ndarje e tillë e kuotave është bërë nga i padituri F.I pa marrë pëlqimin e ortakëve themelues, pasi duke qënë se i padituri është marrë me hartimin e dokumentacionit për rregjistrimin Shoqërisë “Trans-Bistrica” sh.p.k, si person juridik, ka paraqitur në to të dhëna të rreme duke falsifikuar edhe nënshkrimin e tij (fakt ky i provuar dhe nga akt-ekspertimi grafik i nënshkrimit në emër të K.H).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.140, datë 17.02.2006 ka vendosur: “Pranimin e kërkesë padisë së palës paditëse K.H konstatimin e pavlefshmërisë dhe parregullsisë të kufizuar sh.p.k “Trans-Bistrica” me qëndër në Delvinë, të datës 07.06.2000, shoqëri kjo e rregjistruar me vendimin nr.24097, datë 04.06.2000 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, përsa i përket nënshkrimit të ortakut K.H dhe kuotave të këtij ortaku dhe kuotave të paditurit F.I si ortak dhe rregullimin e pasojave, heqjen si anëtar i shoqërisë të të paditurit F.I dhe 5 (pesë) kuotave të tij, duke i saktësuar kuotat e paditësit në masën 10 (dhjetë) %.”

## Konkluzione/ Rekomandime

Jurisprudenca dhe doktrina shqiptare ka përfuruar qëndrimin se, në kushtet e veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme, veprimi është sikur të mos kishte ekzistuar fare dhe palët ose të tretët mund të sillen sikur veprimi juridik të mos ishte kryer.<sup>6</sup> Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm mund të përcaktohet si veprim juridik i cili për shkak të shkeljes së ligjit ose për shkak tjetër të parashikuar në ligj, nuk ka fuqi juridike ose është i paafët të sjellë pasoja juridike të synuara nga palët.<sup>7</sup>

Ndërsa në rastin e pavlefshmërisë relative, veprimet juridike të cilat kanë shkak per ty deklaruar të pavlefshme, konsiderohen të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme.<sup>8</sup>

Pavlefshmëria absolute dhe relative ndryshojnë së pari nga shkaqet, shkaqet për pavlefshmërinë absolute janë të vendosura për mbrojtjen e interes të përgjithshëm të shoqërisë apo në interesin publik, dhe përcaktohen në nenin 92 të kodit civil, ndërsa ato për pavlefshmërinë relative janë të vendosura në favor të palëve që legjislatori synon të mbrojtë, të cilat përcaktohen në nenin 94 të kodit civil. Përveç këtyre dallimeve, një tjetër dallim thelbësor lidhet me pasojat që sjellin të dy llojet e pavlefshmërive. Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm është sikurse doktrina ka përcaktuar, nul, rrjedhimisht pretendimi për të konstatuar pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik mund të ngrihet në cdo kohë duke u vlerësuar si i paparashikueshëm.

Në fushën e shoqërive tregtare, pavlefshmëria e akteve dhe pavlefshmëria e themelimit përbëjnë dy rregjime të ndryshme. Përmendim për shembull se, kontratat e lidhura nga shoqëria tregtare do ti nënshtrohen shkaqeve të pavlefshmërisë së Kodit Civil dhe afateve të tyre të parashkrimit, ndërsa shkaqet e pavlefshmërisë dhe afatet për vendimet e asamblesë parashikohen në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe zakonisht i nënshtrohen afatit të parashkrimit tre vjeçar.

Ndërsa rregjimi i pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare, përcaktohet në mënyrë të vecantë nga neni 3/1 i ligjit 9901. Pra edhe kur ligji tregtar i referon shkaqet e pavlefshmërive në kodin civil, dispozitat e këtij të fundit duhet të kuptohen dhe interpretohen së bashku me dispozitat e ligjit tregtar që kufizojnë efektet e pavlefshmërisë, duke u dhënë përparësi këtyre të fundit. Në mënyrë të përmbledhur, përsa i përket ligjit 9901, me ndryshimet e fundit, duhet theksuar se:

- A) Ligji 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ka një rregjim të ndryshëm për pavlefshmërinë e themelimit dhe një tjetër për pavlefshmërinë e akteve
- B) Rregjimi i pavlefshmërisë së themelimit(neni 3/1) nuk përmban referenca tek Kodi civil në lidhje me shkaqet që mund të cojnë në pavlefshmërinë e një shoqërie tregtare; përkundrazi i përcakton shkaqet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të themelimit në mënyrë shteruese, me karakteristikat specifike të fillimit të prodhimit të pasojave ex nunc, dhe afate të vecanta parashkrimi.
- C) Rregjimi i pavlefshmërisë së akteve të shoqërive tregtare mbështetet në dispozitat e ligjit 9901 ose kodit civil

Për të kuptuar rëndësinë e dallimit të rregjimeve dhe funksionit kufizues të nenit 3/1, përmendim se ndonëse mashtrimi përbën një nga shkaqet e pavlefshmërive të kontratave në shumicën e vëndeve të BE, Gjykata Europiane e Drejtësisë ka vendosur që neni 11 dhe 12 i direktivës nuk mund të interpretohen gjerësisht për të përfshirë edhe mashtrimin në shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit; këto të fundit duhet të interpretohen ngushtësisht në përputhje me tekstin e këtyre dy dispozitave.

<sup>6</sup> Sipas Ardian Nuni, E drejta civile, Pjesa e përgjithshme, Tiranë 2009, faqe 334.

<sup>7</sup> Sipas Vendimit unifikues se Gjykatës së Lartë, Nr.5 datë 30.10.2012.

<sup>8</sup> Mbi dallimin e llojeve të pavlefshmërive dhe pasojat që ato sjellin, Rustem Gjata, E drejta civile, pjesa e përgjithshme, Tiranë 2010, faqe 142-178.



## Bibliografia

- A.Malltezi, J.Rustemaj, A.Kromeci, Gjykatat Shqiptare për shoqëritë tregtare, Mediaprint 2015.  
Ardian Nuni, E drejta civile, Pjesa e përgjithshme, Tiranë 2009.  
Ligji nr.9901 i vitit 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.  
Vendimin nr.140, datë 17.02.2006 i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Sarandë.  
Vendimit unifikues i Gjykatës së Lartë, Nr.5 datë 30.10.2012.  
Mbi dallimin e llojeve të pavlefshmerive dhe pasojat që ato sjellin, Rustem Gjata, E drejta civile, pjesa e përgjithshme, Tiranë 2010.

# PRAKTIKA GJYQËSORE SHQIPTARE DHE PROBLEMATIKAT E MOSMARRËVESHJEVE NË FITIMIN E PRONËSISË ME KONTRATË

---

ARDVIN KRAJA

---

## ABSTRAKT

Mënyrë e fitimit të pronësisë në përgjithësi, por dhe e fitimit të pronësisë së sendeve të paluajtshme është kontrata. Fitimi i pronësisë me kontratë është parashikuar nga neni 164 i Kodit Civil, sipas të cilit: "Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qene e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit". Për sendet që përcaktohen në numër, peshë dhe masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre. Përmbajtjen e kontratës së shitjes e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet. Këto të drejta dhe detyrime qëndrojnë përballë njëra-tjetres në raporte të ndërsjella. Kjo do të thotë që të drejtës së njëres palë i përgjigjet detyrimi i palës tjetër. Me fitimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurine e paluajtshme, meqenëse sendi është i përcaktuar individualisht, blerësit i lind e drejta për të mbrojtur të drejtën si pronar me padinë e rivendikimit kundrejt të paditurve, kurse këta të fundit që e posedojnë pa asnjë titull sendin, detyrohen t'i kthejnë sendin pronarit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre. Në praktikë ka pasur debate nëse kalimi i pronësisë mbi sendet e paluajtshme bëhet vetëm me lidhjen e kontratës në formën e kërkuar nga Kodi Civil apo kërkohet edhe regjistrimi i saj në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Duke u nisur nga problematikat e ndryshme që janë paraqitur në kuadër të mosmarrëveshjeve, Gjykata e Lartë ka njehsuar praktikën gjyqësore me anë të vendimeve respektive në kuadër të problemeve të pronësisë në përgjithësi dhe të fitimit të saj me kontratë në veçanti.

**Fjalë kyç:** *Pronësi; Kontratë; Praktikë gjyqësore; Fitim pronësie; Send i paluajtshëm*

---

## Hyrje

Shumë autorë shqiptarë apo të huaj e kanë trajtuar këtë të drejtë në shumë pikëpamje. Kjo për shkak të rëndësisë së saj, si edhe për faktin së e drejta e pronës është një e drejtë kushtetuese, e patjetërsueshme, e pandashme dhe e padhunueshme dhe qëndron në themel të rendit juridik shqiptar. Dhe, pavarësisht nga formulimi që gjejnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, vënia në jetë e tyre ka shfaqur probleme në shumë raste, jo vetëm në shtetin shqiptar. Megjithatë, këtu do fokusohemi tek vështirësitë që has shteti ynë në njohjen dhe realizimin e kësaj të drejte.

Kontrata në llojin e fakteve juridike është veprim juridik i dyanshëm, kurse vetë kontratat për fitimin e pronësisë mund të jenë të njëanshme ose të dyanshme. Kontrata, duke qënë veprim juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara tek neni 83 i Kodit Civil, sipas të cilit: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm”.

Në nenin 750 të Kodit Civil parashikohet shitje e sendeve të paluajtshme sipas të cilit: “Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme”.

Në një interpretim literal të dispozitave të mësipërme rezulton se, për kryerjen e veprimit juridik të kalimit të pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet respektuar forma e veprimit juridik. Në rastin konkret, veprimi juridik duhet të bëhet me akt noterial, pra është një veprim juridik formal, si edhe në mënyrë kumulative duhet respektuar edhe kërkesa për regjistrimin e sendit të paluajtshëm.<sup>1</sup>

Pronari i një sendi individualisht të përcaktuar, siç mund të jetë edhe një send i luajtshëm, mund të çenohet në të drejtën e pronësisë, duke u zhveshur tërësisht nga posedimi i sendit. Në këtë rast ai do të përdoret si mjet mbrojtjeje të së drejtës së tij të pronësisë së pretenduar, të shkelur duke përdorur padinë për kërkimin e sendit (padija e rivendikimit), parashikuar në nenin 296 të Kodit Civil. Për t’u legjitimuar në kërkimet e tij, pronari duhet të vërtetojë, se është pronari i sendit që kërkon të rivendikojë. Në rastin e fitimit të pronësisë me kontratë, pronari duhet të vërtetojë që pronësinë e ka fituar me kontratë, duke respektuar kërkesat ligjore në lidhje me kryerjen e veprimit juridik përkatës për kalimin e pronësisë.<sup>2</sup>

## Qellimi dhe objektivat e studimit

E drejta e pronës në thelbin e saj duhet të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me praktiken gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg.

Punimi shkencor i cili do të trajtojmë, lidhet me marrjen në vështrim analizues të çështjeve që lidhen me fitimin e pronësisë sipas të drejtës shqiptare. Do të shihen problematikat që lidhen me kontratat e fitimit të pronësisë.

Pronësia është e drejta për të poseduar, gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, po brënda kufijve të caktuar me ligj. Pronari i tre tagreve mund t’i ushtrojë vetë ato, ose dy prej tyre konkretisht, tagret e posedimit dhe gëzimit mund t’ua kalojë të tretëve duke krijuar mbi sendin të drejta reale dytësore. Të tretëve, pronari nuk mund t’ua kalojë tagrin e disponimit, pasi ai është tagri që i përket pronarit, kalimi i të cilit tek të tretët do të çonte në krijimin e një pronësie të re. Pikërisht tagri i disponimit është tagri që përcakton të drejtën e pronësisë, pasi dy tagret e tjera që mund të ushtrohen nga pronari apo një person i tretë krijojnë të drejta reale dytësore lidhur me sendet (në doktrinë).

Në këtë prizëm do të trajtohet punimi në kuadër të praktikës gjyqësore, me problematikat që janë zhvilluar në këtë aspekt si pasojë e vakuimit ligjorë në fitimin e pronësisë me kontratë.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

*Hipoteza:* Të jesh pronar mbi sendin ose sendet do të thotë jo vetëm t’i kesh dhe t’i përdorësh, por dhe t’i tjetërsosh, t’i shesësh, t’i dhurosh, etj; apo të vendosësh për fatin e tyre. E drejta e pronësisë nuk mund të kuptohet pa tagrin e disponimit, i cili mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj.

*Metodologjia e punimit:* Metodologjia e përdorur në përgatitjen e këtij punimi është metoda e analizës së legjislacionit dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë. Kjo metodë konsiston në formulimin e problemeve ligjore nepërmjet analizës së legjislacionit. Duke qënë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nepërmjet interpretimit të këtyre normave.

*Pyetja kërkimore:* Cfarë duhet bërë për një mirë-rregullim të legjislacionit shqiptarë, duke pasur si pikë orientimi vendimet e Gjykatës së Lartë?

<sup>1</sup> Lama, V. “E drejte e Procedures Civile”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2005, Fq. 36.

<sup>2</sup> Nuni, A. “Leksione të së drejtës së pronësisë”, Uet Pres, Tiranë 2009.

## Fitimi i pronësisë me kontratë në legjislacionin shqiptarë

Fitimi i pronësisë me kontratë është një nga mënyrat më të përhapura të fitimit të pronësisë dhe që parashikohet në mënyrë të shprehur në ligj. Kjo mënyrë e fitimit të pronësisë në përgjithësi, por dhe e fitimit të pronësisë së sendeve të paluajtshme në veçanti, është parashikuar nga neni 164 i Kodit Civil, sipas të cilit: “Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qënë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit”. Për sendet që përcaktohen në numër, peshë dhe masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre.

Kontrata në llojin e fakteve juridike është veprim juridik i dyanshëm, kurse vetë kontratat për fitimin e pronësisë mund të jenë të njëanshme ose të dyanshme. Kontrata, duke qënë veprim juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara tek neni 83 i Kodit Civil, sipas të cilit: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm”.

Kontrata e shitjes është një nga kontratat më të vjetra dhe më të përdorshme në qarkullimin civil, me anë të së cilës kryhen pjesa më e madhe e veprimeve tregtare dhe e veprimeve juridiko - civile. Kjo kontratë njihet nga e drejta romake dhe ka ardhur duke u përsosur me kalimin e kohës deri në ditët e sotme. Me përdorimin e monedhës ekuivalenca e mallit filloi të bëhej me të holla dhe është pikërisht ky momenti që shënon lindjen e marrëdhënieve juridike të shitblerjes.

Kontrata e shitjes synon drejtpërdrejt në realizimin e të drejtave materiale dhe ekonomike të të dyja palëve si shitësit ashtu edhe të blerësit. Kontrata është veprim juridik i dyanshëm dhe me shpërblim. Kontrata e shitjes është veprim juridik konsensual, domethënë bëhet e vlefshme që nga momenti i arritjes së marrëveshjes së palëve.<sup>3</sup>

Për fitimin e pronësisë me kontratë mbi sendet e paluajtshme, duhet të plotësohen njëkohësisht këto kushte:

Së pari, të bëhet lidhja e kontratës. Kontrata konsiderohet e lidhur kur vullnetet e kundërta të palëve përputhen.

Së dyti, kontrata të lidhet në formën e përcaktuar nga ligji, që është një kusht specifik dhe element thelbësor. Mungesa e këtij kushti e bën kontratën e pavlefshme.

Së treti, kontrata të ketë për qëllim kalimin e pronësisë nga një subjekt në tjetrin, ku si kontrata të tilla mund të jenë, e shitjes, dhurimit, shkëmbimit, etj.<sup>4</sup>

## Problematikat e praktikës gjyqësore në fitimin e pronësisë

Përsa i përket fitimit të pronësisë vendi ynë ka hasur shumë problematika, të cilat në të shumtën e rasteve nuk janë zgjidhur në mënyrën më të mirë duke mos vënë në vend të drejtat e cënuara. Ka me qindra raste të pazgjidhura në gjykatat tona, por kjo nuk ka ndodhur vetëm për efekt të kulturës tonë jo shumë të zgjeruar nga ana ligjore por për shkak të praktikës ligjore jo shumë të konsoliduar. Po t’i referohemi një vendimi të Kolegjit Civil së Gjykatës së Lartë në rastin Sh. S. kundër Dh.R, gjykata arsyeton:

*“është e vërtetë që i padituri ka blerë sipërfaqen e parcelës nr. 23, por nuk e ka regjistruar atë në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Sipas nenit 83 të Kodit Civil që veprimi juridik i kalimit të pronësisë të jetë i ligjshëm për sendet e paluajtshme duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm. Veprimi juridik i kryer nga i padituri nuk është regjistruar, dmth i padituri nuk është bërë pronar.”*

Për të dhënë një opinion sa më të saktë rreth vendimin nr. 1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara, duhet të realizohen me radhe keto momente:

- a. Vlefshmëria e veprimit juridik për shitje e kontates së paluajtshme;
- b. Kur fitohet pronësia me anë të kontratës së shitjes për sendet e paluajtshme;
- c. Pasojat juridike të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- d. Padia për kërkimin e sendit;

Përmbajtjen e kontratës së shitjes e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet. Këto të drejta dhe detyrime qëndrojnë përballe njëra-tjetres në raporte të ndërsjella. Kjo do të thotë që të drejtës së njëres palë i përgjigjet detyrimi i palës tjetër. Me fitimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, meqenëse sendi është i përcaktuar individualisht, blerësit i lind e drejta për të mbrojtur të drejtën si pronar me padinë e rivendikimit kundrejt të paditurve, kurse këta të fundit detyrohen t’i kthejnë sendin pronarit se e mbajnë pa asnjë titull.

Në nenin 750 të Kodit Civil parashikohet shitje e sendeve të paluajtshme sipas të cilit: “Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme”.<sup>5</sup>

Në një interpretim literal të dispozitave të mësipërme rezulton se, për kryerjen e veprimit juridik të kalimit të pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet respektuar forma e veprimit juridik. Në rastin konkret, veprimi juridik duhet të bëhet me akt noterial, pra është një veprim juridik formal, si edhe në mënyrë kumulative duhet respektuar edhe kërkesa për regjistrimin e sendit të paluajtshëm.<sup>6</sup>

<sup>3</sup> Lamani, A. “Procedura Civile e RPSH”, Shtëpia Botuese “Krsitalina”, Tiranë 2004, Fq. 44.

<sup>4</sup> Nuni, A. Hasneziri, L. “E drejta Civile II (Pronësia)”, Shtëpia Botuese “Morava”, Tiranë 2010, Fq. 103.

<sup>5</sup> “Kodi Civil”, Shtëpia Botuese “Alb Juris”, Tiranë 2009, Fq. 212.

<sup>6</sup> Lama, V. “E drejte e Procedures Civile”, Shtepia Botuese “Pegi”, Tirane 2005, Fq. 36.

Pronari i një sendi individualisht të përcaktuar, siç mund të jetë edhe një send i luajtshëm, mund të çenohet në të drejtën e pronësisë, duke u zhveshur tërësisht nga posedimi i sendit. Në këtë rast ai do të përdorte si mjet mbrojtjeje të së drejtës së tij të pronësisë së pretenduar, të shkelur, padinë për kërkimin e sendit, parashikuar në nenin 296 të Kodit Civil. Për t'u legjitimuar në kërkimet e tij, pronari duhet të vërtetojë, se është pronari i sendit që kërkon të rivendikojë. Në rastin e fitimit të pronësisë me kontratë, pronari duhet të vërtetojë që pronësinë e ka fituar me kontratë, duke respektuar kërkesat ligjore në lidhje me kryerjen e veprimit juridik përkatës për kalimin e pronësisë.<sup>7</sup>

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar çështjen me palë ndërgjyqëse Gj. N., etj, me objekt kërkim sendi, konkretisht të një banese. Paditësi ka pretenduar se ishte pronar i banesës, pronësinë e së cilës e kishte fituar me kontratë shitblerjeje në vitin 1998, dhe që nuk e kishte regjistruar. Gjykata e Shkallës së Parë e kishte legjitimuar paditësin me kërkimet e tij, duke e konsideruar se e kishte fituar pronësinë vetëm me kryerjen e veprimit juridik përkatës në formën e kërkuar nga ligji, ndërsa Gjykata e Apelit nuk e ka legjitimuar, pasi ka arsytuar se për fitimin e pronësisë me kontratë duhet që të bëhet edhe regjistrimi i saj. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore kanë konkluduar se: "Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie...." dhe se, "regjistrimi ka vlera deklarative njohëse dhe nuk ka vlera krijuese, si dhe ka rëndësi për parimin e prioritetit".

Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se regjistrimi i pasurive të paluajtshme nuk ka karakter krijues. Regjistrimi është një formë, me anën e së cilës shënohen në regjistra të posaçme disa veprime juridike për fitimin e pronësisë, por edhe i disa të drejtave reale mbi sendet e paluajtshme, si edhe ndryshimet që ndodhin më pas në këto të drejta. Regjistrimi kërkohet për pasoja të ndryshme. Lidhur me pasojat njihen dy sisteme kryesore të regjistrimit: a) Sistemi i regjistrave të pronave ose kadastrës; b) Sistemi i transkriptimit (hipotekës). Regjistrimi është deklarativ, është një shkak preferimi sipas të cilit midis personave që kanë fituar po nga i njëjti person një send të paluajtshëm, prej tyre ai që e regjistron i pari përjashton çdo fitues tjetër, qoftë edhe i mëparshëm, që nuk ka bërë regjistrimin e veprimit juridik.<sup>8</sup>

Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre. Në praktikë ka pasur debate nëse kalimi i pronësisë mbi sendet e paluajtshme bëhet vetëm me lidhjen e kontratës në formën e kërkuar nga Kodi Civil apo kërkohet edhe regjistrimi i saj në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për këtë problem Kolegji Civil ka vendosur që Gjykata e Lartë të shprehej në Kolegje të Bashkuara për një çështje konkrete të Rrethit Lezhë.<sup>9</sup>

Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme është i vlefshëm në rast se plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79, 663, 659 të Kodit Civil. Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar dhe të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri. Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. Kontrata, e cila nuk është e regjistruar, është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrajt të tretëve.<sup>10</sup>

Pyetjes, nëse janë realizuar disa kontrata shitje me akt notarial dhe që të gjitha janë regjistruar, cila nga këto do të jetë e vlefshme, ligji "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" në nenin 10 të tij parashikon se: "Në rastet kur, për të njëjtën pasuri, janë bërë më shumë se disa regjistrime, të cilat nuk kanë rrjedhur nga njëri – tjetri, në përputhje me dispozitat e këtij ligj, regjistruesi, me vendim të arsytuar, i kërkon Kryeregjistruesit të vendosë fshirjen e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, kur ky i fundit është në përputhje me nenet 192 – 197 të Kodit Civil, duke bërë shënimin në kolonën përkatëse. Deri në nxjerrjen e vendimit të Kryeregjistruesit për miratimin ose refuzimin e kësaj kërkeje, regjistruesi bën pezullimin e regjistrimit dhe mbi pasurinë nuk mund të kryhen veprime, si dhe njofton palën/palët e interesuara brenda 10 ditëve....."<sup>11</sup>

Në rastin e fitimit të pronësisë mbi sendet e paluajtshme me kontratë mund të përmjendim rastet e institutit të parablerjes në bashkëpronësinë e disa personave mbi një send të paluajtshëm. E drejta e parablerjes është një institut shumë i rëndësishëm i drejtës civile që është njohur edhe nga e drejta zakonore shqiptare. Në mënyrë që të zbatohet e drejta e parablerjes duhet të plotësohen disa kushte:

- a) Ekzistenca e një sendi të paluajtshëm në bashkëpronësi;
- b) Tjetërsimi i pjesës nga bashkëpronari duhet të bëhet kundrejt shpërblimit;
- c) Pjesa e bashkëpronarit në sendin e paluajtshëm duhet t'i tjetërsohet personave të tretë jobashkëpronarë;

Me anë të këtij instituti bëhet i mundur kalimi pronësisë me anë të kontratës së shitjes nga njëri bashkëpronarë tek tjerët, pra Kodi Civil parashikon të drejtën e bashkëpronarëve të tjerë që të njoftohen me shkrim nga bashkëpronari që kërkon të shesë pjesën e tij në sendin e paluajtshëm të përbashkët. Sipas ligjit bashkëpronarët e tjerë janë të detyruar që të përgjigjen brenda tre muajve nga dita që janë njoftuar nga bashkëpronari i cili kërkon që të shesë pjesën e tij, nëse ata janë dakort që ta blejnë pjesën e sendit të paluajtshëm, të përbashkët, që kërkon të shesë bashkëpronari.<sup>12</sup> Sidoqoftë kemi shumë problematika

<sup>7</sup> Nuni, A. "Leksione të së drejtës së pronësisë", Uet Pres, Tiranë 2009.

<sup>8</sup> Tafaj, F. Tushaj, V. "Procedura Civile (cikël leksionesh)", Tiranë 2009, Fq. 88.

<sup>9</sup> Vendimi njëses Nr.1, Datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>10</sup> Gjata, R. "E drejta Procuderiiale Civile", Shtëpia Botuese "Dudaj", Tiranë 2008, Fq. 133.

<sup>11</sup> Ligji Nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

<sup>12</sup> Nuni, A. Hasneziri, L. "E drejta Civile II (Pronësia)", Shtëpia Botuese "Morava", Tiranë 2010, Fq. 181.

të hasura në praktikë ku mund të përmendim rastin B. K, M. H, etj. kundër H. K, M. E, S. V, B. V, I. V, J. B, shoqëria “F” shpk, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes me kusht, rikthimin në gjendjen e mëparshme dhe njohjen e të drejtës së parablerjes ka rezultuar se paditësat me një pjesë të të paditurve janë bashkëpronarë në disa prona. Me datë 03.03.2003 midis të paditurve dhe shoqërisë “F” shpk është lidhur një kontratë ku të paditurit pjesët takuese ideale të pronësisë ia shesin kësaj shoqërie dhe të paditurit tjetër J. B.. Shitësit ditën e nënshkrimit të kontratës kanë marrë një pjesë të parave, kurse pjesa tjetër do të paguhej pasi të përfundonte gjykimi i kërkesë padisë për pjesëtimin e pasurisë. Pas hartimit të kontratës të paditurit, konkretisht shoqëria “F” shpk dhe J.B. i kanë regjistruar pronat në favor të tyre. Gjykata ka pranuar padinë në lidhje me kërkimin për pavlefshmërinë e kontratës duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Ne vendim ajo arsyeton:

*“Të paditurit nuk kanë respektuar të drejtën e parablerjes dhe nisur nga ky fakt kontrata nuk është kontratë shitje me kusht pezullues sepse palët e kanë shitur pjesën e tyre ideale gjë e cila del qartë nga kontrata.” Del qartë nga vendimi se e drejta e parablerjes është një institut i të drejtës civile që duhet respektuar me çdo kusht në mënyrë që të bëhet e vlefshme kontrata për kalimin e pronësisë së një sendi të paluajtshëm nga një bashkëpronar në një tjetër.<sup>13</sup>*

Kontrata e shitjes së pasurive të paluajtshme është e parashikuar edhe në ligje të veçanta. Ligji Nr. 7983, Dt. 27.07.1995 “Për shitblerjen e tokës bujqësore livadheve dhe kullotave”, u kalua kjo pengesë ligjore, megjithëse parashikoheshin rregulla të detyrueshme që duheshin respektuar me qellim që të krijoheshin pasojat juridike të dëshiruara duke e vënë theksin edhe tek e drejta e parablerjes. Sidoqoftë në këtë ligj ndalohet shitja e tokës:

- a) Në rast se nuk është bërë regjistrimi fillestar i pasurisë sipas këtij ligjit;
- b) Personave fizikë dhe juridike të huaj, të cilët kanë vetëm të drejtën e marrjes së saj me qira deri në 99 vjet.

Në rastin shoqëria “Albatrucks” kundër K. K, R. K, F. B, A. B, etj me objekt konstatimin e e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes së një sipërfaqe toke lidhur midis K. K. dhe R. K. (shitësat) dhe F. B dhe A. B. (blerësat) më datë 07.04.2007, ka rezultuar se lidhja e kontratës është bërë në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi të shitësave regjistruar në datën 06.04.2005. Me kontratën e shitjes dt. 31.01.1995 paditësi në cilësinë e blerësit, përfaqësuar nga administratorja e tij F. B., ka blerë nga i padituri K. K. sipërfaqen e tokës objekt gjykimi. Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë me këtë arsye:

*“Referuar nenit 663 të Kodit Civil shkaku i ligjshëm i një veprimi juridik nuk mund të reduktohet vetëm te qëllimi i palëve për të lidhur një kontratë, por duhet parë krahasimisht me të gjitha normat ligjore që nuk bien ndesh me rendin juridik. Ligji mbi bazën e të cilit i padituri e ka fituar të drejtën e pronësisë, e ndalonte shprehimisht shitblerjen e tokës. Neni 3 i ligjit 7983 parashikon si të pavlefshme veprimet e shitjes së tokës bujqësore të paregjistruar. Po ashtu neni 195 i kodit ndalon tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme pa u bërë më parë regjistrimi i saj”. Në këtë kuptim akti i marrjes së tokës në pronësi ka një vlerë të kufizuar, ai konsiderohet i paplotë nëse nuk është bërë regjistrimi i pasurisë së paluajtshme sipas këtij ligji.<sup>14</sup>*

Problematikat që kanë dalë gjatë shqyrtimit të dosjeve në gjykatat tona, kanë ndikuar dhe në mbushjen e vakkumeve legjislativ me anë të praktikës gjyqësore edhe në fusha të tjera siç është dhe e drejta e detyrimeve. Mund të përmendim një vendim të Gjykatës së Lartë në rastin Xh.Sh., A. Sh., Q. Sh., kundër Xh. L. me objekt pavlefshmëri veprimi juridik, ku ka rezultuar se në datë 14.11.2003 para noterit pjesëmarrësit (paditësit në pozitën e shitësit dhe i padituri si blerës) kanë lidhur një kontratë shitblerje për një banesë. Paditësja Xh. Sh., konform nenit 46/2 të ligjit “Për Noterinë”, ka shprehur vullnetin para noterit se dëshironte të përfaqësohej për nënshkrimin e kontratës nga paditësja tjetër Q. Sh. dhe ka qenë kjo e fundit që ka nënshkruar për të. Gjykata në vendim arsyeton se:

*“Veprimi i noterit që ka lejuar një person të përfaqësohej në nënshkrim nga një person tjetër është i ligjshëm, për më tepër që të dy ishin palë në kontratë. Neni 47 i ligjit “Për Noterinë” vlen vetëm për një rreth të caktuar personash, përkthyesit dhe dëshmitarët. Nënshkrimi i përmendur në këtë nen lidhet me dy kufizimet e para dhe ka të bëjë me nënshkrimin që bën ky person në akt si përfaqësues i njërit ose tjetrit”.<sup>15</sup>*

Ligji i mësipërm në nenin 46 të tij parashikon se si rregull aktet noteriale duhet të nënshkruhen nga palët dhe nga pjesëmarrësit e tjerë në prani të noterit.

Kështu mund të themi se me anë të mosmarrëveshjeve për çështjet e pronësisë, e drejta ka pasur zhvillim edhe në dimensione tjera meqenëse sistemi i së drejtës në përgjithësi është multidisiplinar dhe nuk mund të jepet drejtësia në rast se nuk bashkohen dhe studiohen të gjitha institutet e së drejtës civile.

## Konkluzione

E drejta e pronësisë si e pjesë e posaçme e të drejtës civile në praktikë ka hasur shumë problematika. Siç u trajtua në punim, një nga problemet më sensitive të kësaj dege të së drejtës është fitimi i pronësisë me kontratë.

Tagri i disponimit, duke iu referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, është ajo e drejtë mbi pronësinë që ka karakter deklarativ për të tretët. Me anë të këtij tagri, pronari i pasurisë së paluajtshme mund të tjetërsojë sendin në kuptimin që mund ta shesë, mund ta dhurojë, etj. Në thelb ky tagër ka për qëllim që të bëjë të mundur ndryshimin e pronësisë së sendit, pra

<sup>13</sup> Vendimi nr. 1377 dt. 13.03.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>14</sup> Vendimi Nr. 6837, Dt. 15.10.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>15</sup> Vendimi Nr. 00-2007-754 Dt. 15.05.2007 i Kolegjit Civil të Gjykatës Lartë.

njohjen nga të tretet. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se të jesh pronar nuk do të thotë që vetëm mund të përdorësh apo gezosh një send të caktuar të paluajtshëm, por mund të vendosësh mbi fatin e tij, duke vënë theksin tek tagri i disponimit pa të cilin nuk mund të kuptohet pronësia.

Meqënëse e drejta civile është e përbërë nga shumë institute, në këtë punim është vënë fokus edhe mbi institutet e tjera që kanë lidhje direkte në fitimin e pronësisë me kontratë. Kështu përmendim këtu të drejtën e detyrimeve si pjesë integrale e fitimit të pronësisë me kontratë. Problematikat që janë paraqitur me anën formale po ashtu edhe ligjet e ndryshme që rregullojnë këtë pjesë së marrëdhënies juridike të pronësisë janë të pandashme nga fitimi i pronësisë me kontratë. Në punim është vënë fokusi mbi problematikat e praktikës gjyqësore duke trajtuar atë pjesë të së dretës së pronësisë duke plotësuar vakuumin ligjor me anë të vendimeve të Gjykatës së Lartë në kuadër të mirë-funksionimit të sistemit ligjor duke dhënë zgjidhje për të gjitha mosmarrëveshjet në këtë aspekt të së drejtës. Pra, aplikimi i vendimeve të gjykatave është shumë i rëndësishëm për gëzimin e pacënuar dhe të qetë të sendit.

## Bibliografia

- Lama, V. "E drejte e Procedures Civile", Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2005, Fq. 36.  
 Nuni, A. "Leksione të së drejtës së pronësisë", Uet Pres, Tiranë 2009.  
 Lamani, A. "Procedura civile e RPSH", Shtëpia Botuese "Krsitalina", Tiranë 2004, Fq. 44.  
 Nuni, A. Hasneziri, L. "E drejta Civile II (Pronësia)", Shtëpia Botuese "Morava", Tiranë 2010, Fq. 103.  
 Kodi Civil, Shtëpia Botuese "Alb Juris", Tiranë 2009, Fq.212.  
 Lama, V. " E drejte e Procedures Civile", Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2005, Fq. 36.  
 Nuni, A. "Leksione të së drejtës së pronësisë", Uet Pres, Tiranë 2009.  
 Tafaj, F. Tushaj, V. "Procedura Civile (cikël leksionesh)", Tiranë 2009, Fq. 88.  
 Vendimi njësuës Nr.1 Datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.  
 Gjata, R. "E drejta procedurale civile", Shtëpia Botuese "Dudaj", Tiranë 2008, Fq. 133.  
 Ligji Nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".  
 Vendimi nr. 1377 dt. 13.03.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.  
 Vendimi Nr. 6837, Dt. 15.10.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.  
 Vendimi Nr. 00-2007-754 Dt. 15.05.2007 i Kolegjit Civil të Gjykatës Lartë.

# E DREJTA E PRONËS NË FOKUSIN E PROCESIT TË LEGALIZIMEVE, SI NJË MËNYRË E FITIMIT TË PRONËSISË MBI SENDET E PALUAJTSHME

---

## ORGENT NAZAJ

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti Juridik, E Drejtë Private  
orgent@live.com

---

## ABSTRAKT

Ky punim paraqet një kuadër të përgjithshëm të së drejtës së pronësisë e parë në fokusin e procesit të legalizimit si një mënyrë e fitimit të pronësisë, duke u mbështetur në nocionet dhe parashikimet ligjore që vendi jonë dhe vende të ndryshme japin për ndërtimet informale, duke shkuar në retrospektivë për të parë sesi ka lindur ky fenomen, duke u ndalur në legjislacionin shqiptar për t'a parë sesi është trajtuar zgjidhja e këtij fenomeni, duke analizuar mënyrat sesi mund të përfitohet nga ky proces, duke i parë këto në një vështrim krahasues ndërmjet disa legjislacioneve që kanë procedura të ndryshme, duke trajtuar dhe analizuar aktet ligjore më të rëndësishme për vendin tonë dhe për këto shtete që i referohen këtij fenomeni. Duhet thënë se çështjet e pronësisë, sidomos në Shqipëri, përbëjnë një nga sfidat më gjithpërfshirëse dhe më me ndikim në shumë sektorë të një vendi ku, ALUIZNI gëzon një pozitë të rëndësishme dhe si i tillë më ka shtyrë të prek dhe të ilustroj problemet me vendime të spikatura gjyqësore për të paraqitur një kuadër të praktikës gjyqësore në definimin sa më të qartë të aspekteve materiale dhe procedurale të normave në lidhje me çështjet e pronësisë dhe të këtyre të fundit në lidhje me ndërtimet informale. Në përfundim të këtij punimi do të pasqyrohet konkluzione dhe zgjidhja e problemeve që lindin nga situata informale e pasurive të paluajtshme në aspektin Europian dhe atë shqiptar, duke u përpjekur që ta përfaqësojmë Shqipërinë në një kuadër dhe në një kontekst koherent me anë të këtyre konkluzioneve të përfutuara nga i gjithë punimi.

**Fjalë kyç:** *Pronësi; Praktikë gjyqësore; Fitim pronësie; Send i paluajtshëm; Ish-pronarë*

---



## Hyrje

Me rënien e diktaturës komuniste Shqipëria, si të gjitha vendet e tjera të Evropës Juglindore, filloi rrugëtimin drejt materializimit të aspiratës për krijimin e një shoqërie demokratike dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut. Realizimi i këtij qëllimi, në periudhën e tranzicionit, u parashikua të vihej në jetë nëpërmjet një procesi transformimi rrënjësor kushtetues dhe ligjor, duke patur si objektiv kryesor, ndër të tjera edhe, reformimin e sistemit të pronësisë dhe lindjen e të drejtës së pronës private. Prandaj, në përmbushje të këtij objekti dhe bazuar në parimet dhe vlerat e reja të shtetit të ri demokratik, një sërë reformash ligjore u ndërmorrën në fushën e privatizimit të tokës, banesave dhe aseteve të tjera shtetërore (Rama, 2010: 97).

Mirëpo, politikat për përdorim privat dhe investime ende nuk ekzistojnë. Infrastruktura për të mbështetur një treg formal të tokës nuk ishte e pranishme. Ndërkohë cilësia e aksioneve ekzistuese të strehimit nuk përmbushte kërkesën në rritje të banorëve të qytetit për standarde më të mira jetese. Kjo solli që njerëzit të uzurponin në mënyrë të jashtëligjshme pronën publike dhe private duke ndërtuar në mënyrë të paligjshme pa plan ndërtimi. Shumë prej tyre në mënyrë informale i shisnin ndërtimet pa patur ende të drejtën e pronës. Në 2006 ekzistojnë rreth 400000 ndërtime pa leje, duke uzurpuar 40.000 hektar tokë. Përkthyer në vlerë monetare 6-8 bilion dollarë të investuara në ndërtime pa leje. Në qytete, zgjerimet ilegale apo shtesat në ndërtesat e vjetra kanë qënë gjithashtu të zakonshme si rezultat i nevojës për strehim dhe mungesave e zonave të reja të planifikuara. Por, që në gjenezë të demokracisë, persona të caktuar në përmbushje të nevojës për strehim ngritën në toka publike dhe private struktura ndërtimore pa leje të autoriteteve publike në qendra të rëndësishme urbane të vendit. Lindja dhe përhapja e këtij fenomeni, jo vetëm që goditi drejtëpërdrejtë instrumentet ligjore dhe institucionale që ishin parashikuar të lindnin dhe mbronin pronën private, por edhe çënoi rëndë dy nga elementët e themelit të shtetit të së drejtës, sundimin e ligjit dhe pronën private.

## Qëllimi dhe objektivat e studimit

Që në nenin 11 të pjesës së parë me titullin parime themelore të kushtetutës parashikohet se “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private dhe publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.” Në paragrafin e dytë të po këtij neni thuhet se prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. Më tej në kushtetutë parashihet se e drejta e pronës private është e garantuar. Mënyrat e fitimit të pronësisë sipas saj janë dhurimi, trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. Fakti që mënyrat e fitimit të pronësisë janë parashikuar në mënyrë të përmbledhur dhe në Kushtetutë tregon për rëndësinë që kanë mënyrat e fitimit të pronësisë për të drejtën civile. Në mënyrë të hollësishme mënyrat e fitimit të pronësisë janë parashikuar nga Kodi Civil respektivisht nga neni 164 e vijim.

Për qëllimin e disertacionit nuk do t’i trajtojmë në mënyrë të hollësishme mënyrat e fitimit të pronësisë sepse objekt i analizës sonë do të jetë ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si një mënyrë e posaçme e fitimit të pronësisë. Nëse analizojmë nenin 17 të Kushtetutës do të arrijmë në konkluzionin se çdo kufizim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut kryhet vetëm me ligj. Në këtë kontekst edhe ligji i sipërcituar për një kategori subjektësh është mënyrë e fitimit të pronësisë ndërsa për një kategori tjetër rezultoi kufizim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

## Pyetja kërkimore, hipoteza dhe metodologjia e punimit

### Pyetja kërkimore

1. A është respektuar parimi i proporcionalitetit midis subjekteve që përfitojnë të drejtën e pronësisë nga ligji për legalizimin dhe atyre subjekteve që zhvishen nga kjo e drejtë?

### Hipotezat

Rishikimet e nevojshme ligjore të shoqëruara edhe me rritjen e përgjegjshmërisë së Aluiznit passjellin një rritje të standardit të respektimit të të drejtave pronësore të subjekteve të përfshira në proces në mënyrë direkte apo indirekte.

Në përgatitjen e këtij punimi baza është kërkimi doktrinar, ku nëpërmjet mbledhjes së librave të ndryshëm të autorëve vendas dhe të huaj është bërë e mundur mbledhja e materialeve të mjaftueshme në të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare për të krijuar një strukturë të tillë për të qënë e mjaftueshme në trajtimin e procesit të legalizimit .

Një metodë tjetër e përdorur është analiza e legjislacionit. Çdo normë kërkon interpretimin e vet dhe duke arritur të analizohet norma e duhur që parashikon një rregull të caktuar duke e vënë dhe në ndërthurje të plotë me doktrinën, arrihet të vihen në dukje problematikat përkatëse dhe aty ku është e mundur të identifikohet dhe një zgjidhje e mundshme ligjore. Pra nëpërmjet analizës të legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar bëhet e mundur dhe dhënia e përgjigjeve të shumë pyetjeve të cilat lindin nga qëndrimet e autorëve të ndryshëm që ato mbajnë në lidhje me ndërtimet informale të janë një fenomen i njohur edhe për vendet e rajonit.

Duke qënë se në punim është trajtuar e drejta e pronësisë si mënyrë e fitimit të pronësisë në mënyrë të posaçme sipas ligjit të legalizimit metoda e kërkimit në rrafshin teorik ka shfaqur vështirësi, pasi literatura për këtë çështje është e varfër megjithëse fenomeni i informalitetit është shfaqur me përmbysjen e sistemit.

Metodologjia përshkruese është përdorur për të shpjeguar e sqaruar nocionet bazë të së drejtës së pronësisë dhe për të renditur hapat në çeljen e një politike ligjore formalizimi siç është edhe ligji për legalizimin, me qëllim për t'i integruar këto ndertime duke i formalizuar dhe rikthyer në qarkullimin civil.

## E drejta e pronësisë si një e drejtë themelore në vështrim kushtetues dhe të KEDNJ

Që në nenin 11 të pjesës së parë me titullin parime themelore të kushtetutës parashikohet se “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private dhe publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.” Në paragrafin e dytë të po këtij neni thuhet se prona private dhe publike mbrohen njëllor me ligj. Më tej në kushtetutë parashihet se e drejta e pronës private është e garantuar. Mënyrat e fitimit të pronësisë sipas saj janë dhurimi, trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. Fakti që mënyrat e fitimit të pronësisë janë parashikuar në mënyrë të përmbledhur dhe në Kushtetutë tregon për rëndësinë që kanë mënyrat e fitimit të pronësisë për të drejtën civile. Në mënyrë të hollësishme mënyrat e fitimit të pronësisë janë parashikuar nga Kodi Civil respektivisht nga neni 164 e vijim. Për qëllimin e disertacionit nuk do t'i trajtojmë në mënyrë të hollësishme mënyrat e fitimit të pronësisë sepse objekt i analizës sonë do të jetë ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si një mënyrë e posaçme e fitimit të pronësisë. Nëse analizojmë nenin 17 të Kushtetutës do të arrijmë në konkluzionin se cdo kufizim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut kryhet vetëm me ligj. Në këtë kontekst edhe ligji i sipërcituar për një kategori subjektësh është mënyrë e fitimit të pronësisë ndërsa oër një kategori tjetër rezulton kufizim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kushtetuta shpall se drejta e pronës private është e garantuar, por kjo garanci nuk është absolute (Daci, 2011: 297). Pavarësisht se e drejta e pronës private listohet në katalogun e lirive dhe të drejtave kushtetuese në grupimin e te drejtave vetjake, ajo nuk mund të absolutizohet si e drejtë tërësisht individuale pasi ka karakter të rëndësishëm social. Ajo influencon drejtëpërsëdrejti në mirëqënien e përgjithshme shoqërore dhe rrjedhimisht duhet të jetë e kufizueshme. Interesi publik apo funksioni shoqëror i pronës është një koncept kushtetues që justifikon kufizimin e jashtëm që i është vendosur të drejtës për pronë nëpërmjet ligjit. Në shtetin e së drejtës, ndërhyrjes së shtetit ndaj pronës private duhet t'i vendosen kufij në nivelin kushtetues që garantojnë individin në respektimin e plotë të kësaj prone. Kufizimi i një të drejte themelore, si ajo për pronë, nëpërmjet ligjit është shprehje e të drejtës dhe detyrimit që gëzon ligjvënësi, që në emër të një qëllimi të ligjshëm në interesin publik, t'i përgjigjet dinamikës së zhvillimit të vendit, si dhe realizimit të reformave që kërkon koha (Rama, 2010: 97). Nëse analizojmë nenin 41 të Kushtetutës arrijmë në konkluzionin se kriteret e kushtetueshmërisë së një politike shpronësimi, që përbëjnë njëkohësisht edhe kriteret kufizuese ndaj të drejtës së pronës private, janë:

- a) *shpronësimi duhet të parashikohet nga ligji;*
- b) *të ndërmerret për interes publik apo në mbrojtje të të drejtave të personave të tjerë;*
- c) *ekzistenca e një shpërblimi të drejtë.*

Krahas këtyre kriterëve të posaçme të shprehura në nenin 41 të Kushtetutës ku elaborohet njohja, mbrojtja dhe njëkohësisht kufizueshmëria e drejtës së pronës private si e një drejtë vetjake, sovranë në nenin 17 të saj ka parashikuar edhe kriteret e tjera që domosdoshmërisht duhen patur parasysh kur ndërmerren veprime kufizuese ndaj të drejtave dhe lirive themelore të individit, e rrjedhimisht të drejtës për pronë private. Kjo dispozitë mund të konsiderohet se e thërret drejtëpërsëdrejti aktin ndërkombëtar KEDNJ, për t'u bërë pjesë integrale e tij dhe për tu zbatuar në të njëjtin nivel sa edhe Kushtetuta e vendit. Konkretisht, kjo dispozitë me karakter gjithpërfshirës i imponon ligjvënësit që sa herë që ndërhyr në sferën e lirive dhe të drejtave të njeriut, në respektim të kriterëve të mësipërme duhet të vlerësojë detyrimisht edhe:

- c) *parimin e proporcionalitetit, si dhe*
- d) *standardet që sanksionon KEDNJ dhe mutatis mutandis jurisprudenca përkatëse në lidhje me vendosjen e kufizimeve mbi të drejtat themelore të njeriut.*

Edhe pse ligji i legalizimeve kaloi në procesin e rishikimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj i kushtoi rëndësi vetëm aspektit formal të kufizimit të së drejtës për pronë, si një e drejtë themelore. Gjykata Kushtetuese në vlerësimin e kushtetueshmërisë së ligjit të legalizimeve iu shmang shqyrtimit të përmbajtjes së ligjit në raport me elementët e një parimi të rëndësishëm kushtetues, si ai i proporcionalitetit, i cili duhet të kihet parasysh sa herë që ndërmerren masa kufizuese mbi të drejta themelore (Daci, 2011: 297). Gjykata Kushtetuese ka një rol më shumë se kontrolli teknik i përpuethshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Ajo duhet të ketë ndjeshmërinë politike e sociale për të gjykuar nëse deklaratimet kushtetuese gjejnë zbatim të plotë në masat ligjore. Respektimi i parimit kushtetues të proporcionalitetit përbën një kushtëzim *sine qua non*, jo vetëm për ligjvënësin, por edhe Gjykatën Kushtetuese në procesin e kontrollit kushtetues sa herë që shqyrtohen masa me karakter kufizues ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Rama, 2010: 97). Vlerësimi i parimit të proporcionalitetit

dhe elementëve të tij përbërës si: *domosdoshmëria e ndërhyrjes, përshtatshmëria apo arsyeshmëria e saj*, si dhe *barra që shkakton masa ligjore tek subjektet që preken*, në vështrim të standardeve kushtetuese dhe të së drejtës dhe jurisprudencës së GJEDNJ do të kishin orientuar Gjykatën në një qëndrim krejtësisht të ndryshëm.

Për të ofruar garancitë maksimale ndaj pronës private dhe për të shmangur arbitraritetin shtetëror, në ushtrimin e të drejtës për të marrë veprime kufizuese mbi pronën private ligjvënësi ka rregulluar me ligj të posaçëm kushtet apo shkaqet objektive kur mund të justifikohet dhe pranohet shpronësimi nën rregjimin juridik kushtetues, si dhe procedurën përkatëse të shpronësimit (Leka, 2008: 55). Nevoja e kryerjes së shpronësimeve vjen si *domosdoshmëri e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit*, pra përdorimit dhe shfrytëzimit të saj në të mirë të interesit të përgjithshëm shoqëror. E drejta për pronë private nuk është një e drejtë absolute, ajo është objekt i kufizimit në kushtet kur përcaktohet se mund të shfrytëzohet për interes publik, duke gjetur balancën e arsyeshme ndërmjet interesit privat dhe atij shoqëror. Balanca nuk anon drejt veprimit të individit, por është ligji që vendos gjendjen juridike, që shpreh kushtet e jetës shoqërore në një moment të caktuar (Zaganjori; Vorpsi; Biba, 2012: 168).

## Mënyrat e fitimit të pronësisë

Me mënyra të fitimit të pronësisë kuptojmë ato fakte juridike me të cilat ligji lidh krijimin apo lindjen e të drejtës së pronësisë. Nga ana e shkencës së të drejtës civile mënyrat e fitimit të pronësisë ndahen në mënyra origjinale të fitimit të pronësisë dhe në mënyra të prejardhura të fitimit të pronësisë (Gjata, 2010: 79).

Krahas mënyrave të mësipërme kemi edhe mënyra të posaçme të fitimit të pronësisë me ligje të veçanta ku një prej tyre është edhe ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje” për të cilin do të flasim në vazhdim duke u përpjekur për të dhënë një panoramë sa më gjithëpërfshirëse të anës materiale dhe procedurale të tij.

Për të bërë një analizë të plotë mbi arsyet që justifikuan legalizimin e ndërtimeve informale duhet të shqyrtojmë fillimisht shkaqet kryesore që kanë ndikuar në lindjen dhe përhapjen e fenomenit të ndërtimeve informale. *Së pari*, në procesin e transformimit rrënjësor të sistemit ekonomik dhe ligjor *shteti demokratik nuk i kushtoi rëndësi politikave publike në fushën e migrimit të brendshëm dhe fenomenit të ndërtimeve pa leje* (Shehu, 2006: 19). Përpara zhvillimeve demokratike kontrolli rigoroz i shtetit në migrimin e popullsisë ishte pjesë e rëndësishme e ekonomisë së planifikuar. Kjo ekonomi kishte mundur një shpërndarje artificiale dhe joeficente të popullsisë. Tashmë, me ardhjen e demokracisë dhe lindjen e një sistemi të ri ekonomik shteti nuk ishte më përgjegjës për t’i siguruar individit punë dhe strehim. Në kuadrin e tregut të lirë kërkesa e popullsisë për sa më shumë burime, të mira materiale e shërbime çoi në lëvizjen e popullsisë drejt zonave urbane. Mosmarrja në kohë e masave ndaj fenomenit të rrezikshëm të ndërtimeve pa leje shpeshherë u justifikua me të drejtën e lëvizjes së lirë të qytetarëve. Lëvizja e lirë e njerëzve në kërkim të punës, kushteve dhe shanseve më të mira të jetesës u konsiderua si një e drejtë themelore e njeriut. Politikat e privatizimit të banesave, si dhe programet e vecanta të strehimit që realizoheshin nga institucionet publike nuk rezultuan të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e qytetarëve për strehim. Ligji nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” jo vetëm që nuk rezultoi i suksesshëm në adresimin e çështjes së strehimit të personave që mbeteshin të pastrehë si rezultat i zbatimit të ligjit nr.7652/1992, por ai linte jashtë fushës së veprimit të tij një sërë familjesh në nevojë (Kripa, 2006: 24). Procesi i zëvendësimit të këtyre instrumenteve dhe implementimit të mekanizmave më të përshtatshëm, më të zgjeruar dhe të orientuar nga tregu i lirë, që marrin përsipër mbështjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë ishte shumë i ngadaltë. Një rregullim më gjithëpërfshirës i çështjes së strehimit erdhi pas rreth 10 vitesh nga miratimi i ligjit të mëparshëm. Ligjvënësi në ligjin nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, përcaktoi rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë pagese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit (Rama, 2010: 97). Por, ligji nuk shtrinte efektet e tij në Komunat e vendit, duke e lënë të pahur për një rregullim të mëvonshëm me ligj çështjen e strehimit në këto njësi administrative. Parimi themelor që karakterizon ligjin është se çështja e strehimit, si një e drejtë sociale, i është lënë në dorë të tregut të lirë privat, ndërsa shteti angazhohet të mbështesë kategoritë në nevojë, që nuk përballojnë ofertën e tregut, nëpërmjet tre llojeve të programeve të veçanta të strehimit:

1. programe të banesave sociale me qira;
2. programe të banesave me kosto të ulët;
3. Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë. Pavarësisht se përmirësimet ligjore erdhën shumë vonë në kohë, në raport me zhvillimet dhe nevojat shoqërore, ato nuk rezultuan të efektshme, duke i hapur rrugë kështu procesit të informalizimit të tregut urban të banesave. Së dyti, kuadri ligjor i trashëguar mbi planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e territorit dhe ligji i ri i miratuar në vitin 1993 nuk arritën t’i jepnin përgjigje kërkesave dhe nevojave të reja ekonomike dhe shoqërore të popullsisë për strehim dhe aktivitete ekonomiko-shoqërore. Mungesa e planeve rregulluese të qyteteve, vonesat në miratimin e tyre apo papërshtatshmëria e tyre me realitetin ekonomik-shoqëror të zonave urbane i hapi rrugë informalitetit në ndërtime (Kripa, 2006: 24). Së treti, ecuria e ngadaltë e reformave të privatizimit ishte një tjetër shkak i lindjes dhe i përhapjes së fenomenit të ndërtimeve pa leje në Shqipëri. Fenomeni i ndërtimeve pa leje lindi në hapat e parë të zhvillimeve demokratike, në periudhën kur shteti dhe individët kishin pak njohuri mbi rëndësinë e mbrojtjes të drejtës së pronësisë private e publike mbi tokën dhe në kushtet kur mekanizmat institucionalë që ishin krijuar për të lindur dhe rregjistruar këto të drejta nuk siguronin dhënien në një kohë të arsyeshme të titujve të pronësisë dhe identifikimin e saktë të kufijve të pronës. Në këtë periudhë, toka shtetërore në proces

privatizimi u pushtua masivisht nga individë të ndryshëm, të cilët zhvilluan me iniciativën e tyre ndërtesa, struktura banimi dhe shërbimi pa leje e organeve kompetente dhe pa asnjë kriter urbanistik. Në kuadrin ligjor shqiptar të vitit 1993, në rregullimin e cështjes së kthimit dhe kompensimit të pronës ndeshim konceptin e ndërtimeve pa leje në tokën që është objekt kërkimi nga subjektet e shpronësuar (Maho, 2009: 155). Ligji sanksiononte kthimin e pronës drejt subjektit të shpronësuar, jo vetëm nëse mbi të kishte ndërtime pa leje, por edhe nëse mund të ishte dhënë leje ndërtimi, por që ende nuk ishte zbatuar. Madje edhe nëse si rezultat i kësaj leje ndërtimi ishte në kuotën +0.0, toka konsiderohej e lirë dhe ajo i duhej kthyer subjektit të shpronësuar përkundrejt pagimit të vlerës që kishte shpenzuar personi i tretë ndërtues. Prandaj, ecuria e ngadaltë e reformave të privatizimit të tokës dhe vecanërisht e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ishte një ndër shkaqet kryesore të përhapjes së fenomenit të ndërtimeve pa leje (Maho, 2009: 125).

*Së katërti*, një aspekt tjetër, që ka patur një ndikim negativ në përhapjen e këtij fenomeni ishte *vakumi që ekzistonte në legjislacionin penal përse i takon ndërtimeve pa leje*. Deri në vitin 2008 Kodi Penal sanksiononte vetëm kundrvatjen penale të pushtimit të tokës dhe nuk njihje ndërtimin e paligjshëm, si vepër penale. Në legjislacionin e kohës kjo e fundit kategorizohej vetëm si kundrvajtje administrative. *Së fundmi*, faktor tjetër që ka patur një ndikim të madh në përhapjen e fenomenit të ndërtimeve pa leje ka qënë *gjendja që ka karakterizuar Shqipërinë pas trazirave të vitit 1997 dhe në vijim, periudhë në të cilën shteti dhe institucionet publike ishin të pafuqishëm për të ushtruar funksionet e tyre kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të jetës, shëndetit dhe në vecanti të pasurisë së individit*. Pikërisht, në këtë periudhë vihet re lëvizja më e madhe e popullsisë drejt qendrave urbane të rëndësishme të vendit, në kërkim jo vetëm të shërbimeve publike, si arsimit, shëndetësia, siguria publike etj, por edhe të mundësive për të siguruar jetesën. Si rezultat i këtyre faktorëve, Shqipëria u karakterizua nga përhapja e vendbanimeve informale, të cilat cuan në rritjen e nivelit të konfliktit social, varfërisë, përjashtimit social dhe pasigurisë së pronës (Zaganjori; Vorpsi; Biba, 2012: 168).

## Kriteret dhe procedurat për legalizimin e ndërtimeve informale

Procedura që ndiqet për fillimin e procesit të legalizimit është si më poshtë<sup>1</sup>:

- vetëdeklarimi nga ana e subjekteve, që kanë ngritur objekte pa leje kryhet në zyrën e urbanistikës, sipas nenit 7 të këtij ligji;
- organi i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, në të njëjtën periudhë me vetëdeklarimin, kryen në terren evidentimin e ndërtimeve pa leje, për përfshirjen e tyre në procesin e legalizimit. Brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, njësia e urbanistikës e qeverisjes vendore përgatit raportin për gjendjen faktike, së bashku me argumentimin teknik e ligjor të zonës;
- për zonat informale dhe vendbanimet informale, në kuptim të këtij ligji, depozitimi i raportit të gjendjes faktike, së bashku me argumentimin teknik e ligjor, bëhet në këshillin e qarkut brenda 30 ditëve me mbarimin e afatit të vetëdeklarimit. Shqyrtimi dhe miratimi i zonave informale në këshillin e qarkut bëhet brenda 30 ditëve nga dorëzimi i materialit përkatës. Zonat i propozohen për miratim KRRTRSH-së në mbledhjen më të afërt;
- për bllokbanimet dhe ndërtimet informale, brenda ose ngjitur vijave kufizuese (të verdha), të miratuara zyrtarisht për zonat e banuara urbane (qytet) ose rurale (fshat), depozitimi i gjendjes faktike dhe argumentimi teknik bëhen në zyrën e urbanistikës të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse brenda 30 ditëve nga mbarimi i afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji. Shqyrtimi dhe miratimi i materialeve bëhen në këshillin bashkiak ose komunal dhe KRRRT-në e bashkisë/komunës përkatëse brenda 30 ditëve;
- për objektet/parcelat informale deri në 1 ha, për bllokbanimet dhe ndërtimet pa leje, të veçuara ose në territore të tjera dhe për „shtesa pa leje në ndërtime me leje“ vendos njësia e urbanistikës dhe KRRRT-ja përkatëse e njësisë së qeverisjes vendore. Depozitimi i gjendjes faktike, i argumentimit teknik, shqyrtimi dhe miratimi bëhen në zyrën e urbanistikës dhe të këshillit të qeverisjes vendore brenda 6 muajve nga mbarimi i afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.

Vetëdeklarimi nga subjektet, që kanë ngritur ndërtimet pa leje, kryhet pranë zyrës së urbanistikës në njësinë vendore, në territorin e së cilës është ndërtuar objekti pa leje. Për Bashkinë e Tiranës vetëdeklarimi kryhet në njësitë bashkiake, në territorin e së cilës ndodhet trualli, sipas nenit 3 të ligjit nr.8654, datë 31.7.2000 „Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës“. Në rastet kur:

- ndërtimi pa leje ndodhet në situata të paqarta administrative, atëherë ato vetëdeklarohen pranë njësisë më të afërt të qeverisjes vendore, duke pasur si kriter orientimi njësinë vendore, që ka regjistruar personin fizik ose banorët e zonës si votues në listën zgjedhore për zgjedhjet për legjislaturën e 17-të të Kuvendit;
- ndërtimi pa leje shtrihet në kufijtë administrativë të më shumë se një njësie vendore, atëherë ndërtimi deklarohet pranë njësisë vendore që zë sipërfaqen më të madhe të parcelës ndërtimore.

Në ligjin e ri, rëndësia e përcaktimit të një rregullimi të drejtë sa i takon kalimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën nga pronarët e ligjshëm drejt ndërtuesve informale mbetej themelore (Maho, 2009: 125). Në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ligji

<sup>1</sup> Ligji nr.50/2014, datë 15.05.2014“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8492, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

i ri kishte si objekt të tij, krahas legalizimit, urbanizimit, integritimit të ndërtimeve pa leje dhe zonave informale edhe kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore<sup>2</sup>.

1. Kur parcela ndërtimore e objektit pa leje është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në emër të subjekteve pronarë joposedues të ndërtimit, masa dhe vlera e kompensimit mbi sipërfaqet takuese pronë private që preken nga objekti miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Në rastet kur parcela ndërtimore, objekt kompensimi, ka kaluar në pronësi të njërive të qeverisjes vendore, sipas ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, ALUIZNI, përpara se të kryejë procedurat e kalimit të pronësisë dhe kompensimit, duhet të kërkojë miratimin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.
3. Për efekt të përllogaritjes së masës së kompensimit, sipërfaqja trajtohet si truall dhe çmimi përcaktohet në bazë të vlerës së pronës të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Shpërndarja e fondit të kompensimit kryhet në përputhje me ligjin nr. 10 239, datë 25.2.2010, "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", të ndryshuar."

Nëse subjekti, që disponon objektin pa leje, posedon kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, të lidhur ose të vërtetuar përpara noterit publik, me pronarin e ligjshëm vetë ose nga personi, i cili i ka kaluar të drejtën e pronësisë, pavarësisht nga numri i transaksioneve të kryera, ai i dorëzon ato në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t.

2. Për të gjithë këtë rreth personash, që posedojnë këto kontrata, kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore regjistrohet sipas kontratës, duke paguar vetëm tarifën në fuqi për regjistrimin në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pa kamatëvonesë dhe taksa të zbatueshme.

Në kuptim të këtij neni, termi „kontratë“ i referohet çdo veprimi juridik për kalimin e pasurisë së paluajtshme të njohur nga dispozitat e Kodit Civil në formën e një kontrate të veçantë, përfshirë edhe marrëveshjet e lidhura apo të vërtetuara përpara një noterit publik, me objekt disponime të pronësisë së paluajtshme.

3. Pronari, i cili ka kryer kalimin e parcelës ndërtimore, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, zhvishet nga e drejta e kompensimit të pronës sipas këtij ligji ose sipas ligjit „Për kthimin dhe kompensimin e pronave“.

Për ligjvënësin, realizimi i qëllimit të kësaj reforme kërkonte shpronësimin e pronarëve të ligjshëm, pra kalimin e detyrueshëm të pronësisë mbi parcelën ndërtimore drejt ndërtuesit informal. Ligji, *de jure*, i zhvesh pronarët e ligjshëm nga e drejta e pronësisë mbi tokën, duke i njohur atyre të drejtën e shpërblimit mbi sipërfaqen e tokës që shpronësohet. Përjashtim specifik nga gjendja juridike e shpronësimit bëhet për ato subjekte që posedojnë objektin pa leje dhe kanë realizuar kontratën noteriale të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore me pronarin e ligjshëm. Ligji krijon një gjendje juridike shpronësimi për pronarët e ligjshëm, ndërsa ligjëron pozitën e posedimit të ndërtuesve të objekteve informale, duke u krijuar premisa për kalimin në pronësi të tokës, sipas disa kushteve dhe kritereve procedurale e materiale. Pavarësisht se kanë humbur posedimin e tokës para shumë vitesh, ligji shpall humbjen e së drejtës së pronësisë mbi pronën e prekur nga ndërtimet e objekteve informale pa u kryer më parë shpronësimi (Kripa, 2006: 24). Derisa të verifikohet ligjshmëria e gjithë kërkesave për legalizim që kanë prekur pronën private dhe të realizohen procedurat që kërkon ligji, askush nga pronarët e ligjshëm nuk e ka të qartë se sa do të jetë sipërfaqja e tokës që shpronësohet, sa do të mbetet pas këtyre procedurave dhe ku ndodhet pjesa e mbetur nga prona e tërë. Një gjë e tillë varet nga numri i ndërtimeve të kryera në tokën pronë private dhe rrjedhimisht nga numri i kërkesave për legalizim, nga sipërfaqet që kanë zënë ato në raport me kërkesat e ligjit etj. Regjimi juridik që vendoste neni 15 i ligjit, për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore sanksiononte regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme të pronave që legalizohen, sipas të dhënave të lejes së legalizimit. Kjo nënkupton faktin se marrja e një dokumenti administrativ nga ALUIZNI, lejes së legalizimit, shndërron në pronar personat që kanë ndërtuar pa leje në pronën e pronarit të ligjshëm (Rama, 2010: 97). Ndërsa, me regjistrimin e lejes së legalizimit në ZRPP, subjektit privat, pronarit legjitim të tokës, i lind e drejta e kompensimit. Sipas ligjit, ndërtuesi informal është kthyer në pronar të ligjshëm të parcelës ndërtimore me lëshimin e titullit të pronësisë, lejes së legalizimit, ndërsa me regjistrimin e saj në ZRPP në favor të ndërtuesit informal, për pronarin legjitim fillojnë procedurat e shpronësimit për sipërfaqen e tokës së zënë nga ndërtimet informale. Prandaj, ajo çfarë vihet re në ligjin e legalizimeve të vitit 2006 është se ligjvënësi sanksionon privimin nga prona të pronarëve të ligjshëm pa u kryer më parë shpronësimi. Ky shpronësim, në kuptim të ligjit, vjen pas procedurës që kryen ZRPP për rregjistrimin e lejes së legalizimit të dhënë nga ALUIZNI në favor të ndërtuesit informal dhe dërgimit (po nga ZRPP) në Këshillin e Ministrave të të dhënave për cdo pasuri private që preket nga rregjistrimi i kësaj leje, dhe më pas vendimit që merr ky i fundit për shpërblimin e pronarëve të ligjshëm (Maho, 2009: 125). Kjo situatë difektoze e ligjit, do të ndreqej vetëm në mesin e vitit 2009. Krijimi i një marrëdhënie të drejtë në procedurat e kalimit të pronësisë, ku paraprakisht duhej të zhvishej pronari i ligjshëm nga e drejta e pronësisë mbi tokën dhe pastaj të realizohej kalimi i pronësisë në favor të ndërtuesit informal ishte një ndër synimet kryesore të këtij amendimi ligjor. Për këtë qëllim, ndryshimi i ligjit preku dispozitat që rregullonin procedurat e legalizimit dhe ato të kalimit të pronësisë mbi parcelën ndërtimore. Ligji i ngarkoi ALUIZNI-t përgjegjësinë, që gjatë procedurës së verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesës për legalizimin e ndërtimit informal të identifikojë në ZRPP, rastet kur pronësia e truallit ku ngrihej ky ndërtim ishte e regjistruar në emër të subjekteve privat460. Për të gjitha rastet kur toka kishte pronar të ligjshëm, ALUIZNI-t i ngarkohet detyrimi për të dërguar në Këshillin e Ministrave, për vendimmarrje, materialin me të dhënat për cdo pronar të ligjshëm dhe për sipërfaqet takuese461. Është ky i fundit që merr vendim për shpërblimin e

<sup>2</sup> Ligji nr.50/2014, datë 15.05.2014“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8492, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

pronarëve të ligjshëm, konkretisht për sipërfaqet që janë prekur nga ndërtimet informale (Maho, 2009: 125). Pas realizimit të një procedure të tillë, i jepet mundësia e ALUIZNI-t të propozonte në Këshillin e Ministrave vendimin për miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të parcelës ndërtimore.

## Konkluzione/ Rekomandime

Zhvillimet ekonomike, shoqërore dhe politike që karakterizuan Shqipërinë në fazën e tranzicionit favorizuan një lëvizje të madhe të popullsisë drejt zonave urbane të vendit dhe rrjedhimisht ndërtimin e strukturave të banimit në shkelje të së drejtës së pronësisë mbi tokën dhe pa asnjë kriter urbanistik. Përhapja e fenomenit të ndërtimeve informale ishte përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e institucioneve shtetërore. Ky fenomen preku rëndë jo vetëm pronën publike, por edhe atë private. Përballë një situatë të tillë, të toleruar për shumë vite me rradhë, autoritetet shqiptare u vunë përballë dilemës se çfarë vendimi duhej marrë ndaj ndërtimeve informale dhe a justifikohet, në bazë të së drejtës ndërkombëtare, një ndërhyrje e shtetit në ligjërimin e ndërtimeve informale që ishin kryer në shkelje të së drejtës për pronë dhe rregullave të përdorimit të pronës.<sup>438</sup> E drejta ndërkombëtare, dhe vecanërisht e drejta dhe jurisprudenca evropiane sensibilizoi autoritetet shqiptare se për shoqëritë moderne dhe demokratike çështjet që lidhen me strehimin e popullsisë, konsiderohen si nevoja primare sociale, të cilat duhen marrë në mbrojtje. Plotësimi i këtyre nevojave bëhet në emër të parimit të mbështetjes apo përkrahjes shoqërore duke synuar për të garantuar mirëqënie për shtresat në nevojë.<sup>439</sup> Prandaj, reforma e legalizimit duhet të ndërmerret për të:

- a) integruar në shoqëri një komunitet të madh banorësh që kanë ndërtuar pa leje, në mënyrë që t'i ofrohet mundësia këtyre banorëve për të patur një banesë të përshtatshme,
- b) ndaluar ndërtimet pa leje në të ardhmen,
- c) stabilizuar rregjimin juridik mbi të drejtat e pronësisë mbi tokën dhe për të vendosur stabilitetin e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, duke evituar konfliktin social ndërmjet personave privatë,
- d) mbrojtur apo ligjëruar dhe për të vënë në qarkullim civil kapitalin e investuar në fushën e ndërtimeve.

Të gjitha këto faktorë përfshihen brenda sferës së interesit publik për të cilin shteti është përgjegjës për ta trajtuar me legjislacion dhe rrjedhimisht justifikojnë nxjerrjen e legjislacionit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.<sup>440</sup> Prandaj, qëllimi që ka legjislacioni i legalizimit justifikon, sipas nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 1 të protokollit shtesë të KEDNJ, ndërhyrjen në të drejtën e pronësisë mbi tokën të pronarëve të ligjshëm.

Në këtë studim argumentohet se qasja aktuale e shtetit shqiptar në mbrojtjen dhe garantimin e së drejtës për pronë private në reformën ligjore të legalizimit të ndërtimeve pa leje ka ecur kundër objektivave të shpallur në Kushtetutë dhe standardet e pranuar të së drejtës ndërkombëtare. Një situatë e tillë, ka bërë që Shqipëria të rankohet ndër vendet me një sistem të dobët të mbrojtjes së të drejtës për pronë. Dështimi i shtetit në mbajtjen e angazhimeve ligjore është një tregues shumë negativ për nivelin e mbrojtjes së pronës që pronës private dhe ndikon rrjedhimisht në imazhin e demokracisë shqiptare dhe në proceset integruuese. Shmangia, që vihet re në ligjin e legalizimeve, nga standardet e sanksionuara nga legjislacioni i brendshëm që garantojnë respektimin e kërkesave të parimit të proporcionalitetit, sa herë që ndërmerret një politikë shpronësuese ndaj pronës private, si dhe dështimi i gjetjes së një barazpeshë të drejtë në këtë ligj ndërmjet interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtje të së drejtës për pronë private ka krijuar një gjendje pasigurie në lidhje me realizimin e të drejtës civile të kompensimit të pronarëve të ligjshëm, gjë e cila konsiderohet si shkelje e së drejtës për pronë të parashikuar nga neni 1 i protokollit shtesë të KEDNJ-së<sup>546</sup>.

Duhet thënë se ecuria me ritme kaq të ngadalëta ka çuar në një situatë të ashtuquajtur "pronësi boshe" sepse nga njëra anë qëndojnë subjektet e përfshira në procesin e legalizimit por që kanë gati 10 vjet që nuk janë pajisur me leje legalizimi ç'ka do t'u mundësonte efektivisht disponimin e pronës dhe do t'i jepte vlerë reale pasurive që posedojnë dhe nga ana tjetër pronarët e ligjshëm por që janë zhveshur nga posedimi i pronës së tyre dhe si rrjedhim ende nuk janë kompensuar dhe edhe ata që janë kompensuar janë kompensuar në masën 49%. Krahas kësaj edhe ato subjekte të cilat janë pajisur me leje legalizimi si pasojë e moskompensimit të pronarëve nuk mund t'i regjistrojnë në regjistrat e pasurive të paluajtshme titujt e tyre të pronësisë për shkak se janë të regjistruar ishpronarët dhe si të tilla nuk prodhojnë asnjë efekt juridik në qarkullimin civil të sendeve të paluajtshme.

## Bibliografia

### Burime parësore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, faqe 1073.

Ligji Nr.8137, datë 31.07.1996 "Për ratifikimin e KEDNJ", botuar në Fletoren Zyrtare nr.20, Faqe 724..

Deklarata e Vjenës "Mbi ndërtimet informale në Vendet e Evropës Juglindore".

Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.8485, datë 12.05.1999, botuar në Fletoren Zyrtare nr.19, faqe 758.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7850, datë 29.07.1994, botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 491.

Ligji nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", Flet. Zyrt. Nr.5, Fq.246.

- Ligji nr.50/2014, datë 15.05.2014“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8492, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.
- Ligji nr.9209, datë 23.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, Flet. Zyrt. Nr.87, Fq.3529.
- Ligji nr.7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 5, faqe 306.
- Ligji nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ishpronarëve”, Flet. Zyrt. nr.5, Fq 346.
- Ligji nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, faqe 1084.
- Ligj nr. 7980 date 27.07.1995 “Per shitblerjen e trojeve”
- Vendim i GJEDNJ, Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë, vendimi 16 shtator 1996.
- Vendim i GJEDNJ Akkus kundër Turqisë, vendimi 9 Korrikut 1997, Reports 1997-IV.
- Vendim i GJEDNJ Cështja James dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, parag. 47.
- Vendim i GJEDNJ Cështja Spadeo dhe Scalobrinò kundër Italisë, vendimi i 28 shtatorit 1995.
- Vendim i GJEDNJ Pincova dhe Pinc kundër Republikës Çeke, aplikimi 36548/97, vendimi 5 Nëntor 2002
- Vendim i GJEDNJ Jordanova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, aplikimi nr.25446/06.
- Vendim i GJEDNJ Ghigo kundër Maltës, aplikimi nr. 31122/05, vendimi i 26 shtator 2006.
- Vendim nr. 35 date 10.10.2007 Gjykatës Kushtetuese.
- Vendim nr.4020 datë 06.11.2014 i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë.
- Vendim nr.27 datë 20.09.2013 i Gjykatës së Apelit Vlorë.
- Vendim nr. 3086 datë 15.07.2014 i Gjykatës Administrative e Apelit Vlorë.
- Vendimi nr.1595 datë 14.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Vlorë.
- Vendim nr. 2405 datë 14.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Vlorë.
- Vendim nr. 1693 datë 23.07.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

#### **Burime dytësore:**

- Maho, B, Fitimi i Pronësisë mbi Pasuritë e Paluajtshme, Tiranë, UET-Press, 2009.
- Nuni, A, Hasneziri, L, Leksione të së Drejtës së Pronësisë, Tiranë, 2007.
- Meçani, D, Pronësia Mbi Tokën, albpaper, Tiranë, 2007.
- Daci, J, Të Drejtat e Njeriut, Julvin 2, Tiranë, 2011.
- Kripa, D, Huaja Hipotekore dhe Pasuritë e Paluajtshme, Pegi, Tiranë, 2006.
- Shuehu, A, Pronësia, albin, Tiranë, 2006.
- Galgano, F, E Drejta Private, Luarasi Unversity Press, Tiranë, 2006.
- Fishta, I, Kareco, Th, Prona Private në Shqipëri 1924-1944, Dituria, Tiranë, 1996.
- Zaganjori, Xh, Vorpsi, A, Biba, D, Parime Kushtetuese dhe Të Drejta Themelore në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ADELPRINT sh.p.k., Tiranë, 2012.
- Gjata, R, E Drejta Civile Sendet dhe Pronësia, albpaper, Tiranë, 2010.
- Aliu, A, E Drejtat Sendore Pronësia, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2009.
- Jus & Justicia, Revistë Shkencore e Fakultetit Juridik, Pronësia Në Tranzicion, UET-Press, Tiranë, 2009.
- Rama, A, Të Drejtat e Pronësisë në Shqipëri, Sfida dhe Perspektiva, Friedrich Ebert Foundation, Tiranë, 2010
- Leka, S., “Shqipëria dhe sfida e integritit urban të zhvillimeve informale në periudhën e tranzicionit”, presented at the Global Land Tool Network Expert Group Meeting, “Tools for legal integration and provision of environmental improvements in informal settlements in Europe: Case study: Albania, Greece”, Athens, 27 and 28 November 2008.

# NON-PECUNIARY DAMAGES; COMPENSATION AND VALUE OF THE BENEFICIARY SUBJECTS. A COMPARISON WITH THE DECISIONS OF THE ITALIAN SUPREME COURT OF CASSATION

---

**PROF. ASOC. HEMION BRAHO, PHD**

Universiteti Europian i Tiranës; Fakulteti Juridik; Departamenti i së Drejtës Private

mail: hemion.braho@uet.edu.al

---

## ABSTRACT

In the Albanian doctrine, non-pecuniary damage is one of the most innovative but also more complicated fields. When we treat the question of damage and its reward, we immediately think about a pecuniary reward, because it is easily identifiable with an economic value. Anyway, both at a theoretical level, also about the concrete consequences the non-pecuniary damage is treated diffusely, which differs profoundly from pecuniary damage. In the category of non-pecuniary damage, by its definition, are involved the entire class of claims that are not included in pecuniary damage, and some of these categories are included the definition of article 625 of the civil code. Some of the most common problems in this field, are encountered in non-pecuniary damage claims. In this regard the Albanian jurisprudence has clarified different problems, and in particular the Albanian High Court. This Court has recognized and accepted the law figures of biological, moral and existential damage, giving a definition for each, but Also the modalities of their assessment, despite the fact that there is no measurement to determine the value in such cases of damage. Another important aspect relates to entities legitimized to exercise these rights related to compensation in this field. In these last two aspects we will deal with the most recent decisions of the Italian Supreme Court of Cassation.

**Fjalë kyç:** *moral damage, biological damage, existential damage, damage compensation, Italian Supreme Court of Cassation*

---



## Introduction

For a relatively long time, non-pecuniary damage was identified only with moral damage, but over the past twenty years, first teaching and then case law has identified two new figures for this damage. Its concept is directly related to the institute of civil damage and extra contractual civil liability.

Through the 1986 decision of the Constitutional Court of Italy it was given a new meaning to the damage of health or the so called “biological damage”; the 2006 decision of the Italian Supreme Court of Cassation, was created the existential damage as a special figure of non-pecuniary damage. In Albania, the decision of the of the Supreme Court United Chambers no. 12, date 13 and 14 September, 2007, gave a new dimension to the category of non-pecuniary damage by putting beside the figure of moral harm (non-property nature of which was consolidated) the figure of existential damage and biological damage.

The provision of Article 625 of the Civil Code is interpreted and applied in accordance and compliance with fundamental principles of constitution and human rights. In this sense, Article 608 and following of Albanian civil code aimed a complete repair of any damage suffered illegally, not only in the sense of economic wealth but also in non-material goods that include values of human being.

So, through this decision is accepted that in the category of non-pecuniary damage provided for in Article 625 of K.C includes three figures:

- figure of moral damage;
- figure of biological damage;
- figure of existential damage.

## Purpose and objectives of the study

The damage of health, recognized by jurisprudence as “biological damage” or “damage the health” is a special figure of non-pecuniary damage and, as a consequence, subject to independent amount of indemnification. Differently from material damage, the biological damage has not an economic value on the free market, its violation is not compensated in kind, nor has the price in cash. But for purposes of health protection, and for facilitating social and physical rehabilitation in the future of the injured, the person responsible for causing biological damage is obliged to pay him an indemnity in money, independently of other pecuniary or non pecuniary damage that eventually the aggrieved party has suffered due to the same illegal fact.

Based on this information, this paperwork will be raised several matters that will be dealt with this topic, in the form of theoretical and practical, but always focusing on the images of non-property damage, giving references also to the law on compulsory insurance, the provisions Civil Code and jurisprudence. These are some basic guidelines in which this work will be based on, by analyzing in detail the concept of non-pecuniary damage and his reward, in theoretical, practical and comparative perspective.

## Research question, hypothesis and methodology

The figures of moral, biological and existential damage are still a problem, both in the sense of the definition so in the sense of the amount of damage. So they will be raised several matters that will be dealt with in a summary, in this topic, in the form of theoretical and practical, but always focusing on the images of non-property damage according to the law on compulsory insurance in the transport sector, but also the provisions Civil Code and jurisprudence.

What represents the non pecuniary damage and how should we define it? Which are the cases we consider inside the extra-contractual damage field? How can be established the pecuniary amount? Which are the differences from moral, biological and existential damage? Which is the situation in Italy?

The methodology is mainly based on comparative method, and qualitative method. Regarding the analysis of law terms, it will be used partly also the quantitative method.

## Analysis of the Albanian legal situation

The article nr. 625 of the Albanian Civil Code, provides the persons right to compensation if the “honor of his personality” is violated. These violations are shaped into two types of non-pecuniary damages: the moral and existential damages<sup>1</sup>. Moral damage (in latin: *pretium doloris*) is the internal and temporary condition, an unfair perturbation (non iure perturbatio), a human mood of pain and suffering or anxiety arising as a consequence of an illegal fact. Anyone who incurs violations in the field of health and personality based on illegal actions or non-actions of a third party, has the right to request a compensation

<sup>1</sup> Unifying Decision No.12 / 2007 of the Albanian Supreme Court, page 14, paragraph 6

of the moral damage suffered. This right, in the quality as an injured part, it belongs to each of the close relatives of persons who have lost their lives or have had prejudice of their health by the illegal fact, if is confirmed their familiar relationship, or their cohabitation. The moral damage suffered by the relatives is considered as an immediate and direct consequence, of the same illegal fact.

In the category of non-pecuniary damage, in addition to damages figures on health and moral damage, other figures included autonomous existential damage, otherwise called damage of the quality of life. Existential damage is a result of violation of the complex and inviolable values of human being, normality and a certain quality of human life, the field of feelings and reciprocal solidarity within the family and the free expression of the full capabilities of human being to develop personality, to be realized in society considered in the framework of its basic unit, as is the family (Articles nr. 53 and 54 of the Albanian Constitution).

As above, the different forms of non-pecuniary damage referring to those of what are called biological, moral and existential damages, are characterized by their nature subjective and complex, are experienced as internal and direct human suffering as a result of damage of health, but also the damage of close relatives, whom has broken a normal life balance negatively affecting their psychological existence in the world.

Law no. 10076 dated 12.02.2009 "On compulsory insurance in the transport sector" already provides the legal criteria table where courts should be supported to determine the value of indemnification, which were missing at the time of the judgment Unifying. The new law, making a specific adjustment to the formula calculation, has established rules for each subject to the same security and standards in the treatment and assessment of damages payment in the territory of the Republic of Albania. Decision no. 6, dated 17.02.2012 of the Constitutional Court, inter alia explained: "legal vacuum that has given rise to the issuance of the Decision Unifying the United Colleges of the Supreme Court ... does not already exist." At a time when the Unifying decision of the Supreme Court in 2007 there was no law to define the criteria table.

Despite the calculations carried out by 29 and 30 of Regulation No.53 / 2009, the limits laid down in Article 26 of Law no. 10076/2009 can not be overcome, referred to the following criteria:

- a) for non-pecuniary damage, caused by a series of accidents, income from an insurance driving:
  - i) moral and existential damage, death or disability, permanent partial one million ALL;
  - ii) moral and existential damage, from other damages 500 000 ALL;
  - iii) moral damage, the total inability, permanent 2 million ALL;
  - iv) Existential damage from total permanent disability 1.5 million ALL;
  - v) biological damage from death or total permanent disability 1 million ALL.

From the above limits that law has fixed for non-pecuniary damage, the maximum value that can respond to an insurance company can not exceed 4,500,000 leke, which along with other damages incurred, can not exceed the maximum limit in value 20,000,000 ALL.

However, some deficiencies observed in the non-pecuniary indemnification limits provided by the Law. 10076/2009, which have created not only a misinterpretation, but also misapplication by the courts.

First, in connection with the biological damage, law provides indemnity in case of death and total or permanent disability. In the case of permanent partial disability that, what is the limit of the amount that can respond to an insurance company? In the case of total permanent disability the amount corresponds to 100%, but in the other cases (partial permanent) law has space for interpretation according to the interests of the parties.

The injured party with partial disability would require a benefit next to the maximum, but objectively it does not belong to this limit. The law has fixed a limit of 1,000,000 ALL for cases of total permanent injuries (100%), and for the other cases has not made any concrete prediction, it is logical that in cases of partial permanent disability that limits is apportioned. This reasoning is based on the fact that for various degrees of pain, the moral damage is different. So, if the degree of disability of the forensic act will result in 40%, the value of biological redress would be 400,000 leke, so in proportion to the extent of disability.

Regarding the procedure, Regulation Nr. 53/2009 provides that the application for compensation must be made by persons aggrieved within 2 years from the date of the accident. This deadline so it should be affected by the provisions of the Civil Code for the prescription of the right to sue for claims arising from the award of damages regarding the contract of insurance and reinsurance, as well as the respective amount deriving from compulsory insurance in stating that the lawsuit filed within 2 years, a period that starts when the subject acquires the right to sue. If this right is not exercised within the time, then it fades and can not be accomplished either by the court.

Despite the calculations performed by articles 29 and 30 of Regulation No. 53 / 2009, the limits laid down in Article 26 of Law no. 10076/2009 can not be overcome, referred to the following criteria:

- a) for non-pecuniary damage caused by a series of accidents, income from insurance driving:
  - i) moral and existential damage, death or disability, permanent partial one million ALL;
  - ii) moral and existential damage, from other damages 500 000 ALL;
  - iii) moral damages, the total disability, permanent 2 million ALL;
  - iv) existential damage from total permanent disability 1.5 million ALL;
  - v) biological damage from death or total permanent disability 1 million ALL.

From the above limits that particular law for non-pecuniary damage, the maximum value that can respond to an insurance company can not exceed 4,500,000 ALL, which together with other damages incurred, can not exceed the maximum limit in 20,000,000 ALL value.

We treated before the biological damage referring to the proportional compensation, due to partial disability. Well, the same reasoning applies to the calculation of moral and existential damage. But here arises another problem. It will be calculated moral and existential damage, dividing separate limit of 1,000,000 ALL for each case, or joint limit set by law means that these figures only count as one?

First, viewed from a logical, although cases of moral and existential damage are recognized as two separate images of non-pecuniary damage, law has set a limit for both. It is due to a grammatical interpretation, the fact that moral and existential damage related by conjunction “and” could mean that these two figures have a common limit. It is necessary to separate them, then the limit is supposed to be divided and divided equally for each case.

On the other hand, moral damages due to the subjective nature and appearance of human’s internal being, it can not be proved in another way, but the way *ius receptum* and *ipso iure*, which means that infringement of moral suffering is presumed due to come the fact of the illegal if the person causing the damage fails to prove the opposite.

Existential damage, otherwise the moral damage can not just rely on a simple presumption, because the court must accept only those specific infringements of personality rights, which the injured has claimed referred to quality of life and balance spoiled due to the fact illegal, are burden of the part who makes judicial lawsuit, which has to prove sufferings of this damage by a psychological expert analysis.

## Albanian Jurisprudence

The Unifying Chambers decision of the Albanian Supreme Court. no. 12, dated 14.09.2007, has categorized the damage figures in the property referred to in Article 640 and following of the Civil Code and non-pecuniary damage provided for in Article 625 of the Civil Code. For non-pecuniary damage the High Court has identified 3 legal figures dividing exactly in biological damage, moral damage and existential damage.

In trials having object the obligations arising from the infliction of a kind of damage, if the plaintiff is seeking damages “for all damages” or “for all property damage and non-material”, this mode of inquiry constitutes his mood for claiming compensation for any figure of pecuniary damage and the non-pecuniary damage. But, if the claim contains research on compensation of concrete figures the extra harm, the court has the obligation to adhere to the judgment and decision these specific searches. However, the court must focus the requirements of the parties to provide explanations about the nature of the dispute in order to clarify the objections research on the legitimate rights and interests of the vulnerable part.

The Supreme Court in this decision concluded that every person infringed on the personal rights and legitimated interests by an unlawful fact, even if it is not himself subject passive of that fact, is entitled as an active legitimated subject, to request (*ius proprius*) the compensation of non-pecuniary and pecuniary damage suffered. This active legitimacy, in principle, is not conditioned upon the enjoyment of the quality of a person’s successor of the damaged person, but only with the quality of the plaintiff to be impaired by the fact illegal.

For these reasons, the The Unifying Chambers of the Albanian Supreme Court also come to the conclusion that the provision of Article 608 of the Civil Code and Article 18 of Decree nr.295 dated 09.15.1992, the legislator provides protection from unlawful fact of third part and his rights, particularly individual rights (absolute or relative) of a person, such as the right to life, health, personality, dignity, family, private life, property, etc. In case of violation of these rights by an unlawful fact, the injured party is entitled to search subjective relative to the extra compensation.

Non-pecuniary damage, regulated in article no. 625 of the Civil Code, includes many cases of non pecuniary damage, includes any type of harm suffered by the violation of the rights and interests belonging to human values, which are not subject of direct evaluation in the economic market. At its core, this provision recognizes all cases of right of compensation for any extra-contractual non-pecuniary damage, different from pecuniary damage. The ranking of “cases” of non-pecuniary damage in paragraphs “a” and “b” of it, is not intended to restrict, but to regulate explicitly, for the purpose of distinguishing the violation, the right of indemnification and distinct active subjects that can have active legitimacy.

The damage of health (biological damage) constitutes, in essence, infringement of right to health and to physical or psychical integrity. This non-pecuniary damage, provided by the letter “a” of Article 625 of the Civil Code, is subject to search and compensation independent from other other pecuniary and non-pecuniary damages and suffered by the injured party due to the illegal fact. Also it constitutes a legitimate interest to impair the reduction of the richness of the injured party in the form of expenses that he supports for care and, in particular, for the treatment of health prejudice sustained as a result of one fact illegal.

Moral damage (*pretium Doloris* or *pecunia Doloris*) is a manifestation of the internal temporary cloudiness situation (*non iure perturbatio*) mood human pain, suffering or anxiety and spiritual torment depending by the illegal fact. Anyone who suffers infringements of health and personality depending by illegal actions or non-actions of a third part, has the right to ask for compensation of moral damage suffered. This right, as the injured party, regards the individual (*ius proprius*) and also each of the families closest to the person who has died or impair his health by the unlawful fact, if verified their relationship special family sensory and coexistence. Moral damage suffered by the relatives is considered as an immediate consequence of that illegal fact.

Existential damage is caused by the fact of illegal third, violates the rights of the human person, damaging permanently the possibility of expression and realization of the injured man, the emergence of his personality to the outside world, damaging

objectively his life and usual activities, causing deterioration in the quality of life and imbalances, changes behavioral habits of life, personal and family relationships. Due to such a state of psycho-physical, the injured party can not carry on certain activities that characterized positively his being or may be characterized positively in the future, forcing his choices towards different solutions to be those the expected or desired and to abandon the latter, due to the verification of the illegal fact. Existential damage is objectively verifiable because it has not only an internal nature depending personal feelings.

In connection with the implementation of that unifying decision of the Supreme Court, it has already been expressed by the Constitutional Court in its decision no. 6 dated 17.02.2012, in which it is clearly defined which will be applicable in cases in trial. According to this decision provides that: "The interpretation of the laws is the responsibility of the courts of ordinary jurisdiction and especially of the Supreme Court. In this sense the Constitution gave the Supreme Court the authority to unify or change judicial practice and to take positions on specific issues with the aim of unifying the decisions of the ordinary courts. This function is exercised by the Supreme Court unifying the Chambers on certain issues. What above is a result of its position as the highest organ of the judicial system and connects to the overall function of its power to ensure uniformity of interpretation of legal norms by ordinary judges, by determining the lines of interpretation which judges must adhere. Conclusions which reaches the Supreme Court does not apply only to resolve the case in exam, but for all similar cases regarding other courts, or even the single Chamber of that court. Equality of rights, among other things, establishes the obligation for the same decision-making and sustainable in similar cases by ordinary courts."

The Supreme Court, given the different positions of the courts regarding the enforcement of the circle of persons affected, the right to compensation for civil damages and the manner of its calculation, especially for non-pecuniary damage, estimated it was necessary to take a decision to unify the judicial practice on these issues.

With the decision no. 12, dated 14.09.2007 of the Supreme Court unified judicial practice in connection with the application of Articles 608, 609, 625, 643/a and following of the Civil Code, stating, in essence, to entities that have the individual right (active legitimization) to seek restitution of property of non-pecuniary damage suffered, the legal figure of the biological damage or harm health (as a special figure of non-pecuniary damage), the figure of moral and the existential damage, the methodology of calculating the amount of compensation etc. In connection with the compensation amount unifying decision stated that the courts should be based on the respective values laid down by the laws in force and only in the absence of these criteria table they can decide according to their interpretation, leaving free the possibility of determining the amount the compensation case.

With this unifying decision was opened a new page on the meaning of non-pecuniary damage and refine its case-law, in which often restored persons who had not suffered any such damage and on the opposite happened to those who actually were harmed by an illegal action.

Referring to law criteria and especially to Regulation No.53 / 2009, the calculation of non-pecuniary damage done on the basis of certain criteria and formulas according to the respective cases. In Chapter VI of this regulation specifically defined "Methodology of calculating the non-pecuniary damage", starting initially with biological damage as defined in Article 29, which explicitly states: "The biological damage constitutes essentially violation of good health, of physical and / or psychological health of human and that has a negative impact on the activity of living everyday in terms of dynamic and interpersonal life of the injured party, despite the possible return of his capacity to earn income; "In addition, the regulation provides for the method of calculation of the damage in case of permanent damage to health and to the death. What is found on the surface, is the lack of profitability of biological compensation in case of temporary impairment of health.

But that does not mean it can not claim damages a person who has received temporary incapacity to work, and Regulation No. 53/2009 provides something like that in Article 19. However, the calculation formula, based on official minimum wage and medical reports of the day the damage happened, makes us realize that this does not benefit this damaged categories based biological damage, not respecting literally the recognition of the harm deriving from that law.

The same conclusion applies to moral and existential damage in case of temporary damage. But unlike the biological damage, this type of damage can be obtained by relatives in case of permanent impairment of health, while biological damage can benefit proportionally from the family only in the case of health damage resulting by death.

This way to estimate so often leaves space for a bad application of this regulation, as being a bylaw pursuant to Law no. 10076/2009, non-pecuniary damage assessment is carried out based on legal definitions, but in reference to the methodology set out in this regulation, which creates tension and confusion for the injured party that claims to be indemnified, to the insurance company which is obliged to respond to damages, and the court that decides to resolve the dispute.

## The Italian situation

To have a better view of the situation it would be useful a brief analysis of the Italian situation, from which the Albanian legal doctrine inspires in this field. In Italy, the damage from the loss of parental relationship is the deprivation of a non-economic value but considered personal value, made up of the irreversible loss of the enjoyment of the person, the final foreclosure of reciprocal relationships. The damage from the loss of parental relationship goes beyond the raw pain that death itself of a loved one, especially if preceded by agony, provokes against close relatives that survive, rather it materialized into the void formed by the non-power to enjoy the presence and relationship with those who had died or had been permanently damaged and therefore irremediable destruction of a way of life based on affection, sharing, on reassuring normality of relations between husband and wife, between parent and child, brother and brother in not being able to do what has been done for years, as well as the alteration that a disappearance of this kind inevitably produces in the relations among the survivors.

That injury is in the area of art. 2059 of the Italian civil code under which the nature of non-pecuniary damage is resumed. The quantification of the damage in question is carried out by taking into account the intensity equitable criterion of family ties, the situation of coexistence and any further useful case in which proof of the intensity of the bond with the deceased. The intensity of family ties, for the evaluation of the moral prejudice resulting to the death of a close relative, may in itself constitute a useful element presumptions on which to base the existence of the mentioned non-pecuniary damage, in the absence of evidence to the contrary while the verifiable absence of cohabitation of those harmed by the joint deceased may represent only one factor of circumstantial evidence from which to infer a smaller pecuniary damage.

The Observatory on the Milan Civil Justice in the year 2014 has issued the following table should be the determination index of the damage from loss of parental relationship. Within these limits the courts at national level should determine the compensation quantity:

|   |
|---|
| non-pecuniary damages for the death of the Joint From - To                  |
| In favor of each parent to the death of a child € 163,080.00 - € 326,150.00 |
| In favor of the son for the death of a parent € 163,080.00 - € 326,150.00   |
| In favor of the spouse € 163,080.00 - € 326,150.00                          |
| In favor of the brother to death of a brother € 23,600.00 - € 141,620.00    |

No pre-established relationship limits are fixed for damages from loss of parental relationship, being the guiding principle of constitutional status to the right of victims to the total damages, pecuniary and non-balance sheet, resulting in the injury of fundamental human rights (Constitutional Court on July 14 1986, no. 184). Resolving itself in the total loss of the family or the loved and dear, the damage from the dead, is also of relevance in cohabitation without being married, provided it is characterized by the bond strength, and find protection, even before a legal viewpoint, in the consciousness social which has ratified this form of relationship based on the stable coexistence, increasingly prevalent in our society and acts as a filter in order to identify the persons entitled to compensation for the loss of the loved one's death. The foregoing was also confirmed with the recent judgment of the Italian Supreme Court no. 46351/2014.

Although in medical liability - a subsisting contractual liability - on health lies the burden of proving that the medical procedure was successful, having held that the illegality of the conduct healthcare proof of the damage from the loss of the relationship parental damage is borne by the person injured, an actor in the compensation proceedings, according to the general wording of Article. 2697 of the civil code.

Such damage item constitutes one of the most significant damages posed when following the patient's death is taken by close relatives a claim for compensation as active legitimated subjects and as having inheritance right.

## Conclusions

It would be wise to not treated as separate figures moral and existential damage, but they are seen as internal cases of biological damage, or as the Italian Supreme Court has indicated as a general non-pecuniary damage. The court will be based precisely on the latter, to personalize the damage suffered and to award compensation to the final. Only if there is a violation of their psycho-physical, it could assess whether or biological damage associated with other consequences, that in previous case law would be rewarded as "moral damage" and "existential damage".

Of course the damage assessment will not be the same in the Albanian law as in the Italian, since it was mentioned before, Italian case law has been developed and detailed than the Albanians. Normally our jurisprudence regarding the compensation of non-pecuniary damage while still seeking to unify and apply equally to all parties and the courts. But this fact also relates to non-legal factors (social, cultural, economic, etc.), which affects many aspects of understanding and appreciation given to this kind of damage.

## Bibliografy

- Law no. 10076, date 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"  
 Regulation no. 53, date 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulojnë nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit" (e ndryshuar)
- Berti, R. (2000), Il danno psichico e il danno psicologico ai confini del danno esistenziale, Tagete.
- Cerisoli, M., Vasapollo, D. (2008), "La valutazione medico-legale del danno biologico di natura psichica, SEU.
- Galgano, F. (2003), E drejta private, Luarasi.
- Sulçe, A. (2012), Dëmi shëndetësor në sigurime (pjesa e parë), "albPAPER".
- Sulçe, A. (2013), Dëmi shëndetësor në sigurime (pjesa e dytë), "albPAPER".
- Internet source:**  
 Altalex (2014) "Danno biologico : La consulta salva la tabella sulle micropermanenti – Corte Costituzionale, sentenza 16/10/2014 n° 235 – Michelle Iaselli"  
 Taken from: <http://www.altalex.com/documents/altalex/news/2014/10/21/danno-biologico-la-consulta-salva-la-tabella-sulle-micropermanenti>.

# BARAZIA GJINORE NË PUNË NË SHQIPËRI. DISKRIMINIMI GJINOR

---

**ALMA HOTI**

Universiteti Europian i Tiranës

ab.hoti@yahoo.com

---

## ABSTRAKT

Diskriminimi gjinor mbetet një çështje sensitive si në nivelin e debatit akademik ashtu edhe në nivelin e politikave të përditshme. Ndonëse studiuesit identifikojnë faktorë të ndryshëm influencues mbi diskriminimin gjinor, ata kanë mendime të ndryshme cili prej tyre është më i rëndësishëm. Punimi trajton në mënyrë të detajuar çështjet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit si në aspektin ndërkombëtar ashtu edhe atë vendor, si në aspektin historik ashtu edhe atë aktual dhe veprimeve sipas etapave dhe ecurisë së proceseve reformuese në vend, studimin e legjislativës europian, me qëllim transpozimit korrekt të tij në vendin tonë. Po ashtu një rol të rëndësishëm në këtë drejtim mbart analiza e diskriminimit në punë si diferencim profesional dhe në pagë. Femrat nepermjet arsimit ashtu sikurse dhe meshkujt mund të aktivizohen në fusha të ndryshme e të jetës shoqërore e të marrin profesione të ndryshme. Zhvillimi i teorisë gjinore së fundmi ka shënuar rritje të madhe vecmas si pjesë e përgjithshme post-moderne dhe vecanërisht në sferën avokuese. Përmes punimit unë do të realizoj hulumtimin e Barazisë gjinore në punë dhe jo vetëm atë, duke e shtrirë edhe në udhëheqje, arsim, e fusha tjera tërë këto analizim duke e gerthurur me analizën juridike dhe faktike.

**Fjalë kyç:** *barazi gjinore, punë, diskriminim, juridik*

---

## Hyrje

Standardet e mbrojtjes me barazinë gjinore, mosdiskriminimin për shkak të gjinisë, janë ngritur sot në nivele të atilla, që mund të sjellin kushtëzime shumë të rëndësishme në zgjidhjen e çështjeve ligjore dhe të raporteve ndërkombëtare. Në legjislationin ndërkombëtar, çështjet gjinore trajtohen shpesh dhe në mënyrë të vazhdueshme. Çështjet e barazisë gjinore dhe të mos diskriminimit gjatë këtij dhjetëvjeçari kanë marrë jetë dhe kuptim të ri dhe kanë adoptuar skema e stile të reja shfaqjeje. Dalja e një ligji të mbrojtjes nga diskriminimi dhe të barazisë gjinore në shoqëri sensibilizoi dhe ndërgjegjësoi aktorë të ndryshëm të cilët janë anëtarë të familjeve, gjithashtu. Kështu, le të themi në mënyrë indirekte, filloi puna me njohjen e koncepteve dhe të përcuarit e tyre përmes sferës publike në sektoret privat.

Në këtë kuadër, mund të themi se zbatimi i drejtë i ligjit nr. 9970, dt. 24. 07. 2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe atij nr. 10221, dt. 04. 02. 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është thelbësor për të kuptuar dhe zbatuar sa më mirë parimin e barazisë gjinore. Instrumentet ndërkombëtare i referohen parimit të mosdiskriminimit dhe të barazisë në familje si një prej parimeve themelore për një jetë cilësore.

Objekti i studimit ka të bëjë me evidentimin e politikave të punësimit në aspektin gjinor në institucionet private dhe publike, identifikimin dhe vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në lindjen e diskriminimit gjinor. Vëmendje e veçantë i kushtohet të drejtave të femrave në punësim dhe masës së respektimit të këtyre të drejtave. Ndërkohë edhe studime të tjera të realizuara nga shoqata shqiptare kanë hedhur dritë dhe mbi diskriminimin gjinor por duke u bazuar më tepër në aspektin e hendekut të pagave. Këto studime kanë arritur në përfundimin që të ardhurat e femrave në punë janë më të ulta se sa të ardhurat e meshkujve, saktësisht 17.4% më pak dhe ky hendek zgjerohet me rritjen e moshës. Gratë përballen me diskriminim në marrëdhëniet e punës.

Ky studim fokusohet në marrëdhëniet mes nomenklaturës Shqiptare dhe asaj Europiane me barazinë gjinore në punësim dhe të punës. Pyetjet që shtrohen në këtë punim janë: Cfarë roli luan barazia gjinore në punësim dhe punë në familjen shqiptare? Cili është ndikimi ekonomik social dhe kulturor i barazisë gjinore në punësimin në Shqipëri?

Papiri organizohet në 5 seksione. Seksioni i dytë përmbledh problemet me përkufizimin, matjen, dhe fushat e diskriminimit të trajtuara në literaturë dhe në ç’ mënyrë mbahen ato parasysh në analizën e këtushme. Seksioni i tretë trajton një analizë të diskriminimit në punë si diferencim profesional dhe në pagë. Seksioni i fundit ofron disa konkluzione.

## Barazia gjinore në vendin e punës dhe aspektet ligjore

Studiues të ndryshëm e analizojnë barazinë gjinore në këndvështrime të ndryshme dhe në varësi të impaktit që ajo ka ata e konsiderojnë atë si një fenomen tejet të rëndësishëm për shoqërinë. Nisur nga këndvështrimi social, barazia gjinore vërehet që ndikon në cilësinë e jetës së njerëzve, shtetit, mirëqenies sociale, sigurimin shëndetësor, kapacitetin e shtetit për të ofruar ndihmë sociale dhe kapitalin njerëzor. (Kraal.K & Wrench.J & Roosblad.J & Simon.P 2009) Ndërsa nga këndvështrimi ekonomik barazia gjinore ndikon mbi cilësinë e burimeve njerëzore, koston e kraut të punës, zhvillimin e bizneseve, apo vetë marrëdhëniet me klientët (Leëis, S. and J. Leëis, 1996).

Barazia gjinore në sektorin privat ndikon në rekrutimin e talentëve (Hsieh, C. T. & E. Hurst, C. I. Jones & P. J. Klenoë 2012), performancën e biznesit, apo cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit, (Carter, D., B. Simkins, and G. Simpson, 2003) ndërsa në kontekstin e punës, ajo ndikon mbi rritjen ekonomike, produktivitetin e punëtorit, burimet njerëzore, zhvillimin e biznesit, të ardhurat nga taksat në buxhetin e shtetit, apo edhe sistemin e sigurimeve shoqërore (Kraal.K & Wrench. J & Roosblad.J & Simon.P 2009).

Studiuesit e barazisë gjinore në punë kanë dalë në konkluzionin se ka një numër faktorësh që ndikojnë shkallën e barazisë gjinore nga ku më të rëndësishmit mund të konsiderohet faktorët social, ekonomik dhe ata juridik. Ndër faktorët e natyrës sociale do të konsiderojmë si të rëndësishëm origjinën etnike (Helgesson, L, 2000: 201-435), aftësitë gjuhësore, arsimimi dhe kualifikimi (Karen, 2009: 11-12), kode familjare diskriminuese, mëmësinë, dhe disa kufizime që konsistojnë në integritetin fizik, të drejtën e kontrollit dhe pronësisë mbi resurset apo edhe vetë liritë civile (North, Douglas, 1990: 97-112). Të rëndësishëm janë dhe faktorët e natyrës ekonomike si pjesëmarrja në punë e grave e cila ndikohet nga mundësitë për punësim të pjesshëm ose të plotë (Buddelmeyer, M, 2005: 13-36), mundësitë për punësim publik (Luttikhuisen, B, 1998: 113), shkalla e arsimimit të gruas, politikat për gratë shtatzëna, sistemi përkujdesjes për fëmijën, si dhe sistemi i taksimit për burimin e dytë të të ardhurave në një familje (Ribberink, 1998).

Ka shumë studiues që shkallën e barazisë gjinore e lidhin me rolin e faktorëve të natyrës juridike, kombëtare apo ndërkombëtare, që konsistojnë në rolin e instrumenteve, aktorëve, dhe institucioneve juridikë. Në nivel ndërkombëtar, instrumentet juridikë përfshijnë traktatet (Tsutsui, H, 2007), konventa (Zëingel, S, 2005: 5), norma, rekomandime, dhe deklarata (Boyle, D, 2001: 112), ndërsa aktorët dhe institucionet përfshijnë gjykata dhe organizata ndërkombëtare, komitete apo komisione ndërkombëtare, dhe shtete kombëtare anëtare të organizatave ndërkombëtare (International Law Association, 2002: 1). Në nivel kombëtar, instrumentet juridikë përfshijnë kushtetutën, ligjet kombëtare, kode, dhe politikat qeveritare (Landsberg-Lewis, I, 1998: 223), ndërsa aktorët dhe institucionet përfshijnë legjislativin dhe komisionet parlamentare, ekzekutivin dhe agjencitë publike, dhe sistemin gjyqësorin të përfaqësuar nga gjykatat dhe gjykatësit (Byrnes, Freeman, 2012) (OECD, 2012: 37-44).

Studiuesit që theksojnë rolin e faktorëve juridikë iu atashojnë këtyre faktorëve një influencë pozitive dhe kontribut në përmirësimin dhe rritjen e barazisë gjinore (Freeman.B, 2012: 2). Megjithatë, brenda këtij këndvështrimi, pikëpamjet mes studiuesit kanalizohen në tre drejtime kryesore që janë:

1. Cilët faktorë ushtrojnë një influencën më të madhe mbi ndryshimet në barazinë gjinore, ata ndërkombëtarë apo kombëtarë,
2. Cilët faktorë juridikë kanë një peshë dhe rol më të madh, instrumentet, apo aktoret dhe institucionet, pavarësisht karakterit kombëtar apo ndërkombëtar të tyre, dhe
3. Ç'kushte influencojnë vetë rolin dhe influencën e faktorëve juridikë, pavarësisht natyrës kombëtare apo ndërkombëtare të tyre.

Në debatet mbi këto çështje disa studiues që i japin përparësi instrumentave ndërkombëtarë (Hathaway, 2002: 1935; Jinks.G, 2003: 183; Gauri, 2011: 33-56; Byrnes, Freeman, 2012: 5-6) sepse i shohin ato si pikë reference që shtetet kombëtare në formulimin e instrumentave të tyre kombëtarë. Studiues të tjerë theksojnë rolin e aktorëve, duke i dhënë përparësi sidomos aktorëve kombëtarë, dhe në mënyrë specifike pushtetit legjislativ (Byrnes, Freeman, 2012: 3-4), pasi roli dhe ndikimi i instrumentave ndërkombëtare ka gjasa të jetë më i madh kur shtetet kombëtare i reflektojnë ato në ndryshimet që bën parlamenti kombëtar në legjislacionin për barazinë gjinore sesa kur shtete kombëtare nuk shprehin vullnetin për të ndryshuar legjislacionin. Ka gjithashtu edhe mendime që lidhin efektin e faktorëve juridikë mbi barazinë gjinore me përcaktimin ose jo të qartë të standarteve të barazisë gjinore (Andrew, 1997: 50-55), reflektimin e këtyre standarteve në instrumentat kombëtarë, pranimin ose jo të standarteve të barazisë gjinore nga aktorët kombëtarë (Agnes, 1997: 101-113), respektimin ose jo të këtyre standarteve nga aktorët kombëtarë, si dhe zbatimin e vendimeve në rastet e konflikteve me karakter gjinore nga institucionet kombëtare, shoqëria në tërësi, apo segmente dhe individë të veçantë (Bhagati, 1997).

Zhvillimi i teorisë gjinore së fundmi ka shënuar progres të konsiderueshëm si pjesë e përgjithshme post-moderne dhe veçanërisht në sferën avokuese. Në një analizë të detajuar aktuale që i bëjme teorisë gjinore arrijmë në përfundimin se:

- gjinia është shkaktari kryesor i pabarazisë në punë dhe në shoqëri.
- dallimet gjinore dhe perceptimet gjinore janë të rëndësishme për të kuptuar të gjitha fazat e historisë (jo vetëm historisë së gruas, burrave, familjes por gjithashtu edhe për të kuptuar historinë politike, ekonomike, institucionale, shkencore, teknologjike të religjionit, dhe të gjitha sferat e tjera)
- gjinia ka qenë dhe është produkt diskursiv.
- nocionet kundërshtuese të meshkujve dhe femrave duhet shikuar në relacione të ndërsjella dhe janë vazhdimisht duke ndryshuar nëpër kohë dhe vende të ndryshme.
- dekonstruktimi gjuhësor është vital për të kuptuar natyrën gjinore të tekstit, burimeve dhe po zbulon rëndësinë gjinore të të gjitha llojeve të shkrimeve akademike. (Bettio.F & Verashchagina.A, 2008; 23, 24)

Bota duhet të çlirohet nga këto diskriminime dhe nuk duhet pasur një dorë dominuese, përkundrazi duhen shikuar gjërat në mundësitë bashkëpunuese dhe në respektimin e natyrës së ndërsjellë gjinore.

**Barazia** gjinore arrihet kur njerëzit janë në gjendje për të hyrë dhe të gëzojnë shpërblime të njëjta, burimet dhe mundësitë pa marrë parasysh nëse ata janë nga gjinia femerore apo mashkullore. Vende të ndryshme përfshirë dhe Shqipërinë kanë bërë përparim të rëndësishëm në drejtim të barazisë gjinore në dekadat e fundit, por pavarësisht këtij progresi përsëri gratë vazhdojnë të fitojnë më pak se burrat dhe hasin vështirësi në realizimin e aspiratave të tyre në fushën e karrierës kundjet burrave.

Qëllimi i barazisë gjinore në punë konsiston në arritjen e një trajtimi në kushte të barabarta mes grave dhe burrave dhe për të arritur këtë kërkohet që:

1. Vendet e punës të ofrojnë pagë të barabartë për gratë dhe burrat për punë me vlerë të barabartë ose të krahasueshme
2. Të heqen barrierat për pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në fuqinë punëtore
3. Qasja për të gjitha profesionet dhe industrinë, duke përfshirë rolet e lidhshme, për gratë dhe burrat
4. Eliminimi i diskriminimit në bazë të gjinisë, veçanërisht në lidhje me familjen dhe përgjegjësitë për të kujdesur si grate ashtu dhe burrat.

Arritja e barazisë gjinore në punë është e rëndësishme jo vetëm sepse konsiderohet “e drejtë” por sepse është me rëndësi jetike dhe për zhvillimin e biznesit dhe produktivitetin e kombit tonë. Rritja e numrit të femrave të diplomuara, është një zhvillim shumë pozitiv në luftën për barazi gjinore. Kjo edhe për faktin sepse rriten ndjeshëm mundësitë për punësim dhe karrierë.

## Diskriminimi në punësim

Ndryshimet sociale, kulturore dhe ekonomike të një vendi ndikojnë pashmangshmërisht në diskriminim. Kultura e mbarsur e të shkuarës si, niveli i ulët i demokracisë si dhe mungesa e respektimit të të drejtave të njeriut shkaktojnë diferencime në fusha të ndryshme. Një nga treguesit esencial social mbi të cilin mund të matet dhe vlerësohet niveli i emancipimit të



shoqërisë shqiptarë është koncepti i barazisë gjinore. Në shoqërinë tonë ka pasur një betejë të vazhdueshme për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vërehet një ndërgjegjësim në rritje, i cili ka filluar të shfaqet pas viteve '70, në aspektin e respektimit të barazisë gjinore në punë. Përgjithësisht diskriminimi gjinor në vendin e punës ndodh në mënyrë të tërthortë përmes stereotipave personal, përmes detyrave dhe përgjegjësi të ndryshme në bazë të gjinisë, mundësive të ndryshme për karrierë, si edhe përmes kriterëve të ndryshme të vlerësimit të punonjësve ndërsa diskriminimi i drejtpërdrejtë është në kufijtë e tij minimal.

Barazia gjinore në punë ndikon në perceptimin individual për arritjet profesionale, zhvillimi në karrierë ashtu si dhe në suksesin e organizatave. Diskriminimi gjinor në punë në kuptimin e gjerë të tij ndodh kur një person ose grup personash trajtohen jo në mënyrë të barabartë në kontekstin e punës për shkak të përkatësisë gjinore. (Semini-Tutulani, 2014:16)

Mungesa e barazisë gjinore në punë vëzhgohet në disa aspekte

1. rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;
2. trajtimin e pabarabartë të punëmarrësve në vendin e punës
3. anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfutur nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.
4. shpalljen e vendeve të lira të punës (AMSHC,2013:6)

Vërehet diskriminimi në mundësitë që iu ofrohen femrave për punësim apo kushtet e kontratës e deri tek gama e pozicioneve që mund të zënë femrat, dallimet në pagë, avancimi në karrierë apo ngacmimet verbale ose fizike. Porsa i përket pjesëmarrjes në punë vërehet që gratë kalojnë një proces punësimi më të vështirë sesa meshkujt dhe kushtet e kontratës së punës janë më të pafavorshme se kontratat e meshkujve.

Në tregun e punës vërehen stereotipe të diskriminimit të natyrave të ndryshme të cilat nisin që nga përcaktimi i pozicionit të punës si një pozicion mashkullor, dhe kjo automatikisht ulë ndjeshëm mundësinë e punësimit të femrave në këtë pozicion pune. Pra kategorizimi i punës sipas seksit është një problem serioz i cili cenon në mënyra flagrante respektimin e barazisë gjinore në punë. Kështu në kur një individ (mashkull apo femër) aplikon për një punë që në mënyrë tradicionale, që është parë si profesion tipik mashkullor, aplikantët meshkuj kanë mundësi më të larta punësimi kundrejt aplikanteve femra. Po e njëjta gjë ndodh kur aplikantet femra aplikojnë në ato pozicione punë të etiketuar si pozicione femërore, në këtë rast ato kanë më tepër mundësi të punësohen. Ndërsa për pozicionet neutrale<sup>1</sup> përkatësia gjinore nuk luan ndonjë rol të veçantë.

Shpesh punëdhënësit tentojnë të përputhin përkatësinë gjinore të aplikantëve për punë me përkatësinë gjinore të punonjësve që kanë, megjithëse kjo është diçka që nuk është shumë e dukshme në sipërfaqe. Kështu që ndarja sipas përkatësisë gjinore të fuqisë punëtore kontribuon në forcimin e stereotipave, që ndikon në punësim të ndryshëm të burrave dhe grave, e që detyrimisht çon që kjo ndarje të riciklohet vazhdimisht.

Sipas Branscombe dhe Smith stereotipat ndikojnë në vendimmarrjen dhe më konkretisht ata mendojnë se :

1. përkatësia gjinore e individit aktivizon stereotipin përkatës të grupit, për shembull një grua kandidate në mënyrë automatike do të aktivizojë stereotipin për gratë.
2. ky stereotip do të filtrojë edhe do të shtojë informacionin për grupin.
3. me qëllim që të merret një vendim për një grup në minoritet në krahasim me një individët caktuar, mund të nevojitet informacion shtesë që ai që zgjedh të ndihet më rehat, për shembull në rast se një grua e pavarur mund të shihet si një rast jo i zakonshëm, më shumë informacion nevojitet për të përcaktuar sesi është në të vërtetë kjo grua.

Nga këto të dhëna edhe studime të tjera, ne mund të listojmë një numër faktorësh që mund të pakësojnë diskriminimin në marrjen në punë. Kur kandidatët për punë janë të individualizuar, të tilla siç ndodhin në intervistat e jetës reale, më pak diskriminim ka për marrjen në punë. Ndërsa kur ekziston informacion kundër stereotipave gjinorë<sup>2</sup> diskriminimi në këtë rast është më i pakët. Në ditët e sotme është i përhapur edhe diskriminimi në mundësitë për një punë të një niveli më të lartë si edhe për mundësitë e ngritjes profesionale.

Gratë në krahasim me burrat tentojnë të punësohen më shumë në organizata të vogla, të cilat mund të kenë mundësi të ndryshme promovimi dhe pagese. Në të njëjtën organizatë ku janë të punësuar gra edhe burra me të njëjtën eksperiencë dhe të njëjtin edukim, ndodh që mundësitë e punësimit edhe avancimit të karrierës t'i jepen të ndryshme. Arsyeja e dhënies së detyrave dhe përgjegjësi të ndryshme ndaj grave dhe burrave mund të duket si e zakonshme dhe jo specifike sipas përkatësisë gjinore, por rezultati është i tillë që shumë burra të promovuar dhe të ngritur në përgjegjësi kanë status më të lartë dhe të ardhura më të mëdha.

Gratë që synojnë të lindin në të ardhmen apo që kanë fëmijë për të rritur hasin shumë më tepër vështirësi për punësim jo vetëm se burrat, por edhe se gratë e tjera që kanë kaluar fazat e lindjes dhe rritjes së fëmijëve (OECD, 2012). Në pozicionet punës që mund të zënë gratë, vihet re se gratë ushtrojnë më pak profesione se meshkujt dhe numri i zanateve dhe sektorëve ku janë present ato është i kufizuar (OECD, 2012). Në pagë vëzhgohet fakti që gratë paguhet më pak se burrat, pagat e tyre ngrihen më pak se ato të burrave, dhe gratë bëjnë më shumë punë të papaguar se burrat (OECD, 2012). Në karrierë vëzhgohet që gratë hasin më shumë vështirësi në bërjen karrierë sesa burrat, ato përgjithësisht zënë ato punë që nuk kanë ndonjë perspektivë për karrierë, dhe grave ju jepet më pak mundësi se burrat për trajnim apo rritje në detyrë (OECD, 2012).

<sup>1</sup> Të tilla si asistent administrative në një bankë.

<sup>2</sup> Kur një aplikonte për një vend pune në një profesion tradicionalisht mashkullor, përshkruhet si një individ me tipare tipike vepruese.

Së fundi, në aspektin e ngacmimit verbal apo fizik, gratë vëzhgohet se janë më të ngacmuara se burrat (Jonsson, Walette, 2001; Zorlu, 2001& Kraal, 2009).

Kur diskutohet për tendencat në rastin e hendekut gjinor në punë, për aspekte të ndryshme vëzhgohen tendenca të ndryshme. Në pjesëmarrjen në punë tendenca është përgjithësisht pozitive. Në vendet e OECD, gjatë periudhës 1990-2010 hendeku gjinor është zvogëluar me 9%. Ka vende si ato në Amerikën e Jugut dhe atë Qendrore që kanë një zvogëlim edhe më të madh të hendekut gjinor, me rreth 12%, dhe ka vende, si ato në Evropën Lindore që këtë hendek e kanë ngushtuar vetëm me 2% (OECD, 2012). Ndërsa sa i përket pozicioneve në punë, tendenca ka mbetur e njëjtë, domethënë edhe gjatë periudhës 2000-2010 ndarja e zanateve ka vazhduar të karakterizohet nga fakti që meshkujt ushtrojnë më shumë zanate se femrat si në Evropë, ashtu edhe në Amerikë (Verashchagina.B, 2009; Hartmann.L, 2010). Në pagë është konstatuar një hendek gjinor pavarësisht faktin që mjaft vende kanë aplikuar ligje që kërkojnë barazi në pagë. Ky hendek rritet proporcionalisht veçanërisht me moshën (OECD, 2012). Për një farë kohe u vëzhgua një tendencë ngushtimi e dallimeve në pagë, por nga viti 2005 nuk është vëzhguar ndonjë progres i mëtejshëm. Në vendet e OECD-së, në vitin 2010, gratë me kohë të plotë pune paguhen rreth 16% më pak se burrat, ndërsa gratë në pozicione manaxheriale drejtuese paguhen rreth 21% më pak se meshkujt. Në 2010, hendeku në pagë u ngushtua me 4%, por ngushtim i mëtejshëm nuk është vëzhguar (Vroman.A, 2003: 145-177; Bryan.A, 2007: 163-186 & Llorens.R, 2008: 776). Në karrierë vazhdon të ekzistojë hendeku dhe nuk ka ndonjë tendencë përmirësimi. Në vendet e OECD-së, gratë në pozicione manaxheriale zënë më pak se 30% të menaxherëve (OECD, 2012). Në këtë studim do të analizojmë barazinë gjinore në punë dhe dinamikat e saj në bazë të tre treguesve:

1. pjesëmarrjes në punë,
2. pozicioneve të punës,
3. trajtimit në pagë.

Sipas raportit të World Economic Forum (WEF) barazia gjinore në punë në Shqipëri nuk është e qëndrueshme duke u karakterizuar nga luhajtje të vazhdueshme. Kështu vërehet një rritje e saj gjatë periudhës 2008-2011, por në periudhën 2011-2013 kemi një rënie të respektimit të barazisë gjinore për të vazhduar më pas përsëri me rritje të saj në periudhën 2013-2014. Nga të dhënat e INSTAT-it kemi një tablo më të detajuar të dinamikës së BGJP në të tre indikatorët matës.

Kështu në periudhën e rënies 2011-2013, BGJP si pjesëmarrje shfaq përkeqësim qoftë si nivel, qoftë si tendenca. Në 2013 niveli i hendekut gjinor si pjesëmarrje kalon shifrën 20%; Në 2013, pjesëmarrja e grave në punë është 50.1% kundrejt 70.2% të burrave, pra -20.1%. (Instituti i Statistikave Shqipëri, 2014).<sup>3</sup> Kur pjesëmarrja shihet në formën e punësimit, vetëpunësimit, ose papunësisë, përkeqësimi i nivelit bëhet edhe më i kapshëm. Niveli i hendekut gjinor në formën e punësimit të plotë është rreth 10%,<sup>4</sup> në atë të punësimit të pjesshëm ose vetëpunësimit është rreth 16%, dhe në atë të papunësisë është rreth 4.3%.<sup>5</sup> Edhe tendencat karakterizohen nga përkeqësimi. Pjesëmarrja e grave në punë, jo vetëm ka pësuar rënie, po rënia është edhe më e madhe se rënia që ka pësuar pjesëmarrja e burrave.<sup>6</sup> Tendencat e përkeqësimit në pjesëmarrje shihet edhe në format e punësimit, vetëpunësimit, apo papunësisë. Në vitin 2013, situata e grave karakterizohet nga një përkeqësim edhe më i madh se ai i burrave pasi numri i grave të punësuar pëson një rënie më të madhe se rënia e përqindje të burrave të punësuar.<sup>7</sup>

## Diferencimi profesional si pjesë e diskriminimit gjinor

Faktori kryesor i cili ndikon në përcaktimin e profesionit tonë është personaliteti ynë. Në këto kushte individët mund të zhvillohen më mirë në ambientet e punës të cilat përputhen me personalitetin e tyre. të pasurit të një karriere të suksesshme i ka rrënjët në arsimimin e duhur dhe në inteligjencën e gjithsecilit. Ndërkohë, gjysma e grave të punësuar janë diskriminuar në vendin e punës për shkak të përkatësisë së tyre gjinore. Në fushën e punësimit gratë kanë më pak mundësi punësimi se burrat mandje edhe kur kjo mundësi ekziston atëher janë diskriminuara kushtet e kontratës. Kryesisht ku diskriminimi në punësim arrina nivelet më të larta te gratë shtatëzana dhe nënat më fëmijë (OECD, 2012). Vërehet se gratë ushtrojnë më pak profesione se meshkujt dhe numri i zanateve dhe sektorëve ku janë present ato është i kufizuar. Po kështu edhe në pagësëne punësimit, gratë paguhen më pak se burrat dhe pagat e tyre ngrihen më pak se ato të burrave, (OECD, 2012). Realizimi i karrierës nga

<sup>3</sup> Në 2013, pjesëmarrja e grave në punë është 50.1% kundrejt 70.2% të burrave, pra -20.1%. Shih Instituti i Statistikave Shqipëri (2014), "Popullsia ekonomikisht aktive" fq. 61, në *Femra dhe Meshkuj në Shqipëri*, INSTAT, Albania.

<sup>4</sup> Në 2013, përqindja e meshkujve të punësuar është 55% ndërsa e grave është 45%, pra një difference është 10%. Shih INSTAT (2014), "Popullsia ekonomikisht aktive", fq. 61.

<sup>5</sup> Në 2013, përqindja e grave të punësuar me kohë të plotë ose të vetëpunësuar është rreth 21% ose rreth 16% më e ulët se niveli 37% i burrave. Shih INSTAT (2014), "Ecuria e statusit të punësimit të meshkujve dhe femrave në 2014", fq. 31-32, në *Femra dhe Meshkuj në Shqipëri*, INSTAT, Albania.

<sup>6</sup> Pjesëmarrja e burrave në punë në vitin 2012 ishte 73.4% ndërsa në 2013 ishte 70.2%. Pra, brënda periudhës 2011-2013, pjesëmarrja e burrave ka pësuar një rënie prej -3.2%. Pjesëmarrja e grave në punë në 2012 ishte 56.4%, ndërsa në 2013 ishte 50.1% ose -6.3%. Rënia e pjesëmarrjes në punë të grave ka qënë më e madhe se rënia e pjesëmarrjes në punë të burrave me rreth -3.1%. Shih INSTAT (2014) "Popullsia ekonomikisht aktive", fq. 61, në *Femra dhe Meshkuj në Shqipëri*, INSTAT, Albania.

<sup>7</sup> Në 2012 numri i burrave të punësuar ishte 55.9% ndërsa në 2013 kjo shifër ishte 50.7%, ose ndryshe, punësimi i burrave ra me -5.2%. Në 2012 numri i grave të punësuar ishte 43.5% ndërsa në 2013 kjo shifër ishte 38%, ose ndryshe, punësimi i grave ra me -5.5%. Shkurt, rënia e punësimit të grave ishte 0.3% më e madhe se rënia e punësimit të burrave. Shih INSTAT (2014) fq. 63-69.

gratë është më i vështirë sesa te burrat kjo sepse gratë punësohen kryesisht në pozicion punë të cilat nuk kanë perspektivë për karrierë, por duhet thënë edhe që mundësitë që u jepen grave janë më të ulta sesa ato që u jepen burrave për rritje në detyrë (OECD, 2012). Së fundi, në aspektin e gacimit verbal apo fizik, gratë vëzhgohet se janë më të ngacmuara se burrat (A., Jonsson & M, Ëallette, 2001). Sidoqoftë, ka shumë gra dhe vajza, të cilat nuk janë të ndërgjegjësuar lidhur me diskriminimin gjinor dhe trajtimin e padrejtë që i bëhet në vendin e punës. Disa prej grave dhe vajzave e pranojnë diskriminimin si kusht për punësimin e tyre, sidomos në rastet kur kanë një burrë në pozicionin e shefit apo drejtuesit. Prandaj, në shumë raste pyetja ndaj grave dhe vajzave a ndjehen të diskriminuara në vendin e punës, mund të mos jetë një indeks i saktë.

Kryesisht gratë donojnë tregun e punës në profesione të cilat konsiderohen femërore. Kështu në një analizë të punësimit me bazë gjinore kemi vënë re në vitin 1991 rreth 3/4 e punëtoreve femra ishin të punësuar në një nga këto tre kategori

- pune mbështetje administrative (28%),
- menaxheriale dhe profesionale (27%);
- kryesisht në mësimdhënie e administratë, si dhe në sektorin e shërbimeve (18%) (Departamenti i Punës së SHBA, 1991).

Ndërsa meshkujt gëzonin një shpërndarje të njëtrajtshme në disa kategori pune si menaxheriale e profesionale (26%), si punëtorë operativë (20%), në punë teknike dhe zanate të ndryshme (19%), në sektorin e shitjeve (11%), si dhe në sektorin e shërbimeve (10%). Gratë janë veçanërisht më pak të punësuar në punë teknike, si punëtore transporti, si fermere, dhe si shitëse mallrash me shumicë, ndërkohë që janë të punësuar më tepër në sektorin e shërbimeve, si shitëse mallrash me pakicë, si mësuese të ciklit të ulët e të mesëm, si mbështetëse administrate dhe si shërbyese shtëpiake private. Në 1989, nga të gjitha gratë e punësuar, vetëm 9% e tyre punonin në vende pune, në të cilat më tepër se 75% e të punësuarve ishin meshkuj (Komisioni Kombëtar i Grave të Punësuar, 1990). Niveli më i lartë i diskriminimit ishte te gratë me ngjyrë nisur nga ky fakt më tepër se 70% e të cilave e gjemë të punësuar në sektorë pa përfitim, si në spitale etj.

Profesionet që zotërojnë gratë dominojnë një pjesë të vogël të tregut të punës, por vërehet që pavarësisht profesionit ekziston tendenca që edhe në këto profesione ato gëzojnë status më të ulët, si dhe të kenë pagesën më të ulët. Kështu, në listën e profesioneve të shpallur nga Zyra e Regjistrimeve të SHBA, shihet se në 500 profesione, punësimi i grave është kryesisht i përqendruar në 22 profesione, të klasifikuara si më pak të paguarat. Madje edhe brenda të njëjtit profesion, gratë zakonisht caktohen në vende pune më pak të paguara.<sup>8</sup>

Meshkujt kryesisht zënë vendet e punës që janë më të paguarat dhe me status më të lartë, qoftë në shoqërinë e sotme, qoftë në shoqëri të tjera të mëparshme. Sa më shumë që një profesion të dominohet nga gratë, aq më pak paguhet ai. Ndërkohë që paga dhe statusi i një profesioni shkojnë drejt rritjes, përqindja e grave dhe vajzave në këtë profesion shkon drejt uljes. Nën etiketimin gjinor të profesioneve gjenden ata faktorë, të cilët tradicionalisht kanë ndikuar mbi pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, por që tanimë nuk janë të vlefshëm për shumë punëtore femra.<sup>9</sup> Kryesisht pjesa më e madhe e të punësuarve të përkohshëm dhe atyre me orar të pjesshëm “*part-time*” janë gra.<sup>10</sup> (Komisioni Kombëtar i Grave të Punësuar, 1990). Fakti që gratë janë kufizuar në pak profesione dhe mund të kenë lëvizshmëri të kufizuar, sepse ato tradicionalisht kanë jetuar atje ku janë punësuar bashkëshortët e tyre, do të thotë se shumë prej tyre përbëjnë një kontingjent rezerve të grave të kualifikuara jashtë tregut të paguar të fuqisë punëtore, për rrjedhojë pagat për gratë qëndrojnë të ulëta. Në vitin 1960 ka pasur një rënie të lehtë të diferencimit profesional, dhe një rritje të lehtë të pranimit shoqëror për zgjedhjet jo tradicionale të karrierës, veçanërisht nga ana e të rinjve. Postet kryesore drejtuese e menaxhues mbeten kryesisht në dorë të meshkujve, por gratë kanë depërtuar në fusha të tjera profesionale. Në 1989 gratë përbënin gati 18% të mjekëve, 22% të avokatëve, dhe gati gjysmën e llogaritarëve dhe kontabilistëve ditorë. Megjithatë, ende mjaft njerëz zgjedhin. Karriera tradicionale dhe rënia e pakët e diferencimit profesional në vitet 1960-1990, ndodhi kryesisht për shkak të rritjes së numrit të vendeve të punës në profesione ku kish më pak diferencim gjinor, si në specialitetet kompjuterike, si dhe për shkak të rritjes së numrit të grave në disa punë menaxheriale. Është i pakët numri i grave që zgjedhin të ushtrojnë profesione që konsiderohen mashkullore apo në punë operative, dhe akoma më i pakët është numri i burrave që zgjedhin profesione të dominuara nga femrat por edhe nëse kjo gjë do të ndodhte atëherë edhe pagesa do të ishte e ndryshme. Çka do të thotë që gratë që ushtrojnë një profesion i cili konsiderohet si tradicionalisht mashkullore fitojnë më pak se burrat, dhe burrat në punë tradicionalisht femërore fitojnë më tepër se gratë.

<sup>8</sup> Për shembull, pjesa më e madhe e shitëseve femra merren në punë si shitëse mallrash me pakicë, ndërsa shumica e shitësve meshkuj janë të punësuar përfaqësues shitjesh të firmave të ndryshme prodhuese. Edhe në shitjet e mallrave me pakicë, ka të ngjarë që gratë të merren me shitjen e mallrave më të lira (si p. sh. veshje), kurse burrat me shitjen e mallrave më të shtrenjta (si p. sh. automobila). Kështu, burrat marrin një sasi më të madhe parash nga përqindja e çdo malli të shitur dhe, për rrjedhojë, fitojnë mbi dyfishin e parave në krahasim me shitëset femra. Edhe në fushat e shkencës që gëzojnë një status të lartë, siç është mjekia, ka më shumë mundësi që, burrat të jenë në poste të fuqishme, si administratorë ose kirurgë, ndërsa gratë të jenë në pozita profesionale me status më të ulët, si mësuese, praktikante e përgjithshme, apo pediatre. Në vitin 1988, gratë mjeke u paguan vetëm në masën 63% në krahasim me kolegët e tyre, mosbarazim kjo që nuk varej nga diferencat në përvojë pune. Pra, modeli i diferencimit profesional në bazë të përkatësisë gjinore është, në fakt, një model i shtresëzimit social.

<sup>9</sup> Mjaft prej atyre që tradicionalisht janë “punë për femra”, nuk kërkojnë një angazhim për kohë të gjatë. Orari i punës është fleksibël, vende pune ka në të gjithë vendin, dhe në vendin e punës nuk nevojitet investim nga ana e punëdhënësit për trajnim. Rrjedhimisht, gratë mund të hyjnë e të dalin nga këto vende pune sipas nevojave të familjes dhe dëshirave të tyre personale.

<sup>10</sup> Përkatësisht 62% dhe 67%, në 1989), një e dhënë tjetër kjo, që pasqyron përgjegjësitë e gruas në punët shtëpiake dhe, për rrjedhojë, “angazhimin” më të dobët në fuqinë punëtore.

Pas viteve `80 numri i të punësuarve meshkujve ka qenë në rënie kjo për faktin se biznese të ndryshme kanë qenë të detyruara të kishin një shumëllojshmëri të punësuarish duke punësuar edhe femra në sektorin e biznesit. Gjatë viteve 1972-1990 gratë përfaqësonin rreth 1/3 e të gjithë menaxherëve, duke e dyfishuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e tyre në menaxhim, por ato vazhdonin ende të dominonin tregun e punëve më pak te paguara. Në vitet 90, vetëm më pak se 3% të pozicioneve të punëve në kompani të ndryshme zihej nga gratë, çka tregon një nivel shumë të ulët të pjesëmarrjes së tyre në tregun e profesioneve të paguara dhe tregon nivelin e lartë të diskriminimit gjinorë në punë. Por edhe brenda të njëjtit profesion ekziston diskriminimi gjinor, si në kushtet e kontratës edhe në pagesën e pozicionit të punës. Kryesisht menaxheret femra gjithashtu paguhën më pak se kolegët e tyre meshkuj.

Edhe përsa i përket pozicioneve të punës në teknologjinë e lartë gratë kryejnë pjesën më të madhe të punës që kërkon aftësi të ulëta, dhe madje marrin paga më të ulëta se burrat në të njëjtat vende pune. Në të vërtetë, mjaft kompani që përdorin teknologjinë e lartë, i lokalizojnë uzinat e montimit në zona ku kontingjenti i grave punëtore është i madh. Punësimi i pakët i grave në fusha tradicionalisht mashkullore, si shkenca dhe teknologjia, ndikon negativisht si mbi gratë, ashtu edhe mbi shoqërinë. Gratë pësojnë humbje, sepse nuk mund të hyjnë në punë të paguara mirë dhe me prestigj të lartë, por edhe shoqëria gjithashtu humbet, sepse shpërdoron një pjesë të rëndësishme të talentit të vet. Nga një studim i bërë në universitetin e Harvardit vërtetohet se rendimentet profesionale të grave janë më të mira se ato të kolegëve meshkuj. Një nga sektorët më të rëndësishëm që u mor si kampion në këtë studim ishte sektori banka, nga ku u vërtetua se bankat e vetme që nuk janë përfshirë në krizën e kredive janë ato që kanë gra në pozicione drejtuese. (McGregor.H, 2012:10) .Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura dhe si rrjedhim gëzimi i një grupi është i kushtëzuar nga gëzimi i grupeve të tjera. Kjo lidhje reciproke apo ndërvarësi ndërmjet të drejtave të ndryshme është më e dukshme për disa të drejta të cilat nuk mund të klasifikohen qartësisht në një grup të vetëm pasi ato bëjnë pjesë në disa grupe të ndryshme në të njëjtën kohë. Për shembull si të tilla konsiderohen e drejta e pronës e drejta për arsimin. Argumenti kryesor për bërjen e dallimit midis të drejtave ka qenë lidhja ndërmjet të drejtave dhe gjykueshmërisë së tyre, e thënë ndryshe mundësisë së gëzimit të tyre me anën e ndihmës së gjykatës. Diskutimi mbi gjykueshmërinë ka shkuar kaq larg duke u mohuar të drejtave ekonomike, social dhe kulturore, statusin e tyre si të drejta të njeriut, duke i konsideruar ato vetëm si parime politike. Në të vërtetë të gjithë këto ide nuk janë të mbështetura nga argumente të ndërtuara mirë, nga teoria e të drejtave të njeriut dhe filozofia. Për më shumë zhvillimet e fundit tregojnë dhe mbështesin idenë që të drejtat e njeriut në tërësi (të gjitha grupet) kanë qenë pjesë e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ato janë të ndërlidhura. Do të jetë vetëm një çështje kohë përpara se të drejtat ekonomike, social dhe kulturore të plotësohen dhe arrijnë status të barabartë me të drejtat civile dhe politike. ekzistojnë pabarazi, gjinore të theksuara, ne çështje të veçanta, në të dyja institucionet. Vihet re se zënia, e pozicioneve manaxheriale, nga meshkujt, zë një vend të konsiderueshëm, në uljen e barazisë gjinore në të dy këto insitucione. Faktin që femrat nuk zënë pozicione drejtuese lidhet dhe me faktin se meshkujt janë më të prirur për sjellje bashkëpunuese. Një matës i rëndësishëm i efektivitetit të bashkëpunimit është mënyra sesi vetë individit e vlerëson dhe e percepton karrierën e tij. Meshkujt synojnë pozicione qendrore dhe kanë tendencën të jenë më influencues, më instrumental dhe më të fuqishëm sesa femrat (Forret dhe Dougherty, 2008). Insitucionet private ofrojnë një barazi më të madhe në rekrutim dhe promovim sesa ato shtetërore. Diskriminimi më i lartë i femrave vjen nga meshkujt, kjo e vërteton dhe përgjigja vetëm nga meshkujt që feramat nuk kanë të njëjtë aftësi si meshkujt për të qenë në pozicione drejtuese. Këtë fakt mund ta lidh me terrenin psikosocial me bazë të fortë patriarkale që ekziston në Shqipëri, në të cilin ende qëndron i fuqishëm si “njësh”, koncepti masiv i rolit me epërsi të mashkullit në të gjithë drejtimet mbi femrën. Ata mendojnë që femrat nuk kanë të njëjtën aftësi si ata për të qenë në pozicione drejtuese, por sipas rishikimit të literaturës që bëmë më parë rendimentet profesionale të grave janë më të mira se ato të kolegëve meshkuj. Në fakt bankat e vetme që nuk janë përfshirë në krizën e kredive janë ato që kanë gra në pozicione drejtuese, shpjegon Heather McGregor, një specialiste finance në bankën “City” në Londër ( Gazeta Shqip )“ Sikur bizneset të drejtohen nga gratë”.Kërkimet tregojnë se meshkujt dhe femrat nuk përfitojnë njësoj nga investimet që ata bëjnë në karrierën e tyre. Bazuar në teoritë ekzistuese dhe në kërkimet mbi organizata, arrihet në përfundimin se ka pak gjasa që femrat të arrijnë të njëjtin nivel përfitimi nga karriera sa meshkujt, për të njëjtën sjellje bashkëpunuese. . Organizatat duhet të njohin dhe të respektojnë barazinë gjinore në punësim në mënyrë që të krijojnë mundësi punësimi për femrat edhe në sektorë dhe pozicione ku dominon gjinia mashkullore.Organizatrat duhet të nxisin punësimin e femrave në pozicione të administratës ose në biznese p.sh duke vendosur si kriter pranimi gjininë, pra të punësohen vetëm femra dhe jo meshkuj në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e femrave në pozicione manaxheriale.Punëdhënësit mund të reduktojnë diskriminimin gjinor duke zbatuar politika kundra-diskriminimit ku përshkruhet sjellja e pranueshme në vendin e punës që lidhet me gjininë, si p.sh barazi mes gjinive në procesin e promovimit. Në rast se ndodhin shkelje të politikave, pala e dëmtuar mund të ngrejë një padi diskriminuese.Diskriminimi gjinor shpesh rezulton nga mungesa e diversitetit brenda një organizate.

## Konkluzione

Barazia gjinore arrihet kur njerëzit janë në gjendje për të hyrë dhe të gëzojnë shpërblime të njëjta, burimet dhe mundësitë pa marrë parasysh nëse ata janë nga gjinia femerore apo mashkullore. Shumë vende në mbarë botën, përfshirë Shqipërinë, kanë bërë përparim të rëndësishëm në drejtim të barazisë gjinore në dekadat e fundit, veçanërisht në fusha të tilla si arsim. Megjithatë, gratë vazhdojnë të fitojnë më pak se burrat, kanë më pak gjasa për të çuar përpara karrierën e tyre ne krahasim me burrat, dhe kanë më shumë të ngjarë të kalojnë vitet e tyre përfundimtare në varfëri. Në të njëjtën kohë, njerëzit shpesh e kanë

të vështirë për të hyrë në politikat familjare-miqësore apo marrëveshjet fleksibile të punës sesa gratë. Qëllimi i barazisë gjinore në vendin e punës është për të arritur rezultate gjerësisht të barabarta për gratë dhe burrat, nuk është saktësisht për të arritur të njëjtin rezultat për të gjithë individët. Për të arritur këtë kërkohet: - Vendet e punës të ofrojnë pagë të barabartë për gratë dhe burrat për punë me vlerë të barabartë ose të krahasueshme; -Të heqen barrierat për pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në fuqinë punëtore; -Qasja për të gjitha profesionet dhe industritë, duke përfshirë rolet e lidhshme dhe të barabartë të grave dhe burrat; -Eliminimi i diskriminimit në bazë të gjinisë, veçanërisht në lidhje me familjen dhe përgjegjësitë për të kujdesur si gratë dhe burrat. Arritja e barazisë gjinore është e rëndësishme për vendet e punës jo vetëm për shkak se ajo është “e drejtë” por ajo është gjithashtu me rëndësi jetike në linjë fund të biznesit dhe produktivitetin e kombit tonë.

Interesimi i grave për të qenë mjaft mirë nga ana financiare ka pësuar një rritje në 20 vitet e fundit (ashtu si dhe interesimi i burrave), dhe mund të sinjalizojë një zhvendosje në zgjedhjet për karrierë të grave. Por, ashtu si interesimi i burrave për të krijuar familje e për të rritur fëmijë, nuk do të thotë domosdoshmërisht se ata vetë do të qëndrojnë në shtëpi për ta bërë këtë. Po ashtu mundet që interesimi i grave për të qenë mirë nga ana financiare nuk do të thotë domosdoshmërisht se ato do t'i fitojnë personalisht këto të ardhura. Për studentët e sotëm të kolegjit mund të jetë e vështirë që të gjejnë mënyra për të realizuar objektivat më të rëndësishme, meqenëse fuqia punëtore nuk është projektuar për të përshtatur në të njëjtën kohë interesat shtëpiake dhe ato të karrierës. N. q. s. do të detyroheshin të zgjidhnin, ka të ngjarë që mjaft persona do iu jepnin përparësi detyrimeve familjare dhe shoqërore. Orientimi relativisht më i madh i grave drejt forcimit të marrëdhënieve me njëra-tjetrën dhe funksionimit si një grup i vetëm, si dhe interesimi më i madh i grave për të ndihmuar të tjerët ndikojnë mjaft në fuqinë punëtore. Ka më shumë mundësi që gratë të jenë më të interesuara se burrat për t'u bërë mësuese, infermiere, kameriere, kujdestare fëmijësh, si dhe për t'u marrë me punë të tjera në sektorin e shërbimeve, por për shkak se dominojnë vlera kulturore mashkullore, këto punë gëzojnë një status të ulët dhe kanë një pagesë relativisht të pakët. Madje edhe brenda të njëjtit profesion, burrat e gratë anojnë drejt aspekteve të ndryshme.

Një shkelje e të drejtave dhe lirive të shtetasve, e parashikuar nga Konventa përpara se të konstatohet nga Gjykata e Strasburgut, duhet detyrimisht t'i nënshtrohet juridiksionit të brendshëm gjyqësor. Shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të konstatuar nga Gjykata e Strasburgut, nënkupton një moszbatim të dispozitave të Konventës nga autoritetet e vendit përkatës. Konventa Europiane, duke qenë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe drejtpërdrejt e zbatueshme, kërkon dhe mjetin ligjor efikas me anë të të cilit të ballafaqojë shkeljet që mund t'i bëhen individëve, si dhe të kërkojë dhe të përshtatë pajtueshmërinë e ligjit me të.

# RAPORTI I JURIDIKSIONIT MIDIS GJYKATAVE NACIONALLE DHE ATYRE NDËRKOMBËTARE

---

DOKTORANTE ARTA MEHMETI

---

## ABSTRAKT

Juridiksioni i gjykatave ka të bëjë me kompetencën e gjykatave që të gjykojnë veprimet kriminale brenda territorit të vet shtetëror. Juridiksioni është pjesë e pandashme e sovranitetit shtetëror, i cili nënkupton supremacionin e organeve të shtetit në ushtrimin e pushtetit shtetëror, brenda kufijve të territorit shtetëror. Sa i përket juridiksionit të gjykatave brenda një territori shtetëror, nuk ka dilema, sepse nënkuptohet se pushteti i të gjitha organeve shtetërore, e me këtë edhe të organeve gjyqësore ushtrohet mbi njerëzit gjegjësisht popullin i cili jeton brenda kufijve të një shteti. Problemi lind kur na paraqiten raste tjera si psh. kur shtetasit e huaj kryejnë vepra penale në shtetin tonë, kur shtetasit tonë kryejnë vepra penale në shtetin tjetër, ose kur nga shtetasit e shtetit ose shtetasit e huaj kryhen vepra kundër sigurisë ose interesave të një shteti të caktuar. Gjithashtu, shumë e ndjeshme është çështja kur kryhen krime ndërkombëtare të cilat nuk parashkruhen, gjatë zhvillimit të konflikteve të armatosura brenda një territori të caktuar ose midis dy e më shumë shteteve. Zakonisht shtetet udhëheqësit e të cilave kryejnë krime të tilla nuk janë të gatshëm t'i nxjerrin para drejtësisë dhe t'i gjykojnë kriminelët e tillë. Si rezultat i një qëndrimi të tillë dhe nga ngritja e vetëdijes se krimet dhe kriminelët e tillë duhet të gjykohen, u themeluan tribunalet ad hoc si dhe Gjykata penale ndërkombëtare, të cilat janë kompetente për gjykimin e krimeve të tilla. Lidhur me çështjen e kompetencës për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, Statutet e tribunaleve ad hoc si dhe Statuti i Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, e rregullojnë në mënyra të ndryshme. Sipas marrëveshjes së Londrës me të cilën fuqitë fituese të LDB nënshkruan themelimin e një gjykate e cila do të ketë në kompetencë ekskluzive gjykimin e kriminelëve nazist të cilët kryen krime gjatë LDB-së, parashihej kompetenca ekskluzive e Tribunalit për krimet dhe kriminelët e caktuar. Edhe Tribunali i Tokios i themeluar dhe i mbështetur mbi të njëjtat parime si ato të Nurembergut, kishte kompetencë ekskluzive gjykimin e kriminelëve japonezë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përgjatë periudhës së LDB-së. Tribunalet ad hoc të mëvonshme gjegjësisht ai i Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë dhe ai i Ruandës për gjykimin e krimeve gjatë zhvillimit të luftës civile, në Statutet e tyre parashohin se për krimet e tilla kompetencë primare kanë Tribunalet në raport me gjykatat nacionale. Kurse në Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, parashihet se GJPN-ja ka rol komplementar, në raport me gjykatat nacionale, për gjykimin e krimeve ndërkombëtare të cilat parashihen me Statutin e Romës.

---

## Raporti i juridiksionit midis gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare

Sovraniteti i shteteve nënkupton pavarësinë e tyre që të veprojnë lirshëm si brenda ashtu edhe jashtë territorit të tyre, pa u kufizuar nga askush. Ky kuptim i sovranitetit absolut të shteteve është tejkaluar, dhe tani në teorinë e së drejtës në përgjithësi njihet parimi i sovranitetit të kufizuar të shteteve, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Parimi i kufizimit të sovranitetit shtetëror, ka zënë vend kryesisht si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve e rrethanave të cilat e arsyetojnë aplikimin e sovranitetit të tillë. Me miratimin e shumë konventave, marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe si dhe shumë rregulloreve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, janë konsoliduar rregulla me të cilat rregullohet çështja e kufizimit të sovranitetit të shteteve, në raste të caktuara.

Shtetet si subjekte të së drejtës ndërkombëtare kanë të drejta dhe detyrime. Shtetet si subjekte juridike ndërveprojnë me shtetet tjera dhe participojnë aktivisht në qarkullimin juridik ndërkombëtar, gjatë të cilit qarkullim shtetet veprimet e tyre duhet t'i bazojnë në ndonjë normë, ligj ose rregullore e cila njihet dhe pranohet nga shumica e shteteve në të drejtën ndërkombëtare. Sepse në të kundërtën do të krijohej anarki dhe për pasojë do të mbijetonin vetëm më të fortit. Për atë arsye që të arrihet një farë mirëqenie juridike ndërkombëtare, shtetet duhet të heqin dorë nga ai sovranitet absolut i cili deri vonë ka qenë pengesë i shumë proceseve ndërkombëtare.

Në sferën e sovranitetit të brendshëm hyjnë puna e organeve legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive. Organet e tilla brenda një territori shtetëror janë të pavarura dhe punën e tyre e bazojnë në kushtetutë dhe ligjet e vendit, mirëpo kur organet e tilla në punën e tyre ndeshen me çështje të sferës ndërkombëtare, na paraqitet dilema se cilin legjislacion duhet aplikuar.

Konventat ndërkombëtare të cilat rregullojnë çështje nga sfera të ndryshme ndërkombëtare, në legjislacionet nacionale inkorporohen kryesisht nëpërmjet dy sistemeve. Njëra mënyrë është kur organi ligjdhënës i një vendi e ratifikon një konventë të caktuar ndërkombëtare dhe mënyra tjetër është kur pas dhënies së pëlqimit paraprak nga ana e organit ligjdhënës është presidenti i shtetit ai i cili jep bekimin përfundimtar. Cilado qoftë mënyrë e ratifikimit të konventave ndërkombëtare, ato bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm të shteteve në momentin e ratifikimit dhe të gjitha organet janë të obliguara t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas tyre.

Pjesë e pandashme e sovranitetit shtetëror është edhe juridiksioni i cili ka të bëjë me fuqinë e shtetit, që në bazë të së drejtës ndërkombëtare të rregullojë ose në mënyrë tjetër të ndikojë te njerëzit, pronën dhe rrethanat si dhe të reflektojë parimet themelore të sovranitetit shtetërorë, barazisë së shteteve dhe mos-përzjerjes në punët shtetërore. (Shaw,2009,551)

Në lidhje me juridiksionin e shteteve që gjykatat nacionale kanë nën kompetencën e tyre për të gjykuar rastet e caktuara kriminale, edhe në të drejtën ndërkombëtare vlejnë po ato parime që vlejnë në të drejtën e brendshme e që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave.

Në teori përmenden disa parime të cilat duhet të respektohen me të cilat përcaktohet se cila gjykatë është kompetente në rastin e caktuar për të gjykuar, parime të cilat janë të vlefshme në shumicën e të drejtave nacionale e të cilat janë të aplikueshme edhe në të drejtën ndërkombëtare. Ato parime janë:

1. Parimi i territorialitetit
  - 1.1. Territori i shtetit
  - 1.2. Vendi i kryerjes së veprës penale
  - 1.3. Parim i flamurit dhe parimi i regjistrimit
2. Parimi real
  - 2.1. Parimi i personalitetit aktiv
  - 2.2. Parimi i personalitetit pasiv
  - 2.3. Parimi universal
  - 2.4. Parimi i juridiksionit përfaqësues (Kamovski,1998,64-84)

### Parimi i territorialitetit

Koncepti i juridiksionit kriminal historikisht është i bazuar në parimin e territorit shtetëror, parim i bazuar kryesisht në teorinë se krimi është i dëmshëm më së shumti në vendin e kryerjes. (Malekian,1991,10)

Baza territoriale për të aplikuar kompetencën gjyqësore e reflekton një aspekt të sovranitetit të aplikuar nga një shtet në hapësirën e saj territoriale, dhe se shteti i caktuar nëpërmjet miratimit të ligjeve dhe aplikimit të të njëjtave në tërë territorin e saj shtetëror, është manifestim logjik i rregullimit botërorë të shteteve të pavarura, sepse organet e shtetit janë përgjegjëse për mbajtjen e rendit dhe aplikimin e së drejtës brenda territorit të vet. (Shaw, 2009, 556)

### Territori shtetëror

Element qenësor për aplikimin e legjislacionit nacional këtu është vendi kryerjes së veprës penale, gjegjësisht territori shtetëror. Derfinimi i territorit shtetëror nuk është nocion juridiko-penal, edhe pse disa legjislacione e definojnë në ligjet e tyre penale. (Kamovski,1998,65)

Territori shtetëror është hapësira që gjendet nën sovranitetin e një shteti dhe mbi të cilin territor shteti e ushtron pushtetin e tij e njohur me termin supremacion territorial. (Gruda,2007,159-161) Territorin shtetëror e përbëjnë sipërfaqja tokësore dhe ujore brenda kufijve shtetëror, toka dhe ujërat nën këtë sipërfaqe dhe hapësira ajrore mbi to. Toka, uji dhe ajri përbëjnë pjesët e vërteta (reale) të një shteti. Gjithashtu edhe disa objekte trajtohen sikur të ishin pjesë të territorit shtetëror, megjithëse janë jashtë kufijve shtetëror. Këto janë pjesë fiktive të territorit shtetëror: pjesët “lundruese” gjegjësisht anijet dhe pjesët “fluturuese” gjegjësisht fluturaket e një shteti, si dhe pjesë të territorit të shtetit tjetër në të cilin janë të vendosura ambasadat e shtetit delegues. ( Gruda,2007,159)

### **Vendi i kryerjes së veprës penale**

Kur një veprë kryhet në territorin e një shteti të caktuar, nuk ka dilemë se aplikohet e drejta e brendshme e atij shteti, pa marrë parasysh se kryesi a është shtetas i atij shteti apo shtetas i huaj. Mirëpo, problemi i përcaktimit se cili legjislacion do të aplikohet mund të paraqitet sidomos te të ashtuquajturat delikte distancionale. Për zgjidhjen e këtij problemi në teori janë paraqitur si zgjidhje të mundshme dy teori edhe atë teoria e ndërmarrjes së veprimit kriminal dhe teoria e shkaktimit të pasojës nga veprimi kriminal. Mirëpo, secila nga këto dy teori i ka mangësitë e veta dhe nuk mund të japë zgjidhje të plotë gjatë përcaktimit se cili legjislacion duhet aplikuar. Prandaj në teori është paraqitur edhe teoria e ubikvitetit e cila në fakt paraqet simbiozë të dy teorive të para e sipas së cilës vepra penale konsiderohet si e kryer si në vendin e ndërmarrjes së veprimit ashtu edhe në vendin e shkaktimit të pasojës. (Kambovski,1998,67-68)

### **Parimi i flamurit dhe parimi i regjistrimit**

Ky parim vlen për pjesët fiktive të territorit shtetëror gjegjësisht për anijet lundruese dhe fluturaket, të cilat mbajnë flamurin e një shteti ose janë të regjistruara në një shtet të caktuar. Këto i nënshtrohen legjislacionit të shtetit amë, dhe në bazë të një fiksioni juridik konsiderohen si territor lundrues ose fluturues i një shteti. (Gruda,2007,160)

### **Parimi real**

Parimi real ka të bëjë me të drejtën e shteteve për mbrojtje të nevojshme nga sulmet që vijnë nga shtetet tjera, të drejtuara kundër sigurisë dhe sistemit të pushtetit. Te ky parim kriterium për aplikimin e legjislacionit nacional është natyra e veprimit kriminal. E rëndësishme është se bëhet fjalë për veprim kriminal drejtuar sigurisë dhe interesave tjera të shtetit, pavarësisht nga cilësia e kryesit, gjegjësisht a është ai shtetas i shtetit ose shtetas i huaj. (Gruda,2007,74-75)

### **Parimi i personalitetit aktiv**

Parimi i personalitetit aktiv ka të bëjë me aplikimin e legjislacionit nacional ndaj shtetasve të vet, kur kryejnë veprime kriminale në territorin e shtetit tjetër. Ky parim është ngushtë i lidhur me nocionin e ekstradimit gjegjësisht me dëshirën e shteteve që gjykatat nacionale të gjykojnë shtetasit e vet edhe kur ata kryejnë veprime kriminale jashtë territorit shtetëror ose edhe me shprehjen e dëshirës së vet kryesit që të gjykohet në vendin e vet, gjë të cilën e arsyetojnë shumë rrethana praktike. (Huet&Koering-Joulin,Paris,230)

### **Parimi personalitetit pasiv**

Parimi i presonalitetit pasiv nënkupton mundësinë e shtetit për aplikimin e legjislacionit të vet, në rastet kur shtetasit e tij janë viktimat të veprimeve kriminale në territorin e shtetit tjetër. Ky parim është i lidhur me të drejtën e shteteve që të mbrojnë shtetasit e vet, në territore të huaja. (Malekian,1991,14)

### **Parimi universal**

Parimi universal ka të bëjë me të drejtën e secilit shtet që të aplikojë kompetencën gjyqësore për procedurat jashtë territorit të saj, në qoftë se procedurat e tilla kanë karakter të rrezikut universal për shtetin ose qytetarët e saj. (Marphy, 2011,246) Parimi universal krijon të drejtën universale të shteteve që të sanksionojnë aktet të cilat janë të njohura si krime në të drejtën ndërkombëtare gjegjësisht si *delicta juris gentium*. (Malekian,1991,18)

### **Parimi i juridiksionit përfaqësues**

Parimi i juridiksionit përfaqësues që njëherit njihet edhe si parim plotësues nënkupton atë mënyrë të veprimit kur një shtet heq dorë nga pushteti i tij represiv, me qëllim që pushtetin e tillë në një rast të caktuar ta ushtrojë një shtet tjetër. Ky parim ka të bëjë me një kornizë të re juridiko-materiale të bashkëpunimit midis shteteve që në thelbin e saj ka të bëjë me transferimin e procedurës penale nga një shtet në shtetin tjetër, e praktikuar në rastet e kryerjes së veprës penale në territorin e shtetit nga shtetas i huaj, dhe me kusht reciprociteti. (Kambovski,1998.83)



Parimet e aplikuarra më lartë janë parime me ndihmën e të cilave përcaktohet juridiksioni dhe kompetenca e gjykatave nacionale. Në të drejtën ndërkombëtare penale nuk ka të përcaktuara parime fikse të përmbajtura në ndonjë konventë ose rregullore me karakter ndërkombëtar, të cilat do të ishin të obligueshme për t'u respektuar nga shtetet, por për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, kur ato procedohen nga tribunale të ndërkombëtare ad hoc ose nga GJPN-ja, zakonisht janë Statutet e tyre të cilat e kanë të precizuar këtë kompetencë, kurse në rastet kur gjykatat nacionale gjykojnë krimet e tilla, udhëhiqen nga parimet e tilla të vlefshme në të drejtat nacionale.

## Juridiksioni primar dhe plotësues

Me themelimin e tribunaleve penale ndërkombëtare si dhe me krijimin e Gjykatës penale ndërkombëtare, u paraqit problemi i përcaktimit të kompetencës se cilat gjykata kanë prioritet në ndërmarrjen e veprimeve për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, gjykatat nacionale apo ato ndërkombëtare. (Cassese, 2003, 336)

Tribunali i Nurembergut i cili njëherit ishte edhe i pari i llojit të tillë për gjykimin e krimeve ndërkombëtare të kryera gjatë LDB, i cili i krijuar nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare të shteteve aleate që dolën fitimtare të LDB, me të cilën parashihej krijimi i një gjykate që do të ishte kompetente të gjykojë kategori të caktuar të krimeve të kryera nga një kategori e caktuar personash gjegjësisht krimet e kryera nga nazistët gjatë LDB.

Edhe Tribunali i Tokios i krijuar mbi parimet e njëjta si ato të Nurembergut, u krijua për gjykimin e kriminelëve japonezë të cilët kryen krime ndaj popullsisë koreane juglindore. Të dy Tribunale të kishin kompetencë primare në gjykimin e krimeve për të cilat ishin krijuar, gjë e determinuar edhe nga arsye logjike, sepse në kohën e krijimit të këtyre Tribunaleve, gjykatat nacionale të vendeve ku ishin kryer krimet nuk mund të ishin objektive në gjykim duke pasur parasysh rrethanat që mbizotëronin në kohën e krijimit të këtyre Tribunaleve, si dhe gjykatat nacionale as që kishin vullnetin për të bërë një gjë të tillë.

Tribunali i Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, si dhe Tribunali i Ruandës në Statutet e tyre parashohin se këto Tribunale kanë prioritet në raport me gjykatat nacionale, por nuk e kufizojnë të drejtën e gjykatave nacionale që të ndjekin personat përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. (Cassese, 2003, 339)

Me Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, rregullohet çështja e juridiksionit sipas të cilit Gjykata Penale Ndërkombëtare në raport me gjykatat nacionale, ka raport komplementar.

Në nenin 1 të Statutit të Romës thuhet se Gjykata Penale Ndërkombëtare është institucion i përhershëm dhe ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare, sipas parashikimit në këtë Statut, dhe është plotësim i juridiksioneve penale kombëtare.<sup>1</sup>

Sa i përket çështjes së përcaktimit të juridiksionit si primar ose plotësues, kemi dallim midis juridiksionit të tribunaleve dhe Gjykatës penale ndërkombëtare.

Në rastin e Tribunalit të Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, arsyet për përcaktimin e juridiksionit të Tribunalit si primar në raport me gjykatat nacionale, kanë qenë të determinuara kryesisht nga rrethanat politike. Konfliktet e armatosura midis shteteve të sapokrijuara si dhe armiqësitë e rrënjësura thellë midis grupeve të ndryshme etnike dhe religjioze kontribuan që të gjykatat nacionale të mungojë vullneti dhe aftësia që të zhvillojë gjykime fer dhe të paanshme. (Cassese, 2003, 339) Në krahasim me tribunale, të Gjykata penale ndërkombëtare situata është ndryshe. Me Statutin e Romës parashihet se Gjykata penale ndërkombëtare në raport me gjykatat nacionale ka juridiksion plotësues, çka nënkupton se Gjykata penale ndërkombëtare ka kompetencë të veprojë vetëm në rastet kur për arsye të caktuara, të cilat numërohen në nenet 15, 17, 18 dhe 19 të Statutit të Romës<sup>2</sup>, gjykatat nacionale nuk janë në gjendje të ushtrojë juridiksionin mbi personat të cilët kryejnë krime që sipas Statutit të Romës janë në kompetencë të Gjykatës penale ndërkombëtare.

## Literatura

- International criminal law, Antonio Cassese, Oxford University Press, 2003, Translation on macedonian
- International Criminal Law, The Legal and Critical Analysis of International Crimes, Volume I, Fehard Malekian, Borgstroms Tryckeri AB, Motala, Upsala, 1991
- Principles of International law, Sean D. Murphy, George Washington University, 2006 Thomson/West 610 Opperman Drive, P.O. Box 64526 St. Paul, Translation on Macedonian, Ars Lamina, 2011
- Vlado Kambovski, E drejta penale ndërkombëtare, Prosvetno delo, Shkup, 1998
- Zejnullah Gruda - E drejta nderkombetare publike. Prishtine 2007
- Droit penal international, Andre Huet, Renee Koering-Joulin, Depot legal-1 edition: 1994 3 edition mise a jour 2005, Septembre, Presses Universitaires de France, 1994 6, avenue Reille, 75014 Paris
- International Law. M.N. Show. Cambridge university Press 2008 Translation an Macedonian Prosvetno dello 2009
- Dokument ligjor:**  
Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare
- Faqet e internetit:**  
<http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>

<sup>1</sup> <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>, neni 1

<sup>2</sup> <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>,

# E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR

---

**ERJONA RAMAJ**

Phd candidate. Universiteti Eurpian i Tiranës, Fakulteti Juridik, Profili Publik, Dega Mardhënie Ndërkombëtare

---

## ABSTRAKT

Duke marrë shkas nga numri i madhë i persona që i derjtohen Gjykatës së Strasburgut për shkelje të të drejtave të tyre nga ana e shtetit Shqiptar, po e nis punimin tim përse shtetasit shqiptar i drejtohen Gjykatës së Strasburgut, por jo vetëm shqiptarët, ka edhe shumë raste të shteteve të ndryshme të Europës si Franca, Italia, Gjermania, Belgjika, Mbretëria e Bashkuar e t.j. Në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Rapoti që qëndron midis së drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare është e përcaktuar mjaftë qartë në Kushtetutën e Shqipërisë dhe më konkretisht në nenin 5 të saj. Por çfarë duhet që të ketë parasysh gjyqtari shqiptar kur merr një vendim. Duhet të ketë parasysh të gjitha parimet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Në Konventën Europiane e të Drejtave të Njeriut është përcaktuar dhe specifikuar çdo e drejtë dhe parim dhe pikërisht neni 6 i saj thotë “çdo njeri ka të drejtën për një proces të rregullt ligjor”. Gjykimi i drejtë dhe i paanshëm si rezultat i procesit të rregullt ligjor është një çështje shumë e rëndësishme. Në dhënien e vendimit gjykata shqiptare duhet të vërë në qëndër të të drejtave dhe detyrave civile, garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Edhe pse në Kushtetutën e vitit 1998 janë të shprehura elementët që garantojnë drejtëpërdrejtë ligjshmerinë dhe drejtësinë e procesit gjyqësor, përsëri ka shkelje të të drejtave apo kapërcim të këtyre të drejtave nga gjyqësori shqiptarë. Dhe kjo bënë që numri i personave që i drejtohen Strasburgut të vij në rritje. Kjo vjen edhe si pasojë e mosfunksionimit të elementëve strategjik në luftën kundër korrupsionit që sjell edhe devijimin e e dhënies së drejtësisë në Shqipëri. Gjithashtu të mosfunksionimit të balancimit të pushteteve, ku njëri pushtet merr kompetencat e pushtetit tjetër, ku përgjithësisht ai legjislativ mban si timon në duar pushtetin gjyqësor. Gjykatës Europiane të Drejtësisë i është dashur që të bëjë vazhdimisht një interpretim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si një parim me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë. Pyetja që shërtohet është, përse numëri i madhë i ankesave që i drejtohet Gjykatës së Strasburgut ka për objekt të drejtën për një proces të rregullt ligjor? Shtetet ratifikuese të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut kanë përgjegjësinë për të siguruar ekzekutimin e vendimeve. Posaçërisht persa i perket vendimeve të Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, për legjislativin lind nevoja për të marrë masa për të harmonizuar legjislativin e brendshëm me dispozitat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Nëse nuk ka harmonizim pra nëse jemi në rastin e vakumit legjislativ ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli duhet të zbatojnë drejtpërdrejtë vendimet e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut.

**Fjalë kyç:** e drejta për një proces të rregullt ligjor, Gjykata e Strasburgut, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, gjykim i drejtë dhe i paanshëm, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

## Hyrje

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht nenit 5 të saj ku thuhet se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombetare të detyrueshme për të. Dhe në nenin 116 të Kushtetutës tonë është e theksuar hierarkia e normave ku direktë pas Kushtetutës vinë Marveshjet Ndërkombetare të ratifikuara dhe më pas ligjet e vendit. Dhe pikërisht këtu flasim për vendin që zë Konventa Europiane e të Drejtave të njeriut dhe pikërisht për detyrimin që kemi për zbatimin e kësaj konvente në të cilën aderojmë. Gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, si rezultat i procesit të rregullt dhe të drejtë, është një çështje shumë e rëndësishme dhe mjaft e trajtuar. Në dhënien e vendimit gjykata duhet të vërë në qendër të të drejtave dhe detyrimeve civile ose të ndonjë akuze penale garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor<sup>1</sup>. Çështja e garancive në procesin civil dhe penal, apo parashikimet kushtetuese të këtyre garancive, janë trajtuar edhe më parë nga gjyqsori shqiptar (para viteve '90) por janë bërë kryesisht në këndvështrimin e një shtetit totalitar me gjykata që ishin shumë pasive.

Pas viteve 90', në Shqipëri me miratimin e ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" u tentua të korrigohejshin të tilla mangësi, duke parashikuar elementë garantues për një proces të drejtë, në të cilat do të mbështetej ky i fundit, që për kohën ishin shumë të evoluara<sup>2</sup>. Në frymën e shtetit të ligjit dhe të së drejtës, edhe në Kushtetutën e R.SH, të miratuar në 1998, kanë zënë vend një sërë garancish të rëndësishme<sup>3</sup> proceduriale. Por pavarësisht këtyre garancive, në praktikën tonë janë hasur raste të mungesës së respektimit të tyre<sup>4</sup>, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ligjshmërinë dhe drejtësinë e procesit gjyqësor.

Megjithatë shpesh herë këto shkelje kanë gjetur mundësi "korrigjimi" në Gjykatën Kushtetuese<sup>5</sup>, e cila ka përcaktuar më së miri se, vendime të tilla gjyqësore janë dhënë në kundërshtim me parimet kryesore kushtetuese, çfarë sjellë edhe antikushtetueshmërinë e tyre. Mosrespektimi i parimit të procesit të rregullt ligjor përbën edhe rastet më të shumta që paraqiten përpara Gjykatës së Strasburgut jo vetëm nga Shqipëria por edhe nga shtete të tjera si: Franca, Mbretëria e Bashkuar, Greqia, Zvicra, Rusia, Austria, Italia, Irlanda etj. Ndaj, GJ.E.D i është dashur që të bëjë vazhdimisht dhe gjerësisht një interpretim të së drejtës për procesë të rregullt ligjor si një parim me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë. Gjithashtu Gjykata Kushtetuese është shprehur dhe në vendimin nr,20 date 01.06.2011<sup>6</sup>, ajo thekson se respektimi i KEDNJ-se dhe standarteve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshem, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. Në çështjen *Delcourt kundër Belgjikes*, GJ.E.D deklaroi se "Në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës, e drejta për një ushtrim të drejtë të drejtësisë zë një vend kaq të rëndësishëm sa një interpretim i kufizuar i Nenit 6 (1) nuk do t'i korrespondonte synimit dhe qëllimit të asaj dispozite<sup>7</sup>". Pyetja që ngrihet është se përse numri më i madh i ankesave që i drejtohen Gjykatës së Strasburgut ka për objekt të drejtën e procesit të rregullt ligjor?

Në vendimet e saj Gjykata është shprehur se e drejta e procesit të rregullt ligjor duhet parë si një e drejtë dinamike e lidhur ngushtë thuhet me të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese që gëzojnë subjektet e së drejtës. Ndaj ka një tendencë, shpesh edhe "pa dashje" për të mos respektuar këtë garanci kushtetuese. Shkeljet e bëra nga shtetet perfshijnë si fushën e çështjeve civile, shtyrjen e procesit gjyqësor duke lënë pezull rezultatet e një çështjeje tjetër, vonesa në drejtimin e seancës nga gjykata ose në prezantimin a nxjerrjen e provave nga ana e Shtetit; ashtu edhe fushën e çështjeve penale.

Shtetet ratifikuese të Konventës kanë përgjegjësinë për të siguruar ekzekutimin e vendimeve. Nga praktika e Gjykatës së Strasburgut është parë se shteti shqiptar ka dalë me shumë dëme monetare, detyrime të cilat nëse nuk i shlyen do ti dalin probleme serioze nëse në një të ardhme do të jetë anëtare e B.E. Ky studim analizon nga këndvështrimi i një metodologjie cilësore rëndësinë dhe rolin që ka garantimi i të drejtës së një procesi të rregullt ligjor para, gjatë, dhe pas procesit gjyqësor.

## Qëllimi i zbatimit të nenit 6

Qëllimi kryesor në këtë studim është të tregojë se si shteteve nënshkruese të Konventës u duhet të përballeshin me GJ.E.D kur shkelin garancinë kushtetuese të procesit të rregullt ligjor. Edhe me konkretisht Shteti Shqiptar në Kushtetutën e vitit 1998

<sup>1</sup> Shih nenin 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

<sup>2</sup> Mund të përmendim Parimi themelore i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor, barazinë përpara ligjit apo pavarësinë e gjykatave.

<sup>3</sup> Mbi këto garanci duhet dhe bazohet procesi civil, që drejtohen në garantimin e palëve për respektimin e të drejtës së disponimit, kontradiktoritetit, në garantimin e vendimeve të drejta dhe ligjore, pavarësinë e gjykatës, garancinë për karakterin publik të gjykimit, garancinë për respektimin e një afati të arsyeshëm në dhënien e drejtësisë etj.

<sup>4</sup> Shih Bajrami v Shqipërisë (për mosekzekutim të vendimit gjyqësor).

<sup>5</sup> Kështu Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 15 të vitit 2007 shprehet: «Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar si detyrim kushtetues gjykimin e paanshëm nga gjykatat...». Gjykata Kushtetuese është shprehur se: «Në vendimin e saj, gjykata e Apelit nuk i jep përgjigje argumenteve të parashtruara ... nga pala e paditur, duke krijuar dyshime se ajo në zgjidhjen e kësaj çështje ka qenë e njëanshme». Më tej vendimi shprehet se «... në këtë proces nuk është respektuar parimi i paanësisë në gjykim, që në rastin konkret reflektohet në drejtim të pranimit më nënë të njëanshme të kërkesave vetëm të njëjës palë, pa dhënë argumente ligjore si dhe të mosdhënies përgjigje dhe të mosanalizimit të argumenteve që ka parashtruar pala tjetër»

<sup>6</sup> Vendimi nr,20 date 01.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur në lidhje me çështjen Xheraj kundër Shqipërisë.

<sup>7</sup> Delcourt kundër Belgjikes, 17 Janar 1970, paragrafi 25.

ka të shprehura elementët që garantojnë drejtëpërdrejtë ligjshmërinë dhe drejtësinë e procesit gjyqësor, përsëri ka shkelje të të drejtave apo kapërcim të këtyre të drejtave nga gjyqësori shqiptarë.

Dhe kjo bënë që numri i personave që i drejtohen Srtasburgut të vij në rritje. Kjo vjen edhe si pasojë e mosfunksionimit të elementëve strategjik në luftën kundër korrupsionit që sjell edhe devijimin e e dhënies së drejtësisë në Shqipëri. Gjithashtu të mosfunksionimit të balancimit të pushteteve, ku njëri pushtet merr kompetencat e pushtetit tjetër, ku përgjithësisht ai legjislativ mban nën kontroll pushtetin gjyqësor. Gjykatës Europiane të Drejtësisë i është dashur që të bëjë vazhdimisht një interpretim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si një parim me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë. Pyetja që shërtohet është, përse numëri i madhë i ankesave që i drejtohet Gjykatës së Strasburgut ka për objekt të drejtën për një proces të rregullt ligjor? Shtetet ratifikuese të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut kanë përgjegjësinë për të siguruar ekzekutimin e vendimeve.

Posaçërisht persia i perket vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për legjislativin lind nevoja për të marrë masa për të harmonizuar legjislativin e brendshëm me dispozitat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Nëse nuk ka harmonizim pra nëse jemi në rastin e vakumit legjislativ ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli duhet të zbatojnë drejtëpërdrejtë vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut është një çështje fundamentale për një shoqëri demokratike dhe të sundimit të ligjit.

Pra një nga këto të drejta mjaftë të rëndësishme është pikërisht e drejta për një proces të drejtë gjyqësor e cila është parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Garancitë e parashikuara në nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Në çështjet penale garancitë përfshijnë hetimet parajjyqësore të kryera nga policia.

Ndërsa në çështjet civile garancitë fillojnë që në momentin që ngrihet padia. Për procedurat pas seancës gjyqësore të tilla si ekzekutimi i një vendimi. Në çështjen *Qufaj kundër Shqipërisë* gjykata u shpreh se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor që mbulohet nga neni 6 do të ishte i reemë nëse një sistem ligjor vendas i një shteti kontraktues do të lejonte që të mbetej mosveprues në dëm të një pale, një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm gjyqësor. Neni 6 nuk parashikon të drejtën për apelim, por kjo e drejtë parashikohet në nenin 2 të Protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në nenin 6 i garantohet gjithësecilit e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në përcaktimin e të drejtave dhe të detyrimeve civile. Duke u nisur nga formulimi i këtij neni është e qartë se ai nuk i mbulon të gjitha proceset gjyqësore ku një individ mund të jetë palë, por kufizohet në ato që kanë të bëjnë me të drejtat civile dhe detyrimet. Gjykata e ka bërë të qartë faktin se koncepti i të drejtave dhe detyrimeve civile është autonom dhe nuk mund të interpretohet vetëm duke ju referuar të drejtës vetiakte të palës kundërshtuese. Në këtë nen jepet dhe koncepti se çfarë kuptohet me akuzë penale, *Njoftimi zyrtar që i jepet një individit nga autoriteti kompetent për një pretendim se ai ka kryer një veprë penale ose kur masat ndikojnë konsiderueshëm mbi gjëndjen e të dyshuarit.*

Nëse akuzat konsiderohen penale në të drejtën e brendëshme të shtetit palë në konventë, neni 6 do të zbatohet automatikisht në procedimet penale. Neni 6 numëron një sërë elementesh që përbëjnë administrimin e mirë të drejtësisë dhe pikërisht në paragrafin e parë të saj shprehet e drejta për një seancë të hapur. Ky nen i garanton çdokujt të drejtën për një seancë të hapur në përcaktimin e të drejtave të tij civile ose të ndonjë akuze penale të ngritur kundër tij.

E drejta për një seancë të hapur ku marrin pjesë publiku dhe media garanton palët në mosabuzimin e gjykatave në dhënien e drejtësisë dhe rrit përgjegjësinë e saj. Prania e publikut në seancë gjyqësore rrit besueshmërinë në gjykata pasi drejtësia e fshehtë mbart në vetëvetë rreziqe, por mund të kemi përjashtim të publikut dhe medjas kur kemi të bëjmë me interes të moralit, rendit publik dhe sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku kërkohen që të mbrohen interesat e të miturve ose të jetës private të palëve.

## Çfare përfshin nocioni i një “procesi të drejtë”?

Neni 6 deklaron se çdokush ka të drejtën e një seance të drejtë gjyqësore<sup>8</sup>. Detyra e gjyqtarit është të sigurojë që të gjitha palët në një mosmarrëveshje të kenë një “seancë të drejtë gjyqësore” për të cilën Konventa i jep këtë të drejtë. Nuk ka një garantim të shprehur mbi të drejtën e aksesit në një gjykatë në tekstin e Nenit 6, por Gjykata Evropiane është shprehur se kjo dispozite siguron për këdo të drejtën për të bërë çdo lloj pretendimi në lidhje me të drejtat e të /saj civile dhe detyrimet përpara një gjykate apo tribunali. Megjithatë, e drejta për akses në gjykatë nuk është një e drejtë absolute.

Gjykata u shpreh në *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar se Nëse Neni 6 (1) do të kuptohej se kishte lidhje ekskluzivisht me drejtimin e një veprimi të caktuar që ka filluar përpara një gjykate, një Shtet Kontraktues, pa vepruar në kundërshtim me atë dokument, duhet të eliminonjë gjykatat ose t'ia heqin juridiksionin atyre duke u kufizuar në marrjen e vendimeve për disa veprime civile dhe t'ia besojnë të tjerat organeve që varen nga qeveria...do të ishte e paimagjinueshme sipas mendimit të Gjykatës që Neni 6 (1) të përshkruajë në detaj garancitë proceduriale që i jepen palëve në një ndjekje gjyqësore.*

Në precedentin e saj Gjykata është shprehur më tej se çdo lloj kufizimi do të jetë në pajtim me Nenin 6 nëse ndjek një synim legjitim dhe nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe synimit

<sup>8</sup> Kjo shprehje përfshin shumë aspekte të procesit të duhur të së drejtës, si e drejta për akses në gjykatë, për një seancë në prezencën e të akuzuarit, e drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim, barazia në mjete, e drejta për seanca gjyqësore me palë kundërshtuese dhe një gjykim i arsyeshëm.

që kërkohet të përmbushet<sup>9</sup>. Çështja e *Golder kunder Mbreterise se Bashkuar* kishte të bënte me një të burgosur të cilit i ishte refuzuar leja për të kontaktuar me avokatin e të për të paraqitur çështjen e të civile për shpifje kundër një oficeri burgu. Gjykata u shpreh se kjo ishte shkelje e Nenit 6 – e drejta për akses në gjykatë nuk duhet vetëm të ekzistojë, por duhet të jetë gjithashtu efektive.

Gjykata u shpreh gjithashtu se pamundësia e një të burgosuri për të patur konsultime konfidenciale përveç seancës gjyqësore me një avokat e privonte atë nga e drejta për akses në gjykatë<sup>10</sup>. Në disa çështje akses në gjykatë refuzohet për shkak të natyrës së ndërgjygesit. Gjykata ka njohur faktin se kufizimet për akses në gjykatë për të miturit, personat me probleme mendore, të falimentuarit dhe ndërgjygesit shqetësues nuk ndjekin një synim legjitim<sup>11</sup>. Në çështjen e *Canea Catholic Church kundër Greqisë* një gjykatë vendosi që kisha aplikuese nuk kishte personalitet ligjor në të drejtën greke<sup>12</sup>.

Dihet se në çështjet penale, gjyqtari duhet të sigurohet që i pandehuri të përfaqësohet në mënyrën e duhur dhe të përfitojë të gjitha mjetet e nevojshme dhe të barabarta ashtu sikundër kundërshtari i tij. Jo gjithmonë ndodh kështu kur flitet për gjykatat shqiptare, por jo vetëm. Në çështjen e *Krcmar dhe te tjerë kundër Republikës Çeke* Gjykata deklaroi se “Një palë në procesin gjyqësor duhet të ketë mundësinë për tu njohur me provat e paraqitura gjykatës, si dhe me mundësinë për të komentuar mbi ekzistencën e tyre, përmbajtjen dhe vërtetësinë në mënyrën e duhur dhe brenda një kohe të përshtatshme, e nëse nevojitet, me shkrim e më përpara<sup>13</sup>”.

Një problem që haset edhe në jurisprudencën shqiptare është fakti se mungon njoftimi i palës akuzuese për tu paraqitur në seancë gjyqësore. Për pasojë mbrojtësi ligjor i kësaj pale nuk mund ketë dijeni për përmbajtjen e dosjes. Gjyqtari, shpesh nuk sigurohet që i pandehuri të vihet në dijeni në detaje për akuzën kundër të /saj. Ai gjithashtu nuk vë në dijeni mbrojtjen mbi konkluzionet që ai/a jo ka nxjerrë nga dosja e akuzës<sup>14</sup>. Gjyqtari gjithashtu duhet të vëre në dijeni mbrojtjen mbi konkluzionet që ai/a jo ka nxjerrë nga dosja e akuzës. Kjo qëndron veçanërisht nëse ato janë kryesore për marrjen e vendimit.

Çështje të tjera lindin përsa i përket përgjegjesisë së gjyqtarit nëse i pandehuri duket se është keqtrajtuar kur ishte në paraburgim. Ky fenomen ndodh shpesh në burgjet apo dhomat e paraburgimit në Shqipëri. Në shumë raporte të tij K.SH.H<sup>15</sup> ka shprehur shqetësim në lidhje me kushtet dhe mënyrat e trajtimit të personave të burgosur apo të baraburgosur, që bien në kundërshtim të hapur me KEDNJ. Ndërsa gjykata ka deklaruar se kur një individ ngre një pretendim mbi faktin se ai është keqtrajtuar rëndë nga policia ose agjentët të tjerë të Shtetit, Neni 3, interpretohet së bashku me detyrimin e përgjithshëm të Shtetit sipas Nenit 1<sup>16</sup>.

Hetimi duhet të jetë në gjendje të çojë në identifikimin dhe dënimin e personave që janë përgjegjës. Nëse kjo nuk ndodh, ndalimi themelor e i rëndësishëm i torturës do të ishte joefikas në praktikë e do të mundësohej që agjentët e Shtetit të vazhdonin të abuzonin me të drejtat e atyre që do të ishin brenda kontrollit të tyre pa u ndëshkuar efektivisht<sup>17</sup>. Kështu në *Selmouni kundër Francës*<sup>18</sup>, Gjykata deklaroi se kur mbahet një individ në paraburgim në gjendje të mirë shëndetësore dhe konstatohet se është plagosur në kohën e lirimit, i përket shtetit që të sigurojë një shpjegim të besueshëm mbi faktin se si u shkaktuan keto plagë. Lidhur me garantitë në procesin penal Gjykata është shprehur se i akuzuari duhet të jetë i pranishëm në seancën gjyqësore<sup>19</sup>. Një gjyq penal në mungesë të të akuzarit apo të një pale mund të lejohet në disa rrethana përjashtuese nëse autoritetet kanë vepruar me kujdes, por nuk kanë mundur të vënë në dijeni dhe mund të lejohet në interesat e ushtrimit të drejtësisë në disa raste sëmundjesh<sup>20</sup>. Një palë mund të heqë dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në një seancë dëgjimore, por vetëm nëse aktдорëheqja është e qartë dhe “që ndiqet nga një mbrojtje minimale e duhur për rëndësinë e saj<sup>21</sup>”.

E drejta për një seancë të drejtë përfshin parimin e barazisë së mjeteve që nënkupton në parim mundësinë për palët në seance civile apo penale që të kenë njohuri edhe mbi komentet mbi provat e nxjerra ose hetimet e arkivuara<sup>22</sup>. Në këto kontekste një rendesi e vecante duhet ti jepet shfaqjes së ushtrimit të drejte të drejtësisë<sup>23</sup>. Keto parime zbatohen si për procesin penal

<sup>9</sup> Ashingdane kunder Mbreterise se Bashkuar, 28 Maj 1985, para.57.

<sup>10</sup> Campbell dhe Fell kunder Mbreterise se Bashkuar, 28 Qershor 1984, para.111-113.

<sup>11</sup> M kunder Mbreterise se Bashkuar, 52 DR 269.

<sup>12</sup> Kjo çoi në pezullimin e çështjes së ngritur për të bere vlerësimin e të drejtës së të pronen. Gjykata Evropiane megjithatë deklaroi se kjo e kishte demtuar thelbin e të drejtës për gjykatë dhe se kishte konstatuar shkelje të Nenit 6. Gjykata gjithashtu kishte konstatuar shkelje kur procedimet ligjore tjetër panvaresisht nga interesi i drejtperdrejte i kerkuesve në procedime.

<sup>13</sup> Krcmar dhe te tjerë kunder Republikës Çeke, 3 Mars 2000.

<sup>14</sup> Shih shembullin F.K, T.M dhe C.H kunder Austrisë, Apl. Nr. 18249/91, kur Komisioni deklaroi te pranueshme një kerkese te aplikanteve te cilet sipas Nenit 5(3) nuk jane sjelle menjehere perpara nje gjyqi kompetent per te konsideruar ceshtjen e tyre. Ceshtja u zgjidh me vone. Neni 5(3) thote : “ Cdo njeri i arrestuar ose i ndaluar ne perputhje me dipozitat e paragrafi t 1.c te ketë Neni do te sillet para nje gjyqtari ose nje nenpunesi te autorizuar me ligj qe te ushtroje kompetenca gjyqësore dhe ka te drejten e gjykimit brenda nje afati te arsyeshem ose te lirimit ne pritje te gjykimit. Lirimi mund te kushtezohet me garanci per t’u paraqitur ne gjyq.”

<sup>15</sup> Për më shumë, shih: *Kushtet e burgjeve dhe të vendeve të paraburgimit në Shqipëri*, botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kristalina KH, Tiranë, f.32-35 dhe f.41-49.

<sup>16</sup> Për sigurimin e të drejtave dhe lirive të Konventës për cilindo brenda juridiksionit perkates, kerkon shprehimisht qe duhet te kryhet nje hetim efikas e zyrtar.

<sup>17</sup> Assenov dhe te tjerë kunder Bullgarisë, 28 Tetor 1998, paragrafi 102

<sup>18</sup> Selmouni kunder Francës, 28 Korrik 1999, paragrafi 87

<sup>19</sup> Ekbatani kunder Suedisë, 26 Maj 1988, para.25.

<sup>20</sup> Shih shembullin Ensslin et al kunder Republikës Federale të Gjermanisë, 14 DR 64, ku aplikantët rezultuan te papershtatshem per te marre pjese pas nje greve urie. Sidoqofte Komisioni theksoi faktin se avokatet e aplikanteve qene present.

<sup>21</sup> Poitrimol kunder Francës, 23 Nentor 1993.

<sup>22</sup> Ruiz-Mateos kunder Spanjes, 23 Qershor 1993, para.63.

<sup>23</sup> Borges kunder Belgjikës, 30 Tetor 1991, para.24.

ashtu edhe me ate civil. Ne çeshtjet penale ato mbivendosen me disa garanci te vecanta te Nenit 6 (3) por nuk kufizohen me ato aspekte te procedimeve.

Per shembull, Gjykata u shpreh ne ceshtjen e *Bonisch kunder Austrise*<sup>24</sup> se kur nje eksperti per deshmimtare i caktuar nga mbrojtja nuk i jepet lehtesia e njejte si atë te caktuar nga prokurori i gjykates, atehere kemi shkelje te Nenit 6 (1). Me pas Komisioni u shpreh ne *Jespers kunder Belgjikes*<sup>25</sup> se parim i barazise ne mjete i interpretuar se bashku me Nenin 6 (3) imponon nje detyrim mbi autoritetet gjyqesore e hetuese per te nxjerre ndonje material qe eshte në zoterim te tyre, ose per te cilat ata mund te marrin akses, qe mund te asistojne te akuzuarin per te dhene prova pafajësie ose per te marre reduktimin e denimit.

Ne *Foucher kunder Frances*<sup>26</sup> Gjykata u shpreh se kur te pandehurit qe deshironte te perfaqesohej iu mohua aksesi nga prokurori i ceshtjes dhe nuk iu lejuan kopje te dokumenteve qe permban ceshtja, e si rrjedhim nuk ishte ne gjendje te pergatiste nje mbrojtje te duhur, kjo rezultoi ne shkelje te parimit te barazise ne mjete. Neni 6 kerkon qe gjykatat vendase te japin arsye mbi vendimet e tyre si nje ndjekjet civile, ashtu edhe ne ato penale. Gjykatat nuk jane te detyruara te japin pergjigje te detajuara per cdo pyetje<sup>27</sup>, por nese nje kerkese eshte thelbesore per rezultatet e ceshtjes, gjykata atehere duhet ta specifikisht atë.

Në jurisprudencën kushtetuese shqiptare, e cila është në përputhje me qendrimet e mbajtura nga Gjykata Europiane për të drejtat e Njeriut ka konkluduar se “pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuojë në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndrojnë në thelb të mosmarrëveshjeve”<sup>28</sup>. Edhe në raste të tjera Gjykata Kushtetuese (vendim nr. 7 datë 19.02.2007) ka konstatuar që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke zhvilluar gjykimin pa praninë e të pandehurit, ka zhvilluar proces të parregullt ligjor, pasi ka shkelur parimin e barazisë së palëve në procesin gjyqësor.

## Cili eshte kuptimi i garantimit te afatit kohor te arsyeshem?

Neni 6 i garanton çdokujt nje seance brenda nje afati kohor te arsyeshem. Gjykata ka deklaruar se qellimi i ketij garantimi eshte qe te mbroje “te gjitha palet ne procesin gjyqesor...kundrejt vonesave te gjata procedurale”<sup>29</sup>. Ky garantim me tej “thekson rendesine e dhenies se gjykimit pa vonese qe mund te vere ne rrezik efikasitetin dhe besueshmerine”<sup>30</sup>. Kuptimi i kushtit te afatit kohor te arsyeshem eshte bere si rrjedhim per te garantuar qe brenda nje afati kohor te arsyeshem dhe me ane te nje vendimi gjyqesor ti jepet fund pasigurise qe ka nje person persa i perket pozites se tij /saj lidhur me nje akuze penale.

Koha qe duhet marre ne konsiderate fillon me nisjen e procedimeve ne çeshtjet civile dhe ne ato penale me akuzen<sup>31</sup>. Gjykata do te shqyrtoje kohezgjatjen e procedimeve qe nga data ne te cilen nje Shtet Kontraktues ka njohur te drejten per peticion individual, por do te marre parasysh situaten dhe progresin e ceshtjes ne ate dite<sup>32</sup>. Gjykata ka percaktuar ne precedentin e saj se kur behet vleresimi nese kohezgjatja mund te konsiderohet e arsyeshme, faktoret e meposhtem duhen marre parasysh: kompleksiteti i çeshtjes, sjellja e kerkuesit, sjellja e autoriteteve gjyqesore dhe administrative te Shtetit dhe ajo qe perben rrezik per kerkuesin<sup>33</sup>.

Gjykata ka parasysh rrethanat e veçanta te çeshtjes dhe nuk ka caktuar nje afat perfundimtar kohor. Vetem vonesat qe i atribuohen Shtetit mund te merren parasysh ne percaktimin nese eshte permbushur afati kohor i arsyeshem. Megjithate, Shteti eshte pergjegjies per vonesat e shkaktuara nga te gjitha autoritetet e veta administrative ose gjyqesore. Ne trajtimin e çeshtjeve qe kane te bejne me kohezgjatjen e procedurave Gjykata ka marre ne konsiderate parimin e ushtrimit te duhur te drejtësisë, pra faktin qe gjykatat vendase kane detyrimin per te trajtuar ne menyren e duhur ceshtjet qe i paraqiten<sup>34</sup>.

## Çfare kerkohet nga nje gjykate per te qene e pavarur dhe e paanshme?

Cdo gjykatë duhet që të ketë parasysh që në çdo rastë të dhënies së drejtësisë duhet detyrimisht të jetë e pavarur dhe e paanshme, në mënyrë që të garantohet zbatueshmëria e legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar që të kemi ekzistencën e një shteti demokratik. Gjykata duhet të ketë parasysh që të marrë këto dy të drejta të ndara nga njëra tjetra se shpesh këto konksiderohen si të jetë një e drejtë e vetme.

Neni 6 deklaron se çdokush ka te drejten per nje seance gjyqesore nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj. Dy kushtet e pavaresise dhe paanshmerise jane te nderlidhura dhe shpesh Gjykata i merr ne konsiderate se bashku.

<sup>24</sup> Bonisch kunder Australise, 6 Maj 1985.

<sup>25</sup> Jespers kunder Belgjikes, 27 DR 61.

<sup>26</sup> Foucher kunder France, 18 Mars 1997.

<sup>27</sup> Van de Hurk kunder Vendeve te Ulta, 19 Prill 1994, para.61.

<sup>28</sup> Në vendimin nr. 5 datë 04.03.2008 Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën e RSH-së pasi ka konstatuar se çështja është shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë pa i njoftuar më parë rekursin të pandehurit dhe as avokatit të caktuar prej tij. Kështu zhvillimi i gjykimit të çështjes pa praninë e të pandehurit apo dhe të mbrojtjesit dhe pa caktuar as edhe mbrojtës kryesisht përbën shkak për shkelje të normave kushtetuese

<sup>29</sup> Stogmuller kunder Austrise, 10 Nentor 1969, para. 5.

<sup>30</sup> H kunder France, 24 Tetor 1989, para.58.

<sup>31</sup> Scopelliti kunder Italise, 23 Nentor 1993, para.18, dhe Deecer kunder Belgjikes, 27 Shkurt 1980, para.42.

<sup>32</sup> Proszak kunder Poland, 16 Dhjetor 1997, para. 30-31.

<sup>33</sup> Shih shembullin Buchholz kunder Republikes Federale Gjermane, 6 Maj 1981, para. 49.

<sup>34</sup> Boddaert kunder Belgjikes, 12 Tetor 1992, para.39.

GJ.E.D është shprehur se gjykata duhet të jete e pavarur si nga ekzekutivi edhe nga palet. Dyshimet persa i perket dukjes se pavaresise ne nje fare mase duhet te justifikohen objektivist. Ne çeshtjen e *Belilos kunder Zvicres* nje “Bord lokal i Policise” i cili gjykoi disa shkelje te kryera nga te miturit ishte i perbere vetem nga nje anetar – nje polic i cili vepronte ne kapacitetin e te personal.

Megjithese ai nuk iu nenshtroa urdherave, e beri nje betim qe nuk mund ta linte ate, me vone iu kthye detyrave ne rajonin e te dhe tendenca ishte qe ai te konsiderohej si anetar i forcave te policise qe varej nga superiorët dhe qe ishte besnik ndaj kolegeve te te , e si rrjedhoje do te thyente konfidencen qe nje gjykate duhet te nxise. Ekzistonin dyshime legjitime persa i perket pavaresise dhe paanshmerise organizuese ne Bordin e Policise qe nuk permbushnin kushtet e Nenit 6 (1).

Gjykata u shpreh ne *Piersack kunder Belgjikes* se *Ndersa normalisht paanshmeria nenkupton mungesen e paragjykimeve ose anshmerise, ekzistenca e saj ose mosekzistenca ne menyre te dukshme ne baze te Nenit 6 (1) te Konventes do te testohet ne menyra te ndryshme. Mund te behet nje dallim ne kete kontekst midis nje menyre subjektive qe perben perpjekjen per te siguruar denimin personal te nje gjyqtari te caktuar ne nje ceshtje te caktuar, dhe nje menyre objektive qe nenkupton percaktimin nese ai ofron garanci te mjaftueshme per te perjashtuar ndonje dyshim legjitim ne kete kuader*<sup>35</sup>

Persa i perket paanshmerise subjektive Gjykata kerkon prova te anshmerise aktuale. Paanshmeria personale e nje gjyqtari te duhur te emeruar prezumohet derisa te kete prova per te kunderten<sup>36</sup>. Ky eshte nje prezumim shume i forte dhe ne praktike eshte mjaft e veshtire qe te provohet anshmeria personale. Asnje pretendim i tille nuk ka qene i suksesshem ne Strasburg panvaresisht nga ankimet e shpeshta. Persa i perket testit te objektivitetit Gjykata deklaroi ne *Fey kunder Austrise* se *Ne baze te testit te objektivitetit duhet te percaktohet nese, pervec faktit te sjelljes personale te gjyqtarit, ekzistojne fakte te vertetueshme qe mund te ngrene dyshime persa i perket paanshmerise se tij. Ne kete kuader edhe dukja e pavaresise objektive mund te kete rendesine e vet. Ajo qe eshte ne rrezik ka te beje me besueshmerine qe duhet te nxisin gjykatat ne nje shqeri demokratike ne publik dhe mbi te gjitha, persa i perket ndjekjeve penale ne te akuzuarin. Kjo nenkupton qe ne marrjen e vendimit nese ne nje ceshtje te caktuar ekziston nje arsye legjitime per te pasur frike se nje gjyqtari te caktuar i mungon paanshmeria, kendveshtrimi i te akuzuarit eshte i rendesishem por jo vendimtar. Ai qe eshte vendimtar eshte fakti nese kjo frike mund te justifikohet ne menyre objektive*<sup>37</sup>.

Gjykata e ka bere te qarte qe cilido gjyqtar ne lidhje me te cilin ekziston nje arsye legjitime per te pasur frike se i mungon paanshmeria duhet te terhiqet<sup>38</sup>. Ekzistenca e procedurave kombetare per sigurimin e paanshmerise jane gjithashtu me vend ne kete kuader. Ndersa Konventa nuk specifikon shprehimisht se duhet te kete mekanizma me ane te te cileve palet ne procesin gjyqesor do te jene ne gjendje te sfidojne paanshmerine, shkeljet e Nenit 6 kane me shume te ngjare te ndodhin kur ato mekanizma mungojne. Nese nje i pandehur ngre problemin e paanshmerise, ajo duhet të hetohet pervec kur eshte “haptazi pa vlere nje hetim i tille”.<sup>39</sup>

## Konkluzione

Nga sa më sipër mund të themi se procesi i rregullt ligjor, si një garanci kushtetuese për çështje civile dhe penale përbën objektin e numrit më të madh të çështjeve që i paraqiten për gjykim Gjykatës së Strasburgut, pasi janë ezauruar të gjitha shkallet gjyqësore vendase. Në vendimet e saj kjo gjykatë ka vërejtur se shtetet janë përgjegjëse për mosgarantimin e kësaj garancie kushtetuese dhe u ka kërkuar atyre që të respektojnë një afat kohor të arsyeshëm dhe të drejtën për një seancë gjyqësore të hapur, objektive dhe të pavarur dhe të shpalljes publikisht të vendimit edhe në procesin penal. Posaqërisht për sa i përket vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislationin e brendshëm me dispozitat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Nëse nuk ka harmonizim dhe nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli duhet të zbatojnë drejtëpërsëdrejti vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta përcakton shprehimisht se dispozitat e marveshjeve ndërkombetare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Pra gjykatat e çdo niveli duhet të kenë parasysh mos cënimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, dhe të japin drejtësi me paanësi, si dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës së Strasburgut. Si dhe në çdo rast të kemi zbatueshmeri të parimit të balancimit të pushteteve, dhe nga sa më sipër do të kemi respektim të të drejtave të njeriut dhe krijimin e besimit të një publik i gjerë në lidhje me gjyqësorin shqipëtar.

E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshim në vetvete shumë nënçështje të cilat janë, vendimet e gjykatave duhet të shpallen publikisht, vetë gjykatat duhet të jenë të pavarura dhe të paanshme në dhënien e drejtësisë. Gjykimi të jetë brenda një afati të arsyeshëm ku qëllimi i këtij garantimi është që të mbrojë të gjitha palët në procesin gjyqësor kundrejtë vonesave të gjata procedurale. Gjykata të jenë të krijuara me ligjë, çka i ben institucione të cilat garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe se vetëm institucione të tilla duhet që të japin drejtësi dhe të garantojnë këto të drejta.

Shtetet ratifikuese të Konventës kanë përgjegjësinë për të siguruar ekzekutimin e vendimeve. Nga praktika e Gjykatës së Strasburgut është parë se shteti shqipëtar ka dalë me shumë dëme monetare, detyrime të cilat nëse nuk i shlyen do ti dalin probleme serioze nëse në një të ardhme do të jetë anëtare e B.E. Ky studim analizon nga këndvështrimi i një metodologjie cilësore rëndësinë dhe rolin që ka garantimi i të drejtës së një procesi të rregullt ligjor para, gjatë, dhe pas procesit gjyqesor.

<sup>35</sup> Piersack kunder Belgjikes, 1 Tetor 1982, para.30.

<sup>36</sup> Hauschildt kunder Danimarkes, para.47.

<sup>37</sup> Fey kunder Austrise, 24 Shkurt 1993, para.30.

<sup>38</sup> Piersack kunder Belgjikes, para.30, Notier para.33, Hauschildt, para.48.

<sup>39</sup> Remli kunder Frances, 30 Mars 1996.

## Bibliografia

1. Bianku, L. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, botim i Qendrës Evropiane.
2. Permbledhje e vendimeve të Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut kundër Shqipërisë. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
3. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.
4. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
5. Karta e të drejtave themelore.
6. Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë
7. Kodi i procedurës civile të Republikës së Shqipërisë
8. "European Constitutional Law Review", Vol 3, 2007/II
9. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nr.20 Date 01.06.2011. Vendimi nr.5 Date 04.03.2008.
10. Standartet e nenit 6 të KEDNJ-së leksione të Prof Dr, Xhezair Zaganjori.
11. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Kushtet e paraburgimit në Shqipëri.



# SHQIPËRIA, STALINI, HRUSHOVI, THYERJA E MARRËDHËNIEVE DHE RITAKIMI DIPLOMATIK NË VITIN 1990

---

**JULJANA KRISAFI**

Doktorante pranë Universitetit European të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega Marrëdhënie Ndërkombetare  
Email: julikrisafi@hotmail.com

---

## ABSTRAKT

Në këtë punim duke bërë një përmbledhje të marrëdhënies së Enver Hoxhës me Bashkimin Sovjetik, ajo që dua të ve në pah dhe të theksoj është fakti që Enver Hoxha ishte një trashëgimtar i Stalinit. Një adhurues i tezave të tij dhe modelit të tij politik. Hoxha nuk mundi asnjëherë të dalë jashtë këtij profili. Une e shoh këtë fakt si arsyen kryesore të konfliktit të tij me Titon e me pas me Hrushovin . Kulti i individit nuk e lejonte të pranonte rotacionin dhe humbjen e pushtetit vetjak . Ai nuk mundi asnjëherë të hidhte poshtë kultin e individit edhe pse u perpoq sa për sy e faqe ta bënte këtë pas kongresit të XX-të të PK-së së BS-së. Nikita Hrushov në kujtimet e tij për Shqipërinë, kujtonte edhe njëherë se Konferenca e Tiranës do të kishte sjellë demokratizimin në Shqipëri, sikur të ishin zëvendësuar Hoxha, Shehu dhe Balluku. Por faktet treguan që Enver Hoxha me diplomacinë e tij të përljes së përhershme kur bëhej fjalë për pushtetin vetjak shpërthente në deklarata me një gjuhë të ashpër, Më të ashprën e vënë re ndonjëherë në kampin socialist madje edhe në ditët më të acarta të tij. Prishja e marrëdhënieve shqiptaro - sovjetike duke analizuar dokumentacionin, dëshmitë e faktet, mund të shpjegohet si një përpjekje e Enver Hoxhës për të shpëtuar regjimin e tij dhe qëndrimin e tij në pushtet, se sa si një konflikt ideologjik, siç është paraqitur deri vite më parë. Nje aspekt i rëndësishëm i paranojës së Enver Hoxhës është edhe figura e Josip Broz Titos. Cili është vendi i tij në këtë marrëdhënie të ndërlikuar dhe a ka qenë vërtet ai një nga shkaqet kryesore të nisjes së furtunës mes të dy vendeve.

---

*Në librin e tij „Hrushovianët“ Enver Hoxha shkruante: “Ne kishim ëndërruar natë e ditë, të takonim Stalinin. Gjatë periudhës së luftës nacional çlirimtare kjo dëshirë u bë edhe më e fortë.... Stalini zhvilloi drejt luftën e klasave , goditi pa mëshirë (dhe bëri shumë mirë) armiq të socializmit . Ai u tregua një marksist - leninist i shquar ”*

Dhe Enver Hoxha ishte i sinqertë në ato që thoshte për Stalinin. Ai mbeti deri në vdekje një stalinist besnik.

Në vitet 1948 -1961 Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik patën marrëdhënie shumë të ngushta. Intensiteti i tyre ishte kaq i madh sa që Shqipëria ekonomisht por edhe politikisht ishte plotësisht e varur nga Bashkimi Sovjetik. Afrimi nisi me përkrahjen në OKB. Delegacioni i parë shqiptar mbërriti në Moskë në vitin 1947, ku takoi Stalinin, udhëheqësin e superfuqisë, e cila doli nga lufta fitimtare dhe duke sikur në atë kohë nuk pyeste për kërkënd. Dëshmitarë të këtij takimi të parë kujtojnë këto takim Stalini e shfrytëzoi për të marrë disa informata rreth këtij vendi të vogël në Ballkan. Ai dëshironte të njihej me historinë, gjeografinë dhe gjuhën tonë. Që prej nisjes së marrëdhënies e deri në 1953-ishin kur Stalini vdiq, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik nuk patën kurrë probleme. Si fillim Bashkimi Sovjetik nuk e shprehu drejtpërdrejt interesin për ne, por edhe përse i përket eksperiencës Stalini i këshilloi shqiptaret ta merrnin atë nga bullgarët dhe jugosllavët edhe për shkak të afërsisë gjeografike.

Deri në vitin 1948 pavarësisht se marrëdhëniet diplomatike me Bashkimin Sovjetik ishin vendosur me kohë, çdo gjë zhvillohej me bekimin e Beogradit. Furtuna në marrëdhëniet midis Moskës dhe Beogradit sollin darjen e madhetë Enver Hoxhës me Titon. Dheishtëkëqokohakur Bashkimi Sovjetikdoli hapur në interesin e tijndaj Shqipërisë. Pozitajonë në kanalin e Otrantosdhefqinjësia me Greqinë dhe Jugosllavinë e nxiti Bashkimin Sovjetikqëtëmbante Shqipërinë sikartëpresionindajfqinjëve duke i premtuarasajsiguridhembështetje. Dhe Enver Hoxhadontepikërishtmbështetjeperballë Jugosllavisëarmiketashmë, poredhembështetjefinanciareaqhtënevojshme për tëkapërcyerverfarërinë e tejskajshmetëvendit...

Gjatë punës në arkivin e shtetit në kërkim të shënimeve, ditareve, kujtimeve, telegrameve, letrave, pra komunikimit mbi dhe nenujor të asaj kohedel qartë një fakt. Ne ishim në çdo qelizë tëvarur nga sovjetikët.Enver Hoxha bindej për çdo gjë. Ai kishte kaq shumë nevojë për ato para që i jepte Bashkimi Sovjetik për të mbajtur gjallë frymën e këtij vendi ekstremisht të varfër në Europë. Për çdo detaj qeveria e Enver Hoxhës konsultohet me ta, për çdo investim, deri tek shkarkimet nga puna të punonjësve do të ishin të diktuar ose të kritikuar nga sovjetikët.Shqipëria komuniste raportonte rregullisht për çdo lëvizje dhe frymëmarrje me frikën permanente se një ditë Bashkimi Sovjetik mund të na ndërpriste kreditë, furnizimet me lëndë të parë,apo se do të gjendeshim të pambrojtur përballë tashmë armiqve jugosllavë. Kaq i pazëshëm dukej Enver Hoxha dhe zëvendësit e tij në takimet me ta sa që figurën e tij prej diktatori e gjithë kjo histori të bën ta shohësh në një dritë tjetër. Në një nga dokumentet sekrete të asaj kohe Lavrentij Beria. koka e shërbimeve sekrete të Stalinit, me ashpërsi i kërkonte udhëheqësve shqiptarë të spastronin radhët e ushtrisë pasi 30 për qind e tyre ishin spiunë. Por në opinionin e historianëve ne ishim një vend i vogël dhe nuk mund të vepronim ndryshe në marrëdhëniet me një superfuqi të përmasave të Bashkimit Sovjetik. Por në këtë këndvështrim në marrëdhëniet në mes dy palëve jo gjithmonë ka barazi, ekziston edhe kjo lloj përlësie, ekziston edhe një lloj marrëdhënie disproporcionale ndërmjet, por këto janë deri në një farë mase normale. Për këtë periudhë vlera jonë kryesore ka qenë siç thuhet në dokumentet e perëndimit jo aq rëndësia e një shteti me performancë të caktuar por ka qenë më shumë pozita strategjike e Shqipërisë në Mesdhe. Ia vlen të theksohet se në pamje të parë duket sikur udhëheqësit shqiptarë janë gjithmonë të përlur por duhet të kemi parasysh se mbi ta ushtrohet edhe një lloj presioni. Por ndoshta thellë thellë Enver Hoxha nuk përulëj se shqetësohet për varfërinë e tejskajshme të popullit të tij, por për pushtetin vetjak. Per karrigen e tij ai kishte qenë gjithmonë i përlur. Iu përul më herët Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës gjatë luftës, faktet tregojnë se iu përul Titos si askush tjetër, iu përul sovjetikëve e më pas kinezëve.

Shpesh herë mentorët sovjetikë na akuzonin për shpenzime të papërgjegjshme dhe për investime në fusha në të cilat do të dështonim. Enver Hoxha ishte i prirur të investonte në industrinë e rëndë ndërkohë që këshillat që vinin nga BS-ja ishin për të investuar në industrinë ushqimore, bujqësi e peshkim. Më vonë kur shkruajti librin „Hrushovianët“ Enver Hoxha i gjykonte si kurth antishqiptar këshillat sovjetike për tu marrë me bujqësi, madje ai citonte këshillat e tyre me ironi : Shqipëria të ecë përpara me pambuk, dele, peshk e agrume....

Shqipëria nuk ishte një aleat i papërfillshëm për Bashkimin Sovjetik në atë kohë dhe duhet theksuar për shkak të pozitës strategjike të vendit tonë.

Kjo gjë u materializua me ndërtimin e bazës ushtarake detare në gjirin e Vlorës por edhe me shumë marrëveshje ushtarake. Dokumentat britanike janë shumë interesante. Në to shkruhet se pas prishjes me Jugosllavinë mendohej që baza do të ndërtohej në Shqipëri. Më herët, në vitin 1952 apo ,53, thuhet se në gjirin e Vlorës është futur një avion zbulimi britanik me firmën e Çurçillit për të parë nëse po ndërtohej me të vërtetë një bazë nëndetësesh në gjirin e Vlorës . Megjithatë një pyetje qëndron ende pa përgjigje. Ky vend qe paska pasur një rëndësi strategjike të dorës së parë për Bashkimin Sovjetik si u la aq lehtë dhe si ikën këta të fundit dhe u tërhoqën kur Shqipëria ishte vija e parë e Bashkimit Sovjetik në detin Mesdhe?! Ndoshta vlera strategjike e Shqipërisë duhet parë në mënyrë relative. Deri në 1948-ën, interesi ishte investuar mbi Jugosllavinë. Ishte dëshira e Bashkimit Sovjetik për ta lënë Shqipërinë të influencohej kaq shumë nga Jugosllavia.Vetëm pas ndarjes me Titon, Shqipëria u kthye totalisht nga Bashkimi Sovjetik.

Ishte vet Marrëshalli Zhukov që në vizitën e tij në 1957-ën në Shqipëri shprehu admirimin e madh për bazën e Pashalimanit në jugperëndim të Shqipërisë....

Sovjetikëve, gjiri i Vlorës u dukej mrekullueshëm, Deti i Zi ku ata kishin një pjesë të madhe të flotës ishte në fakt një liqen krahasuar me të.Ata donin ta dislokonin atë flotë në këtë bazë duke pushtuar në këtë mënyrë gjithë Mesdheun. Ëndrra e tyre do të bëhej realitet , flota e tyre do të dilte në Mesdhe dhe atëherë nga Gjibraltari në Suez dhe deri në Dardanele ata do të sundonin Mesdheun.

Në fakt Zhukovi dhe sovjetikët nuk e pushtuan ndonjëherë Mesdheun e për më tepër as nuk u munduan ta bënin këtë....

Por ekzistonte një zonë me kontraste të fortanë marrëdhëniet tona me sovjetiket. Një çështje për të cilën Enver Hoxha nuk u perul kurrë. Edhe pse i rrezikohej seriozisht pushteti. Marrëdhëniet me Jugosllavinë. Pavarësisht varësisë nga BS-ja dhe pavarësisht ndikimit të tyre tek ne, përsëri ata nuk arritën kurrë të bindnin diktatorin të rregullonte marrëdhëniet me Titon.

Marrëdhënia me Jugosllavinë ishte një nga arsyet e rëndësishme për thyerjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Nikita Hrushov në librin e tij „Unë nuk jam gjykatës“ tregon se Enver Hoxha ishte përpjekur t'i imponohej që të mos rregullonte marrëdhëniet me Titon. Kurse Enver Hoxha pretendonte të kundërtën. Ai shkruante më vonë se ata që përpiqeshin të imponoheshin ishin sovjetikët. Ata donin që shqiptarët jo vetëm t'i zbutnin sulmet ndaj jugosllavëve, por madje duhet të fillonin dhe të kishin marrëdhënie normale, duke devijuar së bashku me jugosllavët nga rruga e marksizëm-leninizmit. Kishte shumë arsye që e ndanin Enver Hoxhën nga Hrushovi. Që nga Stalini dhe modeli i tij, e deri tek vendi i Kinës në bllok. Por Enver Hoxha, nuk ishte absolutisht dakort me qëndrimin ndaj komunizmit të jugosllavëve. Në kujtimet e tij, Enver Hoxha e konsideronte Titon tradhëtarin e marksizem - leninizmit ndërsa Hrushovi jugosllavët i shihte si komunistë të mirëfilltë. Enver Hoxha ishte i bindur se Hrushovi donte një vëllë të vogël që ta mbante nën shtetull dhe vet të merrte rolin e vëllait të madh. Sipas arsyesimit të tij Hrushovi e donte Titon se ky i fundit ishte i pari që i doli kundër Stalinit. Stalinit të madh, modelit të të cilit Enver Hoxha i qëndroi besnik deri në vdekje. Shumë historianë e shpjegojnë thjesht si problem pushteti. Sigurisht këtu ka edhe dicka të vërtetë. Pajtimi me Jugosllavinë ka dhe një aspekt tjetër të rëndësishëm, ky veprim do të thoshte shfaqjesim për jugosllavët dhe fajësim për atë pjesë të udhëheqjes shqiptare që i dënoi jugosllavët. Në majën e kësaj piramide ishte vet Enver Hoxha por edhe të tjerë persona, Mehmet Shehu etj. Nëse do të pranonin gabimet me Jugosllavinë nuk ishte cudi që do të binte kredibiliteti i tyre në sytë e popullit shqiptar por edhe do të mund të zevendesoheshin me persona të tjerë që do të ecnin në të njëjtën linjë me udhëheqjen sovjetike të Hrushovit.

Ndër të tjera ka historianë që i gjejnë themelet e prishjes edhe tek çështja e Kosovës dhe qëndrimi i udhëheqjes jugosllave ndaj saj. Por po të shohim kujtimet e Hrushovit. edhe ai i mëshon marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë në funksion të çështjes së pazgjidhur të Kosovës.

Pas vizitës në 1959 në Shqipëri dhe pritjes shumë të ngrohtë, Hrushovi u shpreh një vit më vonë mjaft I zhgënjyer nga justifikimet që nxirrnin shqiptarët për prishje të marrëdhënieve. Gjate vizitësë tij në Shqipëri sigurisht nuk shkoi gjithçka vaj. Analizuesit e kohës kanë dalluar edhe ato mosmarrëveshjet që ekzistonin pavarësisht nga deklaratat që dukeshin sikur ishin në të njëjtën rezonancë. Por vetëm një vit më vonë në mbledhjen e Moskës në nëntor të 1960-ës Hrushovi thotë kur dëgjon shqiptarët. Ose unë jam budalla ose ju jeni shumë ë djallëzuar.....

Por viti 1961 ishte fundi i një ftohje të gjatë. Në nëntor të 1960 Enver Hoxha dhe njerëzit e tij morën pjesë në kongresin e 81 partive që u zhvillua në Moskë. Pozicionimi i izoluar i Shqipërisë pro Kinës kundër Bashkimit Sovjetik, paralajmeronte furtunë. Incidenti i radhës përkoi me mbledhjen e traktatit të Varshavës në Moskë po në nëntor 1960. Gjeneralët shqiptarë guxuan ti kthenin fjalën marrëshallit Grecko dhe të tjerëve. Mbledhja u prish dhe hendeku ishte hapur shumë i thellë.

Duke filluar nga gushti 1960, BS-ja ushtroi një presion shumë të madh ndaj udhëheqjes shqiptare, dhe presion nga brenda. Dokumentet perëndimore flasin për një lëvizje të brendshme për një grusht shteti nga brenda përmes personave që ishin të afërt me politikën e re sovjetike. Dhe burimet më të mëdha për këtë lloj informacioni vijnë më së shumti nga italianët dhe nga grekëtose nga amerikanët në Beograd etj. Përveç rrezikut të brendshëm për të cilin flasin shumë dokumente amerikane dhe britanike, një problem që është trajtuar gjerësisht nga ata por është pretenduar edhe nga udhëheqja shqiptare, është idea e një sulmi të mundshëm si shenjë hakmarrje për atë që ajo bëri, ndërmarrë nga BS-ja, e ndoshta edhe nga Jugosllavia. Këto dokumente lakojnë shumë këtë problem.

Duhet të kemi parasysh konjunkturën politike ndërkombëtare që sulmi ndaj Shqipërisë të duket i pamundur. Shqipëria për më tepër nuk ka patur lidhje territoriale as me BS-në dhe as me shtetet e tjera të traktatit të Varshavës. Të ndërmerrje një aksion kundër Shqipërisë do të krijonte një konflikt ndërkombëtar. Në kujtimet e tij Hrushovi shkruan se në Shqipëri zbatohet një sistem i tillë nëse dikush gabonte dhe këtë e konstatojnë Hoxha, Shehu dhe Balluku, atëherë të tre bashkë jepnin ndëshkimin. E tëra kjo i ngjante shumë mënyrës që zbatonte Stalini për zhdukjen e kundërshtarëve. Liderët shqiptarë, me metodat e tyre të ekzekutimeve të fshehta dhe të hapura, krijuan një parti e cila mbahej e bashkuar vetëm nga frika, shkruante lideri sovjetik. Bashkimi Sovjetik i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë në 3 dhjetor 1961 në një kohë kur retorika kishte arritur pikën maksimale të agresivitetit dhe egërsisë. Enver Hoxha nuk i kurseu fjalët kundër Hrushovit dhe grupit të tij. Ai e quajti udhëheqësin sovjetik puçist dhe me synime djallëzore kundër Shqipërisë. Në një dokument sekret që mban datën 26 korrik 1989, citohet pak a shume se në atë kohë në Moskë u mblodh një komision i sekretariatit të komitetit qëndror të Bashkimit Sovjetik me specialistë që janë marrë me Shqipërinë. Komisioni konkludoi se në vitet ,60 Bashkimi Sovjetik kishte vepruar gabim ndaj Shqipërisë dhe se për këtë i duhej kërkuar falje asaj. Pra sovjetikët i morën gjithë fajet mbi vete dhe vendosën që ti kërkojnë palës shqiptare normalizimin e marrëdhënieve. Bashkimi Sovjetik pranoi se ajo që ishte bërë kundër Shqipërisë ishte e dhimbshme dhe se për gabimet e bëra nuk do të heshte. Pala sovjetike shprehte gatishmërinë për ti bërë ato të njohura në të gjitha mjetet e informacionit duke kërkuar falje publikisht. Bashkimi Sovjetik nuk do të kishte asnjë pretendim ndaj Shqipërisë dhe ishte i gatshëm e i vendosur të mos vendoste ndonjë kusht ndaj vendit tonë pasi kishte detyrime internacionaliste ndaj saj. Por përgjigjja e qeverisë së Tiranës erdhi e ftohtë dhe mohuese. Për arsyet që dihen“ ne nuk kemi dhe as do të kemi marrëdhënie me Bashkimin Sovjetik“ thuhej në të.....

Një vit më vonë në korrik 1990 Shqipëria dhe Bashkimi Sovjetik rivendosën marrëdhëniet. Dhe arsyet që e detyruan Ramiz Alinë një vit më vonë të ndryshonte mendje dhe të dërgonte një delegacion me në krye këshilltarin e tij më të afërt Sofo Lazrin, për të negociuar në pranverën e 1990-ës në Sofie të Bullgarisë duket se kanë të bëjnë me faktin që udhëheqja shqiptare nuk donte të vendoste marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik para vendosjes së marrëdhënieve me SHBA-të apo

Britaninë madhe. Të armatosur me njëvalixhe plot me dokumenta me anë të të cilave do të justifikonin veten se Shqipëria nuk kishte asnjë faj përkundrejt Bashkimit Sovjetik, përkundrazi, shqiptarët hasën në dashamirësinë, tolerancën dhe një diplomaci tashmë moderne nga ana e sovjetikëve.

# RAPORTI I JURIDIKSIONIT MIDIS GJYKATAVE NACIONALLE DHE ATYRE NDËRKOMBËTARE

---

**ARTA MEHEMETI**

Phd Candidat

---

## ABSTRAKT

Juridiksioni i gjykatave ka të bëjë me kompetencën e gjykatave që të gjykojnë veprimet kriminale brenda territorit të vet shtetëror. Juridiksioni është pjesë e pandashme e sovranitetit shtetëror, i cili nënkupton supremacionin e organeve të shtetit në ushtrimin e pushtetit shtetëror, brenda kufijve të territorit shtetëror. Sa i përket juridiksionit të gjykatave brenda një territori shtetëror, nuk ka dilema, sepse nënkuptohet se pushteti i të gjitha organeve shtetërore, e me këtë edhe të organeve gjyqësore ushtrohet mbi njerëzit gjegjësisht popullin i cili jeton brenda kufijve të një shteti. Problemi lind kur na paraqiten raste tjera si psh. kur shtetasit e huaj kryejnë vepra penale në shtetin tonë, kur shtetasit tonë kryejnë vepra penale në shtetin tjetër, ose kur nga shtetasit e shtetit ose shtetasit e huaj kryhen vepra kundër sigurisë ose interesave të një shteti të caktuar. Gjithashtu, shumë e ndjeshme është çështja kur kryhen krime ndërkombëtare të cilat nuk parashkruhen, gjatë zhvillimit të konflikteve të armatosura brenda një territori të caktuar ose midis dy e më shumë shteteve. Zakonisht shtetet udhëheqësit e të cilave kryejnë krime të tilla nuk janë të gatshëm t'i nxjerrin para drejtësisë dhe t'i gjykojnë kriminelët e tillë. Si rezultat i një qëndrimi të tillë dhe nga ngritja e vetëdijes se krimet dhe kriminelët e tillë duhet të gjykohen, u themeluan tribunalet ad hoc si dhe Gjykata penale ndërkombëtare, të cilat janë kompetente për gjykimin e krimeve të tilla. Lidhur me çështjen e kompetencës për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, Statutet e tribunaleve ad hoc si dhe Statuti i Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, e rregullojnë në mënyra të ndryshme. Sipas marrëveshjes së Londrës me të cilën fuqitë fituese të LDB nënshkruan themelimin e një gjykate e cila do të ketë në kompetencë ekskluzive gjykimin e kriminelëve nazist të cilët kryen krime gjatë LDB-së, parashihej kompetenca ekskluzive e Tribunalit për krimet dhe kriminelët e caktuar. Edhe Tribunali i Tokios i themeluar dhe i mbështetur mbi të njëjtat parime si ato të Nurembergut, kishte kompetencë ekskluzive gjykimin e kriminelëve japonezë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përgjatë periudhës së LDB-së. Tribunalet ad hoc të mëvonshme gjegjësisht ai i Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë dhe ai i Ruandës për gjykimin e krimeve gjatë zhvillimit të luftës civile, në Statutet e tyre parashohin se për krimet e tilla kompetencë primare kanë Tribunalet në raport me gjykatat nacionale. Kurse në Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, parashihet se GJPN-ja ka rol komplementar, në raport me gjykatat nacionale, për gjykimin e krimeve ndërkombëtare të cilat parashihen me Statutin e Romës.

## Raporti i juridiksionit midis gjykatave nacionale dhe atyre ndërkombëtare

Sovraniteti i shteteve nënkupton pavarësinë e tyre që të veprojnë lirshëm si brenda ashtu edhe jashtë territorit të tyre, pa u kufizuar nga askush. Ky kuptim i sovranitetit absolut të shteteve është tejkaluar, dhe tani në teorinë e së drejtës në përgjithësi njihet parimi i sovranitetit të kufizuar të shteteve, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Parimi i kufizimit të sovranitetit shtetëror, ka zënë vend kryesisht si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve e rrethanave të cilat e arsyetojnë aplikimin e sovranitetit të tillë. Me miratimin e shumë konventave, marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe si dhe shumë rregullore të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, janë konsoliduar rregulla me të cilat rregullohet çështja e kufizimit të sovranitetit të shteteve, në raste të caktuara.

Shtetet si subjekte të së drejtës ndërkombëtare kanë të drejta dhe detyrime. Shtetet si subjekte juridike ndërveprojnë me shtetet tjera dhe participojnë aktivisht në qarkullimin juridik ndërkombëtar, gjatë të cilit qarkullim shtetet veprimet e tyre duhet t'i bazojnë në ndonjë normë, ligj ose rregullore e cila njihet dhe pranohet nga shumica e shteteve në të drejtën ndërkombëtare. Sepse në të kundërtën do të krijohet anarki dhe për pasojë do të mbijetonin vetëm më të fortit. Për atë arsye që të arrihet një farë mirëqenie juridike ndërkombëtare, shtetet duhet të heqin dorë nga ai sovranitet absolut i cili deri vonë ka qenë pengesë i shumë proceseve ndërkombëtare.

Në sferën e sovranitetit të brendshëm hyjnë puna e organeve legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive. Organet e tilla brenda një territori shtetëror janë të pavarura dhe punën e tyre e bazojnë në kushtetutë dhe ligjet e vendit, mirëpo kur organet e tilla në punën e tyre ndeshen me çështje të sferës ndërkombëtare, na paraqitet dilema se cilin legjislacion duhet aplikuar.

Konventat ndërkombëtare të cilat rregullojnë çështje nga sfera të ndryshme ndërkombëtare, në legjislacionet nacionale inkorporohen kryesisht nëpërmjet dy sistemeve. Njëra mënyrë është kur organi ligjdhënës i një vendi e ratifikon një konventë të caktuar ndërkombëtare dhe mënyra tjetër është kur pas dhënies së pëlqimit paraprak nga ana e organit ligjdhënës është presidenti i shtetit ai i cili jep bekimin përfundimtar. Cilado qoftë mënyrë e ratifikimit të konventave ndërkombëtare, ato bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm të shteteve në momentin e ratifikimit dhe të gjitha organet janë të obliguara t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas tyre.

Pjesë e pandashme e sovranitetit shtetëror është edhe juridiksioni i cili ka të bëjë me fuqinë e shtetit, që në bazë të së drejtës ndërkombëtare të rregullojë ose në mënyrë tjetër të ndikojë te njerëzit, pronën dhe rrethanat si dhe të reflektojë parimet themelore të sovranitetit shtetërorë, barazisë së shteteve dhe mospërzjerjes në punët shtetërore. (Shaw,2009,551)

Në lidhje me juridiksionin e shteteve që gjykatat nacionale kanë nën kompetencën e tyre për të gjykuar rastet e caktuara kriminale, edhe në të drejtën ndërkombëtare vlejnë po ato parime që vlejnë në të drejtën e brendshme e që kanë të bëjnë me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave.

Në teori përmenden disa parime të cilat duhet të respektohen me të cilat përcaktohet se cila gjykatë është kompetente në rastin e caktuar për të gjykuar, parime të cilat janë të vlefshme në shumicën e të drejtave nacionale e të cilat janë të aplikueshme edhe në të drejtën ndërkombëtare.

Ato parime janë:

- |   |   |
|---|---|
| 1. Parimi i territorialitetit                   | 2. Parimi real  |
| 1.1. Territori i shtetit                        | 2.1. Parimi i personalitetit aktiv                                |
| 1.2. Vendi i kryerjes së veprës penale          | 2.2. Parimi i personalitetit pasiv                                |
| 1.3. Parim i flamurit dhe parimi i regjistrimit | 2.3. Parimi universal   |
|   | 2.4. Parimi i juridiksionit përfaqësues<br>(Kambovski,1998,64-84) |

### Parimi i territorialitetit

Koncepti i juridiksionit kriminal historikisht është i bazuar në parimin e territorit shtetëror, parim i bazuar kryesisht në teorinë se krimi është i dëmshëm më së shumti në vendin e kryerjes. (Malekian,1991,10)

Baza territoriale për të aplikuar kompetencën gjyqësore e reflekton një aspekt të sovranitetit të aplikuar nga një shtet në hapësirën e saj territoriale, dhe se shteti i caktuar nëpërmjet miratimit të ligjeve dhe aplikimit të të njëjtave në tërë territorin e saj shtetëror, është manifestim logjik i rregullimit botërorë të shteteve të pavarura, sepse organet e shtetit janë përgjegjëse për mbajtjen e rendit dhe aplikimin e së drejtës brenda territorit të vet. (Shaw,2009,556)

### Territori shtetëror

Element qenësor për aplikimin e legjislacionit nacional këtu është vendi kryerjes së veprës penale, gjegjësisht territori shtetëror. Derfinimi i territorit shtetëror nuk është nocion juridiko-penal, edhepse disa legjislacione e definojnë në ligjet e tyre penale. (Kambovski,1998,65) Territori shtetëror është hapësira që gjendet nën sovranitetin e një shteti dhe mbi të cilin territor shteti e ushtron pushtetin e tij e njohur me termin supremacion territorial. (Gruda,2007,159-161)

Territorin shtetëror e përbëjnë sipërfaqja tokësore dhe ujore brenda kufijve shtetëror, toka dhe ujërat nën këtë sipërfaqe dhe hapësira ajrore mbi to.

Toka, uji dhe ajri përbëjnë pjesët e vërteta (reale) të një shteti. Gjithashtu edhe disa objekte trajtohen sikur të ishin pjesë të territorit shtetëror, megjithëse janë jashtë kufijve shtetëror. Këto janë pjesë fiktive të territorit shtetëror: pjesët “lundruese” gjegjësisht anijet dhe pjesët “fluturuese” gjegjësisht fluturaket e një shteti, si dhe pjesë të territorit të shtetit tjetër në të cilin janë të vendosura ambasadat e shtetit delegues. (Gruda,2007,159)

### **Vendi i kryerjes së veprës penale**

Kur një veprë kryhet në territorin e një shteti të caktuar, nuk ka dilemë se aplikohet e drejta e brendshme e atij shteti, pa marrë parasysh se kryesi a është shtetas i atij shteti apo shtetas i huaj. Mirëpo, problemi i përcaktimit se cili legjislacion do të aplikohet mund të paraqitet sidomos te të ashtuquajturat delikte distancionale. Për zgjidhjen e këtij problemi në teori janë paraqitur si zgjidhje të mundshme dy teori edhe atë teoria e ndërmarrjes së veprimit kriminal dhe teoria e shkatimit të pasojës nga veprimi kriminal. Mirëpo, secila nga këto dy teori i ka mangësitë e veta dhe nuk mund të japë zgjidhje të plotë gjatë përcaktimit se cili legjislacion duhet aplikuar. Prandaj në teori është paraqitur edhe teoria e ubikvitetit e cila në fakt paraqet simbiozë të dy teorive të para e sipas së cilës vepra penale konsiderohet si e kryer si në vendin e ndërmarrjes së veprimit ashtu edhe në vendin e shkatimit të pasojës. (Kambovski,1998,67-68)

### **Parimi i flamurit dhe parimi i regjistrimit**

Ky parim vlen për pjesët fiktive të territorit shtetëror gjegjësisht për anijet lundruese dhe fluturaket, të cilat mbajnë flamurin e një shteti ose janë të regjistruara në një shtet të caktuar. Këto i nënshtrohen legjislacionit të shtetit amë, dhe në bazë të një fiksioni juridik konsiderohen si territor lundrues ose fluturues i një shteti. (Gruda,2007,160)

### **Parimi real**

Parimi real ka të bëjë me të drejtën e shteteve për mbrojtje të nevojshme nga sulmet që vijnë nga shtetet tjera, të drejtuara kundër sigurisë dhe sistemit të pushtetit. Te ky parim kriterium për aplikimin e legjislacionit nacional është natyra e veprimit kriminal. E rëndësishme është se bëhet fjalë për veprim kriminal drejtuar sigurisë dhe interesave tjera të shtetit, pavarësisht nga cilësia e kryesit, gjegjësisht a është ai shtetas i shtetit ose shtetas i huaj. (Gruda,2007,74-75)

### **Parimi i personalitetit aktiv**

Parimi i personalitetit aktiv ka të bëjë me aplikimin e legjislacionit nacional ndaj shtetasve të vet, kur kryejnë veprime kriminale në territorin e shtetit tjetër. Ky parim është ngushtë i lidhur me nocionin e ekstradimit gjegjësisht me dëshirën e shteteve që gjykatat nacionale të gjykojnë shtetasit e vet edhe kur ata kryejnë veprime kriminale jashtë territorit shtetëror ose edhe me shprehjen e dëshirës së vet kryesit që të gjykohej në vendin e vet, gjë të cilën e arsyetojnë shumë rrethana praktike. (Huet&Koering-Joulin,Paris,230)

### **Parimi personalitetit pasiv**

Parimi i presonalitetit pasiv nënkupton mundësinë e shtetit për aplikimin e legjislacionit të vet, në rastet kur shtetasit e tij janë viktimat të veprimeve kriminale në territorin e shtetit tjetër. Ky parim është i lidhur me të drejtën e shteteve që të mbrojnë shtetasit e vet, në terriore të huaja. (Malekian,1991,14)

### **Parimi universal**

Parimi universal ka të bëjë me të drejtën e secilit shtet që të aplikojë kompetencën gjyqësore për procedurat jashtë territorit të saj, nëqoftëse procedurat e tilla kanë karakter të rrezikut universal për shtetin ose qytetarët e saj. (Marphy,2011,246) Parimi universal krijon të drejtën universale të shteteve që të sanksionojnë aktet të cilat janë të njohura si krime në të drejtën ndërkombëtare gjegjësisht si *delicta juris gentium*. (Malekian,1991,18)

### **Parimi i juridiksionit përfaqësues**

Parimi i juridiksionit përfaqësues që njëherit njihet edhe si parim plotësues nënkupton atë mënyrë të veprimit kur një shtet heq dorë nga pushteti i tij represiv, me qëllim që pushtetin e tillë në një rast të caktuar ta ushtrojë një shtet tjetër. Ky parim ka të bëjë me një kornizë të re juridiko-materiale të bashkëpunimit midis shteteve që në thelbin e saj ka të bëjë me transferimin e procedurës penale nga një shtet në shtetin tjetër, e praktikuar në rastet e kryerjes së veprës penale në territorin e shtetit nga shtetas i huaj, dhe me kusht reciprociteti. (Kambovski,1998.83)

Parimet e aplikuara më lartë janë parime me ndihmën e të cilave përcaktohet juridiksioni dhe kompetenca e gjykatave nacionale. Në të drejtën ndërkombëtare penale nuk ka të përcaktuara parime fikse të përmbajtura në ndonjë konventë ose rregullore me karakter ndërkombëtar, të cilat do të ishin të obligueshme për t'u respektuar nga shtetet, por për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, kur ato procedohen nga tribunalet ndërkombëtare ad hoc ose nga GJPN-ja, zakonisht janë Statutet e tyre të cilat e kanë të precizuar këtë kompetencë, kurse në rastet kur gjykatat nacionale gjykojnë krimet e tilla, udhëhiqen nga parimet e tilla të vlefshme në të drejtat nacionale.

## Juridiksioni primar dhe plotësues

Me themelimin e tribunaleve penale ndërkombëtare si dhe me krijimin e Gjykatës penale ndërkombëtare, u paraqit problemi i përcaktimit të kompetencës se cilat gjykata kanë prioritet në ndërmarrjen e veprimeve për gjykimin e krimeve ndërkombëtare, gjykatat nacionale apo ato ndërkombëtare. (Cassese,2003.336). Tribunali i Nurembergut i cili njëherit ishte edhe i pari i llojit të tillë për gjykimin e krimeve ndërkombëtare të kryera gjatë LDB, i cili i krijuar nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare të shteteve aleate që dolën fitimtare të LDB, me të cilën parashihej krijimi i një gjykate që do të ishte kompetente të gjykojë kategori të caktuar të krimeve të kryera nga një kategori e caktuar personash gjegjësisht krimet e kryera nga nazistët gjatë LDB.

Edhe Tribunali i Tokios i krijuar mbi parimet e njejta si ato të Nurembergut, u krijua për gjykimin e kriminelëve japonezë të cilët kryen krime ndaj popullsisë koreane juglindore. Të dy Tribunalet kishin kompetencë primare në gjykimin e krimeve për të cilat ishin krijuar, gjë e deterrminuar edhe nga arsye logjike, sepse në kohën e krijimit të këtyre Tribunaleve, gjykatat nacionale të vendeve ku ishin kryer krimet nuk mund të ishin objektive në gjykim duke pasur parasysh rrethanat që mbizotëronin në kohën e krijimit të këtyre Tribunaleve, si dhe gjykatat nacionale as që kishin vullnetin për të bërë një gjë të tillë.

Tribunali i Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, si dhe Tribunali i Ruandës në Statutet e tyre parashohin se këto Tribunale kanë prioritet në raport me gjykatat nacionale, por nuk e kufizojnë të drejtën e gjykatave nacionale që të ndjekin personat përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. (Cassese,2003,339)

Me Statutin e Romës për Gjykatën penale ndërkombëtare, rregullohet çështja e juridiksionit sipas të cilit Gjykata Penale Ndërkombëtare në raport me gjykatat nacionale, ka raport komplementar.

Në nenin 1 të Statutit të Romës thuhet se Gjykata Penale Ndërkombëtare është institucion i përhershëm dhe ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare, sipas parashikimit në këtë Statut, dhe është plotësim i juridiksioneve penale kombëtare.<sup>1</sup>

Sa i përket çështjes së përcaktimit të juridiksionit si primar ose plotësues, kemi dallim midis juridiksionit të tribunaleve dhe Gjykatës penale ndërkombëtare.

Në rastin e Tribunalit të Hagës për gjykimin e krimeve të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, arsyet për përcaktimin e juridiksionit të Tribunalit si primar në raport me gjykatat nacionale, kanë qenë të determinuara kryesisht nga rrethanat politike. Konfliktet e armatosura midis shteteve të sapokrijuara si dhe armiqësitë e rrënjësura thellë midis grupeve të ndryshme etnike dhe religjioze kontribuuan që të gjykatat nacionale të mungojë vullneti dhe aftësia që të zhvillojë gjykime fer dhe të paanshme. (Cassese, 2003, 339). Në krahasim me tribunalet, të Gjykata penale ndërkombëtare situata është ndryshe. Me Statutin e Romës parashihet se Gjykata penale ndërkombëtare në raport me gjykatat nacionale ka juridiksion plotësues, çka nënkupton se Gjykata penale ndërkombëtare ka kompetencë të veprjë vetëm në rastet kur për arsye të caktuara, të cilat numërohen në nenet 15, 17, 18 dhe 19 të Statutit të Romës<sup>2</sup>, gjykatat nacionale nuk janë në gjendje të ushtrojnë juridiksionin mbi personat të cilët kryejnë krime që sipas Statutit të Romës janë në kompetencë të Gjykatës penale ndërkombëtare.

## Literatura

- International criminal law, Antonio Cassese, Oxford University Press, 2003, Translation on macedonian  
 International Criminal Law, The Legal and Critical Analysis of International Crimes, Volume I, Fehard Malekian, Borgstroms Tryckeri AB, Motala, Upsala, 1991  
 Principles of International law, Sean D. Murphy, George Washington University, 2006 Thomson/West 610 Opperman Drive, P.O. Box 64526 St.Paul, Translation on Macedonian, Ars Lamina, 2011  
 Vlado Kambovski , E drejta penale ndërkombëtare, Prosvetno delo, Shkup, 1998  
 Zejnullah Gruda - E drejta nderkombetare publike. Prishtine 2007  
 Droit penal international, Andre Huet, Renee Koering-Joulin, Depot legal-1 edition:1994 3 edition mise a jour 2005, Septembre, Presses Universitaires de France, 1994 6, avenue Reille, 75014 Paris  
 International Law. M.N. Show. Cambridge university Press 2008 Translation an Macedonian Prosvetno dello 2009

### Dokument ligjor:

Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare

### Faqet e internetit:

<http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>

<sup>1</sup> <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>, neni 1

<sup>2</sup> <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp>,





**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Universiteti European i Tiranës

Albania as a case study: economy, politics, social development,  
and future perspective: ASD III: international scientific conference:  
April 29-30, 2016: Ligji midis efencës dhe drejtësisë: proceedings/  
Universiteti European i Tiranës. – Tiranë: UET Press, 2016.

108 f.: me foto; 21 x 29.7 cm. - (Acta Scientiarum; 15)

Bibliogr.

ISBN 978-9928-190-97-0

1.Shkenca shoqërore 2. E drejta 3. Konferenca

3(496.5) (062)



